

VENDIM
Nr. 532, datë 1.8.2024

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË PARKUT ARKEOLOGJIK
BYLIS, QYTETET ANTIKE TË BYLISIT DHE KLOSIT, 2024–2029

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 47, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Miratimin e planit të menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis, qytetet antike të Bylisit dhe Klosit, 2024–2029, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë, Bashkia Mallakastër, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



PLANI I MENAXHIMIT

TË PARKUT ARKEOLOGJIK BYLIS

(Qytetet antike të Bylisit dhe Klosit - 2024-2029)



Financuar nga Bashkimi Evropian

Përgatitur për:

Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Shqipëri

Financuar nga:

Bashkimi Evropian - Në kuadër të projektit të IPA 2018 *“BE për Zhvillimin Ekonomik - Drejtuar nga Turizmi, Zhvillimi Ekonomik Vendor, me Fokus mbi Trashëgiminë Kulturore”*

Zbatuar nga: **Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS), Tirana**

AICS Tirana dëshiron të falënderojë të gjithë ata që janë përfshirë në këtë projekt. Veçanërisht shprehim mirënjohjen tonë për mbështetjen personal të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit z. Blendi Gonxhja, ish Ministres së Kulturës, arkitektes Elva Margariti, si dhe për kontributin e vyer të gjithë stafit të Ministrisë së Kulturës. Gjithashtu, dëshirojmë të shprehim falënderime të veçanta ndaj Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Institutit të Arkeologjisë (IA) për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre të vazhdueshme në këtë projekt. Një falënderim të veçantë i drejtohet Bashkisë së Mallakastrës për ndarjen e të dhënave dhe mikpritjen e tyre të ngrohtë, duke kontribuar kështu në suksesin e këtij projekti. Falënderojmë, gjithashtu, drejtoreshën e Parkut Apolloni-Bylis dhe personelin lokal për përkushtimin dhe ndihmesën e tyre të çmuar në këtë projekt.

me ndihmesën teknike nga:

- Universiteti i Bolonjës,
- Rajoni Emilia-Romagna,
- Instituti i Arkeologjisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë,
- Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Po ashtu, falënderojmë ekspertët lokalë, përfshirë arkeologë, arkitektë, dhe të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre në këtë projekt të rëndësishëm.

Team leader i projektit: Ilir Parangoni PhD.

Autorë të tekstit:

Prof. Ass. Mariangela Vandini, Prof. Neritan Ceka, Prof. Skënder Mucaj, Prof. Luan Përzhita, Prof. Loreta Çapeli, Prof. Ass. Luca Cipriani, Prof. Ass. Alessandro Iannucci, Prof. Ass. Giuseppe Lepore, Prof. Ass. Matteo Zaccarini, Dr. Oligita Ceka, Dr. Simone Zambruno, Dr. Sara Fiorentino, Dr. Suela Xhyheri, Dr. Gianna Bertacchi, Dr. Tania Chinni, Michele Colavito, Lorenza Ghini, Anna Lucia Corfiati, Gani Pashaj, Blenard Kerri.

Lista me shkurtesa dhe akronime

AICS	Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim
AKT	Agjencia Kombëtare e Turizmit
DPUR	Departamenti i Planifikimit Urban dhe Rural
KONSULENTËT	Ekspertë Lokale, Arkeologë, Juristë, Arkitektë
KKMPK	Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore
KKTKM	Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
IA	Instituti i Arkeologjisë
ICCROM	Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Preservimit dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore.
ICOMOS	Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet
IKTK	Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MF	Ministria e Financës
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PM	Plani i Menaxhimit
PMR	Plani i Menaxhimit të Riskut
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
SKK	Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 - 2020
ToR	Termet e Referencës
UNESCO	Organizata për Edukimi, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
UNWTO	Organizata Botërore e Turizmit e Kombeve të Bashkuara
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
WHC	Qendra e Trashëgimisë Botërore
WHP	Pasuria e Trashëgimisë Botërore

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 - Pamje ajrore e Bylisit (UNIBO)

Figura 2 - PLANIMETRIA E QYTETIT ANTIK TË BYLISIT GJATË SHEK. IV-I P. KR., SIPAS N. CEKA, P. NAIPI, O. CEKA

Figura 3 - Agoraja e Bylisit me monumentet kryesorë: 1. Propilea; 2. Prytaneioni; 3. Arsenali; 4. Stoa A 5. Stadiumi; 6. Cisterna; 7. Teatri; 8. Katagogion; 9. Stadiumi; 10. Stoa B; 11. Termet; 12. Gimnazi; 13-14. Tempulli

Figura 4 - Bylis. Propiletë, Prytaneioni dhe Arsenali. Foto O. Ceka

Figura 5 - Stadiumi dhe cisterna e Bylisit. Foto O. Ceka

Figura 6 - Cisterna e stadiumit të Bylisit. Rikonstruksion virtual nga O. Ceka

Figura 7 - Teatri i Bylisit. Foto O. Ceka

Figura 8 - Pamje dhe rikonstruksion virtual i parodosit verior. Foto N. Ceka. Rikonstr. N.Ceka-S. Çela

Figura 9 - Stoa A e Bylisit. Pamje e krahut lindor. Foto N. Ceka

Figura 10 - Rikonstruksion virtual i stoas A të Bylisit. N. Ceka-K. Hodaj

Figura 11 - Muri perëndimor i gimnazit. Foto N. Ceka

Figura 12 - Plani urbanistik i Bylisit në shek. III p. Kr. sipas N. Ceka, O. Ceka.

Figura 13 - Banesa A e Bylisit. Foto O. Ceka

Figura 14 - Banesa B e Bylisit në raport me rrugët kryesore në shek. III p. Kr. Skicë nga O.Ceka

Figura 15 - Banesa e Terencianëve me altarët. Foto N. Ceka

Figura 16 - Mbishkrimi i Marcus Lollianus në shkëmbinjtë e anës jugore të Bylisit. Foto N.Ceka

Figura 17 - Bylis. Muri i Viktorinit. Periudha e perandorit Justinian (527-565). Foto S. Muçaj

Figura 18 - Mbishkrimi për ndërtimin e murit rrethues të Bylisit nga Viktorini

Figura 19 - Bylis. Termet bizantine pranë cisternës. Foto N. Ceka

Figura 20 - Bazilika B e Bylisit-Katedralja. Foto N. Ceka

Figura 21 - Katedralja dhe kompleksi peshkopal i Bylisit. Planimetria sipas S. Muçaj.

Figura 22 - Bylis, Bazilika B. Vëllezërit Simon dhe Andrea në peshkim në liqenin e Galilese

Figura 23 - Bazilika A, pamja dhe planimetria. Foto A. Islami, skica S. Muçaj

Figura 24 - Bylis. Bazilika C. Foto N. Ceka

Figura 25 - Bazilika C e Bylisit. Skicë planimetrike nga S. Muçaj

Figura 26 - Bylis. Bazilika D. Planimetria sipas S. Muçaj

Figura 27 - Bazilika E. Pamje nga ajri. Foto A. Përzhita

Figura 28 - Ballsh. Pamje e bazilikës paleokristiane gjatë gërmimeve arkeologjike (1983). Arkivi i IA.

Figura 29 - Kodra ku gjendet qyteti antik i Klosit. Foto N. Ceka

Figura 30 - Klos. Muri rrethues i shek. V p. Kr. Foto N. Ceka

Figura 31 - Klos. Teatri i qytetit antik. Foto N. Ceka

Figura 32 - Klos. Banesa e shek. III p. Kr. Foto N. Ceka

Figura 33 - Bylis, foto ajrore

Figura 34 – harta e bylisit

Figura 35 – koordinatat e parkut arkeologjik bylis

Figura 36 – harta e zonifikimit të qytetit antik të bylisit

Figura 37 – Planimetria e bylisit me disa nga monumentet ku do të ndërhyjet

Figura 38 – planimetri e bazilikës b

Figura 39 – tribeloni i baptisterit, bazilika b

Figura 40 – piedestali verior, bazilika b

Figura 41 – bazilika b

Figura 42 – bazilika c, planimetri

Figura 43 – tribeloni i nefit qendror, bazilika c

Figura 44 – bazilika b dhe zona peshkopale

Figura 45 – planimetria e mureve dhe monumenteve në bylis

Figura 46 – stera e madhe, foto dhe skicë

Figura 47 – planimetri dhe profil i murreve rrethuese, bylis

Figura 48 - Koinoni i Bylinëve në raport me koinonet e shek. III p. Kr. Hartë nga O. Ceka.

Figura 49 - Rikonstrukcion virtual i Portës nr. 5 të qytetit. N. Ceka- S. Çela

Figura 50 - Sistemi urbanistik i Bylisit me zonat kryesore. Planimetri nga N. Ceka, O. Ceka, P. Naipi.

Figura 51 - Agoraja e Bylisit në shek. III p. Kr. Planimetri nga N. Ceka. O. Ceka, P. Naipi.

Figura 52 - Teatri i Bylisit. Rikonstrukcion virtual nga O. Ceka.

Figura 53 - Stoa A e Bylisit. Rikonstrukcion virtual i krahut lindor të monumentit nga N. Ceka-S.Çela

Figura 54 - Bylis. Propiletë e Agorasë. Rikonstrukcion virtual përgatitor nga O. Ceka

Figura 55 - Pjesë e ruajtur e Murit të Viktorinit. Foto S. Muçaj

Figura 56 - Bariu i mirë. Mozaik nga ekzonarteksi i Bazilikës B. Foto N. Ceka

Figura 57 - Bazilika D. Pamje nga ajri. Foto A. Përzhita

Figura 58 - Bylis. Komiku mbi altar; Amazona; Portret i perandorit Hadrian

Figura 59 - Organizimi hapësinor në qytetin ilir të Klosit në shek. III p. Kr. Skicë nga N. Ceka

Figura 60 - Klos. Rikonstrukcion ideal i teatrit sipas L. Papajani

Figura 61 - *Barometri Botëror i Turizmit i UNWTO, një gjurmues i rregullt i tendencave afatshkurtra të turizmit që ofron njohuri të përditësuara mbi turizmin ndërkombëtar, e ka pozicionuar Shqipërinë në vendin e tretë globalisht për periudhën nga janari deri në korrik 2023.*

Figura 62 – Projektimi i rritjes së turizmit në Shqipëri 2015-2023

Figura 63 – Numri i vizitorëve në PAB, 2015-2023, burimi Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Figura 64 - Variantet e vendosjes së Muzeut Arkeologjik në Bylis

Figura 65 - Varianti i parë i vendosjes së Muzeut Arkeologjik në hapësirën poshtë potës nr. 6. Foto N. Ceka

Figura 66 - Shembuj kur ndërtesa e Muzeut kthehet në një “shenjë arkitektonike”. Mountain Museum, Sudtiroli dhe Museo di Oetzi në Bolzano, Itali

Figura 67 - Hapësira e propozuar në variantin II për vendosjen e Muzeut Arkeologjik

Figura 68 - Model ekspozimi në projektin e Muzeut dhe Institutit të Arkeologjisë, Tiranë-1

Figura 69 - MODELI I PARAQITJES SË MATERIALIT ARKEOLOGJIK PËR PERIUDHËN PREHISTORIKE. MUZEU I INSTITUTIT ARKEOLOGJIK TIRANË-2

Figura 70 - Pamje ajrore e kompleksit monumental të shek. III p. Kr. me Stoa A , Propiletë dhe Cisternën e stadiumit. Foto A. Përzhitia

Figura 71 - Model i përgatitjes së sallës muzeale mbi bazën e programit tematik. Salla e skulpturave

Figura 72 - Mbishkrimi i Marcus Lollianus si dëshmi e ndërtimit të rrugës nga Bylisi nëpër Astacia

Figura 73 - Bazilika e Ballshit. Gjendja aktuale. Foto L. Përzhitia

Figura 74 - Pamje ajrore e Parkut Arkeologjik të Bylisit me monumente kryesore që do të vizitohen dhe tre vendosje të ndryshme të Muzeut Arkeologjik. Foto A. Islami, përpunuar nga O. Ceka

Figura 75 - Skemë e Itinerarit të parë dhe lëvizja brenda tij. Përpunoi S. Xhyheri (skica) dhe O. Ceka (foto)

Figura 76 - Skicë e Itinerarit të dytë. Përpunoi S. Xhyheri

Figura 77 - Skicë e Itinerarit të tretë. Përpunoi S. Xhyheri

Figura 78 - Shtegu i kalimit për të mbishkrimi i Marcus Lollianus. Foto O. Ceka

Figura 79 - Itinerari hiking Bylis-Klos

Figura 80 - Qendra e fshatit të sotëm të Klosit. Foto S. Xhyheri

Figura 81 - Shtëpia e familjes Klosi, monument kulture i kategorisë së parë

Figura 82 - Gardhet të vendosura në parcelizimin e territorit brenda qytetit antik Klos (foto S. Mucaj)

Figura 83 - Tabelë shpjeguese për personat që nuk shohin në Parkun Arkeologjik të Egnazias, Bari .

Figura 84 - Rikonstrukcion ideal me perspektivën e leximit të stoas B dhe agorasë në Apolloni.

Figura 85 BASILIKË NË SIPONTUM, <https://www.edoardotresoldi.com/works/basilica-di-siponto/>

Figura 86 – Crypta balbi, rome (<https://www.cosavederearoma.com/crypta-balbi/>)

Figura 87 Parku arkeologjik i Egnazias www.bari.repubblica.it

Figura 88 Bazilika në Sipontum <https://www.edoardotresoldi.com/works/basilica-di-siponto/>

Figura 89 - Banesë e Antikitetit të Vonë në Efes (www.doyouknowturkey.com/3d-animation-of-ephesus-the-ancient-city-in-turkey/)

Figura 90 - Tregtimi i prodhimeve artizanale në Parkun Arkeologjik Butrint (foto rrjeti)

Figura 91 - Skema organizative e parkut arkeologjik Bylis-Klos

Figura 92 - Ekipi i gërmimeve të teatrit të Bylisit në vitin 1978. Në qendër, ulur majtas: L.Papajani, N. Ceka. Më këmbë, i pari djathtas: S. Mucaj.

Figura 93 - Gërmimet arkeologjike në Bazilikën A në vitin 1981

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 VIZIONI I PLANIT TË MENAXHIMIT

1.2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

1.3 AKTIVITETET

1.4 PËRMBAJTJA DHE STRUKTURA

2. HYRJE

2.1 NEVOJA PËR NJË PLAN MENAXHIMI

2.2 METODOLOGJIA E PËRGATITJES SË PLANIT TË MENAXHIMIT

2.3 KONSULTIMET ME GRUPET E INTERESIT

2.4 PRAKTIKAT E MIRA

2.5 MODELET E REFERUAR

2.6 ANALIZA E LEGJISLACIONIT NË FUQI

3. PËRSHKRIMI I PASURISË KULTURORE

3.1 KOMPLEKSET MONUMENTALE NË BYLIS DHE RRËNOJAT E KLOSIT

3.1.1 MONUMENTET E PERIUdhËS ANTIKE KLASIKE TË BYLISIT

3.1.2 MONUMENTET E PERIUdhËS SË ANTIKITETIT TË VONË TË BYLISIT

3.1.3 MONUMENTET E PERIUdhËS ANTIKE KLASIKE TË KLOSIT/NIKAIA

3.2 VLERAT AUTENTICITETI, INTEGRITETI, RËNDËSIA

3.3 KUFIJTË , KORDINATAT GJEOGRAFIKE

4.ASPEKTE TË TJERA TË LIDHURA ME PASURINË

4.1 VLERAT DHE MASAT RUAJTËSE DHE MBROJTËSE NË FUNKSION TË TYRE

4.1.1 RËNDËSIA HISTORIKE DHE KULTURORE

4.1.2 RËNDËSIA ARKEOLOGJIKE

4.1.3 VLERA EDUKATIVE

4.1.4 POTENCIALI TURISTIK

4.1.5 KONSERVIMI DHE RUAJTJA

4.1.6 ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

4.1.7 RËNDËSIA MJEDISORE

4.2 MASAT RUAJTËSE DHE MBROJTËSE NË FUNKSION TË VLERAVE

4.2.1 RUAJTJA E STRUKTURAVE DHE OBJEKTEVE ARKEOLOGJIKE

4.2.2 MENAXHIMI I NDIKIMIT TË VIZITORËVE

4.2.3 SIGURIA DHE MBIKËQYRJA

4.2.4 STUDIME DHE HULUMTIME TË VAZHDUESHME

4.2.5 EDUKIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I KOMUNITETIT

4.2.6 BASHKËPUNIMI ME EKSPERTË DHE INSTITUCIONE

4.2.7 RUAJTJA E MJEDISIT NATYROR

4.2.8 AKTIVITETET DHE ÇËSHTJET E TJERA BRENDA PARKUT ARKEOLOGJIK TË BYLISIT DHE RRËNOJAVE ARKEOLOGJIKE TË KLOSIT

4.3 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I QYTETËRIMIT TË BYLIN

4.3.1 VLERËSIMI I KOMPLEKSEVE ARKITEKTONIKE TË BYLISIT

4.3.2 VLERËSIMI I KOMPLEKSEVE ARKITEKTONIKE TË ANTIKITETIT TË VONË

4.3.3 VLERËSIMI I ARTEFAKTEVE ARKEOLOGJIKE

4.3.4 VLERËSIMI I ASETAVE ARKITEKTONIKE TË KLOSIT

5. ZHVILLIMI I KOMUNITETIT DHE TURIZMI

5.1 PLANI I ANGAZHIMIT TË KOMUNITETIT ME FOKUS ZHVILLIMIN E TURZIMIT KULTUROR

5.1.1 PLANI PARAPRAK I ANGAZHIMIT TË KOMUNITETIT

5.1.2 PLANI PARAPRAK I ZHVILLIMIT TË TURIZIMIT .

5.2 NDIKIMI I COVID-19 NË TURIZMIN NDËRKOMBËTAR DHE RITJIA IMPRESIONUESE E TURIZMIT NË SHQIPËRI

5.3 INVESTIMET NË MBËSHTËTJE TË TURIZMIT KULTUROR PËRRETH BYLISIT

5.4 INVESTIMET NË INFRASTRUKTURËN TURISTIKE - IPA 2018

5.4.1 INFRASTRUKTURA CIVILE

5.4.2 PLANI I MUZEUT TË HAPUR

5.4.3 PANELET INFORMATIVE

5.4.4 ANEKSET E MUZEUT TË HAPUR

5.4.5 ZHVILLIMI DHE KËRKESA E TURIZMIT

6. VIZIONI

6.1 VIZIONI DHE ARDHMJA

6.2 RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I PASURISË NË AFAT TË GJATË

7.ADMINISTRIMI

7.1 ZHVILLIMI I STRUKTURËS SË MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË

7.1.1 ADMINISTRIMI I AKTUAL I P.A.B DHE RRËNOJAVE TË KLOSIT

7.1.2 ANALIZA SWOT

7.1.3 ASPEKTE TË TJERA QË LIDHEN ME SFIDAT E ADMINISTRIMIT

7.2 PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E ADMINISTRIMIT

7.2.1 ANALIZA E MODELIT

7.2.2 ANALIZA E MODELIT TË ADMINISTRIMIT

7.3 STRATEGJIA E ADMINISTRIMIT TË PARKUT

7.4 MBROJTJA E PASURISË KULTURORE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

7.4.1 PLANI I MENAXHIMIT TË RISKUT

7.4.2 MBROJTJA DHE MASAT NGA FATKEQËSITË NATYRORE

7.4.3 MBROJTJA E PASURISË KULTURORE NGA FATKEQËSI TË TJERA

8.PLANI I VEPRIMIT

9.ZBATIMI DHE MONITORIMI

9.1 KOORDINIMI DHE MENAXHIMI NDËRINSTITUCIONAL

9.2 STRATEGJIA E ZBATIMIT

9.3 MONITORIMI DHE VLERËSIMI, MASAT DHE INDIKATORËT

10.SHTOJCAT

SHTOJCA 1 - KËRKIMET ARKEOLOGJIKE DHE HISTORIA E BYLINËVE

SHTOJCA 2 - PLANI I KONSERVIMIT TË QYTETEVE ANTIKE TË BYLISIT DHE KLOSIT

SHTOJCA 3 - INICIATIVA TË TJERA

SHTOJCA 4 - SONDAZHI PYETËSORË / ANKETIM

SHTOJCA 5 - SKEDAT E PARKUT BYLIS DHE KLOS

SHTOJCA 6 - BIBLIOGRAFIA DHE IMAZHE NGA BYLIS DHE KLOSI

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PËRMBLEDHJE, VIZIONI, QËLLIMI, OBJEKTIVAT, PËRMBAJTJA, PROPOZIMET DHE AKTIVITETET KRYESORE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PERIUdhËN KOHORE TË VLEFSHMËRISË SË PLANIT

Parku arkeologjik i Bylisit gjendet në zonën e Mallakastrës, rreth 1.5 km larg fshatit të Hekalit dhe rreth 8 km larg qytetit të Ballshit. Kodra mbi të cilën ngrihet qyteti antik ka një dominim mbi luginën e Lumit Vjosë dhe zonën kondrinore përreth. Më në jug, afërsisht 5 km nga parku arkeologjik i Bylisit, gjendet fshati Klos (qyteti antik i Nikaias). Rrënojat e parkut arkeologjik të Bylisit, së bashku me ato të Klosit, na paraqiten sot si përfaqësuesit më tipikë të qytetërimit ilir në shekullin V-I p. Kr., dhe gjithashtu si një pol i ri për zhvillimin e turizmit kulturor me potencialin për të pasuar ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm të krahinës së Mallakastrës.

Plani i Menaxhimit (PM) është përgatitur nga AICS falë financimit të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit të IPA 2018 - “BE për Zhvillimin Ekonomik drejtuar nga turizmi, zhvillimi ekonomik dhe vendor me fokus mbi Trashëgiminë Kulturore”.



FIGURA 1 - PAMJE AJRORE E BYLISIT (UNIBO)

PM-ja është i organizuar në nëntë pjesë kryesore me nënseksione të përcaktuara sipas VKM 169, dt. 20.02.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”, dhe kapitulli i fundit shtojcat përkatëse. PM trajton kryesisht objektivat afatshkurtër 2024-2026, afatmesëm të periudhës 2027-2029 dhe afatëgjatë përtej vitit 2030¹. Trajtimi i këtyre objektivave shërben për të garantuar efektshmërinë e investimeve, si dhe vazhdimësinë e realizimit të objektivave të përcaktuara në dokumentin themelor “Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025” (SKK). Për këtë arsye, kjo pjesë është strukturuar së pari me vizionin, qëllimet dhe objektivat specifike.

Vizioni dhe qëllimi i planit të menaxhimit janë hartuar si vazhdimësi e punës shkencore dhe gërmimeve arkeologjike shumëvjeçare të realizuara nga Instituti i Arkeologjisë (IA) si dhe të punimeve konservuese e restauruese të kryera nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe institucioneve të tjera nën Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI).

1.1 VIZIONI I PLANIT TË MENAXHIMIT

Vizioni i planit të menaxhimit, i cili do të mundësonte ndikimin pozitiv të këtij potenciali, është formuluar si më poshtë:

Ruajtja dhe kultivimi i vlerave të pasura të qyteteve antike të Bylisit dhe Klosit do të kontribuojnë në formimin e një modeli frymëzues për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, edukimin përmes kulturës, dhe rritjen e ofertës turistike, duke garantuar njëkohësisht që kjo trashëgimi kulturore të mbetet një burim i identitetit kombëtar për brezat e ardhshëm.

Ky vizion do të zhvillohet në dy faza kryesore që janë:

- a. *Propozimi i ndërhyrjeve konservuese, restauruese dhe infrastrukturore, mbi bazën e kriterëve të mbështetura në VKM nr. 1099, datë 24.12.2020, sipas Legjislacionit në fuqi.*
- b. *Zbatimi i projekteve dhe organizimi i administrimit bashkëkohor të Parkut Arkeologjik Bylis, në realizim të objektivave të ndikimit të tij në zhvillimin e turizmit kulturor dhe rritjes së të ardhurave nga veprimtaritë në të.*

¹ Brenda periudhës (2024 – 2028), përfshihet investimi i grantit të Bashkimit Europian, IPA 2018.

1.2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Plani i Menaxhimit (PM) është propozuar për sot dhe për të ardhmen. Qëllimi i PM është *“Të rrisë dhe ruajë përdorshmërinë dhe atraksionin e aseteve të trashëgimisë kulturore në qytetet antike të Bylisit dhe Klosit”*. Mbrojtja, ruajtja dhe vlerësimi publik i vlerave historike dhe arkeologjike dhe kujtesa kulturore e qytetit antik të Bylisit, është konsideruar në kuadër të zhvillimit të një infrastrukture parku modern dhe të aksesueshëm, me qëllim promovimin dhe rëndësine kulturore të sitit përmes një rrëfimi historik tërheqës dhe emocional, nxitjes së zhvillimit të turizmit kulturor dhe inkurajimit të rritjes së qëndrueshme të zonës. Qëllimi merr në konsideratë qëllimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për të mbështetur vizionin i cili do të realizohet përmes këtyre objektivave:

Objektivat afatshkurtër (2024-2026):

1. Ruajtja, konservimi dhe restaurimi i pasurisë kulturore dhe arkitekturore të Bylisit dhe Klosit;
2. Përmirësimi i aksesueshmërisë dhe rritja e qëndrueshmërisë së: trashëgimisë kulturore të Bylisit dhe rrënojave arkeologjike të Klosit, aseteve natyrore, aseteve turistike dhe evente të tjera me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e komunitetit lokal;
3. Nxitja e zhvillimit ekonomik lokal përmes adoptimit të qasjes së zhvillimit lokal drejtuar nga komuniteti, përmirësimin e eksperiencave dhe kapaciteteve, dhe një rritje të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve lokale dhe administratës së parkut.

Objektivat afatmesëm (2027-2029):

1. Propozimi i një modeli të qëndrueshëm dhe efektiv për menaxhimin e Parkut Arkeologjik të Bylisit (PAB) dhe rrënojave arkeologjike të Klosit;
2. Hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe udhëzimeve për menaxhimin e PAB dhe rrënojave arkeologjike të Klosit, bazuar në praktikatat më të mira në këtë fushë;
3. Menaxhimi efektiv i burimeve financiare dhe përdorimi i tyre për qëllime studimore të tilla si gërmime apo vrojtme arkeologjike në Bylis dhe Klos;
4. Përcaktimi i një strukture administrative funksionale, me staf të kualifikuar për menaxhimin e siteve.

Objektivat afatgjatë (2030+):

Administrimi i Parkut Arkeologjik të Bylisit dhe rrënojave arkeologjike të Klosit si atraksione të madha turistike në Shqipëri, shndërrimi i tyre në qendra të rëndësishme të arsimimit dhe kërkimit shkencor të kulturës materiale ilire, pjesë integrale e

trashëgimisë kulturore evropiane, dhe përdorimi i këtyre dy pasurive kulturore si model menaxhimi bashkëkohor i parqeve arkeologjike shqiptare, bazuar në kapacitetet profesionale. Në përputhje me këto politika udhëzuese, propozohen rekomandimet e mëposhtme për objektivin afatgjatë të menaxhimit:

- Ndalimi i degradimit dhe përkeqësimit të mëtejshëm të ekosistemeve nga veprimtaritë e parregulluara dhe të pakontrolluara të njeriut brenda dhe rreth PAB dhe rrënojave arkeologjike të Klosit.
- Garantimi i konservimit brenda PAB dhe rrënojave arkeologjike të Klosit me interes të veçantë, nga pikëpamja e konservimit.
- Përmirësimi i interpretimit dhe prezantimit të aseteve natyrore dhe kulturore të parkut PAB dhe rrënojat arkeologjike të Klosit për kënaqësinë e vizitorëve.
- Promovimi dhe praktikimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.
- Promovimi i turizmit miqësor ndaj mjedisit, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës së ndjeshme për të nxitur angazhimin në veprimtari brenda PAB dhe rrënojave të Klosit që respektojnë asetet natyrore.
- Ndërgjegjësimi i publikut, rritja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe përfitimet nga mbrojtja, përdorimi dhe menaxhimi i duhur i aseteve natyrore dhe kulturore të këtyre dy siteve.
- Arritja e këtyre qëllimeve dhe objektivave afatgjata është qëllimi kryesor i Planit të Veprimit. Megjithatë, ato ndikohen nga një sërë faktorësh të riskut artificial dhe natyror, të jashtëm ose të brendshëm.

1.3 AKTIVITETET

Aktivitetet kryesore që pritet të zhvillohen në periudhën e parashikuar të PM (2024 – 2029) ndahen në tre fusha kryesore:

1 – Ruajtja dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore: Në Bylis - Bazilika B,C, D, teatri, konsolidimi i mureve, shtigjet e brendshme, restaurimi i mozaikëve, shkolla kantier – zonë e hapur restaurimi. **Në Klos-teatri** dhe muri rrethues.

2 – Përmirësimi i aksesueshmërisë, infrastrukturës civile dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë së pasurisë dhe trashëgimisë kulturore: Qendra multi-funksionale e Muzeut Arkeologjik, vendi për parkim, restaurimet, konsolidimet, ndriçimi, ngritja e kapaciteteve të administrimit të PAB dhe rrënojave të Klosit, veprimtaritë e punës shkencore, sinjalistika, tabela informuese, sistemi i survejimit me kamera, heqja e rrethimeve pa leje që pengojnë hyrjen në sitin e Klosit etj.

3 – Aktivitete të zhvillimit ekonomik vendor: aftësi dhe kapacitete të përmirësuara dhe një bashkëpunim i zgjeruar ndërmjet komuniteteve lokale dhe administratës së parkut.

1.4 PËRMBAJTJA DHE STRUKTURA

Në përputhje me VKM Nr. 169, datë 20.2.2020, struktura e planit të menaxhimit përfshin, por nuk kufizohet në:

- Përmbledhje ekzekutive
- Hyrje
- Përshkrimi i pasurisë kulturore
- Vlerësimi i vlerave të pasurisë kulturore
- Aspekte të tjera lidhur me pasurinë
- Vizion, qëllim dhe objektiva
- Menaxhimi i pasurisë kulturore
- Plan veprimi (përshkrimi i ndërhyrjeve dhe aktiviteteve (2024-2030+)
- Zbatimi dhe monitorimi.
- Shtojcat

Në mënyrë të përmbledhur parimet e hartimit dhe përmbajtjes së Planit të Menaxhimit të Bylisit dhe Klosit janë si më poshtë:

Drejtimi

- Përmirësimi i menaxhimit, me qëllim koordinimin efikas të të gjitha veprimtarive në PAB dhe Klos si dhe ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të pasurisë kulturore.
- Ngritja e kapaciteteve lokale dhe profesionale të personelit në këto dy site.

Burimi kulturor

- Ruajtja e integritetit dhe autenticitetit të sitit, nëpërmjet drejtimit të duhur dhe praktikave më të mira, në mënyrë që vlerat shkencore të ofrojnë një burim të qëndrueshëm për edukimin dhe turizmin.
- Rritja e potencialit turistik dhe edukativ të PAB dhe Klos, nëpërmjet një programi të vazhdueshëm konservimi, restaurimi, konsolidimi, kërkimi dhe gërmimi.
- Ndërtimi i një muzeu të ri multifunksional

Turizmi dhe infrastruktura

- Promovimi i formave të qëndrueshme të turizmit me bazë komunitare, që janë të ndjeshme ndaj mjedisit, të realizueshme në aspektin ekonomik dhe të drejta në aspektin social.
- Përmirësimi i infrastrukturës turistike në PAB dhe Klos.

Zhvillimi i komunitetit

- Vlerësimi dhe kujdesi që duhet të tregojnë komunitetet vendase për burimet e Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos.
- Përfshirja e komunitetit vendas në aktivitetet e Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos në një mjedis që nxit edukimin për të gjitha moshat.
- Angazhimi i komunitetit vendas dhe grupe të interesit të Parkut (përfshirë edhe atë të Klosit) në një strategji të unifikuar të zhvillimit të komunitetit.
- Përfaqësimi dhe përfshirja e bashkisë dhe fshatrave në proceset e menaxhimit dhe vendimmarrjes.
- Efikasiteti i koordinimit të palëve të interesit dhe komunikimit me komunitetet lidhur me qëllimet, strategjitë dhe pritshmëritë reale të planeve dhe projekteve zhvillimore.

2. HYRJE

NEVOJA PËR PLANIN E RITË MENAXHIMIT, METODOLOGJIA, KONSULTIMET ME PALËT E INTERESIT, PRAKTIKAT E MIRA, ANALIZA E LEGJISLACIONIT NË FUQI.

2.1 NEVOJA PËR NJË PLAN MENAXHIMI

Faza përgatitore (2018-2021)

Parku Arkeologjik i Bylisit dhe rrënojat arkeologjike të Klosit janë thesare të rëndësishme për kulturën dhe identitetin kombëtar. Si të tilla ato janë në fokus të politikave të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore sipas ligjit Nr. 27, 2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) ka përcaktuar hartimin e planeve të menaxhimit si prioritet, duke iu qasur me një strategji të detajuar që përfshin të gjitha mjetet e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e këtyre pasurive. Këto plane synojnë jo vetëm të përmbushin detyrimet ligjore, por edhe të adresojnë sfidat komplekse të zhvillimit ekonomik dhe kulturor në zonën e Mallakastrës, ku ndodhen këto site. Pas ndërtimit të autostradës Levan-Tepelenë, qyteti i Ballshit dhe Parku Arkeologjik i Bylisit u izoluan nga rrjeti kryesor kombëtar, duke rrezikuar përfshirjen e tyre në zhvillimin rajonal. Ky ndryshim ka bërë që të rritet nevoja për plane menaxhimi të përshtatura, të cilat jo vetëm ruajnë pasuritë kulturore, por edhe promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm me bazë komunitare. Aktualisht, në Parkun Arkeologjik të Bylisit dhe Klosit, sfidat janë të ndryshme dhe komplekse, duke përfshirë konservimin e strukturave arkeologjike, përmirësimin e infrastrukturës turistike, menaxhimin efikas të vizitorëve, promovimin dhe zhvillimin e aktiviteteve, si dhe adresimin e rreziqeve të sigurisë fizike dhe sfidave të ndryshmeve klimatike. Për t'i menaxhuar këto sfida, është thelbësore bashkëpunimi me institucione të specializuara, njësi vendore, partnerë, donatorë të huaj dhe komunitetin lokal. Ky koordinim dhe përfshirje është vendimtare për të rritur efikasitetin në administrimin e këtyre pasurive të çmuara kulturore. Në këtë kuadër, është kritike të zgjerohet dhe thellohet vizioni për menaxhimin dhe prezantimin e këtyre siteve arkeologjike. Kjo do të thotë të integrojmë më mirë këto pasuri në kontekstin më të gjerë të turizmit të rajonit, duke i bërë ato më të aksesueshme dhe të njohura për publikun e gjerë. Kështu, nevoja për përmirësime në menaxhim dhe sfidat që na presin në të ardhmen kërkojnë një qasje të gjithanshme dhe të mirëstrukturuar, e cila synon të balancojë nevojat për ruajtje me ato të zhvillimit.

Bazuar në kuadrin ligjor për trashëgiminë kulturore në fuqi, si dhe “Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”, hartimi i këtij plani menaxhimi shërben si mjet i domosdoshëm për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe do të ndihmojë në përcaktimin e strategjive për ruajtjen dhe zhvillimin e pasurisë kulturore respektive, duke i përshtatur nevojave bashkëkohore të zhvillimit social dhe ekonomik të zonës. Në nivel lokal, nevojat e Bashkisë Mallakastër shtrihen nga mungesa e një plani të zhvillimit lokal të integruar deri te sfidat në zhvillimin e turizmit. Mungesa e infrastrukturës për turizmin natyror dhe kulturor tregon edhe nevojën për një strategji të përgjithshme të marketingut turistik të kësaj zone. Problemet e infrastrukturës, statistikave të pamjaftueshme dhe mosangazhimi i komunitetit krijojnë një kontekst ku zhvillimi turistik ka nevojë për një qasje të koordinuar dhe integruar.

Në një kontekst të mundësive pozitive të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës dhe ndikimeve negative të mungesës së investimeve e planeve përspektive, përfshirja e Parkut Arkeologjik Bylis në aksionin IPA 2018 përbën një shans unik për zhvillimin e PAB, por edhe për një impakt të tij shumë pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Bashkisë të Mallakastrës. Nevoja e një menaxhimi publik të qëndrueshëm funksional dhe roli që ka Parku Arkeologjik Bylis në sistemin Shqiptar të Trashëgimisë Kulturore niset nga parimi se kjo trashëgimi është një aset zhvillimi të qëndrueshëm përmes nxitjes së turizmit, rigjenerimit të ekonomisë vendore.

Si rrjedhojë, ky plan menaxhimi është pjesë e projektit të zhvillimit të Parkut Arkeologjik Bylis në kuadër të “Contribution Agreement - Instrument of Pre-Accession (IPA) 2018” të nënshkruar ndërmjet Komisionit Europian dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Në veçanti, projekti është në përputhje me “Marrëveshjen e kontributit për IPA 2017 - “Modeli i udhëhequr nga Turizmi për Programin e Mbështetjes së Zhvillimit Ekonomik Lokal” nënshkruar me BERZH më 14 dhjetor 2018. Projekti do të kontribuojë më tej në arritjen e objektivave të “Programit të Zhvillimit të Integruar Rural të Qeverisë së Shqipërisë (100 fshatra)” duke realizuar aktivitete zhvillimore lokale në zonën e Mallakastrës. Ai është i rëndësishëm edhe për “Programin Kombëtar të Reformës Ekonomike 2020-2022 - NERP”, sepse i përgjigjet objektivit specifik në lidhje me zhvillimin ekonomik të udhëhequr nga turizmi në të gjithë potencialin e tij turistik e kulturor).

Në perspektivën që hapnin këto marrëveshje, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK - ish Instituti i Monumenteve të Kulturës) përgatitën gjatë vitit 2018, termat e referencës (TeR) për planin e menaxhimit të Bylisit në formën e një dokumenti që u miratua zyrtarisht me Vendim të Këshillit Kombëtar të Restaurimit (KKR) nr.274 datë 31.5.2018. Në vitin

2019 Qeveria e Shqipërisë ra dakord me Delegacionin Evropian në Tiranë (EUD) për një investim me vlerë 6 milionë euro në një periudhë pesëvjeçare për projektin e Parkut Arkeologjik Bylis përmes ndërhyrjeve të rëndësishme konservuese restauruese në monumentet parkut Bylis, përmirësimit rrënjësor të vlerave të trashëgimisë kulturore, krijimit të faciliteteve për rritjen e fluksit dhe kualitetit të vizitave turistike dhe një impakt pozitiv të këtyre ndryshimeve në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të krahinës së Mallakstrës përmes turizmit kulturor.

Një Marrëveshje Kontributi n. 420-271/2020 u nënshkrua në dhjetor 2020, sipas së cilës AICS Tirana dhe dy organizata të specializuara publike italiane: Rajoni Emilia-Romagna dhe Universiteti i Bolonjës, me institucionet e tyre të specializuara, do të mbështesnin Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në përgatitjen e PM.

1. Zona arkeologjike e Parkut Bylisit është pjesë e projektit të financuar nga BE-ja "Zhvillimi ekonomik vendor i drejtuar nga turizmi me fokus të trashëgimia kulturore" në kuadër të Marrëveshjes së Financimit për Instrumentin e Para-Anëtarësimit të nënshkruar nga Qeveria e Shqipërisë dhe Bashkimi Evropian.

2. Organizatat e vlerësuara si më sipër janë organizata ndërkombëtare ose të vendeve anëtare të BE-së, rregullat e të cilave në lidhje me procedurat e prokurimit, kontabilitetin, sistemet e kontrollit të brendshëm, auditimin e pavarur, etj., janë vlerësuar nga BE-ja dhe janë certifikuar si ekuivalente me rregullat dhe procedurat e BE-së. BE-ja mund t'u besojë këtyre organizatave zbatimin e projekteve të financuara nga BE-ja, në emër të BE-së.

Ministria përfituese e këtij projekti është :

- **Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit** për krijimin e politikave kulturore dhe të trashëgimisë dhe menaxhimin e parqeve arkeologjike kombëtare dhe muzeve;

Institucionet përfituese, janë si më poshtë:

- **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, (IKTK)** përfituese dhe bën monitorimin e fazave të projektit dhe zbatimit në përputhje dhe respektimin e standarteve të punimeve konservuese dhe restauruese dhe ligjeve në fuqi.
- **Instituti i Arkeologjisë (IA)** vlerat shkencore të monumenteve të Parkut Arkeologjik Bylis, me funksionin e drejtimit shkencor të projekteve të propozuara dhe me germime Arkeologjike në PAB.
- **Akademia e Shkencave e Shqipërisë** me funksionin e promovimit të një standardi të nivelit të lartë të kërkimit shkencor për PAB.

- **Administrata e Parkut** me funksion aktual të administrimit të Parkut Arkeologjik Apolloni-Byllis gjatë gjithë periudhës së zbatimit të fazës (2024-2029) të PM.
- **Bashkia Mallakastër** si përfituese lokale e projektit në impaktin e tij në zhvillimin e qëndrueshëm përmes promovimit të turizmit kulturor.

2.2 METODOLOGJIA E PËRGATITJES SË PLANIT TË MENAXHIMIT

Përgatitja e planit të menaxhimit për një sit arkeologjik në natyrë dhe jashtë zonave urbane, siç janë Parku Arkeologjik Byllis dhe rrënojat e Klosit, përfshin disa hapa të rëndësishëm që bartin sfida të ndryshme brenda tyre. Për përgatitjen e këtij plani menaxhimi, u angazhuan një ekip konsulentësh ndërkombëtarë nga Universiteti i Bolonjës dhe një ekip ekspertësh lokalë, të cilët kanë kontribuar prej vitesh në Byllis dhe në zonën arkeologjike të Klosit. Kombinimi i vizitave në terren, takimeve me video konferenca, studimi i kuadrit ligjor dhe kuptimi i rëndësisë së Byllisit si park arkeologjik përcaktuan vizionin, qëllimin dhe objektivat për të trajtuar këtë pasuri kulturore si një prioritet për rritjen gjithëpërfshirëse për të ardhmen. Në këtë vështrim strategjik, përgatitja e Planit të Menaxhimit bazohet në VKM 169/ dt 20.02.2020, si dhe në referenca ndërkombëtare duke përfshirë analizën e pasurisë kulturore, hartimin e vizionit, planifikimin strategjik, planin e veprimit, dhe monitorimin e rishikimin e planit.

Analiza e pasurisë kulturore përfshiu të dhëna të terrenit të integruara me vlerat kulturore, duke analizuar integritetin, autenticitetin dhe gjendjen e konservimit të rrënojave arkeologjike në park. Përveç vlerave kulturore, gjatë përgatitjes së planit janë analizuar edhe vlerat e tjera të integruara, si kuadri ligjor dhe institucional (siç shihet më poshtë), si dhe faktorët që ndikojnë në ruajtjen e integritetit dhe autenticitetit.

Hartimi i vizionit për Parkun Arkeologjik të Byllisit dhe Klosit përfshiu investimin në ruajtjen e vlerave kulturore për mbrojtjen e integritetit dhe autenticitetit, përdorimin e një modeli administrativ të qenësishëm, bashkëpunimin efektiv institucional dhe ndërinstinucional, si dhe rritjen e kapaciteteve për të gjeneruar të ardhura dhe për të rritur fuqinë përthithëse të fondeve.

Aktivitetet dhe investimet në shtatë vitet e ardhshme janë të parapara nëpërmjet planit të veprimit, i cili përfshin aktivitetet specifike për realizimin e objektivave, rezultatet e matshme dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin, duke specifikuar buxhetin dhe burimet e nevojshme për zbatim. Për këtë, metodologjia është bazuar kryesisht në zbatimin e projektit IPA 2018 “BE për Zhvillimin Ekonomik drejtuar nga turizmi, zhvillimi ekonomik dhe vendor me fokus mbi Trashëgiminë Kulturore”.

Për të siguruar matshmërinë e treguesve zhvillimorë, plani i menaxhimit monitorohet dhe rishikohet rregullisht, duke përfshirë zbatimin, indikatorët dhe planet e veprimit të përcaktuar në plan.

Në aspektin strategjik, metodologjia e hartimit të këtij plani u përqendrua në vlerësimin e burimeve të mëposhtme:

Burimi Kulturor

Studimi dhe rëndësia e burimeve arkeologjike në Parkun Bylis dhe Klosit. Ruajtja e identitetit dhe autenticitetit të vendit, nëpërmjet drejtimit të duhur dhe praktikave më të mira, në mënyrë që vlerat e tij të qenësishme dhe shkencore të ofrojnë një burim të qëndrueshëm për edukimin dhe turizmin.

Burimi natyror

Hartimi dhe zbatimi i një programi të vazhdueshëm të monitorimit ekologjik, aty ku është e realizueshme dhe e përshtatshme, me qëllim gjetjen e të dhënave të domosdoshme për informimin e vendimmarrjes në të ardhmen. Miratimi i praktikave të qëndrueshme mjedisore brenda dhe përgjatë kufijve të Parkut PAB. Kjo do të kërkojë një ndërthurje incentivash, rregullimesh dhe monitorimi.

Drejtimi dhe menaxhimi

Analiza e modeleve në rajon si dhe referenca e modeleve të reja që po zbatohen aktualisht në Shqipëri. Rezultati do të jetë mbajta e një strukture funksionale të konsoliduar menaxhimi, me qëllim koordinimin efikas të të gjitha veprimtarive që ndikojnë në PAB dhe Klos si dhe të garantojë disponimin e burimeve të mjaftueshme që lejojnë zbatimin efikas të PM për PAB dhe Klos.

Burimet financiare

Identifikimi i burimeve financiare për implementimin e planit dhe përcaktimi i një plani financiar afatgjatë. Mirëmenaxhimi i të ardhurave nga vizitueshërmia si dhe krijimi i partneriteteve dhe mundësive për financim nga donatorë, qeveria, dhe organizata ndërkombëtare.

Mbrojtja dhe Konservimi

Krijimi i një plani për mbrojtjen dhe menaxhimin e konservimit të strukturave dhe artefakteve arkeologjike, duke përfshirë edukim dhe trajnime për stafin dhe personelin përgjegjës.

Turizmi dhe qasja edukuese

-Promovimi i formave të qëndrueshme të turizmit me bazë komunitare, që janë të ndjeshme ndaj mjedisit, të realizueshme në aspektin ekonomik dhe të drejta në aspektin social. Një tjetër element është Agroturizmi dhe Ekoturizmit, që krahas praktikave të qëndrueshme i japin prioritet turistëve për të vizituar PAB dhe provuar traditën e kulinarisë së zonës, i japin zhvillim komunitetit rreth PAB dhe Klos dhe përdorimin e produkteve dhe materialeve vendase.

-Një qasje tjetër metodologjike, e quajtur "Shkolla e Hapur", ka për qëllim të menaxhojë studimin, gjurmimin, ruajtjen dhe aktivitetet restauruese, jo thjesht si faza teknike, por si ndërtuese - kapacitetesh dhe veprimtari gjenerimi të ardhurash për përfituesin e investimit, që është Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe në sektorin e turizmit për komunitetet vendore, duke krijuar kështu një zinxhir të plotë vlerash. "Shkolla e Hapur" do të funksionojë si një laborator arkeologjik dhe konservimi i hapur për turistët ose entuziastët të interesuar në angazhimin e praktikave arkeologjike dhe konservuese në Bylis dhe/ose Klos. Ai do të jetë një "sit i hapur" në mënyrë që të përfshihet publiku në fazat e vazhdueshme të studimit, diagnostikimit, dhe konservimit të monumenteve.

-Ndërtimi i muzeut arkeologjik, përdorimi i teatrit për performanca artistike e kulturore, krijimi i shkollës kantier, ambientet e shtëpisë së arkeologut e restauratorit, aktivitetet e hapura për nxënësit, studentët dhe turistët gjatë aktiviteteve të restaurimit dhe ruajtjes, apo eventet promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare, janë vetëm disa shembuj të ndryshimit themelor në mënyrën e përdorimit të pasurisë kulturore sipas orientimeve të dhëna në SZHK.

Përfshirja e komunitetit lokal

Organizimi i takimeve dhe konsultimeve me komunitetin lokal për të dëgjuar shqetësimet dhe sugjerimet e tyre. Krijimi i një mënyre efektive të përfshirjes së komunitetit dhe vizitorëve në procesin e hartimit të planit (shiko më poshtë konsultimet me palët e interesit).

2.3 KONSULTIMET ME GRUPET E INTERESIT

Ky plan është hartuar në bashkëpunim dhe konsultim me një numër të madh të aktorëve të interesuar, institucione qendrore dhe lokale, përfshirë përfaqësues të Parkut Arkeologjik Apolloni–Bylis dhe komunitetin lokal. Për këtë arsye, u zhvilluan një sërë konsultimesh me përfaqësues të niveleve të ndryshme, me qëllim të arritjes së bashkëpunimit për idetë dhe konceptet. Takimet, prezantimet dhe anketimet, përfshirë pyetësorët dhe përgjigjet e publikut, grupet e interesit, u organizuan nga Zyra e AICS në Tiranë përmes takimeve në terren. Drejtuesit institucionalë të grupeve të interesit u trajtuan si partnerë të rëndësishëm në procesin e përgatitjes së këtij

plani. Këtyre grupeve të interesit iu dërguan draftet e seksioneve, dhe takimet dhe prezantimet zhvilloheshin me frekuencë, duke krijuar kështu një bashkëpunim të ngushtë dhe marrëdhënie pune të mira reciproke.

Menaxhimi i procesit të konsultimit me palët e interesit

Në vijim të një analize të thelluar të interesave të palëve për projektin, u organizuan rregullisht takime individuale me përfaqësues të organeve të qeverisë qendrore, që janë përgjegjëse për PAB dhe rrënojave të Klosit, duke përfshirë Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).

U organizuan takime edhe me përfaqësues të bashkive, të cilat u përqendruan kryesisht te angazhimi në këtë proces të personave vendas me ndikim, kryepleqve dhe vendimmarrësve në fushën e turizmit të qëndrueshëm, mjedisit dhe zhvillimit ekonomik. Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe angazhimit në dialog të komuniteteve vendore, që jetojnë përreth PAB, nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me banorët ose takimeve me kryepleqtë e fshatrave dhe/ose administratorët e njësive.

Qëllimi i këtij procesi është përfshirja e një gamë sa më të gjerë përfituesish të drejtpërdrejtë dhe atyre personave me ekspertizë të veçantë vendore (shoqëri turistike dhe udhërrëfyes turistikë, që kanë lidhje me burimet kulturore dhe natyrore, fermerët vendas, aktivistët e mjedisit dhe zejtarët vendas), për t'iu kërkuar këshilla mbi identifikimin e problematikave aktuale dhe zgjidhjeve të mundshme. Gjithashtu, ai synonte që të gjitha palët të zhvillonin të njëjtën kuptueshmëri dhe të dakordësonin mbi parimet e përgjithshme dhe mekanizmat e koordinimit, të propozuara për Planin e Menaxhimit.

Procesi i konsultimit të palëve të interesit përfshinte edhe përfaqësues të universiteteve dhe akademikëve të spikatur në fushat e arkeologjisë, arkitekturës, menaxhimit të trashëgimisë kulturore, ekologjisë dhe mjedisit, që kontribuuan në identifikimin e problematikave prioritare dhe zgjidhjeve për t'u adresuar. Pjesëmarrja dhe përfshirja e palëve dhe grupeve të interesit rezultoi mjaft e dobishme dhe e frytshme. Megjithatë, ky proces nxori në pah nevojën për konsolidimin e pjesëmarrjes së komuniteteve vendase në fazën e zbatimit të Planit të Menaxhimit. Ky grup palësh përbëhet kryesisht nga banorë vendas të fshatrave Hekal, Klos dhe Qytetin e Ballshit.

Institucionet e interesuara

- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK)
- Instituti i Arkeologjisë (IA)
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
- Parku Arkeologjik Apolloni-Bylis
- Bashkia Mallakastër/Ballsh
- Qendra Kulturore Bashkiake
- Njesia Bashkiake dhe Komuniteti Hekal, Klos
- Universiteti i Tiranës

Grupet e interesit

Përveç institucioneve, një grup tjetër i rëndësishëm ishin komuniteti i grupeve të interesit. Këto grupe u zgjodhën pasi të gjithë janë të vendosur në zonën Mallakastër, Fier, dhe kanë projekte aktive në lidhje me kulturën në qytet dhe kanë interes për mbrojtjen arkeologjike.

Shoqata

- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Ballsh
- Shoqata e Turizmit AAT-HORECA
- Rotary Club
- Trashëgimia Kulturore pa Kufij, Shqipëri

Gjithashtu, janë organizuar seminare, takime dhe intervista me **përfaqësues të bashkive të Ballshit dhe Fier**, kryepelqve të fshatrave të Hekal dhe Klos, dhe fokus grupe të tjera. Do të nevojitet edhe organizimi i diskutimeve të mëtejshme me këto palë interesi për:

- Informimin e tyre mbi mundësitë dhe problematikat të brendshme në
- Parkun Kombëtar Bylis dhe rrenojat e Klosit, në terma afatmesme dhe afatgjata
- Zhvillimin, nevojat dhe interesat e tyre
- Rolet dhe përgjegjësite
- Vlerësimin e kërkesave për ngritjen e kapaciteteve
- Programe të nevojshme të edukimit dhe trajnimit.

Konsultimet e kryera me palët e interesit

Takimet të palëve të interesuara për projektin, janë organizuar edhe me takime individuale me përfaqësues të organeve të qeverisë qendrore, që janë përgjegjëse për Parkun Kombëtar të Apollonisë – Bylis duke përfshirë Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).

Jane organizuar takime edhe me përfaqësues të bashkive, Fier, Ballsh të cilat u përqendruan kryesisht te angazhimi në këtë proces të personave vendas me ndikim, kryepleqve ne Hekal dhe Klos dhe vendimmarrësve në fushën e turizmit të qëndrueshëm, mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

Nje rendësi te veçantë iu kushtua edhe komuniteteve vendore, që jetojnë përreth Parkut Kombëtar Bylis ose brenda rrenojave arkeologjike te Klosit , nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me banorët ose takimeve me kryepleqtë e fshatrave.

Qëllimi i këtij procesi është përfshirja e një gamë sa më të gjerë përfituesish të drejtpërdrejtë dhe atyre personave me ekspertizë të veçantë vendore (shoqëri turistike dhe udhërrëfyes turistikë, që kanë lidhje me burimet kulturore dhe natyrore, fermerët vendas, aktivistët e mjedisit dhe zejtarët vendas), për t'iu kërkuar këshilla mbi identifikimin e problematikave aktuale dhe zgjidhjeve të mundshme.

Objektivi i takimeve me palët e interesuara ishte që të gjitha palët të zhvillonin të njëjtën kuptueshmëri dhe të dakordësonin mbi parimet e përgjithshme dhe mekanizmat e koordinimit, siç janë propozuar për Planin e Menaxhimit. Procesi i konsultimit me palët e interesit përfshiu përfaqësues nga universitetet dhe akademikë të spikatur në fushat e arkeologjisë, menaxhimit të trashëgimisë kulturore, ekologjisë dhe mjedisit të cilët kontribuan në identifikimin e problematikave prioritare dhe zgjidhjeve për t'u adresuar.

Pavarësisht organizimit të konsultimeve me personat përgjegjës nga bashkitë përkatëse dhe përfaqësuesit e Biznesit Privat vendorë, si Agro – Biznesi në Hekal dhe kryepleqtë e fshatrave, është e nevojshme të synohet një pjesëmarrje më aktive e banorëve vendas në konsultimet me publikun e gjerë gjatë fazës së zbatimit.

2.4 PRAKTIKAT E MIRA

Sipas Interreg Europe, *“një praktikë e mirë është një iniciativë... një metodologji, një projekt, një proces ose teknikë që ka disa prova suksesi në arritjen e qëllimit të saj”*. Është e rëndësishme të thuhet se një praktikë e mirë *“ka potencialin të transferohet në zona të tjera gjeografike”*.

**Cilët janë shembujt e praktikave të mira që janë studiuar dhe përfshirë në këtë PM?
Më poshtë po rendisim disa prej tyre:**

- Dëgjimi dhe bashkëveprimi me palët e interesuara institucionale dhe komunitetin ishin thelbësore në procesin e informimit të këtij plani. Ky proces përfshiu gjithashtu testimin e ideve me të njëjtat palë të interesuara nëpërmjet vlerësimeve të shumta, dialogëve, dhe prezantimeve.
- Krijimi i një ekipi partnerësh dhe ekspertësh lokalë dhe ndërkombëtarë në fushën e arkeologjisë, me përvojë ndërkombëtare, ishte një hap kyç. Ky ekip kombinon njohuri të thelluara lokale me njohuri të praktikave të mira ndërkombëtare.
- Kryerja e vizitave njohëse në terren, të kombinuara me hulumtime dokumentare, përfshin një rishikim të legjislacionit, një inventar të shpejtë, zhvillimin e sistemit të informacionit gjeografik, dhe krijimin e një bibliografie të gjerë.
- Strukturimi i përgjigjeve ndaj sfidave të Parkut Bylis dhe Klosit, duke u fokusuar tek aspektet pozitive, fillon me një vizion të mbështetur nga qëllimet, objektivat, objektivat specifike, dhe detyrat në një afat kohor të shkurtër, të mesëm, dhe të gjatë.
- Renditja e masave të rekomanduara nga objektivat në katër kategori përmirësimi, ruajtja dhe prezantimi, rregullorja e mbrojtjes, kapaciteti, përdorimi dhe valorizimi.
- Zhvillimi i një plani veprimi të realizueshëm në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, me përgjegjësi të caktuara të lidhura me objektivin. Krijimi i një dokumenti të përshtatshëm dhe të adaptueshëm që mund të përshtatet kur paraqiten sfida të reja.

2.5 MODELET E REFERUAR

Modelet e administrimit referuar në këtë plan u bazuan në praktika të mira të marra nga sitet arkeologjike që ngjajnë nga tipologjia me Bylisin dhe Klosin. Këto site u zgjedhën nga vende të ndryshme si **Britania e Madhe, Italia, Greqi**, etj. Shqyrtimi i tyre përfshin një analizë të qasjes së tyre ndaj **menaxhimit, konservimit, aksesit publik dhe zhvillimit turistik**, duke shërbyer si një burim i çmuar informacioni për të kuptuar dhe përmirësuar praktikat në menaxhimin e sitit arkeologjik. Sfidat ndërmjet siteve të mara si referencë janë të njëjta me ato në Bylis dhe Klos dhe lidhen me sfidën e ruajtjes dhe konservimit të strukturave dhe artefakteve të tyre. Problemet përfshijnë financimin e duhur për konservimin dhe menaxhimin e këtyre siteve, erozionin, dëmtimin nga kushtet atmosferike, dhe ndikimin e vizitorëve. Gjithashtu, rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi i publikut mbi rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore është një tjetër sfidë për të siguruar mbështetje, ndërkohë që ndryshimet

në ligjet dhe politikat vendore ose kombëtare mund të ndikojnë në mënyrën se si këto site menaxhohen dhe ruhen.

Britania e Madhe

Stonehenge, Angli - Stonehenge, i vendosur në luginën e Wiltshire, është një nga monumentet më të njohura prehistorike në botë. Administrimi i Stonehenge bëhet nga English Heritage, një organizatë kujdestare e monumenteve historike në Angli. Përpjekjet për konservimin e Stonehenge përfshijnë mbrojtjen e peisazhit përreth dhe ruajtjen e strukturave të lashta. Vendi ofron një qendër vizitorësh moderne me ekspozita dhe informacione në lidhje me historinë e Stonehenge dhe jetën gjatë kohës së ndërtimit të tij. Si një destinacion turistik, Stonehenge tërheq mijëra vizitorë çdo vit, të cilët janë të interesuar në misterin e origjinës dhe funksionit të tij.

Vindolanda, Angli - Vindolanda, një sit arkeologjik i pasur në veri të Anglisë, është i njohur për historinë e Murit të Hadrianit. Administrimi i Vindolandës bëhet nga Trusti Arkeologjik i Vindolandës, një organizatë bamirëse e pavarur. Përqendrimi në konservimin e artefakteve dhe strukturave, si dhe vazhdimi i gërmimeve arkeologjike, e bën këtë vend një pikë kyçe për studimin e historisë romake në Britani. Akses publik përfshin një muze dhe qendër vizitorësh, si dhe aktivitete edukative për vizitorët e të gjitha moshave, duke e bërë atë një destinacion tërheqës turistik.

Kompleksi Arkeologjik i Brú na Bóinne, Irlandë - Kompleksi Arkeologjik i Brú na Bóinne në Irlandë përfshin një grup varresh dhe monumentesh të lashta që tregojnë për inxhinierinë arkitekturore dhe përpjekjet artistike të popujve që u vendosën pranë Lumit Boyne. Menaxhuar nga Heritage Ireland, ky kompleks është i përqendruar në ruajtjen e varreve të kalasë dhe peisazhit arkeologjik përreth. Brú na Bóinne ofron ture të guiduara dhe një qendër vizitorësh me ekspozita edukuese. Si një destinacion i rëndësishëm turistik, ai tërheq vizitorë që dëshirojnë të kuptojnë periudhën parahistorike të Irlandës.

Italia

Parku Arkeologjik i Pompeit, Itali - Pompei, një nga sitet më të njohura arkeologjike në botë që tregon historinë e një qyteti romak të varrosur nën hirin vulkanik. Administrimi i këtij parku bëhet nga Soprintendenza Speciale per i Beni Archeologici di Napoli e Pompei, e cila përqendrohet në ruajtjen dhe konservimin e rrënojave dhe artefakteve. Akses publik është i gjerë, me ture të guiduara dhe ekspozita në muze, të cilat ofrojnë një pasqyrë të jetës në Romën e lashtë. Pompei është një destinacion kryesor turistik, i cili tërheq vizitorë nga e gjithë bota për të zbuluar historinë dhe kulturën e tij të lashtë.

Valle dei Templi, Agrigento, Itali – E ndodhur në Agrigento, Valle dei Templi është një kompleks i madh arkeologjik që përmban disa nga tempujt më të mirë të ruajtur grekë. Menaxhohet nga Parco Archeologico e Paesaggistico della Valle dei Templi, e cila ndërmerr hapa të rëndësishëm për konservimin e këtyre strukturave historike. Ky vend ofron ture të guideuara dhe një muze për vizitorët, duke i bërë ato një pikë referimi për të kuptuar periudhën e lashtë greke në Itali.

Sirakuza dhe Parku Arkeologjik i Neapolisit - Në zemër të Sirakuzës në Sicili, ky park arkeologjik përfshin një sërë monumentesh të rëndësishme nga periudha greke dhe romake. Menaxhimi bëhet nga autoritetet lokale dhe qeveritare italiane, me një fokus të fortë në konservimin e teatrove, amfiteatrove dhe monumenteve të tjera. Parku ofron ture të guideuara dhe një muze për edukimin e publikut. Si një destinacion turistik kryesor, ai tërheq vizitorë nga e gjithë bota për të zbuluar trashëgiminë e pasur kulturore dhe historike të Sirakuzës dhe të Neapolisit.

Parku arkeologjik i Brescias romake – Është pjesë e një sistem muzeor kompleks dhe impresionues të menaxhuar nga Fondazione Brescia Musei që fokusohet në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike. Fondacioni përfshin në administrim Muzeun Santa Giulia dhe Zonë Arkeologjike Romake Brixia – e cila është njohur si një sit i mbrojtur nga UNESCO-s që në vitin 2011 – Pinacoteca Tosio Martinengo, Kalaja e Brescias, e cila përfshin Muzeun e Armëve "Luigi Marzoli" dhe Muzeun e Luaneshës Risorgimento të Italisë, si edhe kinemanë Nuovo Eden. Përpjekjet e konservimit janë të përqendruara në mbrojtjen e ndërtesave të lashta dhe ruajtjen e artefakteve. Parku ofron ture të guideuara që eksplorojnë historinë e zonës, duke përfshirë fresket e jashtëzakonshme dhe dyshemetë me pllaka mermeri në Tempullin Capitolium, si dhe statujën e bronzit të "Vittoria alata". Si destinacion turistik, Parku Arkeologjik i Brescias Romake tërheq vizitorë me interes në qytetërimin romak dhe trashëgiminë e tyre kulturore.

Greqia

Sit Arkeologjik i Delphit, Greqi - Delphi, i njohur si qendra fetare e lashtë greke, menaxhohet nga Ministria Greke e Kulturës dhe Sporteve. Përqendrimi në konservimin e tempujve, teatrove dhe strukturave të tjera të lashta është kyç. Vizitorët kanë mundësi të shijojnë ture të guideuara dhe të eksplorojnë një muze arkeologjik. Delphi është një destinacion i rëndësishëm turistik që tërheq vizitorë për të përjetuar historinë dhe mitologjinë greke.

2.6 ANALIZA E LEGJISLACIONIT NË FUQI

Trashëgimia kulturore është gur themeli, mbështetja, identiteti i një kombi dhe një burim i rëndësishëm për turizmin në botë. Është pasuria jonë kulturore që e kemi

trashëguar nga e kaluara, ajo me çfarë jetojmë tani, dhe çfarë transmetojmë tek brezat e ardhshëm. Është burim i pazëvendësueshëm i jetës dhe i frymëzimit. Si një element esencial i jetës dhe kulturës së një kombi, trashëgimia kulturore gëzon mbrojtjen ligjore, si një detyrim pozitiv i çdo shteti, që nga normat ligjore në hirearkitë më të larta deri tek aktet nënligjore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Shqipëria është një vënd mjaft i pasur me trashëgimi kulturore materiale e jo materiale si rrjedhojë dhe kuadri ligjor i cili rregullon këtë fushë ka qenë në evolim të vazhdueshëm. Një pasuri kulturore materiale mjaft tërheqëse, intriguese dhe pothuaj fare e vizituar nga turistët vëndas apo të huaj është dhe parku arkeologjik i Bylis-it dhe rrënojat e Klosit, të cilët janë pjesë e këtij projekti.

Parku arkeologjik Bylis është një nga sitet unike në Shqipëri. Për nga vlerat kulturore dhe monumentale ai është një nga qëndrat më të rëndësishme arkeologjike në vënd. Përmes Vendimit Nr. 396, datë 31.3.2005 “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikutit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit” e ndryshuar me VKM Nr. 249, datë 30.4.2014, janë përcaktuar kufinj të dhe rregullat për mënyrën e administrimit të parkut arkeologjik të Bylisit. Nga ana tjetër, rrënojat e Klosit janë vendosur nën mbrojtje si Monument Kulturore Kategorisë I-rë me vendim të Institutit të Shkencave (botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 95, dt. 16.10.1948); Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës Nr. 6, dt. 15.1.1963; Ministri i Arsimit dhe Kulturës Nr. 1886/ dt. 10. 6.1973. Më 12 qershor 2006, në Luksemburg, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të Bashkimit Europian u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit, e përbërë nga 135 nene, 5 anekse dhe 6 protokolle, e cila hyri në fuqi më me 1 prill 2009, pas ratifikimit të saj nga 25 vendet anëtare të BE-së dhe ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Pjesë e marrëveshjes është dhe përafrimi i legjislacionit tonë të brëndshëm me atë të komunitetit europian ku ne aspirojmë të anëtarësohemi. Ndër të tjera në Nenin 101 të Marrëveshjes palët marrin përsipër që të mbështesin dhe nxisin njëra tjetrën në kuadër të bashkëpunimit kulturor, ku vëmendje e veçantë i duhet kushtuar konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe nxitjen e larmisë kulturore. Në këtë drejtim, nga ana e shtetit shqiptar, është bërë një punë e mirë në kuadër të harmonizimit të legjislacionit, i cili trajton dhe mbron trashëgiminë kulturore, me acquis e BE-së. **Në vitin 2018 është miratuar Ligji Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”** i cili përcakton rregullat, procedurat dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky Ligj përbën bazën kryesore për nga burojnë aktet e tjera ligjore apo nënligjore të cilat trajtojnë dhe rregullojnë trashëgiminë kulturore në vënd. Ligji Nr. 27/2018, “Për

trashëgiminë kulturore dhe muzetë” hyri në fuqi më datë 28.06.2018, duke shfuqizuar në këtë mënyrë Ligjin Nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 9386, datë 04.05.2005, “Për muzetë”, si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore të nxjerra në bazë dhe zbatim të këtyre ligjeve.

Me qëllim përcaktimin e objektivave, vizionit dhe të krijimit të një strategjie për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, siteve arkeologjike etj., në Nenin 5, pika 46 të Ligjit Nr. 27/2018 jepet përkufizimi i termit “Plan i menaxhimit”, i cili është dokumenti që përcakton në detaje të gjitha strategjitë dhe mjetet e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë dhe, në të njëjtën kohë, duke iu përgjigjur nevojave të jetës bashkëkohore. Ai përmban dokumentet legjislative, financiare, administrative dhe të ruajtjes, përveç planeve të ruajtjes dhe monitorimit. Në zbatim të përcaktimeve të sanksionuara në Ligjin Nr. 27/2018 është hartuar dhe Plani i Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos 2024-2029. Në këtë prizëm, mbrojtja, konservimi/restaurimi dhe evidentimi publik i vlerave historike dhe arkeologjike të qytetit antik të Bylisit, është trajtuar në kuadër të zhvillimit të një infrastrukture të parkut modern dhe të arritshëm, që do të nxitë zhvillimin e turizmit kulturor dhe inkurajimin e rritjes së qëndrueshme të zonës. Vizioni i PM-së përfshin një menaxhim funksional të investimeve, në partneritet të ngushtë me të gjithë institucionet e tjera përkatëse publike/jo publike, vëndase apo të huaja dhe palët e interesuara, duke gjeneruar të ardhura të qëndrueshme për t’u rinvestuar në Park.

PM-ja është hartuar në përputhje me kërkesat e Nenit 45, 46 dhe 47 të Ligjit Nr. 27/2018, si dhe me përcaktimet e VKM-së Nr. 169, datë 20.2.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”.

Referuar Nenit 45 të Ligjit, PM-ja përmban: a) Karakteristikat e përgjithshme të siteve të trashëgimisë kulturore të mbrojtura; b) Objektivat dhe organizimin e menaxhimit të siteve; c) Një program afatshkurtër dhe një program afatgjatë për ruajtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore me planin përkatës të veprimit dhe financimin e aktiviteteve të parashikuara; ç) Përfshirjen e partnerëve në zbatimin e planit; d) Kushtet dhe rekomandimet për aktivitetet implementuese; dh) Sistemin monitorues në territorin e mbrojtur dhe sigurimin e masave të shpëtimit në raste emergjence; e) Sistemin e kontrollit të zbatimit dhe implementimit.

Në Nenin 46 të Ligjit përcaktohet se planet e menaxhimit hartohen për vlerat e paluajtshme kulturore, të përfshira në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Shqipërisë, për: a) qendrat historike; b) zonat dhe parqet arkeologjike, siç është dhe rasti i PM i Parkut Arkeologjik Bylis 2024-2029; c) grupin e vlerave të

paluajtshme kulturore të rëndësisë kombëtare; ç) vlerat e vetme të paluajtshme kulturore me rëndësi kombëtare. Po kjo dispozitë përcakton se planet e menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme i nënshtrohen diskutimit publik sipas modaliteteve të përcaktuara në VKM-në Nr. 169/2020, ku drafti i planit të menaxhimit është objekt i konsultimeve publike me institucione qendrore dhe vendore, grupe interesi të identifikuar dhe partnerë/investitorë/donatorë të mundshëm. Konsultimi publik i draftit të planit të menaxhimit bëhet me grupe të ndryshme interesi, në të cilët duhet të përfshihen, por pa u kufizuar subjektet e përfshira në sistemin primar të menaxhimit të pasurisë kulturore (institucionet që kanë në pronësi dhe/ose administrojnë pasuritë kulturore), pronarët e ligjshëm, të njohur brenda pasurisë kulturore, strukturat shtetërore/subjektet që janë burime dytësore për menaxhimin e pasurisë kulturore, komunitetin e zonës. Pas konsultimit publik, referuar Nenit 47 të Ligjit, PM-ja i nënshtrohet marrjes së mendimit paraprak nga ana e KKTKM-së dhe KKMPK-së. Pas opinionit të këtyre dy institucioneve, PM-ja i dërgohet për miratimin përfundimtar ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të aseteve kulturore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Krahas Ligjit Nr. 27/2018 dhe VKM-së Nr. 169/2020, hartimi, implementimi dhe zbatimi i PM-së është në përputhje dhe me “Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”, hartuar dhe miratuar nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Ky akt ka si vizion që përgjatë viteve 2019-2025 artet dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë të shërbejnë si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në këtë prizëm, përmes PM për Parkun Arkeologjik Bylis (përfshi rrënojat e Klosit) dhe aktiviteteve me investimet e parashikuara aty synohet nxitja e zhvillimit të turizmit kulturor të zonës, tërheqja e sa më shumë turistëve vendas dhe të huaj duke gjeneruar mundësi ekonomike dhe të ardhura për banorët e këtyre zonave.

PM-ja është bazuar më tej në “Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023”, përmes së cilës synohet promovimi i Shqipërisë si një destinacion mikpritës, tërheqës, autentik turistik, me qëllim zhvillimin e potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit. Në kuadër të kësaj Strategjie, trashëgimia kulturore bën pjesë tek turizmi tematik, ku edhe pse nuk është qëllimi kryesor i vizitës në Shqipëri, arkeologjia, trashëgimia e kultura identifikohen si pikat e forta të Shqipërisë në studime të ndryshme të kryera me vizitorë dhe industrinë e udhëtimeve nga tregjet e huaja.

Po kështu, PM-ja është bazuar në Vendim Nr. 1117, datë 16.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të menaxhimit të integruar të kufirit deri në 5 vite, 2021-

2026 dhe të planit të veprimit 2021-2026”, vendim i cili përcakton se Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, promovon arritjet e kulturës shqiptare për të rritur në këtë mënyrë konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve. Kjo ministri ka për detyrë regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin, promovimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare, monitoron dhe koordinon punën me njësitë territoriale në fushën e pasurive kulturore nëpërmjet Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

Me qëllim kthimin e parkut arkeologjik të Bylisit dhe rrënojave të Klosit në një atraksion turistik dhe si një vlerë e shtuar për vëndin dhe zonën përreth, PM-ja paraqet në mënyrë të detajuar projektimin e ndërhyrjeve konservuese, restauruese dhe të infrastrukturës muzeale në këto site, si dhe mënyrën dhe metodologjinë e zbatimit të këtyre projekteve. Të gjitha ndërhyrjet që do të realizohen në parkun arkeologjik Bylis dhe Klos, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen, konservimin, restaurimin, zbulimin, administrimin, valorizimin etj. të siteve, do të jenë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Referuar Ligjit Nr. 27/2018, VKM Nr. 581, datë 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore” dhe akteve të tjera nënligjore, të gjitha ndërhyrjet që do zhvillohen në këto dy site do të realizohen pas marrjes së autorizimeve nga autoritetet kompetente dhe në përputhje me planin e projektin e miratuar nga to. Po në këtë kuadër, VKM Nr. 220, datë 7.4.2021 “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”, parashikon që të gjitha lejet për vrojtim, sondazh apo gjurmim arkeologjik në zona pasuri kulturore do të miratohen përmes IKTK-së dhe më pas KTKM-së. Gjithashtu, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore dhe sidomos në zonat arkeologjike duhet të ndjekin VKM Nr. 1099, datë 24.12.2020, “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”, ku përcaktohen normat teknike të ndërhyrjes sidomos në pasuritë kulturore arkeologjike.

Po në këtë kuadër, PM-ja është bazuar në VKM Nr.280 datë 01.04.2015 (i ndryshuar me VKM nr.756 datë 26.10.2016) “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi,në ndërtime me leje, e ndryshuar”- e cila përcakton në mënyrë

konkrete strukturat që nuk mund të legalizohen, dhe që cenojnë ose shkelin trashëgiminë kulturore, përfshi zonat dhe parqet arkeologjike.

Krahas ligjit dhe akteve më sipër cituar, me qëllim ruajtjen dhe rehabilitimin e vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror, ndërhyrjet dhe punimet në park do të zhvillohen në përputhje dhe me Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar. Parë nën optikën e këtij ligji, trashëgimia kulturore bën pjesë në “mjedis”, për rrjedhojë hartimi i dokumentacioneve teknike dhe ligjore, i planeve të zhvillimit urban, duhet të jenë në përputhje me mbrojtjen dhe sigurinë e mjedisit, në të cilin bën pjesë dhe trashëgimia kulturore.

Gjithashtu, në park dhe në sitin e Klosit do të zbatohen dhe do të veprojnë të gjitha dispozitat ligjore të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen, ruajtjen dhe kujdesin për mjedisin kulturor. Në to do të veprojnë Ligji Nr. 71/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, Vendimi Nr. 57, datë 6.2.2019 “Për kriteret dhe mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur mjedisore”, Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligji Nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar, Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar, si dhe do hartohet Rregullorja e Parkut.

Krahas legjislacionit tonë të brëndshëm, në momentin e hartimit të PM-së janë marrë në konsideratë dhe një sërë aktesh ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore, ku ndër to vlen të përmëndim Konventa e UNESCO për “Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore”, e vitit 1972 dhe hyrë në fuqi në Shqipëri në vitin 1989, e cila ka për qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në nivel ndërkombëtar nga degradimi, prishja apo shkatërrimi. Kjo Konventë i nxit shtetet anëtare të saj që të identifikojnë, mbrojnë, ruajnë, të njohin dhe transmetojnë tek brezat e ardhshëm trashëgiminë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e shtetit apo që i përket kryesisht atij shteti. Shtetet anëtare, me qëllim realizimin e këtyre objektivave, marrin përsipër që të bashkëpunojnë mes njëri-tjetrit përmes ofrimit të asistencës financiare, teknike, shkencore apo çdo formë tjetër ndihme që mundëson realizimin e objektivave të Konventës.

Projekti për Parkun Arkeologjik Bylis është një masë adekuate për parandalimin e tjetërsimit në mënyrë të paligjshme të pasurisë kulturore kombëtare që ndodhet në këtë park. Ky projekt dhe PM-ja janë hartuar në përputhje dhe me objektivat e Konventës së UNESCO e vitit 1970, ratifikuar nga vëndi ynë në vitin 1999, për “Mjetet

e ndalimit dhe të parandalimit të importit dhe eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore”.²

Gjithashtu, në momentin e hartimit të PM-së janë marrë në konsideratë përcaktimet e Konventës Europiane për “Mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike” (e rishikuar), e vitit 1992, ratifikuar nga vëndi ynë në vitin 2007. Qëllimi i kësaj Konvente (të rishikuar) është mbrojtja e trashëgimisë arkeologjike si një burim i trashëgimisë europiane, dhe si mjet i cili shërben për studime historike dhe shkencore. Konventa përcakton si elementë të trashëgimisë arkeologjike të gjitha rrënojat, objektet dhe çdo gjurmë tjetër e njerëzimit nga epokat e kaluara, ku: i) ruajtja dhe studimi i të cilave ndihmon në rigjurmimin e historisë së njerëzimit dhe lidhjet e saj me mjedisin natyror; ii) për gërmimet dhe zbulimet e të cilave dhe metodat e tjera të studimit të njerëzimit dhe mjedisit përkatës janë burimet kryesore të informacionit; dhe iii) të cilat janë të vendosura në cilëndo zonë brenda juridiksionit të shteteve anëtare të Konventës. Sipas Konventës, trashëgimia arkeologjike përfshin strukturat, konstruksionet, grupet e ndërtesave, vendet e zhvilluara, objektet e lëvizshme, monumentet e llojeve të tjera, si dhe konteksti i tyre, qofshin mbi tokë ose nën ujë. Çdo shtet anëtar angazhohet që gërmimet arkeologjike të jenë në përputhje me këtë akt.

Legjislacioni shqiptar në fushën e trashëgimisë kulturore ka bërë përparime drejt përafrimit të tij me *acquis* e BE-së. Disa prej parimeve kryesore të legjislacionit të BE-së mbi trashëgiminë kulturore janë pjesë tashmë edhe e legjislacionit tonë të brëndshëm, fakt i cili gjen pasqyrim në Ligjin e ri Nr. 27/2018 dhe në aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij. Ky legjislacion po hartohet dhe përditësohet me asistencën e ekspertëve të vendas dhe të huaj, dhe pasqyron kërkesat e konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare në të cilat vëndi ynë është palë.

Korniza ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore bazohet në Kushtetutë, Konventat ndërkombëtare ku vëndi ynë aderon, legjislacionin e brëndshëm dhe aktet nënligjore mbështetëse, vendimet e qeverisë, urdhërat dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për kulturën.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore si dhe kalimi i saj nga një gjeneratë në tjetrën, janë detyra sfiduese dhe kërkojnë marrjen e masave ligjore adekuate. Për t’i kryer këto

² Nga ana e ligjvënësit i është kushtuar rëndësi faktit të përafrimit të legjislacionit me *acquis* e BE-së, ku si rrjedhojë Ligji Nr. 27/2018 është përafuar pjesërisht me Direktivën 2014/60/BE të Këshillit të Europës dhe Parlamentit Europian, datë 15 maj 2004, “Për kthimin e pasurive kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar” dhe Rregulloren 116/2009/BE të Këshillit të Europës, datë 18 dhjetor 2008, “Mbi eksportin e mallrave kulturore”.

detyra në mënyrë gjithëpërfshirëse, nevojitet një kuadër ligjor i plotë dhe një mënyrë e veçantë menaxhimi e cila rregullohet nga plani i menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Në përfundim, PM-ja për parkun arkeologjik Bylis dhe Klos përbën në thelb një koncept të integruar të planifikimit dhe veprimit, hartuar konform të gjitha akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare të ratifikuara, i cili përcakton synime dhe masa për mbrojtjen, konservimin, përdorimin dhe zhvillimin e parkut arkeologjik në përputhje me interesat historiko-ekonomike të zonës dhe të vëndit tonë, kjo me qëllim për ta shndërruar Bylisin në një atraksion turistik kulturor.

3. PËRSHKRIMI I PASURISË KULTURORE

PËRSHKRIMI I DETAJUAR I PASURISË KULTURORE, KARAKTERISTIKAT, INTEGRITETI, AUTENTICITETI, KUFIJTË, KOORDINATAT GJEOGRAFIKE, HARTA, FOTOGRAFI, SKICA, DHE STATUSI LIGJOR QË MBRON PASURINË KULTURORE.

3.1 KOMPLEKSET MONUMENTALE NË BYLIS DHE RRËNOJAT E KLOSIT

Në jetën e tij rreth 1,000 vjeçare, që nga themelimi rreth mesit të shek. IV p. Kr. dhe deri në braktisjen e tij në fund të shek. VI p. Kr. Bylisi pati dy periudha të mëdha të lulëzimit ekonomik e kulturor, të cilat janë materializuar përmes monumenteve shoqërore, apo private që formuan fizionominë arkitektonike të qytetit.

Periudha e parë është ajo e antikitetit klasik ilir, që përmbledh jetën e qytetit nën administrimin e Koinonit të Bylinëve në shek. IV-I p. Kr. dhe që vazhdon në pikëpamjen arkitektonike edhe në periudhën e administrimit nga Colonia Iulia Byllidenses dhe pushtetit provincial romak në shek. I p. Kr. deri në shek. III m. Kr.

Periudha e dytë përkon me Antikitetin e Vonë, shek. IV-VI m. Kr., kur Bylisi i takon administrativisht Perandorisë së Bizantit, duke pësuar ndryshime themelore në fizionominë e tij arkitektonike.

3.1.1 MONUMENTET E PERIUDHËS ANTIKE KLASIKE TË BYLISIT

Fizionomia e plotë urbane-arkitektonike e Bylisit mori formë rreth mesit të shek. III p. Kr, rreth një shekull pas themelimit të tij, si rezultat i investimeve që bëri komuniteti politik i njohur si Koinoni i Bylinëve, si dhe i rritjes së nivelit të cilësisë së jetës nga pasurimi elitave qytetare. Dallohen tre komplekse të rëndësishme monumentale që mund të përmbliidhen në:

- Muret rrethuese të qytetit, me hyrjet dhe kullat si elemente bazë arkitektonikë.
- Agoraja, me teatrin, stadiumin, stoat dhe ndërtesat e tjera publike.
- Rrjeti rrugor hipodamik me banesat private.

Muret rrethuese

Muret rrethuese të Bylisit janë nga më të ruajturat e më madhështoret ndër fortifikimet antike ilire të mesit të shek. IV p. Kr. Në një gjatësi prej 2250 m ato rrethojnë një sipërfaqe prej 30 ha, në të cilën shtrihet qyteti antik me tri ndarjet e

brendëshme të tij: agoranë, për veprimtaritë shoqërore e kulturore; zonën rezidenciale për banesat dhe *euhorionin* për strehimin e popullsisë së fshatrave në raste luftash

Planimetria e murit rrethues është e thjeshtë, në formën e një trekëndëshi, i cili mbetet i hapur vetëm për rreth 200m, mbi shkëmbinjtë e pakalueshëm të anës jugore. Në kthesat e murit rrethues kanë qenë vendosur pesë kulla të tjera, të cilat shërbenin për vendosjen e rojeve, por edhe forconin qëndrueshmërinë e mureve. Deri tani janë zbuluar tetë porta, që siguronin lëvizjen e shpejtë të banorëve dhe udhëtarëve në qytet, që cilësohen me nr.1-8, sipas rendit të zbulimit. Kalimi përmes tyre kontrollohej nga roje të vendosura në kullat që ngriheshin mbi harqe në korridoret e hyrjeve. Porta nr.4 në anën lindore ka pasur pamjen e një ndërtese të vërtetë me përmasa 10,85 x 8,45 m dhe kishte një lartësi rreth 9 m. Porta nr. 5 i shërbente kryesisht agorasë për hyrjen direkte të pjesëmarrësve në veprimtaritë që zhvilloheshin atje. Një element interesant përbën oborri i fortifikuar, që i ka qenë shtuar murit rrethues në këndin verior të tij në një periudhë të dytë ndërtimi, për të siguruar hyrjen kryesore të qytetit nga goditjet e litobolëve.

Muret me gjerësi prej 3,50 m janë ndërtuar prej blloqesh gëlqerore të punuara në forma katërkëndëshe dhe të vendosura në rreshta pothuaj të barabartë me lartësi 0,55-0,65 m, të johur si teknika izodomike. Struktura e tyre është e tipit emplekton, ku vetëm dy faqet e jashtme të murit përbëhen prej blloqesh, ndërsa brenda tyre ka një mbushje prej gurësh të vegjël, që lidhet nga blloqe tërthore me faqet. Lartësia e murit nga jashtë lëvizte nga 8-9 m, ndërsa nga brenda kishte një shteg rojesh në lartësinë 3,50-5,30 m. Muri rrethues i Bylisit ka qenë pjesë e një sistemi fortifikimesh të krijuar rreth mesit të shek. IV p. Kr. në qytetet ilire Amantia, Olympe (Mavrovë), Partha (Berat), Përsqop pranë Petrelës, Zgërdhesh pranë Krujës, që lidhet me zhvillimin ekonomik shoqëror të Ilirisë së Jugut, si dhe me forcimin e Mbretërisë Ilire në prapatokën e kolonive helene të Dyrrahut dhe Apollonisë.




FIGURA 2 - PLANIMETRIA E QYTETIT ANTIK TË BYLISIT GJATË SHEK. IV-I P. KR., SIPAS N. CEKA, P. NAUPI, O. CEKA.

Një periudhë e dytë ndërtimesh u realizuan në fortifikimet e Bylisit në kushtet e luftrave që u zhvilluan në territorin bylin ndërmjet viteve 230-167 p.Kr. Në këtë periudhë u ndërtua oborri i fortifikuar në anën veriore të qytetit, për t'i bërë ballë goditjeve me makina luftarake. Për këtë qëllim u ndërtua edhe një kullë e rumbullakët me diametër 9,60 m, me parete të trefishta, që siguronin qëndrueshmërinë e saj ndaj goditjeve të litobolëve, por edhe mund të mbanin peshën e maqinave gurhedhëse të instaluar mbi kullë.

Muret rrethuese të Bylisit u ruajtën pa ndryshime të dukshme edhe kur qyteti u shndërrua në koloni romake, me një dekret të veçantë të Augustit, siç vërtëtohet nga mbishkrimi latin i ruajtur në hyrjen nr.5.

Me fortifikimin e tij të fuqishëm dhe sipërfaqen e madhe të rrethuar brenda tyre Bylisi ishte kryeqendra politike, por edhe uhtarake e Koinonit të Bylinëve. Territori dhe pasuria e banorëve të tij mbrohej nga një sistem i plotë fortifikimesh, ku bënin pjesë qytetet e Klosit, Gurëzesës (Eugenium) dhe Margëlliç (Bargulum), si dhe kështjellat në Kalivaç dhe Rabie.

Agoraja dhe monumentet e saj

Agoraja ishte sheshi i mbledhjeve dhe i veprimtarive kryesore shoqërore, politike dhe kulturore të qytetit dhe, në veprimtari të caktuara, edhe të banorëve të tjerë të Koinonit të Bylinëve. Hapësira e saj ka qenë rezervuar që në fillim të themelimit të qytetit në qendër të anës jugore, në pjesën më të lartë dhe piktoreske të kodrës ku u shtri qyteti. Sheshi i agorasë ka formën e një katërkëndëshi të rregullt, tipike për agoratë e qyteteve të *Magna Grecias* (Italia e Jugut). Monumentet ishin vendosur në dy rrafshje me lartësi të ndryshme, të cilat lidheshin nëpërmjet shkallëve të stadiumit dhe të teatrit.

Hapësira e agorasë ndahej nga qyteti nëpërmjet një muri dekorativ nga ana e veriut dhe nga muret e stoas së madhe. Dy hyrje monumentale lejonin futjen e qytetarëve nga ky krah, ndërsa nga ana jugore hyrja bëhej nga pora nr.5 e qytetit. Prej këtu hynin banorët e qendrave të tjera byline, sepse agoraja i përkiste të gjithë qytetarëve të koinonit.



FIGURA 3 - AGORAJA E BYLISIT ME MONUMENTET KRYESORË: 1. PROPILEA; 2. PRYTANEIONI; 3. ARSENALI; 4. STOA A 5. STADIUMI; 6. CISTERNA; 7. TEATRI; 8. KATAGOGION; 9. STADIUMI; 10. STOA B; 11. TERMET; 12. GIMNAZI; 13-14. TEMPULLI

Ndërtimi i agorasë ka qenë realizuar rreth mesit të shek.III p.Kr. sipas një plani të vetëm, që përfshinte harmonizimin e vendosjes së teatrit, stoave, stadiumit, gimnazit dhe ndërtimeve të tjera publike. Ky ishte vendi ku bëheshin mbledhjet politike dhe ku realizoheshin festat, shfaqjet teatrale, lojrat sportive dhe ceremonitë fetare. Agoraja e ruajti rolin si qendër publike e qytetit edhe në periudhën e kolonisë, kur u

transformua në forum. Gjatë kësaj periudhe u rindërtua teatri dhe u ndërtuan disa monumente, siç e dëshmojnë mbishkrimet latine të kohës së Augustit, Vespasianit, Hadrianit dhe Antonin Piut. Dy monumente, ende të pagërmuar plotësisht, formuluan pamjen e re të forumit gjatë sundimit të perandorit August. Në sheshin veriperëndimor të agorasë u ngrit tempulli kushtuar Augustit, i realizuar në përmasa të mëdha me ordrin jonik. Në pjesën jugperëndmore u ndërtuan termet, një monument gjithashtu madhështor me sipërfaqe rreth 1000 m².

Propiletë, prytanioni dhe arsenali

Muri ndarës i agorasë, që shënonte kufirin e saj me zonën rezidenciale të anës veriperëndimore të qytetit, ruhet mirë në të gjithë gjatësinë e tij prej 200 m, i ndërtuar me blloqe gëlqerorë me forma katërkëndëshe, të profiluar me një kornizë zbukuruese. Duke pasur një karakter kryesisht dekorativ, ai shërbente edhe si mbështetje e tre ndërtimeve të rëndësishme, që ishin Stoa A, Prytaneioni dhe Arsenali. Në mesin e gjatësisë muri i agorasë përshkohej nga Propiletë, që ishin hyrja monumentale për në agora me një gjerësi prej 9.20 m. Ruhet mirë bazamenti, që përbën edhe stilobatin e një kolonade jonike me tre kolona dhe dy pilastra si kufizuese të katër kalimeve.



FIGURA 4 - BYLIS. PROPILETË, PRYTANEIONI DHE ARSENALI. FOTO O. CEKA

Pas kalimit të propileve vizitori antik gjëndej para perspektivës së shkallareve të stadiumit në krahun e majtë, ndërsa në krahun e djathtë kishte një ndërtim me përmasa 20,10 x 5,80 m, të ngritur mbi murin e agorasë, që mendohet se ka qenë prytaneioni, zyra e funksionarit më të lartë ekzekutiv të koinonit. Ruhet planimetria me dy kthina anësore dhe një cardak të zbukuruar me një kolonadë të ordërit dorik, nga i cili janë gjetur gjatë gërmimeve një numër i konsiderueshëm elementësh.

Në perëndim të prytaneionit, por me një disnivel prej 3 m, gjëndet një ambient i mbyllur me përmasa 18,20 m x 6,20 m, i ndërtuar prapa murit të agorasë, përmes të cilit komunikonte nëpërmjet një porte. Një rradhë kolonash tetëkëndëshe shërbenin për të mbajtur dyshemenë e katit të parë, i cili duhet të ngrihej mbi rrafshin e agorasë. Vendosja e bankinave prej blloqesh katërkëndësh në anët e ambientit dëshmon se ka qenë përdorur për ruajtjen e trofeve, apo si një arsenal për armët. Ambienti ka qenë rindërtuar në fillim të shek. I m.Kr., duke përdorur një muraturë të tipit *opus reticulatum*.

Në sheshin në Jug të prytaneionit dhe arsenalit është zbuluar një bazamenti në formë katërkëndëshe me përmasa 5,88 m x 7 m i ndërtuar me një bërthamë prej çakulli e llaçi dhe një veshje blloqesh kuadratike të lidhura me shufra hekuri e plumb. Nga studimi gjeofizik dhe sondazhet paraprake të vitit 2021 rezulton që ai të jetë altari i një tempulli të madh të ordërit jonik kushtuar Augustit.

Stadiumi dhe cisterna e tij

Stadiumi i Bylisit paraqet një zgjidhje të veçantë në krahasim me stadiumet në formë patkoi të qyteteve antike. Për shkak të përshtatjes ndaj terrenit ai ka vetëm një krah, që mbështetet në pjerrësinë e terrenit në një gjatësi prej 134 m, duke plotësuar standartn prej 180 m me zgjatjen e pistës përpara teatrit. Veçoria më tipike e stadiumit të Bylisit është ndërtimi i një sterc gjigande uji nën pistën e krahut verior të tij.



FIGURA 5 - STADIUMI DHE CISTERNA E BYLISIT. FOTO O. CEKA

Kjo është edhe pjesa ku ruhet më mirë shkallarja e stadiumit e ndërtuar me blloqe katërkëndëshe gëlqerore. Ruhen 19 shkallë me lartësi 0,30 m dhe gjerësi 0,40 m. Në përmasa të tilla ato nuk ofronin vend për uljen e spektatorëve, të cilët ishin të detyruar

të ndiqnin garat sportive duke qëndruar më këmbë. Pjesa jugore e stadiumit ruhet vetëm në pak rradhë, por dallohen shkallinat 0.58 m (dy këmbë) të gjera, që shërbenin për lëvizjen e spektatorëve të vendosura në largësi të barabartë prej 9.50 m. Në një bllok të radhës së parë të shkallares ka qenë skalitur një mbishkrim në gjuhën greke, që përkthehet: “Kur ishte prytan Aleksomas, Botihu, biri i Lykiskut, ngriti mbishkrimet (për lirimin e tij nga skllavëria), sipas ligjit”. Në këtë pjesë të stadiumit, gjatë gërmimeve, janë gjetur disa tesera të rrumbullakëta prej bronzi, me mbishkrimin Byllis, dhe me një vrimë në mes, për t’u mbajtur të lidhura. Këto s’janë gjë tjetër veçse biletat për t’u futur në stadium apo teatër, të cilat spektatorët bylinë i mbanin të lidhura në brez, ngaqë veshjet e asaj kohe nuk kishin xhepa.

Stera, e cila shërbente për të mbledhur ujrën e shirave nga shkallarja e stadiumit dhe, me sa duket, nga çatia e stoas së madhe, ka formë katërkëndëshe 50.90 x 4.20m dhe thellësi 6.46 m, matur nga brenda. Në këtë mënyrë ajo përbënte një rezervuar të madh uji prej 970 m³, pra rreth 970.000 litra që depozitoheshin gjatë dimrit dhe shërbenin për të furnizuar me ujë qytetarët e shumtë, që mbledheshin në agora gjatë veprimtarive politike, shfaqjeve teatrale, apo garave sportive. Stera ka qenë e ndërtuar e gjitha nën sipërfaqen e tokës, me paretet të gdhendur pjesërisht në shkëmb, apo duke u plotësuar me muraturë blloqesh katërkëndëshe.




FIGURA 6 - CISTERNA E STADIUMIT TË BYLLISIT. RIKONSTRUKSION VIRTUAL NGA O. CEKA.

Për të mbajtur presionin e paretëve dhe për të mënjeluar infektimin e gjithë ujit në raste të veçanta, brendia e sterës është e ndarë në gjashtë hauze nëpërmjet mureve tërthorë. Stera mbulohej me një sistem harqesh prej blloqesh gëlqerorë, mbi të cilët shtroheshin pllaka guri në nivelin e pistës së stadiumit duke lënë të lirë pamjen e spektatorëve drejt garave. Për izolimin e ujit, por edhe ruajtjen nga infiltrimet e papastërta, stera ka qenë e suvatuar me llaç të përzier me thërmija qeramike. Përgjatë

shkallares së stadiumit ruhet sistemi i mbledhjes dhe dekantimit të ujit, i përbërë prej lugjesh të mëdha guri. Në bazë të teknikës së ndërtimit dhe gjetjeve arkeologjike, ndërtimi i stadiumit dhe sterës së tij i takon periudhës së madhe të formulimit arkitektonik të agorasë, rreth mesit të shek.III p.Kr., por ajo vazhdoi të përdorej pandërprerje deri në Antikitetin e Vonë, kur i shërbeu edhe termeve të periudhës së Justinianit.

Teatri

Teatri është monumenti më i rëndësishëm i Bylisit të periudhës antike. Bashkë me stoan e madhe dhe stadiumin ai ka përcaktuar kompozimin arkitektonik të agorasë rreth mesit të shek.III p.Kr. Për ndërtimin e teatrit është zgjedhur këndi juglindor i agorasë, ku ngritja e menjëhershme e terrenit jepte mundësi për shfrytëzimin e shpatit për ndërtimin e shkallareve.

Vizitorit që vinte nga stadiumi, apo futej në qytet nga porta nr.4, teatri i shfaqej përpara si një ndërtim madhështor, me godinën e skenës në sfondin e shkallares. Dy mure mbajtëse anësore e theksonin këtë perspektivë, ndërsa kolonada dorike e portikut të godinës së skenës krijonte një monumentalitet të panjohur për teatrot e kohës. Dy bazamente përpara teatrit shënojnë vendet ku kanë qenë vendosur skulptura të Dionisit, apo muzave. Një hyrje ballore i shërbente aktorëve, për të kaluar në kthinat e prapaskenës, ndërsa spektatorët kalonin në paradoset e zbukuruara me harqe dekorative, sipas një modeli të zbatuar edhe në Dodonë. Frizi i saj zbukurohej me rozeta dhe kurora dafine, që simbolizonin çmimet që u ipeshin fituesve të konkurseve teatrale.



FIGURA 7 - TEATRI I BYLISIT. FOTO O. CEKA

Elementet arkitektonikë të zbuluar në gërmimet arkeologjike ndihmojnë në plotësimin e rikonstruksionit ideal të teatrit. Përpara spektatorëve të ulur në shkallaret e teatrit ngrihej një proskenë e ulët prej rreth 3 m, e zbukuruar me një kolonadë jonike, me një arkitra të dekoruar me motive floreale. Ai mbante tribunën ku luanin aktorët. Prapa tyre ngrihej sfondi arkitektonik i skenës, i trajtuar me një kolonadë dorike, nga e cila ruhen, gjithashtu, disa pjesë kolonash dhe përbërës të antablementit. Godina e skenës ndahej nga spektatorët prej orkestrës gjysmërrethore. Ky ishte vendi ku qëndronte kori, i cili përfaqësonte një element të përhershëm në dramën antike. Orkestra qarkohej nga një kanal me pllaka guri për mbledhjen e ujrave të shirave, të cilët, nëpërmes orkestrës dhe poshtë godinës së skenës, përcilleshin jashtë teatrit. Në një kënd të orkestrës zinte vend edhe altari i punuar në një bllok gëlqeror të Bylisit nga një artist vendës, i cili paraqet një aktor me maskë komike të hipur mbi altarin e Dionisit. Hitoni i shkurtër tregon se aktori luan një skllav, i cili sfidon me një gjest banal pronarin e tij. Sipas zakonit antik skllavi që ndiqej për t'u ndëshkuar nga i zoti i tij, mund të srehohet në teatër, derisa të ndërhyej për ta falur.

Shkallarja e teatrit ka formën e një gjysmërrethi me diametër 78 m. Pjesa qendrore e saj ka qenë thelluar në faqen shkëmbore të kodrës, ndërsa në të dy anët ngrihej mbi mure mbajtëse. Prej tyre ruhen pjesërisht vetëm muret ballore të analemave, të cilat, në ndryshim nga teatrot greke, e mbyllin shkallaren në një vijë të drejtë. Lartësia e përgjithshme e shkallares ka qenë 16 m, e cila në një lartësi prej 0,40 m të ndenjësive, dëshmon se ka pasur 40 shkallë. Numri i përgjithshëm i shikuesve që mund të ulej në to llogaritet në rreth 7,500 spektatorë në krahasim me kapacitetin prej 10 000 spektatorësh të teatrit të Apollonisë. Gjatë gërmimeve u gjetën vetëm pak ndenjësive të punuara në blloqe guri gëlqeror. Pjesa më e madhe e tyre ishin thyer, apo ripërdorur në murin bizantin të shek. VI m.Kr., apo në termet e Justinianit. U gjetën edhe disa ndenjësive të proedrisë, radhës së parë, ku uleshin personalitetet e qytetit. Një rradhë pllakash orthostate, të gjetura gjithashtu gjatë gërmimeve, duket se shërbenin për të veçuar proedrinë nga pjesa tjetër e publikut. Ato janë të zbukuara me kurora, të cilat simbolizojnë çmimet që i jepeshin dramaturgëve fitues. Sipas traditës antike, shfaqjet teatrale ishin edhe një konkurs midis dramaturgëve më të mirë.



FIGURA 8 - PAMJE DHE RIKONSTRUKSION VIRTUAL I PARODOSIT VERIOR. FOTO N. CEKA. RIKONSTR. N. CEKA-S. ÇELA.

Përmasat e mëdha të teatrit të Bylisit ku ulej një numër i madh spektatorësh dëshmon se ata nuk ishin vetëm qytetarët e Bylisit, por vinin nga të gjithë vendbanimet e Koinonit të Bylinëve. Pjesëmarrja masive të një popullsie, të cilën ende Plini i shek. I m.Kr. e quante barbare, pra jogreke, të bën të mendosh se shfaqjet teatrale nuk i drejtoheshin vetëm një elite të edukuar me gjuhën e kulturës së kohës, që ishte greqishtja, por me gjuhën e popullit, pra me ilirishten.

Teatri i Bylisit u përdor edhe në periudhën e kolonisë romake, duke pësuar një restaurim themelor. Ndërtesa e skenës u prish, duke ngritur vetëm një *frons scenae*, një fasadë me mur tullash mbi një bazament blloqesh gëlqerore, si ajo e Butrotit. Kjo u bë për të zgjeruar sheshin e orkestrës, ku zhvilloheshin ndeshjet me gladiatorë, si pjesë e pandarë e mënyrës së jetesës së kolonisë romake të vendosur në Bylis.

Stoat A dhe B

Ndërtimi i stoas më të madhe të Bylisit, të cilësuar si **Stoa A**, përkon me fillimin e ndërtimeve monumentale në agoranë e Bylisit reth mesit të shek.III p. Kr., siç e dëshmon vazhdimi i murit verior të agorasë si mur i vetë stoas. Qëllimi i ndërtimit të stoas ka qenë kufizimi i agorasë nga ana veriore, por edhe mbrojtja e hapësirës së saj nga erërat e ftohta. Për këtë arsye ajo është ndërtuar në formën e gërmës L në një gjatësi të përgjithshme prej 144 m. Në projektimin e stoas arkitekti bylin ka adaptuar tipin apolloniat, të zhvilluar në dy kate të ndarë nga brenda në të dy katet në dy rrugë nëpërmjet kolonadave aksiale. Mbivënia e kolonadës jonike mbi atë dorike në fasadën e monumentit përbën, gjithashtu, një ndjekje të modelit apolloniat, së bashku me përdorimin e kolonave dorike tetëkëndëshe.



FIGURA 9 - STOA A E BYLISIT. PAMJE E KRAHUT LINDOR. FOTO N. CEKA

Pjesa lindore e stoas, e cila ka përmasa 67 m x 11,40 m, ruhet në gjendje më të mirë edhe për faktin se ka qenë gdhendur pjesërisht në shkëmb. Vrimat e trarëve që mbanin dyshemenë e katit të dytëmundësojnë llogaritjen e lartësive të dy kateve, ndërsa ruajtja e stilobatit dhe e disa trungjeve të kolonave jep mundësi të bëhet një rikonstruksion ideal i kësaj pjese të stoas. Një hapësirë prej 4 m, që shërbente si hyrje dytësore në agora, e ndan këtë krah të stoas nga krahu verior që ka pasur një gjatësi prej 73 m, por një gjerësi të njëjtë me pjesën tjetër. Stilobati me gjurmët e kolonave tetëkëndëshe është ruajtur më mirë në pjesën më perëndimore të stoas, ku mbi të ka qenë ndërtuar bazilika A. Gjithashtu, janë gjetur trungje kolonash dhe elemente arkitektonike, të cilat dëshmojnë për të njëjtën mënyrë ndërtimi si në pjesën lindore të stoas. Përpara stoas janë gjetur disa bazamente, të cilat njëlloj si te teatri, shërbenin për ngritjen e shtatoreve.



FIGURA 10 - RIKONSTRUKSION VIRTUAL I STOAS A TË BYLISIT. N. CEKA-K. HODAJ

Stoa A e Bylisit ka qenë përdorur si vend i takimeve dhe i shëtitjeve për qytetarët e lirë, të cilët qarkullonin në të dy krahët e monumentit, duke pasur në mes kolonat.

Gjatë periudhës së hershme të kolonisë romake ka pasur një restaurim të krahut lindor të stoas, ndërsa në shek.III m. Kr. stoa ka qenë shkatërruar dhe në pjesën lindore ka qenë ngritur një faltore e vogël e perendisë Eskulap. Në shek. V m.Kr. në pjesën më perëndimore të stoas u ngrit bazilika A, ndërsa i gjithë krahu lindor i saj u përdor për ngritjen e banesave të kësaj periudhe, në të cilat u ripërdorën si spolie pjesë arkitektonike të stoas.

Stoa B e Bylisit quhet edhe stoa e teatrit, jo vetëm për vendosjen e saj krahu atij monumenti, por edhe sepse ishte ndërtuar në funksion të tij. Shfaqjet teatrale në antikitet lidheshin me festat e Dionisit, që bëheshin në muajt mars-prill. Ato vazhdonin për disa ditë nga mëngjesi deri në mbrëmje, prandaj spektatorët kishin nevojë për një vend çlodhje, për të ngrënë, apo për t'u strehuar në rast shiu.

Për këtë qëllim shërbenin jo vetëm portikët e godinës së teatrit, por edhe një stoa e ndërtuar në krahu të tij, përgjatë gjatë murit rrethues. Stoa ishte një ndërtesë dykatëshe. Ajo kishte përmasat 60 m x 11,40 m (20 x 40 këmbë antike). Shpinën e saj e përbënte muri rrethues, ndërsa nga ana e sheshit të agorasë stoa hapej me një kolonadë dorike në katin e poshtëm dhe me kolonadë jonike në katin e sipërm. Hapësira e brendshme e ndërtesës ndahej në dy pjesë, nga një rradhë kolonash në katin e poshtëm, të cilat mbanin dyshemenë e katit të sipërm, dhe mbi to, një rradhë e dytë që mbante çatinë. Prej ndërtesës ruhet mirë krahu lindor, ku lidhej me teatrin. Këtu u gjetën rrënojat e një furre, ku në shek.VI m. Kr. ishin kthyer në gëlqere skulpturat, elementet arkitektonike dhe mbishkrimet e vetë stoas dhe të teatrit.

Gjimnazi dhe termet romake

Në pjesën jugperëndimore të agorasë, pranë portës nr. 5, janë zbuluar rrënojat e një godine shoqërore, e cila është identifikuar me gimnazin e qytetit për shkak të planimetrisë së saj katërkëndëshe, me një rradhë kthinash që zhvillohen rreth një oborri të brendshëm. Monumenti bënte pjesë në kompleksin arkitektonik të agorasë, siç dëshmon orientimi i tij sipas akseve urbanistike të qytetit. Ai ka qenë ndërtuar në gjysmën e dytë të shek.III p.Kr. me teknikën tipike të kësaj kohe, me blloqe katërkëndëshe, që ruhen vetëm në një rradhë të themelit. Nga një mbishkrim i gjetur në qytetin fqinjë të Klosit, vërtetohet ndërtimi i një gimnazi bylin në kohën e prytanit Aspima Praugu dhe gimnasiarhut Kratilla Mahata.



FIGURA 11 - MURI PERËNDIMOR | GIMNAZIT. FOTO N. CEKA

Ndërtesa e gimnazit ka qenë shkatërruar që në periudhën e krijimit të kolonisë romake dhe mbi të janë ndërtuar termet me një shtrirje prej rreth 1000 m², por me një ruajtje vetëm në nivelin e themeleve. Mbi bazën e tyre, të zbuluar vetëm në pjesën perëndimore të ndërtesës, dallohen *tepidarium*, *caldarium*, *frigidarium*, *praefurnum* dhe katër kthina të tjera. Edhe ky ndërtim i realizuar me teknikën *opus reticulatum*, i ka qenë adaptuar orientimit urbanistik të agorasë. Nga një mbishkrim latin i shek. I m.Kr. dimë se një patron i kolonisë së Bylisit Lucius Domitius Salentinus, kishte ndërtuar një banjë publike me shpenzimet e veta.

Urbanistika e Bylisit dhe banesat private

Ndërtimi i Bylisit, si një iniciativë e Koinonit të Bylinëve, kishte parashikuar jo vetëm krijimin e një fortifikimi të sigurt, por edhe sigurimin e një jete normale të banorëve të tij. Që në planin fillestar ishin përcaktuar tri zona kryesore brenda mureve rrethuese. Në qendër të anës jugore, në pjesën më të lartë dhe piktoreske, një sipërfaqe rreth 4 ha i ka qenë rezervuar veprimtarive shoqërore, politike e kulturore të qytetarëve nëpërmjet veçimit të agorasë me një mur ndarës dekorativ.



FIGURA 12 - PLANI URBANISTIK I BYLISIT NË SHEK. III P. KR. SIPAS N. CEKA, O. CEKA.

Pjesa e dytë, rreth 22 ha, ishte zona rezidenciale e organizuar në një rrjet rrugësh sipas parimit hipodamik. Pjesa e tretë, euhorion, me sipërfaqe rreth 4.4 ha në këndin juglindor të qytetit, nuk përmban ndërtime, sepse ishte e rezervuar për strehimin e banorëve të fshatrave më pasurinë e tyre në rast luftërash dhe rreziqesh të tjera. Ajo komunikon me një hyrje të veçantë në anën lindore, që është edhe rruga më e shkurtër që lidhte Bylisin me Klosin.

Rreth mesit të shek.III p.Kr. mori formën e plotë sistemi urbanistik i Bylisit, i cili i nënshtrohej parimeve hipodamike, pra ndarjes së sipërfaqes së qytetit në një rrjet kudratik rrugësh.

Boshtin e këtij rrjeti e përbënin katër rrugë me gjerësi 8,30 m, të quajtura *plateia*, që kalonin në drejtim veri-jug 134 m larg njëra-tjetrës. Ato ndërpriteshin çdo 69 m nga rrugë tërthore me gjerësi 6,60 m, duke krijuar *insula*, pra ishuj kuadratikë, të ndarë fillimisht në tetë parcela banimi. Midis dy rreshtave të banesave kalonte një rrugicë e vogël, *stenopoi*, shpesh e shkallëzuar, që shërbente edhe për kalimin e ujrave të

shirave. Ndonëse nuk është gërmuar në mënyrë sistematike sistemi hipodamik i rrugëve të Bylist njihet nga zbulimi i pjesshëm i tyre, si dhe nga fotot ajrore. Për qëllime studimi rrugët kryesore Veri-Jug janë emërtuar në shkronjat e mëdha të alfabetit, ndërsa ato Lindje- Perëndim me shifrat romake. Plateia C, që ishte aksi kryesor i rrugëve, kalonte në kurrizin e kodrës së Bylisit dhe ndante zonën e banuar prej asaj të agorasë, e cila kishte një sipërfaqe të barabartë me tri *insula*. Janë zbuluar vetëm katër banesa të periudhës së antikitetit klasik, që janë emëruar sipas rradhës së zbulimit nga A në C.

Banesa A gjendet në anën lindore të Stoa A, në anën tjetër të plateias C, në kryqëzimin e dikurshëm të saj me III, dhe zinte një sipërfaqe prej 30 x 24 m. Në mënyrë që ti përshtatej sistemit ortogonal, banesa ka qenë ndërtuar mbi një terracë të krijuar nga një mur i fuqishëm me kontraforte dhe pjesërisht të gdhendur në shkëmb.



FIGURA 13 - BANESA A E BYLISIT. FOTO O. CEKA

Qendrën e kompozimit të kthinave e përbënte oborri katror me brinjë 9 m, i qarkuar nga një peristil i ordrit jonik. Pas tij vijonte një portik me gjerësi 2,80 m, rreth të cilit zhvilloheshin kthinat. Në anën jugore, menjëherë pas koridorit të hyrjes, gjëndeshin dy kthinat kryesore të banesës, njëra prej të cilave shërbente si andron. Në vazhdim të tyre, në krahun perëndimor, ishin kthinat e shërbimit. Përballë tyre, në këndin jugperëndimor të oborrit gjendej stera, e cila ka qenë thelluar në shkëmb në formën e një dardhe. Ujërat e tepërta të shiut përcillehin jashtë oborrit me anë të një kanali të punuar në blloqe guri, në rrugicën që e ndante banesën me fqinjën e saj nga veriu. Në krahun verior të portikut gjëndeshin kthinat familjare, të cilat janë dëmtuar poshtë nivelit të dyshemesë antikem ashtu si dhe i gjithë krahun lindor. Porta që dilte në plateian III, ka pasur gjerësinë e korridorit, prej 3,50 m. Në të dy anët e saj kishte blloqe katërkëndëshe për t'u ulur. Të dhënat nga gërmimet arkeologjike dëshmuar se banesa

A ka qenë ndërtuar rreth mesit të shek.III p.Kr., njëkohësisht me zbatimin e sistemit ortogonal në Bylis dhe ka vazhduar të banohet pandërprerje deri në gjysmën e dytë të shek. IV m.Kr., duke pësuar ndryshime të pjesshme, por duke ruajtur pamjen e një banese me peristil. Gjatë një rindërtimi në shek.III m. Kr., androni u shtrua me mozaikë shumëngjyrësh me motive gjeometrike të ruajtur pjesërisht. Në shek. V m. Kr. në rrënojat e saj u ndërtua një banesë e thjeshtë me disa kthina.

Banesa B me përmasa 29,5 x 24,8 m, zinte dikur një të gjashtën e një insule, në kryqëzimin midis plateias C dhe asaj IV, në afërsi të murit ndarës të agorasë. Njëlloj si banesa A, ajo ishte e vendosur në një terracë të krijuar nga mure të fuqishme prej blloqesh të punuara trashë, duke niveluar pjesërisht terrenin e pjerrët.




FIGURA 14 - BANESA B E BYLISIT NË RAPORT ME RRUGËT KRYESORE NË SHEK. III P. KR. SKICË NGA O. CEKA.

Qendrën e banesës e formonte oborri katërkëndësh me brinjë 9,6 m, i cili rrethohej nga një kolonadë e ordrit dorik. Korridor i peristilit me gjerësi 3,6 m lidhte kthinat e vendosura në anët lindore e veriore. Ana jugore, ku gjendej edhe hyrja, si dhe ajo përëndimore, e ngritur mbi murin e terracimit, përbënin një hajat të gjatë, që përdorej për veprimtarinë ekonomike. Dhoma kryesore, *andron*, gjendej në krahun lindor dhe ka përmasa 6,4 x 7,7 m. Ajo e ka ruajtur këtë funksion edhe në rindërtimet e mëvonshme të banesës, deri në çshek.III m.Kr., kur muret e saj kanë qenë suvatuar dhe lyer me një kombinim kuadratesh. Oborri ka qenë shtruar me pllaka gëlqerore, për ta mbajtur pastër. Në këndin juglindor gjendet stera, ku mblidhej uji i shirave nga çatia, si rezervë për sezonet e thata. Uji i tepërt përcillej nëpërmjet një kanali në këndin veriperëndimor, për në rrugicën që e ndante këtë banesë nga ato fqinje. Banesa B ka qenë ndërtuar në shek.III p.Kr., nga një familje e pasur dhe ka qenë

përdour pa ndërprerje deri në shek. IV m. Kr. Në shek. V, në rrënojat e saj u ngritën dy banesa dykthineshe me mure të dobët prej gurësh të vegjël me lidhje balte.

Banesa C ishte fqinjë e anës veriore të banesës B, nga e cila ndahej prej një *stenopoi*. Në përdorimin shumëshekullor ajo përfaqëson periudha të ndryshme ndërtimi dhe nuk paraqet vlera të veçanta arkitektonike. Gjatë gërmimit të saj u gjet një kokë mermeri e perandorit Hadrian, që sigurisht është sjellë në këtë banesë nga agoraja, pas thyerjes nga shtati.

Banesa D njihet si **Shtëpia e Terencianëve**, nga gjetja gjatë gërmimeve të dy mbishkrimeve kushtuar dy djemve të tij nga pronari i banesës, Quintus Allius Terentianus. Banesa ka njohur katër periudha ndërtimi, nga të cilat e para i takon shek. III p. Kr. Prej saj është ruajtur një pjesë e stilobatit të oborrit peristil, si dhe pragu i portës që e lidhte me rrugën kryesore në anën jugore të saj.



FIGURA 15 - BANESA E TERENCIANËVE ME ALTARËT. FOTO N. CEKA

Periudha e dytë i takon gjysmës II të shek. II m. Kr dhe shënon një rindërtim rrënjësor të banesës me mure prej gurësh të vegjël të lidhur me llaç balte, ku ambienti më me interes është **lararia**, një faltore e vogël e ngritur në impluvium, me altarë që mbanin dikur statujat e të dy djemve dhe ku janë gdhendur mbishkrimet kushtuar dy djemve

Terentianus. Gjatë gjurmëve u gjet edhe statuja *acefale* prej mermeri e njerit prej tyre. Dy periudhat e tjera të banesës i takojnë Antikitetit të Vonë.

Nga gjurmët e bëra është parë se sistemi urbanistik gjatë gjithë periudhës romake deri në periudhën e shkatërrimeve të mëdha të kryera nga gotët në çerekun e fundit të shek.IV m.Kr. duket se nuk ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Më pas qyteti u rindërtua gati në gjithë sipërfaqen e tij, por me një koncept të ndryshëm urbanistik, u braktis sistemi ortogonal dhe në vend të tij u ndërtuan lagje të veçuara nga njëra - tjetra, të grupuara rreth kishave.

Mbishkrimi i Mark Lolianit

Ndonëse i veçuar nga komplekset monumentale të Bylisit, mbishkrimi i Mark Lolianit përfaqëson një monumet me interes për vizitorët, qoftë për skalitjen e tij në një ambient piktoresk, ashtu edhe për përmbajtjen e tij. Ai gjendet në rrëzë të shkëmbinjëve që kufizojnë *euhorion*-in e Bylisit në anën jugore të qytetit.



FIGURA 16 - MBISHKRIMI I MARCUS LOLLIANUS NË SHKËMBINJË E ANËS JUGORE TË BYLISIT. FOTO N. CEKA

Faqja e shkëmbit, ku është skalitur mbishkrimi ka qenë rrafshuar në formën e një *tabula ansata*, me përmasa 2,03 m x 3,05 m. Mbishkrimi publikonte një dekret të dekursionëve në emër të qytetarit Mark Loliani, i cili me shpenzimet e veta pati ndërtuar një rrugë për karroca, e cila të çonte nga kolonia e Bylisit për në Astacia, duke kaluar në vende të thyera e të rrezikshme dhe duke kapërcyer me një urë lumin Argias.

Gjurmë të kësaj rruge që përmend mbishkrimi të zbuluara së fundi tregojnë se ajo dilte nga porta nr. 5 dhe kalonte pikërisht poshtë mbishkrimit, për të kaluar përrroin e Povlës, që do të ishte Argias, dhe vazhdon në bregun e djathtë të Vjosës, nga ura mbi Vjosë që lidh Poçemin me zonën e Vlorës dhe deri në fushën e Kutës. Në fushën e Kutës ruhen gjurmët e një stacioni rrugor me termen e tij dhe sipas banorëve edhe rrënojat e një ure mbi përrroin e Kutës. Më pas rruga ka ndjekur fushën e Çorrushit dhe Kalivaçit për të vazhduar më pas në grykën e Ylinecit deri në fshatin Buzë Vjosë. Në shumë pjesë të saj ruhen jo vetë muret mbajtësdhe kalldremet, por edhe nike për vendosjen e objekteve votive. Gjerësia e rrrugës në traktet e ruajtura është 2,40 m. Karl Paç (Patsch), në komentin e tij për mbishkrimin mendonte se lumi Argias duhet të ketë qenë Gjanica. Ai e ka datuar mbishkrimin rreth vitit 150 m.Kr.

3.1.2 MONUMENTET E PERIUdhËS SË ANTIKITETIT TË VONË TË BYLISIT

Fizionomia e plotë urbane-arkitektonike e Bylisit në antikitetin e vonë mori formë të plot në fillim të shek. V m. Kr, pas shkatërrimeve të kryera nga gotët në fundin e shek. IV m. Kr. Pas dyndjes gote qyteti i Bylisit pësoi ndryshime të mëdha jo vetëm në fizionomoni e tij urbanistike -arkitektonike por dhe në përbërjen e popullsisë. Banorët e ngelur nga qyteti i braktisur i Apolonisë dhe qendrave të tjera të zonës u vendosën në qytetin e Bylisit. Pasojat që sollën dyndjen bënë të mundur edhe përqaftimin e shpejtë të krishtërimin duke e kthyer në një institucion të rëndësishëm të gjithë jetës politike dhe ekonomike. Në këtë periudhë dallohen tri kategori të rëndësishme monumentale që mund të përmbliidhen në:

- Muret rrethuese të qytetit, me hyrjet dhe kullat si elemente bazë arkitektonikë.
- Monumentet e kultit të krishterë: Katedralja me gjithë kompleksin peshkopal dhe Bazilikat A, C, D, E.
- Sternat, termat dhe banesat private.

Muret rrethuese të qytetit në antikitetin e vonë (Bylis III- IV)

Gjatë antikitetit të vonë Bylisi u pajis me mure rrethues dy herë, së pari në fillim të shek. V, në kohën e sundimit të perandorit Teodosi II dhe më pas në mesin e shek. VI, gjatë sundimit të perandorit Justinian I.

Bylis III. Muret rrethuese të Bylisit u ruajtën edhe kur qyteti u shndërrua në koloni romake. Madje ato ishin pjesërisht të ruajtura në lartësi, edhe në fillim të shek. V m. Kr., por jo në përdorim, kur Bylisi u rifortifikua pas shkatërrimeve që pësoi qyteti nga dyndjet e gotëve në mesin e viteve '80 të shek. IV m. Kr.

Në sistemin e fortifikimit të Bylisit vërehen tri teknika kryesore ndërtimi: me blloqe kuadratike të vendosura në të thatë (opus quadratum) (Bylis I-II); me blloqe kuadratike

të lidhur me Ilaç (Bylis III); muratura me gurë mesatarë e të vegjël të lidhur me Ilaç të bollshëm (opus incertum) (Bylis IV).

Fortifikimi i fazës Bylis III ndjek plotësisht trasenë e fortifikimit të fazës Bylis I -II duke pasur një perimetër prej 2550 m dhe sipërfaqe prej 30 ha. Karakteristikë themelore e planimetrisë së fortifikimit të Bylisit III është se ajo ruan plotësisht të njejtët elementë mbrojtës të fazës së parë, siç janë dhëmbëzimet, kullat, bastionet dhe oborrin e fortifikuar.

Për rindërtimin e murit, përgjithësisht janë përdorur blloqet e rrëzuara të murit të fazës Bylis I, por të vendosura në mënyrë të ç'rregullt dhe të lidhur me njëri-tjetrin me një shtresë të hollë Ilaçi. Kullat për gjatë kurtinave dhe ato në hyrje janë ndërtuar mbi konstruktionet e mbetura të kullave të fazës Bylis I-II duke ruajtur gjithmonë planimetrinë, por duke i shtuar dhe një kat të ri. Hyrjet gjatë këtij rindërtimi nuk kanë pësuar ndryshime në tipologjinë e tyre (tipi tërthor), por vetëm disa ndryshime të vogla që qëndrojnë në ngushtimin apo funksionimin e portave. Pas shkatërrimeve që pësoi qyteti gjatë viteve 547-51 dhe dobësimit ekonomik të Perandorisë Bizantine, sistemi fortifikues i ndërtuar nuk mund ta kryente më funksionin e tij prandaj Justiniani u detyrua të ndërtojë një sistem të ri në sistemi mb të shkaktuara nga dyndjet

Fortifikimi i Viktorinit (Bylis IV).

Pas shkatërrimeve të viteve 547 – 551, Justiniani urdhëroi ndërtimin e mureve rrethuese, por jo në shtrirjen e tyre të mëparshme. Megjithatë, fortifikimi është përsëri i fuqishëm dhe ka një zgjidhje të re dhe të studiuar planimetrike. Për ndërtimin dhe rindërtimin e mureve të Bylisit, sikurse thonë tekstet e mbishkrimeve, u përkujdes Viktorini. Vepra e tij u krye në dy drejtime: në rindërtimin e mureve rrethuese, por edhe në ndërtimin ex novo të tyre. Viktorini shfrytëzoi muret e dy fazave të mëparshme në të gjithë anën perëndimore dhe jugore të qytetit, kurse në anën veriore dhe lindore ai ndërtoi një mur të ri me trashësi 2.20 m, të pajisur me kulla trekatëshe me lartësi 12 m.

Bylis IV përfaqësohet nga muri i ri i ndërtuar gjatë kurrizit të kodrës dhe nga linja perëndimore e fortifikimit të fazës I, II, duke mbyllur kështu vetëm anën perëndimore me një sipërfaqe prej 11 ha ndaj 30 ha të qytetit të lashtë. Ai ka përfshirë kështu brenda rrethimit agoranë e qytetit dhe gjithë tarracat e banuara të anës perëndimore, planimetria e të cilit ka formën e një katërkëndëshi jo të rregullt. Veçanti e murit është ndjekja e linjave pak a shumë të drejta dhe paisja me një varg kullash katërkëndëshe.



FIGURA 17 - BYLIS. MURI I VIKTORINIT. PERIUDHA E PERANDORIT JUSTINIAN (527-565). FOTO S. MUÇAJ.




FIGURA 18 - MBISHKRIMI PËR NDËRTIMIN E MURIT RRETHUES TË BYLISIT NGA VIKTORINI.

Rrethimi i ri ndonëse përfshin brenda ndërtimet kryesore shoqërore, lë para vetes një zonë të mbushur me ndërtime të shumta banimi ku nuk mungojnë edhe ndërtimet shoqërore siç është bazilika D, E, tashmë të gërmuara.

Fortifikimi i anës perëndimore dhe jugore ndjek me besnikëri jo vetëm drejtimin e linjës së vjetër, por edhe trajtimin e elementeve të veçanta mbrojtëse dhëmbëzimet, kullat, hyrjet, duke qenë shpesh vetëm superstrukturë e bazamenteve të vjetra.

Teknika e përdorur në fazën Bylis IV është e njëjtë si në murin e ri dhe atë të rindërtuar, në faqe janë përdorur blloqe të ripërdorur, pjesë arkitektonike, gurë mesatarë të lidhur me llaç, kurse bërthama është bërë me derdhje (gurë dhe llaç të bollshëm).

Në një linjë mjaft të drejtë të trasesë së murit, elementi më tipik i planimetrisë së Bylisit IV janë kullat. Në pjesën që ngrihet mbi murin antik është ndërtuar vetëm një kullë e re (F) dhe janë rindërtuar dhe dy të vjetrat (E dhe G). Kurse nga hyrjet janë ruajtur të tri hyrjet 5, 6, 7, kurse muri në trasenë e re është pajisur me një një hyrje normale (9) dhe një portëz të fshehtë (8).

Të gjitha kullat janë katërkëndëshe me trashësi muresh rreth 1.40 m, por me përmasa të ndryshme në planimetri. Ngjitja për në shtegun e kalimit është bërë pranë sejcilës kullë me anën e një shkallareje.

Meqense kullat në trasenë e re (S, T, U, V, X, Y) ruhen më mire dhe do jenë pjesë programit të restaurimit do të trajtohen veçmas në skemat përkatëse.

Identifikimi dhe datimi i murit të Viktorinit në periudhën e sundimit të perandorit bizantin Justinian (527-565) u bë i mundur nga mbishkrimet e gjetura në Bazilikën e Ballshit, të cilët ishin transportuar atje nga Bylisi.

Terma e Justinianit

E ngritur në perëndim të sternës duke shfrytëzuar ka formë katërkëndëshe 24,50 m x 6,40 m. Dallohen aty apodyterium (dhoma e zhveshjes) ku janë dhe vaskat e ujit të freskët (frigidarium), tepidarium (ambjenti i vakët) , sudatio (banja e djersitjes), caldarium (salla e nxehtë), furra dhe dhoma e zjarrit (prefurnum).



FIGURA 19 - BYLIS. TERMET BIZANTINE PRANË CISTERNËS. FOTO N. CEKA.

Monedhat e shumta prej bronxi (numia) të gjetura në prefurnum, prerje të Justinianit I dhe Baduilës (Totila) e datojnë shkatërrimin e saj në vitet 547 – 551, kurse kohën e ndërtimit të saj e jep një mbishkrimi gjetur në murin rrethues të qytetit, që mund të vij ndoshta nga kjo banjë e gërmuar. Mbishkrimi i skalitur në një tabula ansata, i ruajtur pjesërisht flet pikërisht për ndërtimin e një banje në kohën e Justinianit I. “E Justinianit (sundimtar) shumë të fuqishëm,(...)unë jam banja, (ndërtim?) i dobishëm;(…)por (mbaj emrin) e vetë atij (....)që (...), sipër mbi gjithë (...)”. Duke qenë se terma është pjesë e kompleksit të stadiumit dhe sternës së madhe duhet të ndëryhet për të restauruar pjesët e hipokausit që janë dëmtuar gjatë viteve të fundit, si dhe të bëhen restaurime për pjesët e veçanta të mjediseve sipas gjurmëve të gjetura.

Bazilika B- Katedralja

Katedralja e Bylisit e përbërë nga bazilika, baptisteri dhe kompleksi peshkopal është monumenti më i madh i qytetit për antikitetin e vonë duke zënë një sipërfaqe më shumë se një ha në pjesën më të rëndësishme të tij.



FIGURA 20 - BAZILIKA B E BYLISIT-KATEDRALIA. FOTO N. CEKA

Katedralja, një monument i permasave të mëdha, shquhet për shumëllojshmërinë e vlerave arkeologjike, arkitektonike dhe skulpturore. Arkitektura dhe skulpturat dekorative janë të pasura, ndërsa zgjidhja planimetricke është e ndërlikuar, shpeshherë pa krahasim me shembuj të tjera. Dyshemet e shtruara me mozaik, mbishkrimet, dhe elementët e bakrit dhe baltës, së bashku me veglat e punës, objektet e zbukurimit dhe instrumentët muzikorë, përbëjnë një pasuri të vërtetë. Numri i madh i thesareve të monedhave të gjetura e bën këtë katedrale një shembull të shquar të monumenteve të kultit paleokristian.

Bazilika e katedrales, (B), planifikuar dhe ndërtuar me kujdes, shfaq një trajtim shumë të pasur në pikpamje planimetricke dhe volumore. Korridoret e perparme, atriumi, narteksti, transepti me krahë të spikatur dhe absida gjysmërrethore janë të vendosura në nivele të ndryshme, duke ndjekur njëra-tjetrën me një gjatësi totale prej 67m. Plani i përfunduar i bazilikës karakterizohet nga një strukturë e ngushtë dhe e gjatë, me nefen anësore, narteksin, ekzornarteksin dhe portiket e atriumit të kurorëzuar me galeri, që shtohen lartësisht ndaj faqes së tokës.

Atriumi ka formë katërkendëshe të zgjatur në drejtim L-P me permasa 11,15 m x 6.80 m i rrethuar nga katër portik, si portik i katert është ekzonarteksti. Një sitern në formë dardhe me thellësi 8,45 m është ndërtuar në portikun perëndimor, ndryshe nga rastet e tjera të shumta kur në mesin e oborrit ndërtohej një vaskë e madhe. Ekzonarteksti dhe tre portiqet e tjerë hapeshin ndaj oborrit të atriumit me ane të arkadave të ngritura mbi kolona të vendosura mbi një stilobat të lartë. Mbi kolona kanë qenë vendosur kapitele të trajtuara sipas ordrit të vjetër dorik, kurse në arkadën e katit të dytë që ka ndjekur të njëjtin ritëm kapitelet janë të ordrit jonik. Lartësia e madhe e stilobatit dhe mungesa e shkallëve e ka veçuar plotësisht oborrin nga portiqet.

Planimetria e katedrales




FIGURA 21 - KATEDRAJA DHE KOMPLEKSI PESHKOPAL I BYLISIT. PLANIMETRIA SIPAS S. MUÇAJ.

Në qoshen verilindore të ekzonarteksit është ndërtuar një shkallare që të çonte në katin e sipërm të tij dhe prej andej në të gjitha galeritë e tjera. Narteksi me gjatësi 3.96 m e gjerësi 14,40 m, i ndjekur në veri dhe jug nga anekse, hapet në nefin qendror përmes një tribeloni, ndërsa ndaj nefeve anësore me dyer të thjeshta.

Naosi me gjerësi 14,40 m dhe gjatësi 24,70 mpërbëhet nga tre nefe me gjerësi; qendrori 7,75 m, veriori 2,30 m dhe jugori 2,90 m. Një ambon, me një zgjidhje të platformës tepër orgjinale, është vendosur në jug të aksit gjatësor të nefit qendror, ndërsa në nefin jugor ka një bankinë. Nefet ndahen njeri nga tjetri me harkadë të ngritur mbi kolona dhe këto të fundit mbi piedestale të vendosur mbi një stilobat të lartë. Me të njëjtin ritëm vazhdon dhe harkada e galerive, e ngritur mbi kolona dhe piedestale të njëjta si dhe kati i parë. Për katin e parë janë përdorur kapitele jonik me impost, kurse për galeritë kapitele me katër gjethe. Kapitelet jonik me impost të punuar në gurë gëlqeror nga i Bylisit imitojnë tipet prej mermeri të Konstandinopojës, kurse ata me katër gjethe janë trajtuar në mënyrë të veçantë. Kapitelet përveç

dekoracionit të gdhendur janë zbukuruar dhe me bojë, një traditë e ndeshur që nga periudha antiketite ilir në Bylis. Në galeri parapetet janë realizuar me pllaka të zbukuruara vetëm nga faqa e nefit qendror ku kanë qenë instaluar dhe stativa për fiksimin e ndriçuesve të shumtë. Sanktuari ka ndryshuar përmasat nga faza e parë e ndërtimit në atë dytë.

Skulptura dekorative arkitektonike dhe ajo e paisjeve liturgjike e gjetur në këtë bazilikë është më e shumtë dhe më shumë variacione se ato të gjetura në bazilikat e tjera të Bylisit dhe ndahet në dy grupe: grupin e parë e përbëjnë ato të gdhendura në gurë gëlqeror, kurse grupin e dytë ato prej mermeri të importuar. Shumë nga skulptura e Katedrales është transportuar në bazilikën e Glavinicës në periudhën mesjetare.



FIGURA 22 - BYLIS, BAZILIKA B. VËLLEZËRIT SIMON DHE ANDREA NË PESHKIM NË LIQENIN E GALILESE.

Dyshemeja e ekzonarteksit, nefeve, sanktuarit dhe krahut verior të transeptit janë shtruar me mozaikë, duke shënuar dhe sipërfaqen më të madhe me mozaikë të zbuluar deri tani në territorin e Shqipërisë. Motivet dhe skenat janë tepër të larmishme, aty gjejmë skena nga jeta e përditëshme e barinjëve, por dhe paraqitjet nga jeta e peshkatarëve të Galilesë si ajo e vëllezërve Simon dhe Andrea.

Një numër i madh mbishkrimesh gjenden në dyshemenë e nefit qendror dhe në pjesën më të madhe ata i përkasin riparimeve të bëra gjatë periudhës së Justinianit. Të gjithë muret kanë qenë veshur me afreske por nga ata janë ruajtur vetëm ata me motive gjeometrike që i përkasin paneleve të brezit të parë.

Nga narteksi për në jug futesh nëpërmjet një tribeloni në kompleksin e pagëzimit. Nëpërmjet një parasalle kalon në sallën e pagëzimit dhe në dy dhoma të tjera të pajisura me bankina dhe lavamane që kanë shërbyer për përgatitjen e të rinjve

(katekumenus) me mësimet e dogmës së krishterë. Vaska e pagëzimit ka ndryshuar jo vetëm formën por dhe thellësinë e saj në varësi të mënyrës së pagëzimit. Ajo furnizohesh me ujë të ngrohtë nga një furrë të ndërtuar në oborin në lindje të pagëzimit. Shkallët e ndërtuara në njërin nga dhomat kanë shërbyer për t'u ngjitur në katin e sipërm jo vetëm të kompleksit të pagëzimit por dhe në ato të kompleksit peshkopal, që është i ndërthurur me baptisterin.

Kompleksi peshkopal, me një numër të madh kthinash, kalimesh, oborresh, sternash është akoma në proces gërmimi. Kati i parë i këtij kompleksi ka qenë përdorur për depo rezervash ushqimore, punishte dhe stalla dhe përfundimi i gërmimeve do të ndihmojë për të kuptuar më mirë rolin që luan kleri në një qytet të antikitetit të vonë. Numrin i madh i elementëve arkitektonikë të dritareve tregojnë se ndërtimet në Bylis kanë qenë tepër të ndriçuara duke vazhduar traditën mesdhetare.

Katedralja gjatë një periudhe gati 200-vjeçare ka tri faza të rëndësishme ndërtimi, e para në fundin e shek. IV ose fillimin e V m. Kr.; e dyta në vitet 470 dhe fundit lidhet me periudhën e sundimit të Justinianit para vitit 547 m. Kr. pësuar ndryshime të shumta, Në fazën e parë një bazilikë trenefshe me një narteks dhe portik dhe një baptister të thjeshtë; në fazën e dytë shtohet atriumi dhe galeritë dhe atriumi shndërrohet në një kompleks; në fazën e fundit ndërtohet kompleksi peshkopal.

Kompleksi Peshkopal.

Kompleksi peshkopal përfaqëson deri tani vetëm pjesën ekonomike të peshkopatës së Bylisit, se pallati i peshkopit dhe hoteleria përkatëse janë ende të pa gërmuara. Nga pjesa e kompleksit me vlera të veçanta për t'u vizituar është punishtja e verës dhe sistemi i furnizimit me ujë të ftohtë. Sistemi i furnizimit me ujë i qytetit ka qenë i projektuar që në fillimet e tij, ku përveç banesave që kanë secila sternën e saj, janë edhe ato publike.

Bazilika A

Bazilika është ndërtuar brenda agorasë së periudhës helenistike, duke shfrytëzuar pjesërisht mbetjet konstruktive të krahut verior të stoas në formë L në një pozicion zotëruar ndaj pjesës veriperëndimore të qytetit. Pjesët përbërëse të këtij monumenti janë ngritur në nivele të ndryshme, duke u ngjitur gradualisht nëpërmjet një shkallareje, portiku, narteksi për të arritur në naos. Nuk kanë qenë kushtet topografike ato që kanë përcaktuar shkallëzimin e ngritjes së nivelit të pjesëve të bazilikës, por kanë qenë vetë ndërtuesit që kanë zgjedhur një terren të tillë të pjerrët, për të rritur monumentalitetin e godinës.

Gjithë sheshi në lindje dhe në jug të bazilikës, është lënë pothuajse pa ndërtime të tjera në një distancë të konsiderueshme, gjë që nuk përsëritet tek bazilikat e tjera të qytetit

Bazilika A është trenefëshe dhe përbëhet nga një absidë gjysmërrethore, transepti trepjesësh, narteksti, portiku dhe dy kthina në anën jugore, një shkallare e vendosur para saj, duke arritur përmasat maksimale: gjatësi maksimale 38.22 m dhe gjerësi maksimale 23.42 m. Gjendja e ruajtjes së këtij monumenti, lejon të përcaktohen qartë elementët planimetrikë dhe vëllimor. Nefet ndahen njeri nga tjetri me harkada të ngritura mbi shtylla të murëzuara dhe këto të fundit mbi një stilobat të lartë. Hapësirat midis shtyllave janë të mbyllura me parapete.

Nefet ndërpriten nga transepti me tri pjesë ku në mes është sanktuari i përcaktuar qartë nga bazamenti i ruajtur mirë. Kangjella e sanktuarit në fazën e parë ka qenë e ulët, kurse në fazën e dytë bëhet e lartë. Sintroni me tri shkallë ka qenë i pajisur me një podium druri, i rrallë në formën e tij në kishat e kësaj periudhe. Para absidës poshtë altarit ruhet vetëm depua e relikeve në formë kryqi.




FIGURA 23 - BAZILIKA A, PAMJA DHE PLANIMETRIA. FOTO A. ISLAMI, SKICA S. MUÇAJ.

Në një fazë të dytë mbi narteks është shtuar një galeri. Skulptura arkitektonik dhe të instalimeve liturgjike e dekoruar që ka arritur deri në ditët tona e plotë apo e fragmentuar është e punuar në gur gëlqeror të marrë nga karrierat e Bylisit. Numrin më të madh të kësaj e përbëjnë pllakat e perdes ndarëse të kangjellës dhe parapeteve ndarse të nefeve, kornizat e vendosura në ballin e bazilikës dhe në numër më të vogël janë kapitelet dhe kapitel-impostet. Ato janë të dekoruara me motive të pasura dhe të larmishme gjeometrike, floreale dhe ezomorfe. Sanktuari, nefi qendror e verior, krahu verior i transeptit dhe narteksti e kanë dyshe-menë të shtruar me mozaikë shumëngjyrësh. Motivet janë të larmishme dhe ndonjë prej tyre është krijim i kësaj atelieje. Bazilika A është ndërtuar në gjysmën e parë të shek. V dhe djegur në mesin e shek. VI m. Kr. (547 - 548).

Bazilika C

Bazilika C me një hapësirë gjysmë rrethore, me tre nefe, narteks, portik, disa anekse në krah të tyre është e pajisur dhe me një galeri mbi narteks. dhe anekse. Përmasat maksimale të bazilikës janë gjatësia 33 m dhe gjerësia 22,80 m. Nefi qendror i shtruar me pllaka guri ka një gjerësi 5,80 m, kurse nefet anësorë të pajisur dhe me bankinë për t'u ulur besimtarët kanë gjerësi 2.46 m dhe 2.26 m.



FIGURA 24 - BYLIS. BAZILIKA C. FOTO N. CEKA

Sanktuari (bema) përfundon në lindje me një sinthronon (vendi ku ulet kleri) të thjeshtë me tri shkallë dhe para tij qëndron altari, nga i cili ruhet në vend bazamenti dhe poshtë tij depua e relikeve. Ndarja e nefeve është bërë me harkada të mbështetura mbi kolona monolite prej guri dhe këto të fundit mbi një stilobat të lartë. Mbi kolona qëndrojnë kapitelet jonik me impost të zbukuruar në të dy faqet. Hapsirat midis kolonave janë mbyllur me parapete të përbëra nga shtylla dhe pllaka guri të zbukuruar me motive të shumta dhe origjinale.




FIGURA 25 - BAZILIKA C E BYLISIT. SKICË PLANIMETRIKE NGA S. MUÇAJ

Sanktuari dhe njëri nga anekset janë të shtruar me mozaikë me motive gjeometrike, bimore, zomorfe dhe figura njerëzore. Në sanktuar ka dhe dy skena jo të zakonshme e para 6+6 qengja që personifikojnë apostujt shkojnë drejt altarit, kurse tek e dyta pjestarë të klerit me kandelabër në dorë drejtohen për në kishë. Një mbishkrim i shkruar në mozaik tregon se ky është bërë në kohën e peshkopit Praisios, i cili nuk përmendet në listat e peshkopëve të Bylisit gjë që do të mundësonte një datë për ndërtimin e mozaikut. Megjithatë, çereku i dytë i shek. VI m Kr. duket se do të ishte më afër të vërtetës për periudhën e ndërtimit të bazilikës C.

Pranë bazilikës është një ndërtesë e shekullit VI m. Kr. Ajo futet tek tipi më i përhapur gjatë shek. V-VI në Bylis. Banesat e kësaj periudhe janë zakonisht me tri dhoma drejtëkëndëshe, paralele me njëra tjetrën të pajisur me një verandë. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë me një kat dhe një gjysmë kat, që ka shërbyer për mbajtjen e rezervave ushqimore. Banesa ka nevojë për të përforcuar muret që janë ndërtuar me gurë dhe baltë.

Bazilika D

Rrënojat e kësaj bazilike gjenden në pjesën veriore të qytetit jashtë murit të Viktorinit. E ndërtuar në një sipërfaqe pak a shumë të rrafshët, me një pjerrësi të vogël drejt

verit dhe lindjes, në lartësi 478 m mbi nivelin e detit, ajo është monumenti i parë, me të cilin ndeshesh pasi ke kaluar hyrjen nr 2 të qytetit.




FIGURA 26 - BYLLIS. BAZILIKA D. PLANIMETRIA SIPAS S. MUÇAJ.

Bazilika D, është trenefëshe me një absidë gjysmërrethore të përforcuar nga tre kontrafortë, një sintroon, një sanktuar, një narteks, dy kthina në veri dhe në jug të tij, një atrium me katër portiqe dhe një propilë të thjeshtë. Mbi narteks dhe nefet anësore ka pasur galeri. Përmasat e saj maksimale janë gjatësia 45,25 m dhe gjerësia 26,15 m.

Nefet ndahen njeri nga tjetri me harkada të ulta të ngritura mbi shtylla të murëzuara dhe këto të fundit mbi një stilobat të lartë. Harkadat e ruajtura përcaktojnë dhe lartësinë e katit të parë deri në nivelin e dyshemesë së galerive 3,80 m – 4 m. Hapësirat midis shtyllave janë të mbyllura me parapete të ndërtuar me mur të hollë, ndryshe nga kishat e tjera duke krijuar edhe sofate për t'u ulur. Kalimi nga narteksti në nefet bëhet me anë e hyrjeve me hark. Një shkallare e ndërtuar në qoshen jugperëndimore të narteksit dhe në një periudhë më të vonë në portikun jugor të çonte në galeri. Kangjella e sanktuarit që në fillemet e saj ka qenë e lartë. Sintroni me dy shkallë të drejta ka qenë i pajisur me një podium druri. Para absidës poshtë altarit ruhet vetëm depua e relikeve në formë kryqi. Në nefin verior poshtë dyshemesë është një varr me qemer cilindrik. Bazilika D me formën e saj planimetrike tepër klasike shquhet edhe për cilësinë e mirë të mozaikëve të dyshemesë. Me mozaikë janë të shtruara narteksti, nefi qendror, aneksi verior dhe një pjesë e nefit verior, kurse dyshemetë e tjera kanë qenë të shtruara me pllaka të mëdha mermeri dhe tulla. Figurat e kafëshëve,

shpendëve dhe panelet me mbishkrime përbëjnë repertorin kryesor të këtyre mozaikëve. Ndër skenat me përmbajtje është ajo e Lumenjëve të Parajsës, ku ndryshe nga rastet e tjera të paraqitura në Bylis janë shkruar edhe emrat e katër Lumenjëve: Fison, Gjeon, Tigër dhe Euftrat. E ndërtuar në fillimet e shek. VI m. Kr. ajo pas shkatërrimeve të mesit të po këtij shekulli dhe lenies jashtë rrethimit të ri portiqet e saj janë përdorur ashtu si dhe në katedrale për banim.

Bazilika E



FIGURA 27 - BAZILIKA E. PAMJE NGA AJRI. FOTO A. PËRZHITA

Duke ndjekur rrugën e mesit në drejtim të lindjes arrijmë tek bazilika E. Bazilika E me një absidë gjysmë rrethore, me tre nefet, narteks, portik dhe dy anekse ka përmasa maksimale, gjatësia 33 m dhe gjerësi 22,80 m. Dyshemeja e sanktuarit dhe nefit qendror janë të shtruara me mozaik me motive të ndryshme, gjeometrik, zoomorf dhe floreal. Skulptura dekorative e gjetur në bazilikën E ka tipare të veçanta që nuk ndeshen tek bazilikat e tjera. Parapetet ndarës dhe transenat e dritareve janë të tejçpuara, kurse në gdhendjet në relief janë të stukuara me ngjyra të ndryshme. Gjetja e shkallëve në egzonarteks që të ngjisin në katin e dytë tregon se narteksi dhe nefet anësore janë pajisur me tribunë dhe galeri që në fazën e parë, ndryshe nga bazilika A dhe B që janë shtuar në një fazë më të vonë.

Bazilika e Ballshit

Rrënojat e bazilikës në qytetin e Ballshit së bashku me rrënojat e tjera rreth saj njihen në popull si ish Manastiri i Shën Mërisë. Problemi i identifikimit të Ballshit dhe i Manastirit të Shën Mërisë me qëndrën mesjetare të Glavinicës ka qenë objekt studimi për shumë historianë dhe arkeologë Glavinica njihet në burimet e shkruara në gjuhën greke e bullgare dhe mbishkrimet me emrin Κεφαληνία-Κεφαλονία; Γαβηνίτζα-Γλαβενίτζα duke filluar nga shek. IX dhe në vazhdim deri në vitin 1751 vit pas të cilit nuk përmendet më, kurse Ballshi përmendet për herë të parë në shekullin XV tek shqiptarët e Peloponezitet të emigruar aty nga krahina e Mallakastrës në fundin e shek. XIII dhe fillimin e shek. XIV edhe si emër fshati dhe si mbiemër Dokumenti kryesor, që është bërë shkas për lokalizimin e Glavinicës në Ballsh, është mbishkrimi i gjetur në rrënojat e kishës së Ballshit, gjatë Luftës së Parë Botërore dhe që bën fjalë për kthimin e Borisit dhe të popullit bullgar në fenë e krishterë, në shekullin e IX (866).



FIGURA 28 - BALLSH. PAMJE E BAZILIKËS PALEOKRISTIANE GJATË GËRMIMEVE ARKEOLOGJIKE (1983). ARKIVI I IA.

Të dhënat e para më të plota për manastirin e Ballshit i takojnë arkeologëve austrik K. Paç; K. Prashniker që vizituan rrënojat e manastirit përkatësisht në vitin 1900 dhe gjatë dimrit 1917-1918. Ata panë aty shumë mbishkrime si ato të Pakatianos-it, Viktorin-it, Boris-it- Mihal i I, Robert de Montfort, që i takonin periudhës antikitetit të vonë dhe mesjetës. Gërmimet e kryera nga S. Anamali në rrënojat e Ballshit gjatë katër fushatave në vitet 1975 1976, 1978, 1983 bënë të mundur të zbulohet bazilika., një termë një trakt i murit rrethues dhe disa varre të periudhës mesjetare.. Bazilika e

Ballshit, e ndërtuar në periudhën e Justinianit, ka qenë në origjinë tre nefshe, me baptister i transformuar më vonë në kapelë, dhe narteks e egzonarteks. Baptisteri i Ballshit duket se është një kopje e baptisterit të katedrales së Bylisit jo vetëm në plan por dhe në lartësi Gjatë ekzistencës së saj shumë shekulle ajo ka pësuar shumë herë dëmtime dhe transformime. Pamja e saj e fundit është pasojë e ndryshimeve të bëra gjatë restaurimeve, dy nga të cilat janë më të mëdha dhe më të dukëshme; e para po gjatë shekullit të VI dhe e dyta gjatë mesjetës. Muret kanë qenë të ndërtuar me teknikën opus mixtum, ndërsa dyshemeja me opus sectile. Balli i bazilikës ka tri absida poligonale (me tri faqe) dhe një sintron të tipit të thjeshtë. Fazës së parë i përket pjesa kryesore e skulpturës dekorative përfshi dhe mbishkrimin e Pakatianos-it. Bazilika e Ballshit është rindërtuar e tëra në shekullin e IX dhe me këtë rindërtim lidhet skulptura që është tipike për shek. IX – X. Në fazën e rindërtimit janë përdorur për ndërtim shumë spolje të marra nga qyteti i Bylisit, përfshi dhe mbishkrimet e Viktorinit Ngjashmëritë e shumta me bazilikat e Bylisit ndihmojnë në përcaktimin e kohës së ndërtimit të saj gjatë çerekut të dytë të shek. VI pas Kr.

Glavinica është një nga qendrat më të rëndësishme peshkopale deri në shek XIV për territoret e shqipërisë së Jugut. Prej saj vjen Epitafi i Glavinicës, dhe ndoshta edhe kodikët më të vjetër të Beratit që përfunduan aty së bashku dhe me shumë libra të shenjta.

Epitafi i Glavinics përbën një dëshmi unike të objekteve liturgjike prej tekstili, si dhe një document të rëndësishëm historik: “U plotësua (u qendis) ky aeras (epitaf) i gjithnderuar dhe i hyjshëm i së mbishenjtes hyllindëses së patundur, me shpenzimin dhe mundimin e peshkopit të gjithhirshëm Kalistit të Glavenicës dhe Beratit, në muajin mars 22, viti 6881 (= 1373). Ti që zotron jetën, ah! Si (je) trup i vdekur pa frym. Në kohën e zotërimit të zotërive të shumëlartë të Serbisë, Rumanisë dhe gjithë Albanit dhe vëllezërve Gjergjit dhe Ballshës. Dora e Gjergj Arianitit dhe arqendisësit”.

3.1.3 MONUMENTET E PERIUdhës ANTIKE KLASIKE Të KLOSIT/NIKAIA

Nga Bylisi, nëpërmjet rrugës që del nga porta nr. 4, për më pak se një çerek ore mbërrije në qytetin e Nikaiës (fshati i sotëm Klos). Vendbanimi antik i Klosit shënonte fillësën për vetë qytetin e Bylisit, sepse atje në shek. VI p. Kr. ishte krijuar një qendër e thjeshtë protourbane, buzë rrugës që lidhte bregdetin e Adriatikut me Epirin. Në gjysmën e dytë të shek. V p.Kr. Klossi u shndërrua në një qytet të fortifikuar me mure të fuqishme të stilit poligonal dhe kuadratik.



FIGURA 29 - KODRA KU GJENDET QYTETI ANTIK I KLOSIT. FOTO N. CEKA

I pari që shkruajti për qytetin e Klosit ishte arkeologu austriak K. Paçi, i cili e vizitoi atë në vitin 1900. Ai vuri në dukje teknikën e ndërtimit me blloqe kuadratike të mureve rrethuese dhe transkriptoi një mbishkrim greqisht që jep të dhëna për organizimin administrativ të qytetit. Gjatë Luftës I Botërore qytetin u studiua nga një tjetër arkeolog austriak, K. Prashniker, i cili hartoi një planimetri të murit rrethues të qytetit dhe përshkroi disa gjetje arkeologjike të rastit. Në vitet 1971-1975 u kryen gërmimet e para arkeologjike, si dhe punime konservim-restaurimi nën drejtimin e L. Papajanit, të cilat vazhduan dhe në vitet 1974-1975. Epigrafisti francez L. Robert ka shprehur hipotezën për identifikimin e Klosit me qytetin Nikaia, që është pranuar përgjithësisht nga arkeologët. Megjithëse ishte vetëm 1 km larg Bylisit, Nikaia si kryeqendra e lashtë e bashkësisë byline, ruajti edhe më pas jetën e veçantë politike e shoqërore, gjë që vërehet në ndërtimin e një agoraje të saj në shek. III p. Kr. Në agora përveç teatrit dhe një stoa të gërmuar, duken edhe gjurmët e një stadiumi, me një vendosje njëkrahëshe, si në Bylis. Gjithashtu, një numur mbishkrimesh me emrat e prytanëve të qytetit janë tregues i prirjes së fortë për autonomi në gjirin e Koinonit Bylin, por edhe i një jete të gjallë politike, shoqërore e kulturore të kësaj bashkësie byline. Pikërisht në kë këtë periudhë, një i ri nga Nikaia kishte fituar garën e vrapimit me armë në lojrat e qytetit Oropos në Greqi.

Monumentet kryesore në Rrënojat Arkeologjike Klos /NIKAIA;

Muri rrethues. Qyteti antik ka qenë ndërtuar në një kodër me shpate të pjerrëta në tri anë dhe i lidhur me një qafë me kodrën mbi të cilën ngrihej Bylisi. Muri rrethues me një gjatësi 1850 m e qarkon plotësisht kodrën në një sipërfaqe prej 18 ha, duke ndjekur linjën e terrenit. Muri, nga më të hershmit e fortifikimeve qytetare ilire, ka

trashësi 3 m - 3,5 m. dhe është ndërtuar në dy faqe me blloqe të mëdha guri gëlqeror lokal. Hapësira midis faqeve është mbushur me gurë të papunuar.



FIGURA 30 - KLOS. MURI RRETHUES I SHEK. V P. KR. FOTO N. CEKA.

Bloqet kanë forma poligonale e trapezoidale në murin e periudhës së parë (gjysma II e shek. V p.Kr.) dhe kuadratike në fazën e dytë (mesi i shek.IV p.Kr.). Qyteti ka vetëm një hyrje të formuar nga zgjatja paralele e dy krahëve të mureve, të vendosur në qafën që e lidh me zonën përreth. Pranë hyrjes dhe në pikat më të mundshme për t'u sulmuar janë ndërtuar tre bastione mbrojtëse.

Teatri. Vendi për ndërtimin e teatrit të Klosit është zgjedhur në një formacion shkëmbor. Formën harkore, të përshtatur për teatër, ai e ka marrë nëpërmjet heqjes së blloqeve të gurëve, të cilat duhet të kenë shërbyer për ndërtim. Në krahun lindor kodra nuk ka pasur lartësinë e nevojshme, prandaj kjo anë e shkallareve të teatrit ka qenë lartësuar me mur dhe mbushur me çakull.



FIGURA 31 - KLOS. TEATRI I QYTETIT ANTIK. FOTO N. CEKA

Ashtu si teatri i Bylisit, edhe ai i Klosit, ka arritur deri në ditët tona tepër i dëmtuar. Nga shkallarja ruhet mirë vetëm shkalla e parë, proedria, kurse paraskena dhe skena kanë vetëm gjurmët e tyre të gdhendura në shkëmb. Orkestra, me diametër 11,60 m dhe formë gjysmërrethi jo të plotë ka shfrytëzuar si dysHEME shkëmbin e gdhendur. I ndërtuar sipas formës tipike ilire-epirote, njëlloj si teatri i Bylisit, në shkallaren e tij me 17 shkallë zinin vend rreth 700 spektatorë. Radha e parë, e rezervuar për aristokracinë e qytetit, i ka fronat me një shpinore të lartë 0,25 m dhe veçohet nga radhët e tjera, që shërbenin për publikun e thjeshtë, nga një koridor.

Në murin e ruajtur të analemës lindore të teatrit, e cila të çon drejt shëtitores, janë gdhendur 14 dekretet për dhënien e qytetarisë. Ato datohen në gjysmën e dytë të shek.III p.Kr. dhe dëshmojnë një politikë për të tërhequr banorë të rinj në Nikaia.

Stoa, që përfaqëson një monument tjetër tipik për gora në antike, është zbuluar pjesërisht në shpatin lindor të qytetit në gjatësi 40 m dhe gjerësi 10 m. Ajo ka qenë një ndërtesë dykatëshe sic dëshmojnë elementët arkitektonikë dorikë dhe jonikë të gjetura në hapësirën e saj. Në anën perëndimore shpina e saj ka qenë e mbyllur me mur, ndërsa në anën lindore stoa hapej me një kolonadë dorike në katin e parë dhe jonike në të dytin. Hapësira e brëndshme e ndërtesës ndahej për së gjati në dy pjesë të barabarta nga një rradhë kolonash, të cilat mbanin çatinë.

Banesat e thjeshta të Nikaia-s tregojnë për një jetë modeste të banorëve, pa cilësinë e Bylisit. Njëra nga banesat e gërmuara në anën jugore tregon se ato kishin një oborr të vogël, ku dilnin dritaret e dy dhomave të vendosura anës një koridori, i cili

vazhdonte te qilari ku mbaheshin zairetë nëpër pitosa. Uji i çatisë grumbullohej në një sterë të gdhendur në shkëmbin poshtë oborrit. Kjo ishte e vetmja mënyrë për të siguruar ujin për përdorim dhe për të pirë në rast rreziku, kurse në periudha të qeta qytetarët e merrnin atë në burimet jashtë qytetit.



FIGURA 32 - KLOS. BANESA E SHEK. III P. KR. FOTO N. CEKA

Në Klos, si dhe në qendrat e tjera qytetare të Gurzezës dhe të Margëlliçit, shtresat arkeologjike mbyllet me një shkatërrim të fuqishëm, që datohet nga monedhat republikane epirote dhe ato të mbretit maqedonas Persé në vitin 167 p.Kr., kur ushtria konsullore e Pal Emilit shkatërroi jo vetëm Epirin, por edhe disa krahina ilire në kufi të tij.

Analiza e mësipërme në përshkrimin dhe vlerësimin e aseteve arkitektonike të Parkut Arkeologjik Bylis shërben për përcaktimin e objektivave kryesore të ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese në Parkun Arkeologjik të Bylisit:

- Muri rrethues i periudhës byline dhe ai i periudhës bizantine
- Rrjeti rrugor dhe banesat e Antikitetit klasik Agoraja e periudhës byline dhe Forumi i periudhës koloniale romake
- Bazilikat paleokristiane

Në rrënojat arkeologjik të Klosit ka vetëm dy grupime kryesore:

- Muri rrethues i qytetit dhe banesa e shek. III-II p. Kr.
- Teatri i qytetit antik dhe strukturat e ruajtura të stoas.

Proceset kryesore që do të kryhen në përgatitjen e atyre ndërhyrjeve janë:

- Studimi arkeologjik i aseteve arkitektonike dhe vlerësimi i gjendjes së tyre të ruajtjes, i cili përmban shfrytëzimin e të gjithë botimeve mbi monumentet ku do të ndërhyhet. Përdorimi i dokumentacionit të botuar, si dhe ai i depozituar në arkivat e Institutit të Arkeologjisë dhe Institutit të Monumenteve do të jetë pjesë e këtij studimi.
- Vlerësimin i integritetit strukturor dhe i veçorive të materialeve të ndërtimit, në varësi të funksionit të monumentit dhe periudhave ndërtimore
- Përcaktimi i prioriteteve dhe rradhës së ndërhyrjeve, bazuar në rezultatet e arritura nga fazat e studimit dhe diagnostikimit.
- Heqja e gardheve private që rrethojnë dhe nuk lejojnë vizitueshmërinë e sitit.

Si rrjedhojë, ndërhyrjet në të ardhmen duhet të konsistojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë së monumenteve përmes zbatimit të teknikave bashkëkohore të konservimit, si dhe evidentimi i vlerave të tyre arkitektonike e historike përmes restaurimeve. Ndërhyrja në bazë të komplekseve ka si qëllim formimin e bashkësive të vizitueshme përmes krijimit të lidhjeve pamore midis tyre, si dhe adaptimit të itinerareve të lëvizjes sipas atyre komplekseve (Për më shumë shiko planin e konservimit në Kapitullin 10).

3.2 VLERAT AUTENTICITETI, INTEGRITETI, RËNDËSIA

Analiza e mësipërme e aseteve kulturore në Bylis dhe Klos nxjerrë në pah potencialin e tyre në tërheqjen e vizitorëve të huaj dhe vendas, gjenerimin e të ardhurave, stimulimin e hulumtimeve të reja arkeologjike dhe menaxhimin e pasurive kulturore, ringjalljen e ekonomive lokale, nxitjen e pjesëmarrjes, promovimin e diversitetit kulturor dhe fuqizimin e identitetit të rajonit. Bazuar në këtë qasje, Parku Arkeologjik Bylis dhe rrënojat e Klosit janë vlerësuar në katër aspekte të rëndësishme:

Vlerat

Vlerat janë faktorët që përcaktojnë çfarë duhet ruajtur - pasuritë materiale që përfaqësojnë historinë dhe trashëgiminë tonë për brezat e ardhshëm. Vlerat i referohen gjithashtu interpretimeve që individët ose grupet u japin ndërtimeve, siteve arkeologjike, peizazheve dhe elementeve jomateriale. Këto përfshijnë vlera historike, estetike, sociale, shkencore dhe ekonomike. Vlerat historike të Bylisit dhe Klosit janë të konsiderueshme, duke zbuluar shtresa historie që shtrihen për shekuj me radhë. Këto dy site arkeologjike nuk janë vetëm struktura fizike, por simbolizojnë udhëtimin kulturor dhe historik të krahinës dhe rajonit. Vlerat estetike janë po aq të rëndësishme,

pas rrënojat e Bylisit dhe Klosit dhe peizazhet përreth tyre ofrojnë një pamje vizuale mahnitëse që tërheqin turistë dhe studiues nga e gjithë bota.

Autenticiteti

Autenticiteti është thelbësor për të kuptuar dhe vlerësuar trashëgiminë në tërësinë e saj. E varur nga lloji i trashëgimisë kulturore dhe konteksti i saj, një pasuri mund të konsiderohet autentike nëse vlerat e saj kulturore shprehën me vërtetësi nëpërmjet një seri elementesh si forma, materialet, përdorimi, traditat, vendndodhja, shpirti dhe ndjenjat, dhe faktorë të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm. Autenticiteti i Bylisit dhe Klosit në këtë rast qëndron në ruajtjen e tyre si dëshmi autentike të jetës dhe kulturës antike në Shqipëri. Kjo përfshin respektin ndaj formave origjinale të ndërtimit, materialet e përdorura dhe interpretimin e tyre në kontekstin historik dhe rajonal.

Integriteti

Integriteti lidhet me shkallën në të cilën një pasuri përfshin të gjithë elementët e nevojshëm për të shprehur vlerën e saj (ndonjëherë të jashtëzakonshme universale) dhe ka një madhësi të përshtatshme për të garantuar përfaqësimin e plotë të karakteristikave dhe proceseve që transmetojnë kuptimin e saj. Integriteti i këtyre dy siteve lidhet ngushtë me ruajtjen e tyre të plotë dhe të paprekur. Kjo do të thotë që të gjitha elementet - nga strukturat kryesore të objektet e vogla - duhet të mbrohen dhe të ruhen. Integriteti i tyre siguron që brezat që do të vijnë do të kenë mundësinë të shohin dhe të mësojnë nga këto pasuri në gjendjen e tyre më të mirë të ruajtur.

Rëndësia

Rëndësia është niveli i veçantë i kuptimit që e dallon një pasuri nga e zakonshmja dhe që e bën atë të vlefshme për ta mbajtur dhe transmetuar brezave të ardhshëm. Rëndësia është një term kolektiv që përmbledh të gjitha vlerat e trashëgimisë të grumbulluara në një vend, qoftë një ndërtesë, një sit arkeologjik, ose një zonë më e gjerë historike si një fshat i tërë apo peizazh. Rëndësia e Bylisit dhe Klosit shtrihet përtej vlerave të tyre fizike. Ato janë simbole të identitetit kulturor dhe historik të rajonit dhe kanë një rëndësi të madhe edukative dhe shkencore.

3.3 KUFIJTË , KORDINATAT GJEOGRAFIKE



FIGURA 33 -BYLIS, FOTO AJRORE

Kufijtë e Parkut Arkeologjik Bylis

Parku Arkeologjik i Bylisit ndodhet në krahinën e Mallakastrës në jug të Shqipërisë. Ky park ndodhet në krahun e majtë të Rrugës Nacionale Fier – Tepelenë, në afërsi të fshatit Hekal dhe Klos. Qyteti antik i Bylisit është rreth 1.5 km larg qendrës së fshatit Hekal dhe shtrihet në pllajën e një kodre me lartësi 547 metra mbi nivelin e detit, me një pozicion gjeografik mbizotërues dhe panoramik mbi Luginën e Lumit Vjosë. Bylisi ka qenë qyteti ilir më i madh në Ilirinë e Jugut me një sipërfaqe rreth 30 hektarë. Në jug të Bylisit ndodhen rrënojat arkeologjike të qytetit Nikaia, themeluar në gjysmën e dytë të shek. V p.Kr. Në perëndim të Bylisit ndodhen dy qendra të tjera, ajo e Gurëzezës në Cakran dhe Margellici në Patos. Në lindje të Bylisit ndodhen rrënojat e dy kështjellave, ajo e Rabijes dhe e Kalivacit të Tepelenës, të cilat shënojnë kufijtë lindorë të Bylisit. Në veri të qytetit të Bylisit, rreth 13 km larg, ndodhet qyteti Ballsh.

Koordinatat për kufijtë e PAB janë tashmë të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa rrënojat e Klosit nuk kanë koordinata kufijsh në sistem GIS. Prandaj, rekomandohet kryerja e rilevimit dhe matja me sistemin GIS dhe shpallja zonë e mbrojtur me Vendim të Këshillit të Ministrave të kufijve dhe koordinatave të rrënojave të Klosit.

Harta , Koordinatat Gjeografike, Bylis, Sip. Rreth 30 ha;




FIGURA 34 – HARTA E BYLISIT

KOORDINATAT E PARKUT ARKEOLOGJIK BYLIS

Pikat me numra në hartën me shkallën 1:5000; kufijtë e Parkut Arkeologjik Bylis, sipas koordinatave kombëtare shqiptare WGS 84 (X, Y).

Nr Pikes	East_m (X)	North_m (Y)
1	393721.5512	4487960.25
2	393696.1511	4487948.608
3	393647.9969	4487955.487
4	393607.251	4487961.837
5	393550.63	4487990.942
6	393517.8216	4488011.579
7	393475.4882	4488062.909
8	393449.559	4488095.188
9	393429.9798	4488114.238
10	393369.6546	4488129.054
11	393316.2087	4488148.634
12	393270.7003	4488169.271
13	393251.6502	4488175.092
14	393222.0169	4488204.196
15	393197.146	4488235.946
16	393122.0042	4488274.576
17	393072.2624	4488294.155
18	393028.3415	4488314.263
19	393001.3539	4488306.326
20	392972.2497	4488298.388
21	392927.7996	4488302.621
22	392896.0495	4488308.972
23	392850.0119	4488331.726
24	392817.7327	4488362.947
25	392807.1494	4488384.113
26	392799.741	4488465.076
27	392812.9702	4488506.351
28	392801.8577	4488557.151
29	392776.9868	4488589.96
30	392745.2367	4488616.418
31	392735.7117	4488631.764
32	392735.1825	4488666.16
33	392748.4117	4488696.851
34	392745.7659	4488725.427
35	392735.7117	4488765.643
36	392755.2909	4488826.498
37	392776.4576	4488868.831
38	392803.9743	4488902.698

FIGURA 35 – KORDINATAT E PARKUT ARKEOLOGJIK BYLIS

Harta , skica, foto




FIGURA 36 – HARTA E ZONIFIKIMIT TË QYTETIT ANTIK TË BYLISIT

Planimetria e qytetit të Bylisit me monumentet ku do të ndërhyhet




FIGURA 37 – PLANIMETRIA E BYLSIT ME DISA NGA MONUMENTET KU DO TE NDËRHYJET

BYLIS - Planimetria e bazilikës B
muret që do të konsolidohen gjatë vitit 2004





FIGURA 38 – PLANIMETRI E BAZILIKËS B



BYLIS - Bazilika B - Tribeloni i baptisterit
pamje nga perëndimi

FIGURA 39 – TRIBELONI I BAPTISTERIT, BAZILIKA B

BYLIS - bazilika B
pedestali verior i hyrjes në baptister




FIGURA 40 – PIEDESTALI VERIOR, BAZILIKA B




FIGURA 41 – BAZILIKA B




FIGURA 42 – BAZILIKA C, PLANIMETRI

BYLIS Bazilika C - Tribeloni i nefit qendror
pamje nga perëndimi




FIGURA 43 – TRIBELONI I NEFIT QENDROR, BAZILIKA C




Figure 2.

BYLLIS - BASILIQUE B et QUARTIER EPISCOPAL
 plan d'ensemble : état 2002
 Moush Moush-Evans - 2002

FIGURA 44 – BAZILIKA B DHE ZONA PESHKOPALE




FIGURA 45 – PLANIMETRAIA E MUREVE DHE MONUMENTEVE NË BYLIS




Foto: Z. Marika

STERA E MADHE



- A PAMJE BALLORE E ARMATURES
MBAITISE
- B RIVENDOSIA E QUREVE TE HARRKUT
TE DALE NGA GERMIMI ARKEOLOZI.
- 1 BLOQET E DALE NGA GERMIMI
2 ARMATURA MBAITISE E
QEMERIT.



PAMJE BALLORE SHK 1:50

FOTO 1

FIGURA 46 – STERA E MADHE, FOTO DHE SKICË





FIGURA 47 – PLANIMETRI DHE PROFIL I MURREVE RRETHUESE, BYLIS

4. ASPEKTE TË TJERA TË LIDHURA ME PASURINË

VLERËSIMI I VLERAVE KULTURORE, VLERA TË TJERA TË NATYRAVE TË NDRYSHME NGA AJO KULTURORE, MASAT RUAJTËSE DHE MBROJTËSE NË FUNKSION TË VLERAVE

4.1 VLERAT DHE MASAT RUAJTËSE DHE MBROJTËSE NË FUNKSION TË TYRE

Në qendër të ruajtjes dhe mbrojtjes së Parkut Arkeologjik të Byllisit dhe rrënojave të Klosit qëndron një sfidë komplekse dhe e rëndësishme: mbajtja në ekuilibër e nevojave të ruajtjes me ato të promovimit dhe aksesit publik. Këto dy site arkeologjike, që kanë vlera të jashtëzakonshme historike, kulturore dhe shkencore, kërkojnë një strategji të qëndrueshëm të menaxhimit që synon të mbrojë dhe të ruajë vlerat e tyre unike.

Masat Ruajtëse dhe Mbrojtëse në Funkcion të Vlerave përfshijnë një sërë rekomandimesh që adresojnë sfidat specifike të konservimit, mbrojtjes, edukimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të këtyre pasurive të çmuara. Nëpërmjet një qasjeje të integruar dhe të bazuar në njohuri, ky plan synon të sigurojë që çdo element i Byllisit dhe Klosit - qoftë një strukturë, objekt, ose vetë mjedisi përreth - të trajtohet me kujdesin dhe respektin që meritojnë. Kjo përfshin jo vetëm veprime të drejtpërdrejta të konservimit dhe restaurimit, por edhe menaxhimin e ndikimit të vizitorëve, sigurinë e siteve, studime dhe hulumtime të vazhdueshme, ndërgjegjësimin dhe edukimin e komunitetit, si dhe bashkëpunimin me ekspertë dhe institucione të ndryshme.

4.1.1 RËNDËSIA HISTORIKE DHE KULTURORE

Parku arkeologjik i Byllisit dhe rrënojat e Klosit (e njohur si Nikaia e lashtë) janë dëshmi të çmuara të qytetërimit Ilir. Këto site përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe historike të Shqipërisë përmes ndërtimeve karakteristike dhe planifikimet e zhvilluara urbane. Të dy këto qendra zotërojnë monumente me vlera të larta arkitekturore për botën antike si teatro, tempuj antik, agora, mure mbrojtëse dhe rrugë të gjera, të cilat dëshmojnë për një shoqëri të organizuar mirë dhe me një zhvillim të konsiderueshëm për kohën. Rëndësia e tyre historike dhe kulturore nuk qëndron vetëm në ndërtimet dhe objektet që kanë mbijetuar deri sot, por edhe në atë çfarë ato tregojnë për organizimin shoqëror, jetën e përditshme, dhe vlerat estetike të banorëve në këtë zonë. Ruajtja dhe promovimi i këtyre dy siteve jo

vetëm që nderon historinë e pasur të Shqipërisë, por gjithashtu ndihmon në kuptimin e rrjedhës së historisë në Ilirinë e Jugut dhe kontaktet e saj me botën mesdhetare. Kjo përfshin njohjen e ndikimit të tyre në zhvillimet politike, ekonomike dhe kulturore që kanë ndodhur në këtë rajon gjatë mijëvjeçarëve.

4.1.2 RËNDËSIA ARKEOLOGJIKE

Parku arkeologjik i Bylisit dhe rrënojat e Klosit janë thesare të çmuara për arkeologët e periudhave të antikitetit. Çdo gjetje gjatë gërmimeve arkeologjike në këto site ofron informacion të ri dhe të çmuar për të kuptuar më mirë mënyrën e se si kanë jetuar popujt e Ilirisë së Jugut në antikitet. Për shembull, rrënojat e teatrove në Byllis tregojnë për rëndësinë e artit dhe kulturës në shoqërinë e asaj kohe. Në të njëjtën kohë, rrënojat e Klosit, si një qendër fetare dhe tregtare, ofrojnë njohuri të çmuara mbi praktikat e kultit dhe marrëdhëniet ekonomike të kohës.

Për më tepër, këto site arkeologjike janë dëshmi e metodave të ndërtimit dhe arkitekturës antike, duke u shërbyer si burime të pasura studimore për arkitektët dhe inxhinierët e sotëm. Muret e qytetit dhe sistemet hidrike, për shembull, tregojnë për aftësinë e komuniteteve në antikitet për të planifikuar dhe ndërtuar struktura komplekse për kohën. Ruajtja dhe studimi i këtyre siteve jo vetëm që ndihmon në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike, por gjithashtu siguron një bazë të fortë për hulumtimet e ardhshme arkeologjike. Çdo gërmim dhe studim të këto site mund të çojë në zbulime të reja që mund të ndryshojnë mënyrën se si kuptojmë historinë dhe kulturën e lashtë të rajonit.

4.1.3 VLERA EDUKATIVE

Si pjesë e rëndësishme e sistemit të vlerave që bartin, këto dy site janë një burim i pasur edukativ për studiuesit, studentët dhe vizitorët. Si qendra historike që kanë ruajtur elemente të qytetërimeve të lashta, Byllis dhe Nikaia antike janë libra të hapur që rrëfejnë për mënyrën e jetesës, arkitekturën, artin dhe praktikat shoqërore të ilirëve të Jugut. Për studentët e arkeologjisë, historisë, dhe shkencave të tjera shoqërore, Byllisi dhe Klosi janë laboratorë të jashtëzakonshëm terreni. Këto site u ofrojnë mundësinë të zbulojnë direkt dhe të interpretojnë gjetjet arkeologjike, të mësojnë për metodat e gërmimit dhe të dokumentimit, dhe të zhvillojnë një kuptim më të thellë për kulturat e antike. Për më tepër, këto site janë burime të çmuara për mësimdhënësit që dëshirojnë të pasurojnë mësimet e tyre me studime të drejtpërdrejta. Vizitat në terren në Byllis dhe Klos mund të inspirojnë studentët dhe t'u japin një perspektivë më të gjerë mbi historinë dhe arkeologjinë.

Vizitorët e përgjithshëm gjithashtu përfitojnë nga vlera edukative e këtyre siteve. Përmes turizmit edukativ, ata kanë mundësinë të mësojnë për historinë e Shqipërisë

dhe të kuptojnë më mirë kontekstin historik dhe kulturor të rajonit. Për të maksimizuar vlerën edukative, është e rëndësishme që menaxhimi i këtyre siteve të përfshijë programe dhe materiale edukative, si udhëzues, dhe seminare që tregojnë për rëndësinë historike dhe arkeologjike të tyre.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme që nëpërmjet këtij plani menaxhimi të investohet në formimin e profesionistëve të rinj në disiplinat e studimeve arkeologjike, konservimit, apo menaxhimit të pasurive kulturore. Projekti "BE për Zhvillimin Ekonomik të Drejtuar nga Turizmi, Zhvillimi Ekonomik dhe Vendor me Fokus mbi Trashëgiminë Kulturore" ka një komponent thelbësor si "scuola cantiere", i cili do të shërbejë për të avancuar kapacitetet lokale dhe stafit që punon në sektorin e trashëgimisë kulturore.

4.1.4 POTENCIALI TURISTIK

Zotërimi i një potenciali të madh për zhvillimin e turizmit kulturor dhe arkeologjik që këto site kanë i shdërron ato në destinacione tërheqëse për vizitorët të interesuar për historinë dhe arkeologjinë. Turizmi në këto site ofron një mundësi të shkëlqyer për të njohur nga afër trashëgiminë historike dhe arkeologjike të Shqipërisë të mësojnë për jetën e ilirëve dhe të vlerësojnë artin dhe arkitekturën e tyre. Përveç kësaj, udhëtimet edukative dhe guidat turistike mund të ofrojnë një perspektivë të thelluar mbi rëndësinë historike dhe kulturore të këtyre siteve.

Zhvillimi i turizmit në këto zona gjithashtu mund të kontribuojë në ekonominë lokale. Kjo përfshin krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe rritjen e të ardhurave për bizneset vendore si restorantet, bujtina, agroturizimin, dhe dyqanet e suvenireve. Për të maksimizuar potencialin turistik, është e rëndësishme të investohet në infrastrukturë dhe shërbime turistike. Kjo përfshin përmirësimin e hyrjes në site, ndërtimin e qendrave të vizitorëve ose multimediale, dhe zhvillimin e materialeve informative dhe edukative.

4.1.5 KONSERVIMI DHE RUAJTJA

Përpjekjet për konservim përfshijnë mbrojtjen e strukturave dhe objekteve arkeologjike nga dëmtimet natyrore dhe njerëzore. Një aspekt kyç i konservimit është menaxhimi i duhur i siteve. Kjo përfshin kontrollin e aksesit të vizitorëve për të parandaluar dëmtimet dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme për të identifikuar dhe trajtuar çështjet e konservimit në mënyrë proaktive. Po ashtu, është e rëndësishme të zhvillohen programe të trajnimit për stafin që punon në site, për të siguruar se ata kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të menaxhuar dhe ruajtur këto pasuri kulturore. Në aspektin teknik, konservimi përfshin përdorimin e metodave dhe

materialeve të përshtatshme për të ruajtur objektet dhe strukturat arkeologjike. Është jetike që këto ndërhyrje të bëhen me respektin më të madh ndaj origjinalitetit dhe rëndësisë historike të objekteve. Përprojekjet për konservim duhet gjithashtu të përfshijnë një element të edukimit dhe ndërgjegjësimit publik. Ngritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e ruajtjes së këtyre siteve mund të ndihmojë në mbrojtjen e tyre nga dëmtimet dhe në nxitjen e përkrahjes publike për përprojekjet e konservimit. Në fund, bashkëpunimi me institucionet arkeologjike, organizatat kulturore dhe autoritetet lokale dhe ndërkombëtare është jetik për të siguruar burimet, ekspertizën dhe mbështetjen e nevojshme për konservimin e qëndrueshëm të këtyre siteve³.

4.1.6 ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

Përfshirja e banorëve të zonës në menaxhimin dhe promovimin e këtyre siteve mund të krijojë një ndjenjë pronësie dhe krenarie për trashëgiminë e tyre kulturore. Një strategji efektive për angazhimin e komunitetit përfshin edukimin dhe trajnimin e banorëve lokalë në fushat e turizmit, udhëheqjes së vizitorëve dhe konservimit. Kjo mund të ndihmojë në krijimin e mundësive të reja të punësimit dhe të ardhurave, duke i bërë banorët pjesëmarrës aktivë në ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre siteve (shiko kapitullin pasardhës). Gjithashtu, krijimi i partneriteteve me shkollat dhe institucionet lokale mund të nxisë pjesëmarrjen e të rinjve në projekte të konservimit dhe edukimit. Kjo jo vetëm që rrit ndërgjegjësimin në mesin e brezit të ri, por gjithashtu siguron që njohuritë dhe vlerat lidhur me këto site të transmetohen nga një brez në tjetrin.

Organizimi i aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore, si festivale, ekspozita dhe seminare, në ose pranë këtyre siteve, mund të tërheqë vëmendjen e komunitetit dhe të vizitorëve. Këto ngjarje mund të përdoren për të treguar rëndësinë historike dhe kulturore të Byllisit dhe Klosit, si dhe për të promovuar kulturën dhe traditat lokale.

Në fund, është e rëndësishme që zëri i komunitetit të dëgjohet në procesin e vendimmarrjes dhe planifikimit të menaxhimit të këtyre siteve. Kjo përfshin marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre në çështjet e ruajtjes, zhvillimit turistik dhe projekteve të ndryshme që ndikojnë në site dhe në komunitetin përreth.

4.1.7 RËNDËSIA MJEDISORE

Peizazhet natyrore që rrethojnë Parkun Arkeologjik të Byllisit dhe rrënojat e Klosit janë po aq të rëndësishme sa vetë sitet arkeologjike. Ruajtja e mjedisit rreth këtyre zonave

³ Për më tepër rreth konservimit, shiko kapitullin e shtojcave ku është zhvilluar një plan i menaxhimit të ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese për pesë vitet e ardhshme.

është kyçe për të mbajtur autenticitetin historik dhe vlerën estetike të tyre. Mjedis natyror jo vetëm që shton bukurinë vizuale të këtyre sitet, por gjithashtu ndihmon në tregimin e plotë të historisë dhe kulturës së zonës. Ruajtja e peizazheve dhe habitatëve natyrore rreth Byllisit dhe Klosit mbështet një ekosistem të shëndetshëm dhe ndihmon në parandalimin e erozionit dhe dëmtimeve të tjera mjedisore që mund të kenë ndikim negativ në sitet arkeologjike.

Edukimi i vizitorëve dhe banorëve lokalë rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit është gjithashtu thelbësor. Kjo mund të përfshijë informacion mbi si të vizitohet site pa lënë ndikim negativ në mjedis dhe përfshirjen e tyre në aktivitete të ruajtjes mjedisore.

Për më tepër, bashkëpunimi me organizatat mjedisore dhe agjensitë e qeverisë mund të sigurojë burime dhe ekspertizë për të mbështetur përpjekjet e ruajtjes së mjedisit. Kjo mund të përfshijë projekte për rritjen e biodiversitetit, menaxhimin e mbetjeve dhe parandalimin e ndotjes. Në këtë kuadër, një rol të rëndësishëm do të luaj edhe shpallja e Lumit të Vjosës, Park Kombëtar.

4.2 MASAT RUAJTËSE DHE MBROJTËSE NË FUNKSION TË VLERAVE

Ruajtja dhe mbrojtja e Parkut Arkeologjik të Byllisit dhe rrënojave të Klosit kërkojnë një sërë masash të përqendruara për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre afatgjatë. Këto masa duhet të jenë të drejtuara drejtpërdrejt për ruajtjen e vlerave historike, kulturore, arkeologjike, edukative dhe mjedisore të këtyre siteve.

4.2.1 RUAJTJA E STRUKTURAVE DHE OBJEKTEVE ARKEOLOGJIKE

Ruajtja e strukturave dhe objekteve përfshin një sërë teknikash dhe praktikash të konservimit të përshtatshme për kushtet dhe karakteristikat specifike të secilit objekt dhe strukturë.

a. **Restaurimi dhe Mirëmbajtja:** Strukturat e mëdha, si muret, kolonat dhe mozaikët, duhet t'i nënshtrohen restaurimeve të kujdesshme që përdorin materialet dhe teknikat që janë në harmoni me ato origjinale. Kjo do të thotë përdorimin e materialeve tradicionale dhe metodave që minimizojnë ndërhyrjen dhe mbështeten në njohuritë e fundit arkeologjike dhe konservuese.

b. **Analiza dhe Diagnostikimi:** Çdo pjesë e siteve duhet të analizohet për të identifikuar nevojat e konservimit. Kjo përfshin ekzaminimin e gjendjes së materialeve, si gurë, metal, dhe qeramikë, dhe zbulimin e çdo shenje të dëmtimit ose degradimit.

c. **Përdorimi i Teknologjive të Avancuara:** Teknologjitë si skanimit 3D dhe fotogrametria mund të përdoren për të krijuar modele të hollësishme të strukturave dhe objekteve.

Këto modele mund të ndihmojnë në planifikimin e restaurimeve dhe në monitorimin e ndryshimeve që ndodhin me kalimin e kohës.

d. Trajnimi i Specialistëve: Është thelbësore të trajnohen specialistë në fushën e konservimit të objekteve arkeologjike dhe në metodat e restaurimit më të mira ndërkombëtare.

e. Mbikëqyrje e Vazhdueshme: Pas restaurimeve, është e rëndësishme të monitorohen strukturat dhe objektet për të identifikuar çdo shenjë të degradimit të mëtejshëm. Kjo do të ndihmojë në zbatimin e ndërhyrjeve të nevojshme në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

4.2.2 MENAXHIMI I NDIKIMIT TË VIZITORËVE

Menaxhimi i ndikimit të vizitorëve është esencial për të mbrojtur integritetin e këtyre siteve arkeologjike. Masa të tilla përfshijnë:

a. Rregullimi i Qasjes dhe Rrugëve të Vizitimit: Vendosja e rrugëve të caktuara për vizitorët ndihmon në minimizimin e dëmtimit të strukturave dhe peisazheve. Kjo mund të bëhet përmes krijimit të shtigjeve të shënuara dhe platformave të vëzhgimit që lejojnë vizitorët të shijojnë site duke i mbajtur larg zonave të ndjeshme.

b. Numri i Vizitorëve dhe Kontrolli i Hyrjeve: Duke parë numrin në rritje të vizitorëve, vendosja e një numri maksimal të vizitorëve që lejohen të hyjnë në site në një kohë të caktuar ndihmon në menaxhimin e ndikimit të tyre. Sistemet e bileva të parapare mund të përdoren për të rregulluar fluksin e vizitorëve.

c. Edukimi i Vizitorëve: Ofrimi i informacionit mbi rëndësinë e ruajtjes së siteve dhe udhëzime për sjelljen e përshtatshme gjatë vizitës është thelbësor. Kjo mund të bëhet përmes tabelave informuese, broshurave dhe guidave turistike që theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së monumenteve në këto site.

d. Monitorimi dhe Mbikëqyrja: Vëzhgimi i vazhdueshëm i siteve dhe sjelljes së vizitorëve është i rëndësishëm për të identifikuar çështje të mundshme dhe për të marrë masa korigjuese. Kjo mund të përfshijë instalimin e kamerave të mbikëqyrjes.

e. Përdorimi i Teknologjisë së Realitetit Virtual dhe Augmentuar: Krijimi i përvojave virtuale mund të ndihmojë në reduktimin e ndikimit të vizitorëve në zonat më të ndjeshme, duke u ofruar atyre mundësinë të eksplorojnë site në mënyrë interaktive dhe edukative pa i shkaktuar dëme. Nëpërmjet këtyre masave, mund të sigurohet që vizitorët të kenë një përvojë të pasur dhe edukative, ndërsa mbrohet integriteti dhe vlera e pasurisë kulturore.

4.2.3 SIGURIA DHE MBIKËQYRJA

a. Instalimi i Sistemeve të Sigurisë: Vendosja e kamerave të mbikëqyrjes dhe alarmeve në zonat kyçe të siteve ndihmon në parandalimin e vjedhjeve dhe aktiteteve të paligjshme.

b. Patrullimi: Angazhimi i një ekipi të sigurisë për të kryer patrulla të rregullta, veçanërisht gjatë orëve kur site nuk janë të hapura për publikun, është jetik për të identifikuar dhe parandaluar çdo rrezik të mundshëm.

c. Koordinimi me Autoritetet Lokale: Bashkëpunimi me policinë lokale dhe autoritetet e tjera të sigurisë është thelbësor për të siguruar një përgjigje të shpejtë në rast të incidenteve të sigurisë.

d. Trajnimi i Stafit të Siteve: Stafi që punon në site duhet të trajnohet për të njohur dhe raportuar çdo aktivitet të dyshimtë, si dhe për të menaxhuar situata të emergjencës.

4.2.4 STUDIME DHE HULUMTIME TË VAZHDUESHME

Studimet dhe hulumtimet e vazhdueshme janë jetike për të kuptuar nevojat dhe sfidat ruajtjes.

a. Hulumtime Arkeologjike dhe Historike: Vazhdimi i gërmimeve dhe hulumtimeve arkeologjike do të ndihmojë në zbulimin e më shumë informacioneve rreth historisë dhe kulturës së siteve. Kjo përfshin studimin e materialeve të gjetura dhe interpretimin e tyre në kontekstin historik dhe kulturor.

b. Analiza Shkencore dhe Teknike: Përdorimi i metodave shkencore si analizat kimike dhe fizike të materialeve, studimi i ndikimit të faktorëve mjedisorë, dhe hulumtimi i teknikave të ndërtimit antike janë thelbësorë për të kuptuar më mirë proceset e degradimit dhe metodat më të mira të konservimit.

c. Publikimi dhe Ndarja e Rezultateve: Rezultatet e hulumtimeve duhet të publikohen dhe të ndahen me komunitetin shkencor dhe publikun e gjerë. Kjo ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit dhe vlerësimit të siteve, si dhe në nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e konservimit.

d. Trajnime dhe seminare për Stafin: Organizimi i trajnimeve dhe seminareve për stafin e siteve në fushat e arkeologjisë, konservimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore është jetik për të ndërtuar një ekip të fortë dhe të informuar.

4.2.5 EDUKIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I KOMUNITETIT

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit rreth rëndësisë së ruajtjes së Parkut Arkeologjik të Byllisit dhe rrënojave të Klosit janë thelbësore për mbrojtjen e tyre afatgjatë.

a. Programe Edukative: Organizimi i programeve edukative dhe aktiviteteve që synojnë të ndërgjegjësojnë publikun dhe komunitetin lokal mbi rëndësinë e këtyre siteve. Kjo mund të përfshijë udhëtime shkollore, seminare, dhe ekspozita.

b. Materiale Informuese dhe Promovuese: Krijimi dhe shpërndarja e materialeve informative si broshura, posterë dhe faqe interneti që ofrojnë informacion mbi historinë, kulturën dhe rëndësinë e konservimit të këtyre dy siteve.

c. Ngjarje dhe Aktivitete Komunitare: Organizimi i ngjarjeve si festivale, ekspozita dhe seminare që promovojnë kulturën dhe historinë e siteve dhe angazhojnë komunitetin lokal.

d. Trajnimi i Guidave Turistike Lokale: Trajnimi i banorëve lokalë si guida turistike që mund të ndihmojnë në shpjegimin e historisë dhe kulturës së siteve për vizitorët.

e. Përfshirja e Komunitetit në Vendimmarrje: Përfshirja e komunitetit lokal në proceset e vendimmarrjes dhe menaxhimit të siteve për të krijuar një ndjenjë të pronësisë dhe përgjegjësisë.

4.2.6 BASHKËPUNIMI ME EKSPERTË DHE INSTITUCIONE

Bashkëpunimi me ekspertë dhe institucione të ndryshme është gjithashtu thelbësor për menaxhimin efektiv dhe ruajtjen e pasurisë kulturore në këto dy site.

a. Partneritete me Institucionet Akademike: Lidhja me universitete dhe institucione të hulumtimit për të përfituar nga ekspertiza dhe burimet e tyre. Kjo mund të përfshijë bashkëpunime në hulumtime, projekte konservimi dhe programe edukative.

b. Pjesëmarrja në Konferenca dhe Seminare: Pjesëmarrja e rregullt në konferenca dhe seminare të lidhura me arkeologjinë, konservimin dhe menaxhimin e siteve të trashëgimisë kulturore për të qëndruar të informuar mbi zhvillimet e fundit dhe për të ndarë përvojat.

c. Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare: Angazhimi me organizata ndërkombëtare si UNESCO dhe ICOMOS për të marrë këshilla teknike, mbështetje financiare dhe për të ndarë praktikat më të mira në fushën e konservimit dhe menaxhimit të siteve arkeologjike. Në një perspektivë afatgjatë, këto bashkëpunime do të ndihmojnë në përgatitjen e dosjes së nominimit të parkut për të qenë pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore nën UNESCO-n.

d. Marrëveshjet me Autoritetet Lokale dhe Qeveritare: Bashkëpunimi me autoritetet lokale dhe qeveritare për të siguruar mbështetje ligjore, financiare dhe administrative. Kjo mund të përfshijë mbështetje në infrastrukturë dhe akses në burime shtesë.

4.2.7 RUAJTJA E MJEDISIT NATYROR

a. Menaxhimi i Burimeve ujore dhe Bimësisë Vendase: Ruajtja dhe menaxhimi i burimeve të ujit dhe mbrojtja e bimësisë vendase për të parandaluar erozionin dhe për të mbështetur biodiversitetin lokal.

b. Kontrolli i Ndërtimit: Vendosja e zonave të mbrojtura rreth siteve për të parandaluar ndërtimet dhe zhvillimet që mund të kenë ndikim negativ në mjedisin natyror dhe peisazhet historike.

c. Edukimi Mjedisor për Vizitorët dhe Komunitetin: Organizimi i aktiviteteve dhe programeve edukative për të nxitur vizitorët dhe komunitetin lokal të marrin pjesë në mbrojtjen e mjedisit dhe të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit.

d. Përdorimi i Praktikave të Qëndrueshme: Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës turistike në mënyra që minimizojnë ndikimin në mjedis, përfshirë përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe materialet e qëndrueshme.

e. Monitorimi i Ndikimit Mjedisor: Vëzhgimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve njerëzore në mjedisin natyror rreth siteve, për të identifikuar dhe trajtuar çdo problem të mundshëm.

4.2.8 AKTIVITETET DHE ÇËSHTJET E TJERA BRENDA PARKUT ARKEOLOGJIK TË BYLISIT DHE RRËNOJAVE ARKEOLOGJIKE TË KLOSIT

Aktivitetet që lidhen me praktikat fetare janë të rëndësishme për t'u zhvilluar brenda standardeve të caktuara. Është e domosdoshme që ritualet e sakrificave të cilat organizohen për ditë festash të ndalohen në ambientet e Parkut Arkeologjik të Bylisit dhe të zhvillohen jashtë tij. Gjithashtu, identifikimi dhe trajtimi i objekteve, shtesave dhe rrethimeve pa leje janë esenciale. Ato që klasifikohen si “ndërtime informale” rekomandohet të hiqen. Në rastet kur objektet janë në proces legalizimi ose tashmë janë legalizuar, ato duhet të përshtaten nga pikëpamja ndërtimore për të ruajtur integritetin me pasurinë kulturore përreth tyre. Nga ana tjetër, duhet të shqyrtohet mundësia e blerjes së këtyre ndërtimeve në të ardhmen për aktivitetet e parkut në rast se lind nevoja. Sa i përket rrethimeve informale në rrënojat e Klosit, është e nevojshme që ato të hiqen për të siguruar një vizitueshmëri më të lehtë të monumenteve.

Këto masa do të ndihmojnë në ruajtjen e mjedisit natyror, integritetin kulturor që rrethon këto site të rëndësishme, duke siguruar që ato të mbeten si dëshmi të bukurisë dhe historisë së lashtë, si dhe si burime për edukimin dhe kënaqësinë e vizitorëve.

4.3 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I QYTETËRIMIT TË BYLIN

Në përbërjen e tij Parku Arkeologjik Bylis përfshin një nga qytetet më të mëdha dhe emblematike Ilire. Formimi i tij në rrjedhën e shek. V-IV p. Kr ka qenë rezultat i një zhvillimi të hershëm të jetës qytetare të nisur në qendrat protourbane të Margëllicit, Mashkjesës dhe Klosit, që nisi në mesin e shek. VII p. Kr., para themelimit të Apollonisë dhe u zhvillua nën ndikimin e saj gjatë shek. VI-V p. Kr. Të dy qytetet janë pjesë e një konstelacioni qytetar të përbërë nga katër qytete (Bylisi, Klosi, Gurëzeza dhe Margëlliçi) dhe tri kështjella (Rabie, Kalivaçi dhe Cfiri). Ky është kompleksi më i plotë dhe më i qartë i zhvillimit urban të Ilirisë së Jugut në atë periudhë, e cila karakterizohet edhe nga formimi i Mbretërisë Ilire si një nga faktorët e rëndësishëm të Ballkanit ilir. Në këtë optikë modeli urban i Koinonit të Bylinëve është një nga treguesit më të qartë të qytetërimit antik ilir, si pjesë integrale e historisë dhe kulturës shekullore të popullit shqiptar.




FIGURA 48 - KOINONI I BYLINËVE NË RAPORT ME KOINONET E SHEK. III P. KR. HARTË NGA O. CEKA.

Një model i ngjajshëm është ai që u zhvillua në të njëjtën kohë në Koinonin e Amantëve, në bregun tjetër të Aosit antic (Vjosa), me kryeqendër Amantian, Olympen dhe Kaninën si qytete, si dhe kështjellat në Cerje dhe Matohasanaj, por model i Byllisit

dhe i Koinonit të Bylinëve është padyshim më i përsosur në pikëpamje organizative dhe më cilësor në zhvillimin e jetës qytetare.

Ajo që e dallon përsëri Bylisin dhe territorin bylin në këtë pikëpamje është vazhdimësia e pandërprertë e zhvillimit kulturor që nga periudha byline, në atë ilire-romake dhe ilire-bizantine, deri në kalimin e peshkopatës së Bylisit me të bjejtin emër në Ballsh në fillim të Mesjetës, kur dokumentohet në burimet historike formimi i popullsisë arbërore.

Edhe nga vendosja ambientale Parku Arkeologjik Bylis përmban një kontrast me Parkun Arkeologjik të Apollonisë. I pari është vendosur në mes të lartësive zotëruese mbi luginën e Aosit antik, me pamjen që përfshin në 360° Detin Adriatik, Malet e Akrokerauneve, Tomorrit dhe grykat e Antigonesë, ku në vitin 198 p. Kr. u zhvillua beteja vendimtare për Ballkanin midis Maqedonisë së Filipit V dhe Romës së konsullit T. C. Flaminius. I dyti mbështjell qetësisht kodrën vetem 104 m m.n.d. të Pojanit, me fushën e sheshtë të Myzeqesë, me një vështrim magjepsës dhe paqësor ndaj këndit të Akrokerauneve që ulen drejt Karaburunit dhe ishullit të Sazanit, si dhe të kurorave të kodrave byline, mbi të cilat ngrihet maja e Tomorrit.

Evidentimi i këtyre vlerave, i bërë deri më sot kryesisht përmes botimeve të rezultateve të kërkimeve arkeologjike, do të gjejë mënyra të reja shprehje dhe dokumentimi, si dhe me paraqitjen e historisë, kulturës dhe artit të tyre në Muzeun Arkeologjik të Ri në PAB. Në këtë kuadër, e rëndësishme është botimi i kërkimeve arkeologjike të kryer në dekadat e fundit në këto dy site. Botimi i këtyre gërmimeve do të ndihmojë në rindërtimin e mënyrës se si këto komunitete jetonin dhe bashkëvepronin në përditshmërinë e tyre, duke ndriçuar aspektet e ndryshme të jetës, nga marrëdhëniet tregtare deri te aktivitetet kulturore, fetare dhe deri te kontaktet me botën Mesdhetare.

Theksimi i dallimeve midis kulturës qytetare ilire të Bylisit e Klosit dhe asaj *genuine* helene të Apollonisë fqinje do të ndihmojë vizitorët, shqiptarë dhe të huaj, si dhe banorët e Mallakastrës të moshave e përgatitjeve të ndryshme arsimore, për të formuar një ide të qartë për identitetin historik lokal të krahinës së Mallakastrës.

Krijimi i një brandi të ri përmes kompleksit monumental dhe muzeor të Parkut Arkeologjik Bylis, të ndryshëm në kompleksitetin urban, format kulturore, por edhe mënyrën e paraqitjes, do të japë mundësi për rritjen e fluksit turistik, të interesuar për diversitetin kulturor dhe, si rrjedhim edhe të të ardhurave të parkut, për tu përdorur për mbulimin maksimal të shpenzimeve dhe për investime të mëtejshme në pasurimin e aseteve të tij.

4.3.1 VLERËSIMI I KOMPLEKSEVE ARKITEKTONIKE TË BYLISIT

Në sitin arkeologjik të Bylisit veçohen katër komplekse arkitektonike: i) Sistemi fortifikues ilir-bizantin; ii) Agoraja byline-Forumi kolonial romak me monumentet kryesore: Teatri, Stoaat A dhe B, Stadiumi dhe Cisterna e tij, Propiletë me Ndërtesat administrative; Termet romake dhe tempulli i Augustit; iii) Sistemi urbanistik hipodamik me banesat A dhe B; iv) Kompleksi i bazilikave të periudhës ilire bizantine.

Sistemi fortifikues i Bylisit ka qenë zhvilluar në dy periudha të ndryshme kohore, por duke e ruajtur funksionin e tij për rreth 1000 vjet, që nga krijimi i tij *ex novo* rreth mesit të shek. IV p. Kr. dhe braktisjes së plotë në cerekun e fundit të shek. VI m. Kr.

Periudha e parë e fortifikimit shënonte njëkohësisht edhe fillesat e qytetit, sipas një ideje arkitektonike që parashikonte zhvillimin e tij në dekadat që do të pasonin. Këtë e dëshmon planifikimi fillestar i ndarjeve të hapësirës së brendëshme të qytetit, duke përjashtuar ndërtimet në zonat e agorasë dhe të euhorionit. Krijimi i pesë hyrjeve në planin fillestar ishte, gjithashtu, pjesë e asaj ideje, duke parashikuar një popullim të dendur, si dhe veprimtari të ndryshme të qytetit, që do të kishte nevojë për hyrje dhe dalje të shpeshta nga qyteti. Ky ishte një ndryshim themelor me Klosin dhe qytetet e hershme të shek. V p. Kr., ku kishte një hyrje të vetme.

Sistemi fortifikues i Bylisit përmban edhe një vlerë tjetër të rëndësishme historike dhe arkeologjike, sepse është modeli më i hershëm i plotë i zbatimit të teknologjisë së re të ndërtimeve të mëdha publike, ku u zbatua ndarja e punës midis gurores dhe ngritjes së muraturës me blloqe kuadratikë. Ndërtimi i kullave katërkëndëshe në pikat strategjike, si dhe ngritja e tyre mbi harqe në portat e qytetit janë risi të rëndësishme, që e vendosin Bylisin në rrolin e krijuesit të kësaj mënyre të re ndërtimi.



FIGURA 49 - RIKONSTRUKSION VIRTUAL I PORTËS NR. 5 TË QYTETIT. N. CEKA- S. ÇELA

Vlerësimi i plotë i fortifikimit antik të Bylisit kërkon ndërhyrje në vazhdimin e këtij procesi, si një monument i vetëm, si dhe të elementeve të veçantë si kurtinat, hyrjet dhe kullat.

Rrjeti urbanistik dhe banesat. Ndërtimi i Bylisit mbi bazën e parimit hipodamik ishte rrjedhim i zhvillimit të tij si qendër politike dhe ekonomike e Koinonit të Bylinëve në shek. III p. Kr. Studimi urbanistik ka dëshmuar se ky model u adaptua nga Apollonia për mënyrën e vendosjes së rrugëve, por jo të agorasë. Për këtë arsye kombinimi i sistemit jonik të një agoraje të gjeometrizuar me sistemin e rrjetit rrugor apolloniat përbën një veçori tjetër që dëshmon origjinalitetin e arkitekturës byline në kuadrin e zhvillimit bashkëkohor të saj, ku Apollonia ishte gjithmonë pasqyrë e risive të qytetërimit helenistik.



FIGURA 50 - SISTEMI URBANISTIK I BYLISIT ME ZONAT KRYESORE. PLANIMETRI NGA N. CEKA, O. CEKA, P. NAPI.

Ndonëse gërmimet e deritanishme arkeologjike e kanë eksploruar vetëm pak atë sistem, njoja e tij është bërë e mundur nga shfaqja e tij në sipërfaqet e gërmuara të banesave A dhe B, të bazilikës B dhe banesës së Terencianëve, por kryesisht nga vëzhgimet nga ajri. Pastrimet e thjeshta të bimësisë dhe të gurëve në sipërfaqet midis rrugëve kanë evidentuar një pjesë të këtij rrjeti në shpatin lindor të qytetit, ku shfaqen linjat e rrugëve kryesore. Kjo metodë mund të jetë pjesë e PM për të mundësuar leximin e rrjetit hipodamik nga pikat e panoramike që do të krijohen përgjatë murit të Viktorinit. Gjithashtu, ndërhyrjet në sipërfaqet e banesave A, B dhe banesën e Terencianëve duhet të synojnë në ruajtjen e strukturave delikate të tyre, po aq sa edhe në evidentimin e tipologjisë peristile të huazuara nga Apollonia. Zotërimi i banesave me sipërfaqe rreth 800 m² dhe organizimi i brendshëm i tyre është një dëshmi e cilësisë së jetës, e cila kishte të njëjtin nivel si e qytetit të afërt helen të Apollonisë.

Agoraja e Bylisit është përfaqësuese e vetme e plotë e njohur deri më sot në qytetet ilire e kësaj hapësire publike në modelin e gjeometrizuar nëpërmjet kufizimit me një mur të veçantë dhe vendosjes skenografike të monumenteve kryesore, teatrit, stoave, stadiumit dhe ndërtesave të tjera shoqërore.

Duke qenë një sipërfaqe e rezervuar që në fillim brenda murit rrethues, ajo ka marrë formën e plotë vetëm rreth mesit të shek. III p. Kr. sipas një ideje të vetme arkitektonike dhe ndoshta të një arkitekti të vetëm të panjohur.

Model i saj me vendosje në harmoni planimetricë të monumenteve ka ndjekur parimin e zbatuara nga agoratë e tipit jonik, të zbatuara që në shek. IV p. Kr. në Magna Graecia, nga u sollën në Dodonë nga mbreti Pirro në çerekun e parë të shek. III p. Kr. Risia që ka sjellur arkitekti bylin është zbatimi i saj i kombinuar me parimin e agorasë perspektive të Apollonisë, duke i ndërtuar monumentet në dy plane, me vendosjen skenografike të teatrit, që unifikon planin e sipërm të stoas me atë të poshtëm të stadiumit dhe prytaneionit.

Hyrja monumentale me ndërtimin e propileve ka qenë çelësi i leximit të kësaj vendosje dhe duhet të shërbejë si pikënisje për evidentimin e vlerave të agorasë.




FIGURA 51 - AGORAJA E BYLISIT NË SHEK. III P. KR. PLANIMETRI NGA N. CEKA, O. CEKA, P. NAIPI.

Me themelimin e kolonisë romake të Bylisit nga Augusti rreth vitit 31 p. Kr., agoraja e Bylisit vazhdoi të përdorej si sheshi kryesor publik i qytetit, por duke pësuar ndryshime në formën dhe funksionin e saj. E gjithë fasha perëndimore e agorasë, që kishte mbetur e pandërtuar për të lejuar shikimin e horizontit nga monumentet e periudhës byline, u përdor për shtrirjen e Forumit. Dy monumentet kryesore të identifikuar në këtë hapësirë janë termet e mëdha romake në anën jugore dhe tempulli i periudhës së Augustit në pjesën veriore. Të dy monumentet ende nuk janë gërmuar plotësisht dhe do të përbëjnë objektivat e ardhshme të kërkimeve arkeologjike në kuadrin e PM. Ndryshime të rëndësishme strukturore dhe funksionale pësoi edhe teatri, që u adoptua për ndeshjet me gladiatorë. Për këtë qëllim proskena dhe skena e periudhës byline u kthye në një *frons scenae*, duke zgjeruar hapësirën para saj, për tu përdorur për luftimet e gladiatorëve. Qoftë nga strukturat e ruajtura, ku u ripërdorën si spolie elementët më të hershëm arkitektonikë, qoftë nga dekoracionet, skena e periudhës romake nuk paraqet vlera të veçanta në krahasim me atë parardhëse.

Teatri është padyshim monumenti më i rëndësishëm i Bylisit jo vetëm për përmasat e tij impresionuese, por edhe për zgjidhjen arkitektonike. Megjithatë gjatë Antikitetit të Vonë është shkatëruar pjesa kryesore e ndërtesës së tij, teatri ruan plotësisht formën e *cavea-s*, si dhe të gjithë muret që përbënin strukturën e asaj ndërtese. Kjo ka dhënë mundësi për një rindërtim të saktë 3D të teatrit, si dhe klasifikimin e tij në tipologjinë e teatrove bashkëkohore. Si i tillë ai i takon tipit të teatrove të *Magna Graecia* të shek. III p. Kr., të karakterizuar nga forma gjysmë rrethore e *cavea-s*, me analema

monolineare dhe proskenë të zhvilluar, për zhvillimin e performimit teatral. Prototipi i këtij teatri përfaqësohet në Dodonë rreth vitit 280 p. Kr., për t'u zbatuar përveç Bylisit në Finiq, Klos, apo Dimal rreth mesit të shek. III p. Kr. Teatri i Bylisit përfaqëson modelin më të zhvilluar arkitektonik të këtij tipi me krijimin e hyrjeve monumentale, të cilat unifikojnë për herë të parë *cavea*-n me ndërtesën e plotë të skenës, gjë që përbënte një mangësi të teatrit kanonik helen.



FIGURA 52 - TEATRI I BYLISIT. RIKONSTRUKSION VIRTUAL NGA O. CEKA.

Ashtu si në tipin e agorasë, edhe në modelin e teatrit, arkitekti bylin është larguar nga modelet bashkëkohore të Apollonisë dhe ka ndjekur koinenë arkitektonike adriatike, të ndikuar fuqimisht nga Magna Graecia. Teatri i Bylisit përfaqëson një tip më vehte midis teatrove të botës antike. Duke u bazuar tek elementet themelore të teatrit klasik grek, arkitekti i Bylisit ka përvehtësuar risitë e teatrit të Dodonës, siç janë hyrjet ballore dhe portat monumentale. Ai ka adaptuar, gjithashtu, edhe proskenën monumentale, ku u zhvendos loja e aktorëve, njëlloj si në teatrin e Sirakuzës në Sicili.

Stoa A me gjatësinë prej 143 m në dy krahë, ndërtimin dykatësh dhe zbatimin e dy ordërave, dorik dhe jonik, është një monument më imponant i këtij tipi të arkitekturës ilire-epirote të shek. III p. Kr. Duke u nisur nga tipologjia e stoave me ante, me origjinë korintase, stoa e Bylisit ka marrë së pari funksionin e kufizimit të hapësirës së agorasë, si pjesë integrale e murit ndarës të saj. Gjithashtu, mund të thuhet se arkitekti bylin ka marrë si model stoan e Apollonisë përse i përket funksionit të saj dhe volumetrisë dykatëshe me dy navata, por ka krijuar një tip të ri me dy krahë në forme të shkronjës L, si dhe me vendosjen e lirë të monumentit, ndryshe nga Apollonia, Butrinti, apo Antigonea, ku i mbështetej faqes së kodrës.

BYLLIS STOA A




FIGURA 53 - STOA A E BYLLISIT. RIKONSTRUKSION VIRTUAL I KRAHUT LINDOR TË MONUMENTIT NGA N. CEKA-S.ÇELA

Përdorimi i kolonave dorike tetëfaqëshe mbi bazë eliptike ka qenë një risi tjetër e zhvilluar në adaptimin e modelit apolloniat. Punimi i një pjese të krahut lindor të stoas në shkëmb dhe ruajtja e punimeve për instalimin e dikurshëm të dyshemesë dhe çatisë së monumentit, japin mundësi për një lexim të lehtë të formës së dikurshme të tij nga vizitori. Ruajtja e elementëve të shumtë arkitektonikë, si kolona dhe kapitele, ofrojnë mundësi që të arrihet një vertikalizim i këtij leximi përmes anastilozës dhe plotësimit virtual të tij në pjesën më juglindore të monumentit. Çlirimi nga banesat e Antikitetit të Vonë që e vështiresojnë këtë lexim dhe që përmbajnë spolie të shumta, që mund të përdoren në anastilozë është një mundësi për të krijuar imazhin e plotë të monumentit.

Stoa B përfaqëson një monument interesant për vendosjen e saj në funksion të teatrit, që përbën një zgjidhje ende të padëshmuar në Apolloninë fqinje. Këndi lindor i saj ruhet mjaft mirë, duke dhënë mundësi të perceptohet lehtësisht si funksion i teatrit edhe nga vizitori i thjeshtë. Përkundrazi, ruajtja e dobët për shkak të shkatërrimit gjatë Antikitetit të Vonë, bën të vështirë leximin e planimetrisë së saj nga vizitori i thjeshtë. Ndërhyrjet konservuese restauruese duhet të evidentojnë formën e saj tipike të stoas me ante, ilire-epirote, njëllon si ajo e stoas A, si dhe mundësojnë ruajtjen e strukturave nga dëmtimet e faktorëve atmosferikë.

Stadiumi dhe cisterna e tij përfaqësojnë gjithashtu një kombinim interesant arkitektonik jo vetëm për arkitekturën ilire-epirote, por edhe për atë të antikitetit klasik. Ndërsa vendosja e stadiumit pranë teatrit në planin e agorasë është një përsëritje e modelit të zbatuar më herët në agoranë e Dodonës, forma e stadiumit dhe vendosja e cisternës përfaqësojnë një arritje origjinale arkitektonike. Ndryshe nga stadiumi i Amantias, që ka formën kanonike gjysmëeliptike të zgjatur, stadiumi i Byllisit

ka vetëm një krah të vendosur në pjerrësinë e kodrës, duke shërbyer njëkohësisht në ndarjen, por edhe komunikimin e të dy planeve të agorasë. Pjesa më veriore e tij është punuar me shkallëzim të rregullt, për të krijuar aksesin në sheshin e stoas A, ndërsa pjesa më jugore është lënë vetëm në nivelin e pistës, për të plotësuar gjatësinë prej një stade (180 m) përpara teatrit.



BYLIS 2021 CISTERNA E STADIUMIT

Një veçori tjetër origjinale e stadiumit të Bylisit është gjerësia e vogël e shkallëve, që lejonte qëndrimin vetëm në këmbë të spektatorëve. Por origjinaliet kryesor në zgjidhjen e formës së stadiumit është shfrytëzimi i shkallares së tij për mbledhjen e ujrave të shirave gjatë dimrit dhe depozitimi i tyre në cisternën që gjendej poshtë pistës së tij. Gërmimi i cisternës, i filluar që në vitet '80, ka vazhduar me ndërprerje për tri dekada, për shkak të vështirësive që paraqet rindërtimi i pareteve dhe harqeve të rrëzuara të mbulesës së tij. Ruajtja pothuaj e plotë e materialeve ndërtimore në rrënojat e cisternës jep mundësi për një rikonstruksion të plotë të saj. E rëndësishme është që anastiloza e monumentit të evidentojë vlerat konstruktive të monumentit, ku përdorimi i harqeve dhe qemerit për mbulimin e hapësirave të konsiderueshme përbën një nga arritjet kryesore të arkitekturës byline dhe asaj ilire-epirote në përgjithësi.

Propiletë dhe ndërtesat shoqërore pranë tyre përbëjnë një kompleks original të ruajtur relativisht mirë me elememtë të kolonave dhe pilastrave, që ka dhënë mundësinë e anastilozës fillestare të tyre, krahas një rikonstruksioni 3D të monumentit. Porta monumentale e agorasë e zgjidhur me krijimin e katër hapësirave kalimi midis një kolonade të ordërit jonik është e vetmja e këtij lloji e zbuluar në një

qytet antic të vendit tonë. Me këtë formë decorative monumentale ajo shënon edhe rastin e vetëm edhe në arkitekturën ilire-epirote. Dallimi është i qartë edhe me zgjidhjen e thjeshtë, pa asnjë veshje dekorative të propileve të agorasë së Apollonisë të ndërtuar afërsisht në të njëjtën periudhë të shek. III p. Kr.




FIGURA 54 - BYLIS. PROPILETË E AGORASË. RIKONSTRUKSION VIRTUAL PËRGATITOR NGA O. CEKA

Përdorimi i ordrit jonik në nivelin bazë, ndryshe nga përdorimi i ordrit solid dorik të propileve të njohura të arkitekturës Helene, është një risi tjetër e arkitekturës së Bylisit, që synonte që të theksonte elegancën e kolonadës së hyrjes në sfondin e thjeshtë të murit dekorativ të agorasë të përshkuar prej saj. Si e tillë ajo formonte një kompleks arkitektonik me ndërtesën e prytaneionit, që ngrihej menjëherë në të djathtë të hyrjes, duke u dalluar nga brenda me kolonadën e tij të ordërit dorik. Anastilozja e përkohëshme e saj ka krijuar vertikalishtin aq të nevojshëm për leximin e kompleksit arkitektonik, si dhe për kuptimin e tërësisë së tij me përfshirjen edhe të ndërtesës së arsenalit. Ky kombinim monumentesh ishte i rëndësishëm për konceptin e vlerësimit të investimeve publike në atë periudhë të zhvillimit të demokracisë, ku ndërtesat administrative shprehnin një pamje modeste në krahasim me madhështinë e ndërtimeve të mëdha shoqërore, si teatri, stoat, apo stadiumi. Ndërhyrja konservuese- restauruese në këtë kompleks duhet të synojë evidentimin e këtyre vlerave të monumentit.

4.3.2 VLERËSIMI I KOMPLEKSEVE ARKITEKTONIKE TË ANTIKITETIT TË VONË

Bylisi përfaqëson qendrën më komplekse dhe më të rëndësishme të Antikitetit të Vonë të gjithë Shqipërisë, për arsye të zotërimit të një tërësie monumentesh arkitektonike si muri i Viktorinit dhe pesë bazilikat e zbukuruara me mozaikë të cilësisë së lartë, që përfaqësojnë një vision të plotë të kulturës ilire-bizantine të shek. IV-VI m. Kr, duke përbërë njekohësisht një vazhdimësi të kulturës antike në territorin e bylinëve ilirë.

Muri i Viktorinit është fortifikimi më i ruajtur i Antikitetit të Vonë në Shqipëri krahas mureve të perandorit Anastas në Durrës. Fortifikimi i Bylisit ka vlerën e veçantë të datohet me saktësi në periudhën e Justinianit (527-565 p. Kr.) dhe t'i takojë dorës së një arkitekti të njohur edhe në një ndërtim tjetër të Perandorisë Bizantine në Istmin e Korintit. Si i tillë ai ka marrë vlera referimi shkencor në përmasat ballkanike për kohën e ndërtimit të tij. Një vlerë të veçantë arkitektonike paraqesin kullat e fortifikimit, që ruhen në gjendje të mirë dhe japin mundësi për restaurimin dhe kthimin e tyre në objekte ekspozimi dhe vizitash. Dy prej tyre, kulla T dhe Y do të propozohen të restaurohen plotësisht, për t'u kthyer në pika të vështrimit panoramik mbi qytetin antik.



FIGURA 55 - PJESË E RUAJTUR E MURIT TË VIKTORINIT. FOTO S. MUÇAJ

Bazilika B është bazilika më e madhe dhe më komplekse e zbuluar deri më sot në territorin e Shqipërisë. Në kontekstin e pesë bazilikave të Bylisit ajo shquhet për përmasat dhe pasurinë e dekoracioneve, që i japin padyshim vendin e katedrales së qytetit. Prezenca e mozaikut të Peshkatarëve të Galilesë, ku figura kryesore është ajo e Shën Andresë ka përcaktuar edhe hierarkinë e dishepujve të Krishtit në ndërtimet më të hershme paleokristiane. Në kompleksin e saj, ku janë integruar ndërtesa e pagëzimore dhe një kompleks i tërë ambientesh me karakter ekonomik, Bazilika B

është qendra e një Manastiri të madh, i vetmi i kësaj natyre i zbuluar pothuajse plotësisht.

Nga pikëpamja arkitektonike vlerësohen si zgjidhje origjinale vendosja e bazilikës në një terren të pjerrët për pjesën e kuadriportikut, që krijonte një sfond të zgjatur horizontal, mbi të cilin zhvillohej volume vertical i anijatës qëndrore. Vetë kuadriportiku i impresiononte besimtarët e atëhershëm me shkallëzimin e tij monumental dhe kolonadën e oborrit qëndror, si një ftesë për tu bashkuar me Mbretërinë e Qiellit.

Mozaiku i ekzonarteksit të bazilikës B është më i bukur dhe më i ruajturi i zbuluar në vendin tonë dhe ka një vend nderi në artin muziv të periudhës së konsideruar si Rilindja e Justinianit. Të dy tabllotë e mozaikut, të punuar nga mjeshtër të ndryshëm, i referohen paradigmave të Dhjatës së Re me temën e përhapjes së krishterimit, që ishte aktuale në kohën e veprimtarisë së gjerë religjioze të Justinianit dhe Teodorës. Motivi i peshkatarëve të Galilesë, që sipas porosisë së Krishtit “do të gjuanin njerëz dhe jo peshq”, ka të bëjë me këtë mission të kishës, po aq sa edhe tema e “Bariut të Mirë”, si alegori e punës që bënte klasa e priftërinjve dhe e murgjve.



FIGURA 56 - BARIU I MIRË. MOZAIK NGA EKZONARTEKSI I BAZILIKËS B. FOTO N. CEKA

Në kuadrin e PM bazilika B do të ketë rolin e tërheqjes së vëmendjes së vizitorëve dhe do të konsumojë një pjesë kryesore të kohës së qëndrimit të tyre, duke transmetuar njëkohësisht mesazhet e vlerave të veçanta të periudhës që përfaqëson. Për këtë arsye do t'i kushtohet një vëmendje e veçantë ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese që do të evidentojnë ato vlera.

Bazilikat A, C, D dhe E përfaqësojnë një seri monumentesh me interes të veçantë shkencor, për studimin e historisë së arkitekturës së Antikitetit të Vonë në territorin e Shqipërisë. Njëkohësisht, secila prej tyre dallohet për veçoritë arkitektonike dhe temat e ndryshme të realizuar përmes artit të mozaikëve.

Bazilika A karakterizohet nga mozaiku i ruajtur pothuaj plotësisht, me një pasuri të jashtzakonshme motivesh gjeometrike dhe nga jeta e natyrës, si dhe nga përshtatja e arkitekturës së saj ambientit të antikitetit, nga i cili kishte adoptuar shkallaren e stadiumit, murin ndarës të agorasë, si dhe stilobatin e Stoas A.

Bazilika C paraqet vlera të veçanta për skenat e mozaikëve, ku tregohet “Grigja e Krishtit” e 12 apostujve të simbolizuar nga qëngjat, si dhe paraqitja e murgjëve në procession. Mbishkrimi i peshkopit Praisos, të panjohur nga burimet historike, i jep atyre edhe një vlerë dokumentare.

Bazilika D krijon një kompleks me vendosjen e saj në sfondin e murit të Viktorinit dhe shënon një objekt të vizitueshëm në itinerarin turistik të Bylisit. Vlera të vecanta paraqet mozaiku me paraqitjen e katër Lumenjëve të Parajsës, të shoqëruar edhe me emra e tyre biblikë: Fison, Gjeon, Tigër dhe Euftrat.



FIGURA 57 - BAZILIKA D. PAMJE NGA AJRI. FOTO A. PËRZHITA

Bazilika E përfaqëson fazën e fundit të zhvillimit arkitektonik të bazilikave në Bylis, si një tregues i vlefshëm edhe për studimin e këtij lloji monumenti kryesor në provincën e Epirit të Ri në periudhën e shek. V-VI m. Kr. kur ndodhi ky zhvillim.

Edhe dy ndërtime të tjera të kësaj periudhe duhen marrë në konsideratë për vlerat e tyre arkitektonike.

Termet e Justinianit pranë cisternës janë të vetmet e këtij lloji të zbuluara në vendin tonë dhe përfaqëojnë fazën e fundit të zhvillimit të këtij monumenti të rëndësishëm të arkitekturës romake-bizantine. Është me interes fakti se monumenti i Bylisit ka ruajtur gjithë strukturën tradicionale të termeve romake me ambientet e *caldarium* dhe *tepidarium* me *hypocaust*, por ka shfrytëzuar edhe cisternën antike të Bylisit, duke e bërë atë monumentin më jetëgjatë të Bylisit.

4.3.3 VLERËSIMI I ARTEFAKTEVE ARKEOLOGJIKE

Gjatë gërmimeve prej më se katër dekadash në Bylis është grumbulluar një material i pasur arkeologjik, i magazinuar kryesisht në Institutin e Arkeologjisë dhe në depon e Muzeut të Apollonisë. Një numër i konsiderueshëm artefaktesh me vlera të vecanta artistike dhe historike janë ekspozuar në Muzeun Historik Kombëtar, në Muzeun e Apollonisë, në Muzeun e Fierit dhe në Muzeun e Institutit të Arkeologjisë në Tiranë.



FIGURA 58 - BYLIS. KOMIKU MBI ALTAR; AMAZONA; PORTRETI I PERANDORIT HADRIAN

Si të tilla duhen konsideruar skulpturat, si Komiku i ulur mbi altar, që vjen sigurisht nga teatri i Bylisit dhe datohet në shek. III-II p. Kr. Ai paraqet një personazh të komedisë antike të asj periudhe, duke qenë njëkohësisht një nga veprat më interesante të artit ilir të periudhës qytetare byline. Po kjo shkollë sculpture, paralele me atë të Amanties ka dhënë edhe Amazonën e ulur në fron, që ka qenë pjesë e një kompleksi arkitektonik. Për periudhën koloniale romake në Bylis është me vlera të vecanta portreti i perandorit Hadrian (117-135), si një nga replikat më të arritura të modelit të përpunuar në Perandorinë Romake.

Edhe periudha ilire-bizantine ka një repertory të pasur objektesh arkeologjike, ku një vend të rëndësishëm ka koleksioni i enëve liturgjike të gjetura në gërmimet e bazilikave. Të gjitha këto do të jenë pjesë e katalogut që do të përgatitet në kuadrin e projektimit të Muzeut Arkeologjik të Bylisit

Një vlerë të vecante kanë edhe mbishkrimet e gjetura në Bylis, Klos, apo territorin bylin, që dokumentojnë jetën politike e shoqërore të territorit të bylinëve në shek. IV-II p. Kr., ashtu si dhe proceset e romanizimit, apo të krishterimit të hershëm që u zhvilluan në atë territor në shek. I-VI m. Kr.

4.3.4 VLERËSIMI I ASETEVE ARKITEKTONIKE TË KLOSIT

Ndryshe nga Bylisi, Klosi ka pasur një jetë më të shkurtër qytetare, që shtrihet midis gjysmës së dytë të shek. V p. Kr., kur u themelua qyteti i mirëfilltë mbi vendbanimin e hershëm protourban, deri në gjysmën e parë të shek. II p. Kr., kur qyteti u shkatërrua, pa njohur asnjë rindërtim të mëvonshëm. Për këtë arsye, si dhe për shkak të kërkimeve të kufizuara arkeologjike në shekullin e kaluar, Klosi na paraqet një ofertë më të kufizuar asetesh arkitektonike në kuadër të PM.

Vetë siti arkeologjik i Klosit është një aset i rëndësishëm historik dhe urban, si një nga qytetet e para ilire të krijuara në prapatokën e kolonive helene në gjysmën e dytë të shek. V p. Kr., krahas Amantias në prapatokën e Orikut dhe Dorëzit në atë të Durrhahut. Vendosja e tij kronologjike si paraprirëse e zhvillimit urban të vetë Bylisit e bën të domosdoshëm perceptimin e Klosit në një binom unik në trevat ilire-epirote.




FIGURA 59 - ORGANIZIMI HAPËSINOR NË QYTETIN ILIR TË KLOSIT NË SHEK. III P. KR. SKICË NGA N. CEKA

Aseti më i rëndësishëm arkitektonik i Klosit është muri rrethues, i cili përfaqëson modelin më të hershëm të arkitekturës ilire epirote me planimetrinë e thjeshtë, të përforcuar vetëm me bastione, por pa kulla, si dhe me prezencën vetëm të një hyrje kryesore, me strukturën e thjeshtë të mureve rrethuese dhe përdorimin e teknikës trapezoidale poligonale në fasadat e tyre. Ruajtja e tij në përmasa madhështore, veçanërisht në anët perëndimore dhe jugore të qytetit dhe aksesit relativisht të thjeshtë në vizitimin e tyre ofron një atraksion të rrallë turistik, si dhe një imazh të veçantë në perceptimin e përzgjedhjes së vendit dhe në fortifikimin e qytetit të hershëm antik ilir.

Një aset tjetër të rëndësishëm arkitektonik përfaqëson teatri, i vendosur në agoranë e qytetit, të eksploruar vetëm pjesërisht, por që identifikohet ashtu si ajo e Bylisit në llojin e agorave ilire-epirote të tipit të Magna Graecia. Edhe vetë teatri i takon të njëjtit tip si Bylisi, me planimetrinë në formë gjysmërrethore dhe analemat monolineare. Ruajtja relativisht mirë e pjesës së proedrisë dhe parodosit lindor jep mundësi për përdorimin e tij në raste të veçanta për shfaqje artistike në koordinim me aktivitete kulturore në kuadrin e Parkut Arkeologjik Bylis.




FIGURA 60 - KLOS. RIKONSTRUKSION IDEAL I TEATRIT SIPAS L. PAPAJANI

Monumentet e tjerë të Klosit, stoa dhe banesa, që ruhen në gjendjen e zbulimit mund të përfshihen në një itinerar vizite që pason atë të teatrit, duke krijuar edhe perspektivën e zgjerimit të zonës turistike përmes gërmimeve të ardhshme arkeologjike si pjesë e planit afatgjatë.

5. ZHVILLIMI I KOMUNITETIT DHE TURIZMI

ASPEKTI I ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOMUNITETIT PËRRETH PASURISË KULTURORE, INFRASTRUKTURA CIVILE, TURIZMI, DHE ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR MË PASURINË.

Angazhimi i komunitetit lokal në site arkeologjike si ai i Bylisit dhe Klosit është i shumë i nevojshëm për të ruajtur, promovuar dhe zhvilluar trashëgiminë kulturore dhe historike në zonën e Mallakastrës. Procesi i bashkëpunimit midis arkeologëve dhe komunitetit lokal ka një ndikim të thellë në identitetin kulturor dhe ekonominë e zonës. Përfshirja e tyre në procesin arkeologjik i bën ata të ndjehen pjesë e zbulimeve dhe mbrojtës të trashëgimisë së tyre. Kjo mund të ndihmojë në kultivimin e ndjenjës së krenarisë dhe përgjegjësisë për ruajtjen e kësaj pasurie unike. Në aspektin ekonomik, angazhimi i komunitetit lokal në turizmin arkeologjik mund të sjellë avantazhe të mëdha. Pjesa aktive e komunitetit në promovimin dhe ofrimin e eksperiencave turistike rrit atraktivitetin dhe ndikon pozitivisht në numrin dhe eksperiencën e vizitorëve. Kjo krijon mundësi për krijimin e bizneseve lokale, të cilat mund të ofrojnë produkte dhe shërbime turistike. Me investimin në trajnime dhe programe të përbashkëta arkeologjike dhe turistike, komuniteti lokal mund të përgatitet për të ndarë historinë dhe kulturën e tyre në një mënyrë të qëndrueshme dhe të edukojë vizitorët. Ky shkëmbim i njohurive dhe kulturës ndihmon në krijimin e një mjedisi më të pasur dhe më të kuptueshëm për të gjithë pjesëmarrësit. Prandaj, angazhimi i komunitetit lokal në sitet arkeologjike të Bylisit dhe Klosit është jetik për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore. Ky bashkëpunim me ta krijon një qëndrueshmëri afatgjatë dhe shpërblen komunitetin lokal, duke i dhënë atyre një rol aktiv në mbrojtjen dhe promovimin e pasurive të tyre kulturore të zonës. Për t'ia arritur kësaj, është e rëndësishme përgatitja e një plani të angazhimit të komunitetit dhe të zhvillimit paraprak të turizmit.

5.1 PLANI I ANGAZHIMIT TË KOMUNITETIT ME FOKUS ZHVILLIMIN E TURIZMIT KULTUROR

5.1.1 PLANI PARAPRAK I ANGAZHIMIT TË KOMUNITETIT

Në kuadër të projektit “BE për Zhvillimin Ekonomik drejtuar nga turizmi, zhvillimi ekonomik dhe vendor me fokus mbi Trashëgiminë Kulturore – IPA 2018”, komunitetet lokale që gjenden pranë siteve arkeologjike të Bylisit dhe Klosit dhe jo vetëm do të përfshihen aktivisht në planifikimin e zhvillimit lokal të lidhur me turizmin në zonën e Mallakastrës përmes krijimit të një Grupi të Veprimit Lokal dhe dy nën-grupeve të punës. Këto grupe do të krijohen dhe do të financohen nga ky projekt i cili do të bëjë gjithashtu koordinimin e aktiviteteve dhe zbatimin e tyre. Në përputhje me kërkesat e

LEADER/CLLD⁴, do të miratohet një qasje nga poshtë-lart dhe e bazuar në zonë, duke i konsideruar lojtarët lokalë jo si përfitues, por si aktorë zhvillimi, duke i fuqizuar ata që të kontribuojnë në planifikimin e zhvillimit lokal të lidhur me turizmin e Mallakastrës në përputhje me nevojat dhe pritshmëritë e tyre. Nëpërmjet krijimit dhe financimit nga projekti i BE të Grupit të Veprimit Lokal (GVL), që përfshin aktorë publikë, privatë dhe të shoqërisë civile, qytetarët dhe organizatat e Mallakastrës do të mund të marrin pjesë në përcaktimin e prioriteteve për zhvillimin lokal. Ndërsa vetë natyra e qasjes LEADER/CLLD kërkon adoptimin e një qasjeje të integruar dhe shumësektorale ndaj zhvillimit lokal, GVL-ja e Mallakastrës do të fokusohet kryesisht në mundësitë e zhvillimit që rrjedhin nga turizmi kulturor dhe në përdorimin e qëndrueshëm të aseteve të territorit të Mallakastrës për qëllime turizmi.

Në këtë mënyrë, Plani Paraprak i Angazhimit të Komunitetit do të identifikojë në detaje hapat që duhen ndërmarrë për përfshirjen e aktorëve të ndryshëm të territorit të Mallakastrës në një Grup të Veprimit Lokal dhe për t'u ofruar atyre mbështetje dhe informacion si për ngritjen e GVL-së, ashtu edhe për fazën e fillimit të tij dhe rrjetëzimi i tij me eksperiencat e tjera të ngjashme nga Shqipëria dhe jashtë saj. Në mënyrë të veçantë, aktivitetet e mëposhtme do të planifikohen në Planin Paraprak të Angazhimit të Komunitetit:

- Oferta e trajnimeve dhe njohurive për grupet rurale, veçanërisht gratë në zonat rurale të synuara, mbi CLLD, GVL-të dhe Programin IPARD (i cili ka një komponent specifik për GVL-të);
- Rrjetëzimi në komunitetin e Mallakastrës për zhvillimin e një GVL-je dhe mbështetje për pjesëmarrjen e anëtarëve të GVL-së në ngjarje dhe forume, me aktorë të bashkëpunimit publik dhe privat, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar për menaxhimin e fondit;

⁴ Qasja LEADER, e cila rrjedh nga fraza franceze "Liaison Entre Actions de Développement de l'Économie Rurale", synon të trajtojë çështjet e zhvillimit rural duke angazhuar komunitetet dhe organizatat lokale si pjesëmarrës aktivë dhe jo thjesht si përfitues. Karakteristikat kryesore të LEADER përfshijnë themelimin e Grupeve të Veprimit Lokal (GVL) për të drejtuar strategjitë dhe vendimmarrjet e bazuar në zonë. Fillimisht i prezantuar si një Nismë Komunitare në 1991, LEADER u zhvillua nëpërmjet fazave të ndryshme, duke kulmuar me integrimin e tij si një komponent i detyrueshëm i Programeve të Zhvillimit Rural deri në 2007. Me kalimin e kohës, LEADER u zgjerua tematikisht në politikën e peshkimit dhe zgjeroi më tej fushën e tij të veprimit nën Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti (Community-Led Local Development - CLLD), duke përfshirë zonat rurale, të peshkimit dhe urbane. CLLD, tani i aplikueshëm në të gjitha Fondet Strukturore dhe të Investimeve Evropiane, thekson strategjitë e integruara, multi-sektoriale dhe inkurajon rrjetëzimin, inovacionin, bashkëpunimin dhe konsultimin gjithëpërfshirës për të nxitur fuqizimin lokal dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Për më shumë vizito: https://ec.europa.eu/enrd/leader-clld/leader-toolkit/leaderclld-explained_en.html

- Mbështetje për strukturat qytetare dhe komunitare për t'u vetëorganizuar në GVL, duke përfshirë krijimin e anëtarëve të bordit, përpunimin e statutit ligjor dhe aktit të regjistrimit, kodit të etikës dhe Strategjisë së Zhvillimit Lokal.

Për më tepër, Plani Paraprak i Angazhimit të Komunitetit do të diskutojë fushën e veprimtarisë, përmbajtjen e propozuar dhe funksionimin e dy grupeve të punës që do të ngrihen dhe aktivizohen brenda GVL-së përgjatë zbatimit të projektit “BE për Zhvillimin Ekonomik drejtuar nga turizmi, zhvillimi ekonomik dhe vendor me fokus mbi Trashëgiminë Kulturore – IPA 2018”. Grupet e punës kanë për qëllim t'i japin një perspektivë të prekshme angazhimit të komuniteteve vendore dhe palëve të interesuara në planifikimin e zhvillimit lokal të Mallakastrës.

Grupi i punës "Sipërmarrësi" do të përbëhet nga autoritetet publike, sipërmarrës lokalë të sektorit të turizmit dhe zinxhire të tjera vlerash të ndërlidhura, dhe (nëse gjykohet e përshtatshme) operatorë ekonomikë përkatës të zonave/qyteteve të tjera shqiptare. Ai do të lehtësojë rrjetëzimin e palëve të interesuara për zhvillimin e produkteve të integruara të turizmit të qëndrueshëm (p.sh., turne që integrojnë dimensionin kulturor me temat e ushqimit, artizanatit dhe traditës lokale) dhe për integrimin e Bylisit, Klosit dhe Mallakastrës në produktet e turizmit kulturor dhe bregdetar.

Grupi i punës "Qëndrueshmëria" do të përbëhet nga autoritetet publike dhe organizatat e shoqërisë civile në Mallkastër (përfshi Bylis dhe Klos) që merren veçanërisht me çështjet e aftësisë së kufizuar dhe mjedisore dhe do të stimulojë zhvillimin me pjesëmarrje të një strategjie të qëndrueshme për marketingun territorial. Kështu, organizatat lokale të shoqërisë civile do të përfshihen thellësisht në planifikimin dhe zbatimin e masave të qëndrueshme për të ardhmen e strategjisë së marketingut territorial, për të siguruar që ndikimi social i PM të zgjasë dhe të rritet me kalimin e kohës. Konkretisht, grupi i punës do të synojë identifikimin e shërbimeve që do t'i menaxhojë OSHC në lidhje me zhvillimin e turizmit të zonës; shërbimet do të kenë një përmasë të fortë sociale dhe do të punojnë për të reduktuar ndikimin negativ social/mjedisor të rritjes dhe për të nxitur përfshirjen e zhvillimit lokal.

Plani paraprak i zhvillimit ekonomik drejtuar nga ai lokal


Synimi i ndërhyrjes së përgjithshme në Parkun Arkeologjik të Bylisit dhe rrënojave të Klosit është që t'i shndërrojë ato në asete kryesore të territorit të Mallakastrës, rreth të cilit të zhvillohet një formë e qëndrueshme e turizmit kulturor dhe, në këtë mënyrë, të përcaktojë zhvillimin ekonomik të zonës.

Sektori i turizmit në nivel lokal është kompleks, me një zinxhir të gjerë furnizimi që përfshin zinxhirë nën-furnizues të ndërlidhur, si ato të promovimit të informacionit, transportit, hotelerisë dhe aktiviteteve turistike të drejtpërdrejta. Zinxhiri i furnizimit të turizmit paraqitet, në grafikët e mëposhtme, në një perspektivë procesi, duke identifikuar fazat që operatorët e ndryshëm ekonomik lokal duhet të zhvillojnë: zinxhiri primar i furnizimit (nga koncepti i produkteve në treg) dallohet nga zinxhiri dytësor i furnizimit (te politikat, strategjitë dhe shërbimet publike funksionale për të parën).

Zinxhiri i vlerës së nivelit të parë (inputet/hyrjet)



Zinxhiri i vlerës së nivelit të dytë (politikat, strategjitë dhe shërbimet publike)



Në kuadër të projektit BE për Zhvillimin Ekonomik drejtuar nga turizmi, zhvillimi ekonomik dhe vendor me fokus mbi Trashëgiminë Kulturore – IPA 2018 do të financohet dhe përpunohet një plan paraprak për zhvillimin ekonomik, udhëhequr nga vendasit, i cili do të përbëjë pikënisjen dhe premisën për zbatimin e komponenteve të zinxhirit të vlerës në nivel të dytë. Këto komponente do të krijojnë një mjedis të favorshëm për rritjen e turizmit, si në sasi ashtu edhe në cilësi, në Mallakastrë. Kështu, synohet trajnimi i zhvillimit ekonomik të zonës.

Plani paraprak do të përpunohet në bazë të qasjes së Zhvillimit Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti (CLLD), që synon të sigurojë sinergji ndërmjet tre aktorëve kryesorë në zhvillimin lokal:

- 1) **bashkitë** mbështeten në zhvillimin e strukturave dhe infrastrukturës komunitare;
- 2) **grupet e interesit dhe shoqëria civile** thirren të luajnë një rol të qëndrueshëm dhe të planifikuar në zhvillimin e komuniteteve të tyre; dhe

3) **sektori privat**, i cili duhet të zgjerohet dhe angazhohet për të adoptuar një qasje të ngjashme dhe sistematike ndaj zhvillimit ekonomik dhe zinxhëve të vlerës.:

Plani paraprak do të marrë në konsideratë:

- planet dhe strategjitë ekzistuese territoriale për territorin e Mallakastrës, dhe
- objektivat dhe rezultatet që i nënshtrohen veprimeve/projekteve për zhvillimin territorial të lidhur me turizmin, përfshirë projektin '100 Fshatrat'.


dhe do të përfshijë elementet e mëposhtme:

- Identifikimin e burimeve dhe asetëve territoriale;
- Rishikimin e informacionit të disponueshëm për kapacitetin, kompetencat dhe autoritetin e njësive të qeverisjes vendore në territorin e Mallakastrës;"
- Analizën SWOT e territorit, me fokus në turizëm;"
- Të dhënat për një plan të integruar dhe të qëndrueshëm territorial me përqendrim në turizëm;
- Inputet teknike për percaktimin e proceseve dhe krijimin e mjeteve për ndërtimin e kuadrit institucional për menaxhimin e planit të integruar të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.
- Mbi bazën e Planit Paraprak, do të mundësohet fillimi i dialogut me autoritetet vendore të Mallakastrës, për të:
 - Mbështetur zhvillimin e planeve specifike organizative, bazuar në informacionin e mbledhur për asetet, burimet dhe situatat e tyre të përgjithshme;
 - Asistencë në formulimin e profileve teknike/zhvilluese të Mallakastrës, duke marrë parasysh burimet e përziera të reja urbane-rurale të zgjeruara, planet ekzistuese të zhvillimit kombëtar dhe vendor dhe kompetencat dhe autoritetin e NJQV-ve;
 - Përpunuar – së bashku me Bashkinë e Mallakastrës dhe duke marrë parasysh kapacitetet e pushtetit vendor – një Plan Zhvillimi Vendor, me referenca specifike për zonat rurale dhe pasuritë e burimeve kulturore dhe natyrore të territorit.

5.1.2 PLANI PARAPRAK I ZHVILLIMIT TË TURIZIMIT

Një Plan Paraprak i Zhvillimit të Turizmit do të hartohet dhe financohet në kuadër të projektit të BE-së për Zhvillimin Ekonomik të Drejtuar nga Turizmi, zhvillimi ekonomik dhe lokal me fokus mbi Trashëgiminë Kulturore – IPA 2018, me një fokus të veçantë në planifikimin e aktiviteteve që lidhen me zinxhirin e vlerës të nivelit të parë të furnizimit në turizëm, siç është paraqitur më lart.

Zinxhiri i vlerës së nivelit të parë (inputet)



1) Ide për produkte-shërbime

Plani Paraprak i Zhvillimit të Turizmit do të përfshijë një planifikim të aktiviteteve të mëposhtme:

- Harta e Komunitetit, që paraqet ndërthurjen e marrëdhënieve ndërmjet elementeve materiale dhe jo-materiale të një vendi, duke nxjerrë në pah tiparet dalluese të identitetit me aktorët lokalë;
- Plani Paraprak do të përfshijë një planifikim të fazave të ndryshme të zbatimit të këtij aktiviteti, përkatësisht:
 - hartëzimi i aseteve territoriale (private dhe publike) që lidhen me turizmin ose që do të përdoren për rritjen e atraktivitetit të turizmit dhe analiza e statusit të tyre;
 - lehtësimi i procesit pjesëmarrës (ku përfshihet komuniteti Mallakaster) për identifikimin me pjesëmarrje të elementeve materiale dhe jo-materiale të territorit të Mallakastrës dhe tipareve dalluese të identitetit të tij territorial.
- Asistencë teknike për planifikimin dhe monitorimin me pjesëmarrje të produkteve të integruara të turizmit, që do të ofrohet nëpërmjet animimit të

grupit të punës "Sipërmarrës" të GVL-së (ose shoqatës së ngjashme me GVL-në) e sapo krijuar, siç përshkruhet më sipër.

II) Menaxhimi i produkteve-shërbimeve

Plani Paraprak i Zhvillimit të Turizmit do të përfshijë planifikimin e aktiviteteve të mëposhtme, të cilat synojnë të ofrojnë mbështetje për GVL-të e sapokrijuara (ose shoqata të ngjashme me GVL-të) në mënyrë që ato të bëhen të afta për të menaxhuar produktet dhe shërbimet turistike:

- mbështetje ligjore dhe teknike për fazën e regjistrimit dhe fillimit (start-up) të shoqatës;
- takime të rregullta për përditësimin dhe përhapjen e ofertave të produkteve dhe shërbimeve turistike;
- mbështetje për organizimin e studimeve vjetore për matjen e prurjeve turistike dhe përpunimin e të dhënave;
- sigurimi i një modeli dhe mbështetje për shpërndarjen e një permbledhjeje mësimore;
- lehtësimi i praktikave më të mira, dhe shkëmbimi i njohurive me palet e interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare.

III) Zhvillimi i produkteve-shërbimeve

Plani Paraprak i Zhvillimit të Turizmit do të përfshijë një planifikim të aktiviteteve të mëposhtme, që do të zbatohen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet vendore të Mallakastrës dhe GVL-në e sapokrijuar, për të garantuar përshtatshmërinë vendore të rezultateve të tyre:

- Konceptimi dhe zbatimi i tre edicioneve të para të një eventi kryesor të qëndrueshëm, që do të promovojë markën territoriale dhe potencialisht do të krijojë një traditë tërheqëse, me të cilën emri i Mallakastrës mund të lidhet në të ardhmen. Ngjarja mund të jetë, për shembull, një festival muzikor ose teatri në zonën arkeologjike, ose një festival i bazuar në një traditë lokale, që do të organizohet çdo vit dhe do të promovohet si i lidhur me markën Bylis/Mallakastra. Koncepti i eventit do t'u ofrohet autoriteteve vendore në formën e një plani të plotë dhe të detajuar për organizimin dhe menaxhimin e eventit. Një vëmendje e madhe do t'i kushtohet qëndrueshmërisë, përfshirjes së gjithëpërfshirëse dhe aksesueshmërisë së eventit.
- Integrimi i Bylisit, Klosit dhe Mallakastrës në të paktën një produkt turistik kulturor (si p.sh. një tur në zonat arkeologjike shqiptare) dhe një produkt turistik bregdetar (si p.sh. një ofertë turistike detare), të menaxhuar nga

operatorë turistikë rajonalë/kombëtare. Kështu, ky aktivitet do të hedhë themelet e lidhjeve të Bylisit si me rrugën arkeologjike shqiptare që do të ndërtohet rreth vetë Bylisit, Apolonisë dhe Antigonës, ashtu edhe me ofertën turistike bregdetare që ofron zona e Vlorës. Aktiviteti do të zbatohet përmes krijimit dhe funksionimit të një grupi pune "Sipërmarrës" në kuadër të GVL-së së sapokrijuar, siç është përshkruar më lart; grupi i punës "Sipërmarrësi" do të përbëhet nga autoritetet publike, sipërmarrës lokalë të sektorit të turizmit dhe zinxhira të tjera vlerash të ndërthurura, dhe (nëse vlerësohet e përshtatshme) operatorë ekonomikë përkatës të zonave/qyteteve të tjera të mëdha shqiptare.

- Zhvillimi i një strategjie qëndrueshmërie për të ardhmen e strategjisë territoriale të marketingut, për të siguruar që ndikimi social i PM të zgjasë dhe të rritet me kalimin e kohës. Aktiviteti do të zbatohet përmes krijimit dhe aktivizimit të një grupi pune "Qëndrueshmëria" në kuadër të GVL-së së sapokrijuar, siç është përshkruar më sipër; grupi i punës "Qëndrueshmëria" do të përbëhet nga autoritetet publike dhe organizatat e shoqërisë civile që merren veçanërisht me aftësitë e kufizuara dhe çështjet mjedisore. Konkretisht, grupi i punës do të synojë identifikimin e shërbimeve që do të menaxhojnë OSHC-të në lidhje me zhvillimin e turizmit të zonës; shërbimet do të kenë një përmbajtje të fortë sociale dhe do të punojnë për të reduktuar ndikimin negativ social/mjedisor të rritjes dhe për të nxitur përfshirjen e zhvillimit lokal. Për shembull, organizatat që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mund të përfshihen në planifikimin e masave për aksesin e zonës së Bylisit dhe më pas mund të vazhdojnë të menaxhojnë aktivitetet e destinuara posaçërisht për përdoruesit me aftësi të kufizuara (si një shërbim transporti i dedikuar nga Fieri ose Vlorë ose turne të aksesueshëm); ose organizatat mjedisore mund të angazhohen në menaxhimin dhe rikuperimin e mbetjeve në parkun e Bylisit ose në burimet natyrore përreth zonës.

IV) Strategjia e Marketingut Territorial

Plani Paraprak i Zhvillimit të Turizmit do të përfshijë një planifikim të aktiviteteve të mëposhtme, ku synimi përgjithësor është një strategji marketingu territorial për territorin e Mallakastrës, e zhvilluar rreth Parkut Arkeologjik të Bylisit dhe Klosit si asete kryesore për nxitjen e një zhvillimi të qëndrueshëm të bazuar në turizmin e zonës:

- Një strategji e markës territoriale, e bazuar në aspektet unike të rajonit (prania e parkut të Bylisit dhe Klosit, burimet lokale, kulturore dhe natyrore) dhe mbi konceptin e një "territori të pazbuluar". Strategjia e markës do të identifikojë një mënyrë gjithëpërfshirëse për promovimin e të gjithë territorit si produkt

turistik, duke përfshirë të gjitha burimet kulturore dhe natyrore të rajonit, duke përfshirë produktet ushqimore, artizanale dhe traditat kulturore jomateriale; do të përcaktojë me saktësi elementet që duhen theksuar në përpjekjet promovuese/komunikimi dhe do të zhvillojë një tregim koherent për rrefimin e territorit. Strategjia e markës jo vetëm do të jetë themeli për krijimin e markës (logo/slogan) dhe do të sigurojë përmbajtjen themelbërëse për të gjithë materialin e komunikimit që do të hartohet dhe prodhohet më vonë, por gjithashtu do të krijojë një mënyrë koherente, tërheqëse dhe të dallueshme të prezantimit të territorit, që do të përdoret në vitet në vijim.

- Një analizë tregu, e bazuar në vlerësimin e llojeve të pranishme turistike në rajonet kufitare (veçanërisht në zonën e Vlorës) dhe në rajone me karakteristika të ngjashme (zonat e sitëve të Apolonisë dhe Antigonisë). Analiza e tregut do të sugjerojë skenarë të mundshëm për turizmin vendor, duke identifikuar tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare për të fokusuar, por dhe mundësitë për t'u afruar atyre në objektiva afatmesëm dhe afatgjatë (pjesëmarrje në panairë turistike, përpjekje të përshtatura komunikimi për grupe të veçanta përdoruesish...); do të identifikojë gjithashtu nevojat dhe mundësitë për krijimin e agjencive të reja turistike dhe organeve publike në nivel vendor dhe për zhvillimin e sipërmarrjeve të reja të mikpritjes apo turizmit.
- Një trajnim për administratoret lokale mbi strategjinë e marketingut territorial, menaxhimin e shërbimeve publike të lidhura me turizmin dhe menaxhimin e ngjarjeve të lidhura me turizmin.

Strategjia do të bazohet në potencialin turistik të rajonit të Mallakastrës për nxitjen e rritjes së zinxhirëve të ndryshëm të vlerave të lidhura me turizmin, duke nxitur kështu një zhvillim vendor gjithëpërfshirës, me ndikime pozitive në punësimin dhe kohezionin social.

Strategjia e marketingut territorial do të ndërtohet mbi rezultatet e Planit Paraprak për zhvillimin ekonomik vendor dhe do të fokusohet në promovimin strategjik të territorit dhe krijimin dhe forcimin e sinergjive publiko-private.

Strategjia e marketingut territorial do të përbëjë gjithashtu mjetin kryesor referues për vënien si prioritete aktiviteteve/nderhyrjeve të Fondit të Zhvillimit Lokal, i cili do të krijohet nga AICS dhe do të përbëhet nga një linjë grantesh në shkallë të vogël për të financuar 70% të aktiviteteve sipërmarrëse të vogla, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë, kryesisht në Hekal dhe fshatra të tjera përreth.

5.2 NDIKIMI I COVID-19 NË TURIZMIN NDËRKOMBËTAR DHE RITJIA IMPRESIONUESE E TURIZMIT NË SHQIPËRI

Pandemia COVID-19 ka prekur ndjeshëm turizmin ndërkombëtar, duke shkaktuar një rënie prej 72% në ardhjet ndërkombëtare në vitin 2020 dhe një rënie prej 71% në vitin 2021 krahasuar me vitin 2019, rezultuar në një humbje të përbashkët të 2.1 miliard ardhjeve ndërkombëtare⁵. Të ardhurat nga eksportet në turizmin ndërkombëtar gjithashtu ranë me 63% në vitin 2020 dhe 61% në vitin 2021, duke regjistruar një humbje të përbashkët prej 2.1 trilionë dollarë në këtë periudhë dyvjeçare.

Përpara sfidave, turizmi ndërkombëtar tregoi elasticitet në vitin 2022, duke rimarrë 63% të niveleve para pandemisë. Evropa udhëhoqi rimarrjen me 80% të ardhjeve para pandemisë, ndërsa Lindja e Mesme përjetoi rritjen relative më të fortë, duke arritur në 83%. Afrika dhe Amerika rimorën rreth 65%, ndërsa Azi dhe Paqësori vetëm 23%, kjo për shkak të kufizimeve të forta të lidhura me pandeminë.

Viti 2022 pa një rimarrje të fortë në shpenzimet turistike, duke çuar në rimarrjen e niveleve të ardhjeve para pandemisë në shumë destinacione. Duke parë përpara, pritet që turizmi ndërkombëtar të konsolidojë rimarrjen edhe pas vitit 2023, e mbështetur nga kërkesa e mbetur, veçanërisht nga Azia dhe Paqësori, me hapjen e destinacioneve dhe tregjeve.

Anketimi i Panelit të Ekspertëve të UNËTO tregoi optimizëm për vitin 2023, me 72% që presin një performancë më të mirë. Megjithatë, 65% e ekspertëve besojnë se turizmi ndërkombëtar nuk do të rikthehet plotësisht në nivelet e vitit 2019 deri në vitin 2024 apo më vonë. Rreziket si sfidat ekonomike, tensionet gjeopolitike dhe pasiguritë lidhur me shëndetin vazhdojnë të kërcënojnë.

Parashikimi i **UNWTO** për vitin 2023 sugjeroi që ardhjet e turistëve ndërkombëtarë mund të arrijnë nga 80% deri në 95% të niveleve para pandemisë, me Evropën dhe Lindjen e Mesme drejtues. Megjithatë, rreziqet potenciale, përfshirë frenimin ekonomik dhe çështjet gjeopolitike, mbeten shqetësuese⁶.

Pavarësisht kësaj, raporti më i fundit i Barometrit Botëror të Turizmit të **UNWTO**⁷ tregoi se Shqipëria ishte në vendin e tretë në nivel global në rritjen e sektorit të

⁵ <https://www.unwto.org/impact-assessment-of-the-covid-19-outbreak-on-international-tourism>

⁶ Vështirësitë ekonomike, të shënuar nga inflacioni i lartë dhe rritja e çmimeve të naftës, vazhdon të ndikojë në rimarrjen e turizmit. Për më tepër, pasiguria që vjen nga agresioni rus kundër Ukrainës dhe tensionet gjeopolitike në Azinë Lindore, së bashku me sfidat e lidhura me shëndetin dhe mungesën e forca punëtore, paraqesin risqe të tjera të rëndësishme.

⁷ www.unwto.org

turizmit gjatë shtate muajve të parë të vitit 2023 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Numri i turistëve në Shqipëri u rrit me 56% krahasuar me periudhën para pandemisë në 2019. Vendin e parë e zuri Katari, me një rritje prej 95%, ndjekur nga Arabia Saudite me një shkallë rritjeje prej 59%. Shqipëria përmbysi destinacionet më të njohura evropiane si Kroacia, Franca, Greqia, Italia dhe Spanja, ndërsa turizmi global vazhdon rimarrjen pas pandemisë, megjithatë shifrat totale ende mbeten mbrapa vitit 2019. Vende tjera me një rimarrje të fortë në turizëm përfshijnë Armeninë, Malin e Zi dhe Serbinë.



FIGURA 61 - BAROMETRI BOTËROR I TURIZMIT I UNWTO, NJË GJURMUES I RREGULLT I TENDENCAVE AFATSHKURTRA TË TURIZMIT QË OFRON NJOHURI TË PËRDITËSUARA MBI TURIZMIN NDËRKOMBËTAR, E KA POZICIONUAR SHQIPËRINË NË VENDIN E TRETË GLOBALISHT PËR PERIUdhËN nga JANARI DERI NË KORRIK 2023.

Megjithatë, për të realizuar një analizë të rritjes së turizmit në Shqipëri dhe për të bërë një parashikim deri në 2030 janë përdorur si një udhëzues trendet dhe parashikimet e përgjithshme të UNWTO. Të dhënat e UNWTO zakonisht përfshijnë informacione si numri i arritjeve ndërkombëtare të turistëve, të ardhurat nga turizmi, dhe ndikimi i ngjarjeve globale si pandemia COVID-19. Bazuar në këto informacione, projeksioni merr parasysh një rimëkëmbje të fortë pas pandemisë dhe një rritje të qëndrueshme në vitet në vijim.



FIGURA 62 – PROJEKTIMI I RITJES SË TURIZMIT NË SHQIPËRI 2015-2023

Projektimi i mësipërm është krijuar nga konsulentët dhe tregon një rritje të qëndrueshme nga viti 2015 deri në 2019, një rënie të ndjeshme për shkak të pandemisë në vitin 2020, dhe një rimëkëmbje në vitet pasuese me një rritje të theksuar në vitin 2023. Duke u bazuar në këtë rimëkëmbje të fortë të vitit 2023, projektimi për periudhën 2024-2030 parashikon një rritje të vazhdueshme vjetore prej rreth 10%. Kjo supozon një zhvillim të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm të sektorit të turizmit në Shqipëri e cila ndikohet dhe do të vazhdoj të ndikohet nga faktorë si zhvillimi i infrastrukturës turistike, nisma dhe politika qeveritare për promovimin e turizmit, si dhe trendet e udhëtimeve globale.

5.3 INVESTIMET NË MBËSHTËTJE TË TURIZMIT KULTUROR PËRRETH BYLISIT

Parku Arkeologjik i Bylisit dhe rrënojat e Klosit janë dy një nga pasuritë më unike në Shqipëri dhe pjesë e itinerareve turistike elitare që nga fillimet e turizmit në vend. Si dy nga gurët e çmuar të arkeologjisë shqiptare, këto site ka tërhequr vëmendjen e shumë turistëve vendas dhe të huaj, megjithatë, mungesa e infrastrukturës rrugore ka kufizuar aksesin, kryesisht në Bylis (për më tepër shiko tabelën).




FIGURA 63 – NUMRI I VIZITORËVE NË PAB, 2015-2023, BURIMI MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Analiza e të dhënave të vizitorëve në Parkun Arkeologjik të Bylisit nga viti 2015 deri në vitin 2022 ofron një pamje të zhvillimit të interesit të vizitorëve në këtë periudhë.

- **Tendencat Vjetore**

Nga viti 2015 deri në vitin 2018, ka një rritje e vazhdueshme e numrit të vizitorëve, duke arritur në kulmin e saj në vitin 2018 me 5,587 vizitorë. Pas vitit 2018, ka një rënie e ndjeshme e numrit të vizitorëve në vitin 2019, nga 5587 në 4595. Në vitin 2020, shënohet një rënie drastike në numrin e vizitorëve, duke arritur në 625, një reduktim i madh i lidhur me ndikimet e pandemisë COVID-19.

- **Ndikimi i Pandemisë COVID-19**

Rënia drastike e numrit të vizitorëve në vitin 2020 është një shenjë e ndikimit të fuqishëm të pandemisë në industrinë e turizmit. Në vitin 2021, ka një rritje e cila tregon një përmirësim gradual pas mbylljes së masave kufizuese dhe rikthimit të besimit të vizitorëve për të vizituar. Në vitin 2022, numri i vizitorëve vazhdon të rritet, duke treguar një tendencë pozitive të rimëkëmbjes.

- **Potenciali për Rritje**

Numri i vizitorëve në vitin 2022, me 3701, është ende nën nivelin e kulmit të vitit 2018 (5587). Kjo mund të shpjegojë se ka ende potencial për rritje në të ardhmen me përmirësimin e strategjive të marketingut, promovimit të aktiviteteve të veçanta, dhe sigurimin e një eksperience të paharrueshme për vizitorët. Viti 2023 tregoi se kjo mund të arrihet me rritje afërsisht 5897.

- **Aktivitete Shtesë**

Për të shtuar vlerë për eksperiencën e vizitorëve, duhet të propozohen ngjarje dhe aktivitete shtesë që lidhen me trashëgiminë kulturore të sitit, duke krijuar kështu një motivim më të madh për vizita të rregullta nga vizitorë lokal dhe ndërkombëtarë.


Për të përmirësuar qasjen dhe për të ndihmuar në zhvillimin e mëtejshëm të parkut dhe zonës përreth, është e domosdoshme të investohet në infrastrukturë. Puna e re në rrugën që lidh qytetin antik të Bylisit me autostradën Levan-Tepelenë pritet të ndihmojë në lehtësimin e aksesit dhe të kontribuojë në rritjen e turizmit në zonë. Një mundësi shtesë për të nxitur turizmin në Parkun Arkeologjik të Bylisit dhe Klos është edhe shpallja e Lumit të Vjosës Park Kombëtar. Kjo hapësirë e re mund të sjellë perspektiva të reja në fushën e mjedisit dhe turizmit në jug të vendit. Lumi Vjosë dhe degët e tij përshkojnë zonat e Përmetit, Gjirokastrës dhe Tepelenës, duke bërë këtë zonë një burim të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomive lokale, veçanërisht të turizmit ekologjik dhe kulturor. Një tjetër faktor i rëndësishëm që pritet të shfaq mundësi të tjera për zhvillimin turistik në këtë zonë është ndërtimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës. Ky investim pritet të sjellë një rritje ekonomike me një kthim investimi 23% e shtrirë në 10 vite në zonën e Vlorës ku në aspektin e turizmit me rëndësi është afrimi i siteve kulturore të Bylisit, Apolonisë, Gjirokastrës dhe Butrintit më pranë udhëtarëve ndërkombëtarë. Ky investim së bashku me rrugën e re që lidh Bylisin me autostradën Levan-Tepelenë dhe zhvillimi i investimeve turistike në Parkun Kombëtar të Lumit të Vjosës do të ndihmojnë në kthimin e kësaj zone në një destinacion të preferuar për ekskursionet dhe itinerarët turistike, ndërkohë që investimi direkt i Bashkimit Europian për Bylisin, përmes fondit IPA, do të ndihmojë rritjen e ofertës turistike me fokus kulturën jo vetëm në zonën e jugut të Shqipërisë por edhe Greqinë veriore dhe Maqedoninë e Veriut.

5.4 INVESTIMET NË INFRASTRUKTURËN TURISTIKE - IPA 2018

Investimet e propozuara në kuadër të projektin të IPA 2018 “BE për Zhvillimin Ekonomik drejtuar nga turizmi, zhvillimi ekonomik dhe vendor me fokus mbi Trashëgiminë Kulturore”, paraqesin një mundësi të shkëlqyer për të transformuar parkun arkeologjik të Bylisit dhe atë të Klosit në një destinacion të rëndësishëm. Ky program investimesh parashikon përgatitjen e një koncept Masterplani ku do të përcaktohen të gjitha ndërhyrjet në infrastrukturë që vijnë si rezultat i vlerësimeve të studimeve të mundshme dhe projektit paraprak, i bazuar në hulumtimet diagnostikuese. Ai përmban, në fakt, raporte të specialistëve, dizajne grafike të lidhura me strukturat, përlllogaritje ekzekutive të mjedisit të rrethuar, kornizën ekonomike, kalendarin kohor, vlerat metrike, etj.

Përcaktimi i faciliteteve në shërbim të vizitorëve dhe të perceptimit unik të parkut përfaqëson një trajtim krejt të ri të problematikës së Parkut Arkeologjik Bylis, për shkak të mungesës së plotë aktuale të këtyre përbërësve themelorë. Si të tillë PM ka evidentuar: njësitë e biletarisë, nyjet sanitare; Muzeun e Parkut Arkeologjik të Bylisit dhe Klos; këndin SAL; Laboratorin e Restaurimit me magazinimin përkatës të gjetjeve

arkeologjike; ambientet e arkeologeve për vendosjen e ekspeditave kërkimore; Shkollën-kantier për edukimin e nxënësve dhe studentëve, si dhe parkingun për mjetet e vizitorëve e autobuzët turistikë. Përzgjedhja e një vendi të përshtatshëm për ndërtimin dhe përmbajtja e muzeut do të synojnë të jenë pjesë themelore e brand-it të Parkut Arkeologjik Bylis. Nga pikpamja metodologjike muzeu do të synojë që përtej paraqitjes së historisë dhe kulturës së Bylisit të përfaqësojë qytetërimin më të zhvilluar ilir të shek. IV-I p. Kr., ndërsa vendndodhja e Muzeut do të harmonizohet me profilin arkeologjik dhe ambiental të sitit. Është e rëndësishme të theksohet se detajimi i masterplanit dhe ndërhyrjet e propozuara në të do të diskutohen dhe miratohen sipas kuadrit ligjor të parashikuar në Ligjin Nr. 27/2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.



Koncepti për një masterplan, është subjekt i përpunimit, rishikimit dhe detajimit të mëtejshëm në kuadër të projektit "BE për Zhvillimin Ekonomik të Drejtuar nga Turizmi, Zhvillimi Ekonomik dhe Vendor me Fokus mbi Trashëgiminë Kulturore" dhe do t'i përshtatet kuadrit ligjor për trashëgiminë kulturore. Elaborimi dhe detajimi i masterplanit do të përfshijë projektimin e qendrës muzeale, shtigjeve turistike, pikave të interesit etj.

5.4.1 INFRASTRUKTURA CIVILE

5.4.1.1 KONCEPTIMI I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE - MUZEU

Investimet në infrastrukturën civile kanë për qëllim të krijojnë fizionominë bashkëkohore të Parkut Arkeologjik Bylis, duke siguruar ruajtjen maksimale të aseteve të ti dhe duke ofruar përdorimin e tyre në arritjen e objektivave të përcaktuar në “Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025”. Krijimi i një brandi original në sistemin aktual të parqeve arkeologjike dhe tërheqja e një numuri të konsiderueshëm turistësh do të ketë një ndikim të dukshëm në zhvillimin e qëndrueshëm të trevës së Mallakstrës përmes turizmit kulturor. Impakti në formimin e identitetit lokal të krahinës dhe në atë kombëtar është një nga synimet e tjera të fokusimit në infrastrukturën civile të parkut, vecanërisht në krijimin e Muzeut Arkeologjik të tij.

Parashtrimi i objektivave që lidhen më këtë kapitull të PM është mbështetur në kriteret e përgjithshme si më poshtë:

- vlerësimi i kujdesshëm i situatës aktuale i bazuar në mbledhjen dhe përpunimin e dokumentacionit ekzistues, vecanërisht në përzgjedhjen e vendit të ndërtimit të objektit multifunksional, që përcakton edhe planin e mobilitetit të vizitorëve;
- përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve turistike, duke parapëlqyer zgjidhjet teknike që kanë më pak ndikim në situatën ekzistuese dhe çojnë në uljen e kostove të menaxhimit dhe mirëmbajtjes;
- konsiderimi i dinamikës së zhvillimit të rrugëve të qëndrueshme turistike që përcakton mundësitë e aksesit për vizitorët, përdoruesit lokalë dhe kohën e vizites (vizitë e shkurtër/e gjatë).
- vlerësimi i mundësisë së ripërdorimit të ndërtesave ekzistuese;
- përfshirja e komuniteteve lokale dhe institucioneve përkatëse në veprimtaritë specifike, apo ato të lidhura me bizneset në dobi të turizmit kulturor.

Mbi bazën e kërkesave të parashtruara më sipër janë vlerësuar ndërtimet e mëposhtme civile:

1. Qendra multifunksionale me funksionet e mëposhtme:

- a. Muzeu arkeologjik i Qytetërimit Antik Ilir me sallat që do të paraqesin përmes artefakteve dhe mjeteve multimediale zhvillimin e qytetërimit antik në periudhën ilire, në atë koloniale dhe provinciale romake dhe gjatë Antikitetit të Vonë, duke përfshirë edhe premisat e tij në periudhat prehistorike, si dhe trashëgiminë e tij në Mesjetën e hershme në trevën e Mallakastrës.

- b. Depot e magazinimit të fondit të artefakteve të zbuluara në gërmimet arkeologjike dhe ato që do gjenden në ekspeditat e ardhëshme, të shoqëruara me instalimin e sistemit të regjistrimit dhe dokumentimit të tyre.
- c. Laboratorin e konservimit dhe restaurimit paraprak të objekteve arkeologjike të Fondit arkeologjik të Parkut Bylis.
- d. Sallat e konferencave dhe ekspozitave të përkohëshme, së bashku me ambientet e Shkollës kantier dhe Klasës didaktike, ku do të bëhet demonstrimi i teknikave të gërmimit dhe studimit arkeologjik për nxënësit e shkollave, apo turiztët kuriozë.
- e. Shtëpia e arkeologut dhe restauratorit me ambientet e nevojshme për akomodimin e personelit të ekspeditave përkatëse që do të punojnë në Bylis.
- f. Dyqani për tregtimin e suvenireve dhe librave të lidhur me funksionin e muzeut.
- g. Kafeteria me shërbimin e pijeve analkolike dhe ushqimeve të paketuara.
- h. Zyrat e administratës së Parkut Arkeologjik Bylis.


2. Facilitetet e pritjes së vizitorëve me funksionet e mëposhtme:

- a. Biletaria me instalimin për kontrollin digital të biletave.
- b. Parkingu për autobuzët, atoveturat dhe i vecuar për personelin dhe pjestarët e ekspeditave arkeologjike dhe restauruese.
- c. Nyja sanitare

3. Ndërtesat ndihmëse

- a. Mbi bazën e përdorimit të ndërtesave egzistuese brenda territorit të Parkut, apo pranë tij propozohet të bëhet marrja nën administrim e ndërtesës së Restorantit, si dhe të riparohen ndërtesat e ndërtuara nga Instituti i Arkeologjisë dhe ish Instituti i Monumenteve të Kulturës (sot IKTK), për tu përdorur për nevojat e ndryshme që do të ketë administrata e Parkut.

Plani i Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos përmban vetëm udhëzimet kryesore në realizimin e ndërtimeve civile të Parkut. Në to do të përfshihen gjithashtu edhe Plani Paraprak për Menaxhimin e Mbetjeve të Parkut; Projekti Paraprak për Sistemin Elektrik të Parkut; Plani Paraprak për Furnizimin me Ujë të pijshëm dhe për vaditjen e sipërfaqeve të gjelbëra të Parkut; Plani Paraprak për Sistemet e Sigurisë me monitorimin në distancë dhe regjistrimin e aktiviteteve të ndryshme.



Ideja për një qendër multifunksionale. Projektimi dhe detajimi i qendrës multifunksionale do të realizohet nga studio të specializuara arkitektonike në bashkëpunim me MEKI-n.

5.4.1.2 MUZEU ARKEOLOGJIK, ANALIZË PËR POZICIONIMIN E NDËRTESËS

Propozimi i ndërtimit të Muzeut Arkeologjik në Bylis, një godine multi funksionale me një zone shërbimesh, parkimi dhe muzeor, duhet të respektojë parime të cilat janë të njohura në ligjin e Trashëgimisë Kulturore dhe Muzeumeve të vitit 2018:

- a) Ndërtimi i këtij kompleksi multi funksional nuk duhet të çenojë zonën arkeologjike të njohur nga hulumtimet e kryera nga arkeologët.
- b) Nuk duhet të çenohet pamja e përgjithshme e peizazhit të brendshëm e të jashtëm mijëravjekar të sitit.
- c) Kompleksi duhet të ndërtohet në një zonë të parkut Bylis-Klos që nuk ka potencial arkeologjik.
- d) Në ndjekje të një parimi të zbatuar në site të ngjashme arkeologjike, kjo godinë në përbërje të së cilës do të jetë dhe Muzeu Arkeologjik, duhet të mbyllë vizitën turistike në park.

Në konsultën edhe me IA, që kemi realizuar gjatë kësaj kohe dhe njohjen me dokumentacionin e përgatitur të PM në lidhje me këtë ceshtje janë propozuar dy variante:

- a. **Varianti i parë** propozon vendosjen e një zone muzeale së bashku me shërbime dhe zonë parkimi jashtë mureve të qytetit, tek sheshi në perëndim të oborrit të fortifikuar deri poshtë portës 6. Kjo vendosje ka prioritetin, sepse gjendet jasht murit rrethues të qytetit, duke siguruar aksesin e vizitorëve nëpërmjet

një rrugë vetëm për vizitorët, që kalon përmes portës nr. 6, për të filluar vizitën në Bazilikën B.

Ndërkohë varianti ka këto disfavore:

- Në njohje të potencialit arkeologjik që ka kjo zonë e Bylisit për egzistencën e nekropolit të periudhës romake, vendosja e ndërtesës multifunkionale presupozon paraprirjen nga gërmimi arkeologjik në një sipërfaqe rreth 1650 m² ku do të shtrihet kompleksi, si dhe në rrugën prej rreth 1000 m², e cila do ta lidhë atë me porten nr.6. Kjo do të rriste shumë kostot financiare të projektit pasi siç dihet gërmimet arkeologjike janë të shoqëruara me restaurime objektesh si dhe me nje procedurë të gjatë të kohës së realizimit të studimit. Njëkohësisht nuk jemi të sigurtë që pas gërmimit arkeologjik kjo zonë do të jetë e pastër arkeologjikisht për të realizuar ndërtimin.



FIGURA 64 - VARIANTET E VENDOSJES SË MUZEUT ARKEOLOGJIK NË BYLIS

- Aktualisht vendi i propozuar gjendet jasht rrjetit rrugor auromobilistik dhe për lidhjen e tij me rrugën e re që lidh Parkun Arkeologjik të Bylisit me autostradën do të nevojitet hapja e një degëzimi tjetër të saj me gjatësi rreth 300 m.



FIGURA 65 - VARIANTI I PARË I VENDOSJES SË MUZEUT ARKEOLOGJIK NË HAPËSIRËN POSHTË POTËS NR. 6. FOTO N. CEKA



FIGURA 66 - SHEMBUJ KUR NDËRTESA E MUZEUT KTHEHET NË NJË "SHENJË ARKITEKTONIKE". MOUNTAIN MUSEUM, SUDTIROL DHE MUSEO DI OETZI NË BOLZANO, ITALI

- Varianti i dytë** parashikon vendosjen e kompleksit brenda murit rrethues, por në zonën e euhorionit, një sipërfaqe rreth 4 ha në pjesën juglindore të qytetit antik, ku nuk ka asnjë gjurmë arkeologjike, sepse i ka qenë rezervuar vendosjes së banorëve të fshatrave bashkë me kopetë e pasuritë e tyre në raste luftash. Si rrjedhim terreni është i përshtatshëm për vendosjen e kompleksit pa nevojë gjermimesh arkeologjike paraprake, apo zgjidhje. Favoret dhe disfavoret e

kësaj zgjidhje do të ishin si më poshtë. Vendosja e muzeut arkeologjik në pjesën më jugore të terrenit, të ekspozuar ndaj pamjes nga autostrada, do të ishte një promovim i natyrshëm i Parkut Arkeologjik të Bylisit, për tërheqjen e vizitorëve që përshkojnë atë rrugë.



FIGURA 67 - HAPËSIRA E PROPOZUAR NË VARIANTIN II PËR VENDOSJEN E MUZEUT ARKEOLOGJIK

Disfavoret e kësaj vendosje janë:

- Aksesi në zonën e kompleksit do të kërkojë një rrugë të re prej rreth 800 m të shtruar vetëm me çakull, për të siguruar kalimin e automjeteve, pa dëmtuar ndërtimet e mbuluara nga dheu mbi të cilët do të kalojë rruga.
- Furnizimi me ujë dhe korrent do të kërkojnë shpenzime shtesë për të gjithë gjatësinë prej 800 m që e ndan nga pikat e furnizimit.
- Në një vendosje të tillë biletaria dhe facilitetet e pritjes së vizitorëve do të shkëputeshin nga kompleksi, për tu vendosur në hyrje të parkut, duke krijuar probleme për vizitorët dhe administratën e parkut.

Duke marrë parasysh kushtet e mësipërme, do të preferohej që kompleksi multifunksional i Bylisit të ndërtohet në njërin nga zonat jashtë mureve rrethuese, si pjesë mbyllëse e vizitës në sitin arkeologjik. Funkzioni i tij, që është shumëdimensional, përfshin muzeun arkeologjik, ambientin e punës së arkeologëve, ambientin administrativ të parkut, depo arkeologjike, sallën e laboratorit, sallën e bibliotekës dhe konferencave, ambientin e suvenireve, tualetet, ndihmën e shpejtë, etj. Këto kushte kërkojnë që ky kompleks, edhe pse është në shërbim të sitit, të ruajë autonomi në funksionimin e pjesëve të veçanta. Marrja e një vendimi përfundimtar duhet të

paraprihet patjetër nga një konsultim *ad hoc* i arkeologëve, të cilët njohin rrezikun arkeologjik, së bashku me arkitektët që njohin teknologjinë e vendosjes së komplekseve të tilla. Ndërtimi duhet të miratohet sipas kuadrit ligjor, ku para ndërhyrjes parashikohen vëzhgime dhe sondazhe arkeologjike për të vlerësuar potencialin arkeologjik. Gjithashtu, është e rëndësishme që në këtë kuadër të evidentohet pronësia mbi pronën para se të fillojnë ndërhyrjet.

5.4.1.3 MUZEU ARKEOLOGJIK, ZGJIDHJA ARKITEKTONIKE

Shumë objekte arkeologjike të gjetura në Bylis dhe territorin e tij, pjesa më e madhe e tyre ruhet në Fondet e Institutit të Arkeologjisë dhe Muzeut Arkeologjik të Apollonisë, ndërsa një pjesë e objekteve më të spikatura janë të ekspozuara në Muzeun Kombëtar, Muzeun Arkeologjik të Institutit të Arkeologjisë në Tiranë, Muzeun Historik të Fierit dhe Muzeun e Apollonisë. Ndërtimi i Muzeut Arkeologjik të Bylisit do të japë mundësinë e ekspozimit të një pjese të rëndësishme të atyra objekteve në një program të veçantë dhe në një funksion shumë më të gjerë didaktik dhe kulturor.

Muzeu Arkeologjik I Bylist është pjesë përbërëse e Godinës multifunkionale që do të ndërtohet në Parkun Arkeologjik Bylis. Kjo godinë do të përbehët nga Muzeu me Sallat e ekspozitës muzeale; Sallën e Mbledhjeve dhe Ekspozitave të Përkohëshme; Sallën e Muzeut Virtual për "Story Telling; Dyqanin e suvenireve dhe Librarisë, Zyrën e Personelit dhe ambiente të tjera ndihmëse. E njejta ndërtesë do të strehojë edhe Fondet Arkeologjike, Laboratorin, Ambientin e Kantierit- shkollë dhe Muzeut në Natyrë për veprimtaritë didaktike e edukative për nxënësit e arsimit parauniversitar. Në varësi të kushteve që do të ofrojë përzgjedhja e vendit për ndërtimin e kompleksit, ai do të përmbajë edhe Biletarinë me instalimin elektronik për verifikimin e biletave, Bar-kafe në shërbim të vizitorëve, si dhe Nyjet Sanitare.

Muzeu arkeologjik; do të ketë *dy kate* duke u shtrirë horizontalisht për të siguruar sipërfaqet e duhura, pa u ngritur në lartësi. Në *katin e përdhe* do të vendoset Arkivi, Fondi i materialeve arkeologjike dhe Laboratori, Tualet , Shtëpia Arkeologeve . Në Arkiv do të depozitohen të gjithë materialet e dala nga gërmimet arkeologjike, pasi të kenë kaluar procesin e pastrimit, katalogimit dhe të restaurimit. Për të favorizuar një mikroklimë të interierit të fondit, të përshtatshëm për ruajtjen e artefakteve, por edhe që të mund të sigurohet pa shpenzime të mëdha energjitike, sugjerohet që pjesa e fondit të vendoset në pjesën e prapme të muzeut duke shfrytëzuar pjerrësinë e terrenit, duke u futur pjesërisht në të. Fondi, si një hapësirë pa nevoja specifike ndriçimi, është ambienti më i përshtatshëm për tu mbështetur e pjesërisht për tu zhytur në shkëmb, duke zvogëluar kështu vellimet e spostimeve të dherave, dhe për pasojë edhe kostot e kohët e ndërtimit. Për fondin do të parashikohet një hyrje e veçantë dhe një rrugë e veçantë, e cila do të jetë një degëzim i rrugës që të çon në

sheshin para muzeut, dhe do të mundësojë hyrje nga anash objektit edhe për mjetet mekanike.

Sallat ekspozuese do të vendosen në katin e pare, në një tarracë të sipërme, të shkallëzuar, duke mos rënduar ndërtesën e duke kursyer kosto ndërtimi që në të kundërt, do të duheshin për të realizuar struktura me aftësi të mëdha mbajtëse. Krahas sallave ekspozuese ne katin e pare do te jene dhe ambjentet e tjera sekondare të muzeut (sallë konference dhe demonstrimi të “story telling” e mjeteve të tjera innovative digitale të paraqitjes, njësi tregtare për suvenire, qendër kërkimore, tualet , holl etj) .

Laboratori i restaurimit mund të jetë një hapësirë që do të pozicionohet në katin perdhe , dhe edhe pse është një ambient që duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me fondin, në sajë të një ideje innovative projektuese, mund të gjendet mënyra për të patur një lidhje të lehtë me të, edhe duke qenë në katin 2.

Programi i Muzeut Arkeologjik do të synojë të rindërtojë imazhin e Bylisit si një qendër e rëndësishme politike dhe kulturore ilire përmes ekspozimit të materialeve arkeologjike në një sistem kronologjik dhe tematik. Si i tillë ai përfaqëson një unitet paralel me Muzeun e Hapur, që përbëhet nga monumentet në natyrë të Parkut Arkeologjik Bylis. Kjo ndarje do të rrisë alternativat që i ofrohen vizitorit, duke ju përshtatur kërkesave të tij dhe kohës që ka në dispozicion.

Plani i Menaxhimit parashtron vijat e përgjithshme të përmbajtjes së Muzeut Arkeologjik, ndërsa detajimi i tyre me përcaktimin e funksionit dhe hapësirave të ekspozimit do të jetë detyrë e një grupi të Licencuar dhe me eksperience arkeologjesh e arkitektësh që do të përgatisin projektin e Muzeut Multifunksional Arkeologjik. Per projektin e Muzeut është e nevojshme përvoja e muzeologut për të përcaktuar kriteret metodike të ekspozimit. Informacioni duhet paraqitur e organizuar duke patur parasysh kategori të ndryshme vizitorësh, të cilët në sajë të bagazhit të tyre kulturor, do të mund të asimilojnë lehtësisht atë. Rekomandohet që ky informacion ti përshtatet grupkategorive të vizitorëve, si dhe grupmoshave. Në mënyrë të veçantë do të konsiderohen moshat shkollore parauniversitare,që do të duhet të marrin nga muzeu kuriozitetin, shpirtin e aventurës e të eksplorimit, duke i mundësuar lehtësinë e thithjes së informacionit të prezantuar shkurt, të koncentruar dhe atraktiv. Për këtë do të shërbejë një lidhje e ngushtë e përmbajtjes së muzeut me Kantierin Shkollë, që do të ketë ambientin e tij brenda ndërtesës së Muzeut Arkeologjik.

Krahas Muzeut Arkeologjik në Ndërtesën multifunksionale propozohet të integrohet edhe **Shtëpia e Arkeologut dhe Restauratorit**, që do të shërbejë për strehimin e specialistëve përkatës në periudhat e ekspeditave, por edhe të studiuesve që kanë si

temë Bylisin dhe territorin e tij. Pozicionimi i saj do të bëhet në katin +1 të ndërtesës, duke siguruar njëkohësisht edhe një hyrje të pavarur për të. Në rastet kur nuk ka ekspedita arkeologjike, shtëpia e arkeologut duhet të transformohet në rezidencën e arkeologut të ftuar. Si në raste të ngjashme në ekperiencat botërore, edhe struktura menaxhuese e PAB do të duhet të bëhet pjesëmarrëse e aplikuese në projekte ndërkombëtare të fushës, ku një të pjesë e rëndësishme ti dedikohet “arkeologut në Rezidencë”. Arkeologë shqiptarë, apo të huaj, të financuar nga fonde projektsh kombëtare dhe ndërkombëtarë do të qëndrojnë periudha të caktuara në Bylis, do të zhvillojnë temat e tyre studimore dhe do të bëhen për pasojë promotorë e promovues të Muzeut dhe Parkut arkeologjik të Bylisit, duke influencuar direkt në njohjen e tij në botë e për pasojë, edhe në rritjen e impaktit të turizmit në të.

Hapësira e Muzeut Arkeologjik do të zhvillohet në harmoni me a) Biletarinë dhe Nyjen Sanitare; b) Hyrjen për në Parkun Arkeologjik me sistemin e kontrollit të biletave; c) Parkingun e PAB, të cilat do të jenë pjesë e të njëjtit projekt dhe e së njëjtës zgjidhje arkitektonike. Në cdo rast do të merret parasysh përzgjedhja e vendit të Muzeut Arkeologjik në vendosjen e parkingut dhe faciliteteve të pritjes, sepse në rastin e vendosjes së muzeut në zonën e euhorion do të ketë një shpërndarje të tij nga biletaria dhe hyrja e Parkut Arkeologjik.

5.4.1.4 PËRMBAJTJA E MUZEUT ARKEOLOGJIK

Përmbajtja e Muzeut Arkeologjik do të trajtohet në vijat themelore të karakterit të atij muzeu, si dhe të renditjes kronologjike dhe tematike asaj përmbajtje. Zhvillimi i plotë i ekspozitës muzeale do të jetë detyrë e një projekti të veçantë, që do t'i bashkëngjitet projektit arkitektonik. Krijimi i një database të gjetjeve arkeologjike me potencial muzeal, të zbuluara ndër vite nga gërmimet arkeologjike dhe të cilat që ndodhen aktualisht në Fondet arkeologjike të Institutit Arkeologjik dhe në Fondet Arkeologjike në Apolloni, si dhe të eksponateve të veçanta në muzetë e ndryshëm do të jetë një veprim i domosdoshëm për realizimin e këtij projekti. Njëkohësisht duhet të skedohet dhe të instalohet në atë database edhe materiali arkitektonik që aktualisht është i shpërndarë në sit, por që mund të ekspozohet në pavionet e muzeut arkeologjik. Me rëndësi është dhe përzgjedhja e dokumentacionit të gërmimeve arkeologjike dhe të restaurimeve të kryera që nga viti 1978 në Bylis, që ndodhet në Arkivat e IA dhe IKTK. Përgatitja e një projekt ideje paraprake mbi organizimin e pavioneve të muzeut, planifikimit të sipërfaqës së ekspozimit, si dhe hartimi i një katalogu të eksponateve të mundëshme të Muzeut Arkeologjik do të jetë detyrë e një grupi specialistësh që do të angazhohen në ekipin që do të përgatisë projektin e Muzeut Arkeologjik të Bylisit dhe Klosit. Njohjen me materialin arkeologjik të zbuluar ndër vite nga gërmimet e kryera në Bylis dhe rrënojave të Klosit të cilat plotësojnë parametrat shkencore dhe

historik për ekspozitën e perhershme të Bylisit, mendojmë që hapësira e ekspozimit të jetë rreth 850 m² në katin e parë të ndërtesës multifunktionale.



FIGURA 68 - MODEL EKSPOZIMI NË PROJEKTIN E MUZEUN E INSTITUTIT TË ARKEOLOGJISË, TIRANË-1

Sugjerohet që në Muzeun Arkeologjik të pasqyrohet gjithë dinamika e zhvillimit ekonomik-kulturor të qytetit të Bylisit dhe të zonës përreth tij (përfshi Klosin) që nga periudhat e hershme prehistorike e deri në mesjetë. Natyrisht përmbajtja e muzeut me një diapazon të gjërë kulturorë është I mundur pasi vetë treva ku është ngritur qyteti i Bylisit ka një potencial të zhvilluar arkeologjiko-historik. Gërmimet arkeologjike të kryera për një periudhë shumëvjecare kanë zbuluar një material muzeal me shumë rëndësi jo vetëm historike por edhe estetike që është një tjetër potencial për ngritjen e muzeut.

Tashmë në depot arkeologjike të Apollonisë dhe Tiranës janë shumë objekte arkeologjike të regjistruar me prejardhje nga territori i Bylinëve, nga ku mund të vecojme;

- skulptura: Komiku mbi altar, Amazona, Portreti i perandorit Hadrian, etj.
- fragmente arkitektonike: Altarët e vëllezërve Terentianus, Bomos-i i gjetur bashkë me Amazonën, Siamt e gjetura pranë prytaneion, Kolona dhe kapitele të përdorura si spolie në ndërtimet e antikitetit të vonë, etj.
- mbishkrime latine: Mbishkrimi i Salentinus, Mbishkrimi i Duumvirëve, Mbishkrimi për shkronja bronzi i Augustit, Mbishkrimi i Cecilians, etj
- ene prej balte dhe metalike: Inventari i varreve të zbuluara pranë portës nr.3 dhe portës nr. 6, etj

- vegla te shumta pune, instrumente liturgjike nga bazilikat paleokristiane, etj.
- Amforat tipike të prodhuara në Bylis dhe pitosat e gjetur në gërmimin e bazilikave, etj.

Propozojmë që Muzeu Bylisit të jetë një model i veçantë nga muzeumet e tjera të siteve arkeologjike si në Apolloni, Durrës, Butrint dhe Korçë. Kjo do të realizohet duke ndjekur një metodologji të ndryshme nga sa më sipër si në përmbajtje ashtu edhe në strukturë.

a. Metodologjia e realizimit të ekspozitës muzeale

Mendojmë që Muzeu Arkeologjik të përmbajë artefakte që vijnë nga gërmimet në monumente kryesore me qëllim të krijimit të një vizioni mbi nivelin e zhvillimit urbanistik, shoqëror dhe religjioz të qytetit dhe zonës, të cilët duhet të ekspozohen mbi parimet e mëposhtme metodologjike:

- Hartimi i një data basë që do të përmbajë të gjithë artefaktet dhe materialet fotografike, grafike, etj., të cilat do të krijojnë përmbajtjen e Muzeut Arkeologjik është e domosdoshme për fillimin e punës. Konservimi i artefakteve është një detyrë e rëndësishme që duhet planifikuar dhe përfunduar krahas përgatitjes së Ekspozitës së Përhershme. Shkalla në të cilën do të prezantohen temat kryesore dhe nën-temat përkatëse do të varet shumë nga disponueshmëria e artefakteve dhe informacionit që do të prezantohet në mënyrë dixhitale.
- Bashkëpunimi me punonjës të specializuar të Institutit të Arkeologjisë, IA dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, IKTK në të gjithë procesin është një nga kriteret në realizimin e ekspozitës së Muzeut Arkeologjik, projektin e ndërtimit të Muzeut Arkeologjik, si dhe të zbatimit të ekspozitës muzeale, si dy procese krejtësisht të veçantë nga njëri tjetri
- Duhet të ndiqet një rënditje kronologjike e kulturore në zhvillimin urban dhe arkitektonik të qytetit nga themelimi i tij e deri në braktisjen në fund të shekullit VII.
- Të shtjellohet më shumë marrëdhëniet e qytetit me Apoloninë dhe me brendësinë e siteve arkeologjike;
- Të trajtohen objektet në kuadrin historik dhe kulturor të kohës, psh. Qyteti në periudhën e Cezari dhe Pompeut; Zhvillimi gjatë shekujve I-IV dhe aspekte të romanizimit; Kulti i Perandorëve
- Ekspozita e përhershme do të japë informacion të plotë mbi zhvillimin e qytetit të Bylisit gjatë Antikitetit të Vonë.

Një ekspozitë tematike konsiderohet mënyra më e mirë për të shpjeguar zhvillimet komplekse të këtij qyteti, prandaj tetë temat kryesore janë identifikuar dhe renditur më poshtë. Në trajtimin e tyre janë marrë parasysh zhvillimet e mëposhtme të rëndësishme historike, ekonomike dhe kulturore:

1) Transformimet dhe Zhvillimet Urbane. Nëpërmjet artefakteve, paneleve shpjeguese dhe mjeteve të tjera dixhitale të prezantimit do të sigurohet një pamje gjithëpërfshirëse e transformimeve urbane, me fokus të veçantë në:

- Muret fortifikuese;
- Planet urbane (transformimi i hapësirave publike dhe private), infrastrukturaturat;
- Zhvillimet arkitekturore (fetare, administrative, shtëpiake, ushtarake).

2) Qyteti i Bylisit si qendër politike dhe administrative.

Një pamje e zhvillimeve komplekse politike të qytetit si njëra nga qendrat kryesore strategjike dhe kishtarë qendër e Provincës Bizantine Epirus Nova;

3) Ekonomia.

Informacion sintetik për Bylsin si qendër ekonomike në Illyricum

- Burimet natyrore dhe shfrytëzimi i tyre;
- Artizanati;
- Tregti dhe transporti.

4) Religjioni dhe artet si veprime shoqërore me rolin e thellë që ka pasur feja dhe ideologjia në transformimin e qytetit dhe jetës së qytetarëve të tij.

- Krishterimi i hershëm;
- Mes Lindjes dhe Perëndimit: feja, politika dhe pushteti;
- Artet dhe shprehjet artistike.
- Trashëgimia urbane, religjioze dhe etnike. Bazilika e Ballshit një qendër religjioze me rëndësi në periudhën mesjetare shek. IX-XI.
- Vendbanimi mesjetar i Cakranit
- Berati qendër e Principatës së Arbërit dhe trashëgimia Bylis-Ballsh-Berat.

5) Jeta dhe vdekja. Të pasqyrohet një pamje sintetike të dinamikës së jetës në këtë qendër të rëndësishme urbane dhe që ndihmon vizitorin të reflektojë mbi urbanizmin e sotëm.

- Jetëgjatësia;
- Higjiena;

- Sëmundjet dhe Pandemitë;
- Rituatet e varrimit.
- Llojet e varrimit dhe shpërndarjet e varrezave në peisazhin urban.

b. Temat kryesore të përmbajtjes së ekspozitës do të jenë:

I. Tema e parë. Vështrim mbi zhvillimin paraprirës të krijimit të qyteteve Klos dhe Bylis

Gjeografia dhe mjedisi:

- Historiku i gërmimeve arkeologjike
- Zhvillimi parahistorik. Gjetjet më të hershme paleolitike dhe shpërndarja e tyre.
- Vendbanimi i Neolitit të Mesëm në Cakran dhe lidhjet e tij kulturore
- Tumat e Patosit dhe Lofkendit dhe zhvillimi i kulturës së grupit jugor ilir. Lidhjet kulturore me kulturën Devollite dhe Epirote




FIGURA 69 - MODELI I PARAQITJES SË MATERIALIT ARKEOLOGJIK PËR PERIUDHËN PREHISTORIKE. MUZEU I INSTITUTIT ARKEOLOGJIK TIRANË-2

II. Tema e dytë. Premisat e formimit të qyteteve ilire në territorin e Bylinëve

- Periudha protorbane në territorin e Mallakastrës. Të dhënat arkeologjike nga gërmimet në qytezat e Margëllicit dhe Mashkjesës/
- Themelimi i Apollonisë dhe ndikimi mbi zhvillimin urban të prapatokës.
- Të dhënat historike mbi Atintaninë dhe bylinët në shek. V-IV p. Kr.

- Themelimi i Klosit si paraprirës i themelimit të Bylisit. Struktura urbane ilire në prapatokën e Apollonisë.
- Themelimi i Bylisit. Modeli arkitektonik i tij në arealin ilir-epirot.
- Zhvillimi urban në territorin Bylin. Qytetet në Klos, Gurëzezë dhe Margëllic. Kështjellat në Rabie e Cfir. Vendi i Koinonit Bylin në zhvillimin Urban të Ilirisë së Jugut dhe Epirit.
- Kultura e shek IV në territorin Bylin. Importet nga Apollonia dhe Magna Grecia. Qarkullimi monetar.

III. Tema e tretë. Jeta politike, shoqërore dhe kulturore e Koinonit Bylin

Dokumentacioni historik dhe epigrafik mbi Koinonin Bylin në shek. III-I p. Kr. Organizimi politik i tij mbi bazën e materialit epigrafik dhe të dhënave të autorëve antikë. Organizimi i shoqëror i dokumentuar nga materiali epigrafik dhe artefaktet arkeologjike. Mbishkrimet për lirim të skllëvërve dhe pranimin e qytetarëve të rinj në Klos dhe Bylis.



FIGURA 70 - PAMJE AJRORE E KOMPLEKSIT MONUMENTAL TË SHEK. III P. KR. ME STOAN A , PROPILETË DHE CISTERNËN E STADIUMIT. FOTO A. PËRZHITA

Kultura dhe arti në territorin e Bylinëv. Teatri dhe dokumentacioni arkeologjik mbi zhvillimin e tij në Bylis dhe Klos. Paralelet dhe dallimet nga teatri në Dimal, Apolloni , Foinike, Butrint. Stadiumi dhe zhvillimi i sportit në territorin Bylin. Stadiumi i Bylisit dhe fituesi i garës në Oropos nga Nikaia e bylinëve.

Arti në territorin bylin. Zhvillimi i relievit me shembujt nga Bylisi, Gurëzeza, Margëllici dhe Klosi. Rtipi i gruas ilire dhe krahasimi me teritorin e Dimalit, Amantias dhe elementin ilir në Apolloni.

IV. Tema e katërt. Jeta ekonomike

Veprimtaria prodhuese në Bylis dhe territorin bylin e dokumentuar nga materiali i gërmimeve arkeologjike në Bylis, Klos, Gurëzezë, Margëllic, etj.

Qarkullimi monetar në territorin bylin. Thesaret e monedhave të Monunit në Kreshpan dhe thesari i Gurëzezës. Sistemi monetar i Koinonit të Bylinëve në kontekstin numizmatik të prapatokës së Apollonisë. Raporti me ngjarjet politike të kohës.

Prodhimi i qeramikës si veprimtari kryesore në qytetet e Koinonit. Prodhimi i Bylisit dhe Klosit-vulat e punishteve. Prodhimi i Gurëzezës dhe punishtet e qytetit.

Tipologjia e prodhimeve mbi bazën e enëve të gjetura në gërmimet arkeologjike dhe lidhja e tyre me jetën sociale të banorëve të Koinonit të Bylinëve.




FIGURA 71 - MODEL I PËRGATITJES SË SALLËS MUZEALE MBI BAZËN E PROGRAMIT TEMATIK. SALLA E SKULPTURAVE.

V. Tema e pestë. Jeta religjioze në Koinonin Bylin

- Panteoni bylin i rindërtuar sipas dëshmive arkeologjike përmes skulpturave (koka e Poseidonit) dhe mbishkrimeve (kushtimet për Herën, Asklepin, Poseidonin, Artemisinm etj).
- Kult i Nymfave si baza e religjionit bylin. Lidhja me Nymfeun e famshëm në kufi të Apollonisë, Bylinëve dhe Amantëve sipas burimeve historike. Dëshmitë arkeologjike të kultit: mbishkrimet, monedhat, relievi i Klosit, etj.
- Jeta dhe vdekja në religjionin bylin. Típet e varrimit në shek. IV-I p. Kr. relievet sepulkralë nga Bylisi, Klosi, Margëllici dhe Gurëzeza.

VI. Tema e gjashtë. Themelimi i kolonisë romake në Bylis

- Të dhënat historike, mbishkrimore dhe arkeologjike për vendosjen e kolonisë romake në Bylis dhe roli i kolonisë në strukturën administrative. Ngjarjet historike që përcaktuan atë vendosje.
- Ndryshimet kulturore, etnike, politike dhe ekonomike në *Colonia Iulia Byllidenses* në shek. I-II m. Kr. Shkrimi latin, reorganizimi kolonial administrativ, ndërhyrjet në adaptimin e agorasë bylinë në një forum romak dhe monumente e rinj të krijuar në Byli: termet romake dhe tempulli i Augustits. Dokumentacioni epigrafik dhe artefaktet e periudhës koloniale romake.
- Qyteti ilir-romak në shek II-III m. Kr. Fizionomia e Bylisit si qytet provincial në kuadrin e administrimit romak. Arti dhe kultura ilire-romake në territorin bylin.
- Fshati Bylin. Vila romake në Qesarat dhe vendbanimet përgjatë rrugës së Astacias- Kuta. Diga e Krapsit dhe digat e tjera të Gjanicës në kontekstin e zhvillimit të pronave të mëdha.



FIGURA 72 - MBISHKRIMI I MARCUS LOLLIANUS SI DËSHMI E NDËRTIMIT TË RRUGËS NGA BYLISI NËPËR ASTACIA

VII. Tema e shtatë. Bylisi i Antikitetit të Vonë

Krishterimi i hershëm në territorin e bylinëve dhe ndërtimet e hershme kristiane.

Vendosja e selisë peshkopale në Bylis dhe raporti me Apolloninë. Kalimi i qendrës shpirtërore dhe ekonomike nga Apollonia në Bylis.

- Ndërtimet e bazilikave të shek. V-VI në Bylis dhe paraqitja e vlerave të tyre përmes ilustrimeve dhe mjeteve digitale.
- Roli kulturor dhe ekonomik i Bylisit në krishterimin e hershëm. Dëshmitë arkeologjike dhe epigrafike.

- Ekonomia byline në Antikitetin e Vonë. Qarkullimi monetar në territorin bylin. Manastiri i Bylisit si qendër prodhimidhe ekonomie për qytetin dhe rajonin. Prodhimi i verës dhe amforat byline.

VIII. Tema e tetë. Trashëgimia e Bylisit në Mesjetën e Hershme.

Të dhënat historike dhe arkeologjike mbi braktisjen e Bylisit dhe kalimin e Peshkopatës në Ballsh. Transferimi i librave (Kodiku i purpurt i Beratit), mbishkrimeve dhe relieveve në Ballsh dhe pastaj në Berat.



FIGURA 73 - BAZILIKA E BALLSHIT. GIENDJA AKTUALE. FOTO L. PËRZHITA

Bazilika e Ballshit si trashëgimtare e traditës byline dhe roli i saj në ruajtjen e ritit të krishterë si element themelor etnik popullsisë arbërore dhe Bylisi si vendi i kalimit të Bullgarëve në fenë e krishterë.

5.4.2 PLANI I MUZEUT TË HAPUR

5.4.2.1 KONCEPTI DHE ITINERARËT E MUZEUT TË HAPUR (BYLIS)

Me Muze të hapur kuptohet përdorimi i aseteve arkeologjike dhe i ambienteve të Qendrës Multifunktionale për ushtrimin e veprimtarive ndërvepruese me kategori të caktuara të komunitetit vendor, si dhe me vizitorët e parkut. Për këtë qëllim është parashikuar edhe një ambient i veçantë pranë Muzeut Arkeologjik, si dhe një punonjës i stafit të Parkut që do të angazhohet periodikisht në këtë veprimtari. Plani i Muzeut të Hapur do të synojë ta bëjë pasurinë arkeologjike e kulturore të parkut të aksesueshme për këto grupe, duke përfshirë përvojën e restaurimit dhe riprodhimit,

por edhe pjesëmarrjen në punimet konservuese-restauruese, apo gëhimet arkeologjike që zhvillohen në territorin e parkut. Qasja metodologjike e propozuar do të trajtojë aktivitetet e studimit, gërmimit, konservimit dhe restaurimit jo vetëm si faza teknike, por edhe si një mjet të fuqishëm komunikimi. Në përputhje me sigurinë e fondeve dhe eksponatet e Muzeut, ambiente të posaçme të qendrës multifunktionale do të jenë të hapura për publikun për vizita dhe projekte komunikimi në "Kantierin e Hapur – Scuola Cantiere". Në të do të zbatohen praktika interesante për të angazhuar publikun në fazat e studimit, diagnostikimit, restaurimit dhe konservimit në vazhdim. Aktivitetet do të shoqërohen me shpjegime shkencore nga stafi i Parkut dhe i ekspeditave prezente në Bylis, për të kuptuar domethënien dhe kompleksitetin e një qasjeje ndërdisiplinore të aplikuar për njohjen, ruajtjen dhe mbrojtjen e aseteve arkeologjike. Të gjitha këto veprimtari kanë për qëllim promovimin e turizmit të qëndrueshëm dhe cilësor, nxitjen e angazhimit dhe përfshirjen publike të komunitetit vendas në projekte të lidhura me trashëgiminë dhe, në këtë mënyrë, në formimin e identitetit lokal kulturor.

Aktivitetet e Kantierit të Hapur do të zbatohen duke ndjekur përcaktimin e subjekteve dhe temave dhe përfshirjen e nevojshme të ekspertëve vendës, apo të huaj.

Për të nxitur njohuritë e komunitetit lokal dhe turistëve mbi ruajtjen dhe restaurimin e aseteve të Parkut, mund të parashikohet një plan në kudirin e Muzeut të Hapur, për moshat e ndryshme: 9-14 vjeç; 15-18 vjeç; studentët dhe të rriturit.

Pastrimi radikal terreneve që do të përshkohen nga itinerarët është kusht i domosdoshëm për zhvillimin normal të tyre. Në rradhë të parë kjo do të realizohet në të gjithë terrenin brenda Murit të Viktorinit, ku përgje gurësh gjenden pranë Stoa A, Bazilikës B, Banesës B, Murit ndarës të Agorasë, etj. Heqja e gureve në përgje do të bëhet në afërsi të Murit të Viktorinit, për t'u përdorur në rrestaurime dhe konsolidime të kullave T dhe Y, si dhe në plotësimin e traseve të mureve. Duhet të hiqen njëkohësisht edhe dherat e hedhura nga gërmimet arkeologjike në afërsi të Bazilikës B, Stoa A, Murit Ndarës të Agorasë, etj, të cilët do të spostohen në zonën e euhorionit, për të krijuar mundësinë e mbjelljes së pemëve dhe krijimit të një zone rekreative.

- a. Muzeu i hapur, që do të përfshijë të gjithë sitin/parkun arkeologjik Bylis, do të ndërtohet mbi bazë **itinerarësh**, të cilët duhen të përgatiten nga grupi i studiuesve të IA, PAB, dhe IKTK.

Këto itinerare duhet të organizohen në bazë tematike, kronologjike, artistike e arkitektonike:

- Itinerari i bazilikave,

- Itinerari i agorasë,
- Itinerari i banesave
- Itinerari i mozaikëve,
- Itinerari i cisternave.

Itinerarët duhet të bëhen të dallueshëm në sit me anë të shenjave dalluese të veçanta e të diferencuara për secilin itinerar, duke u treguar në harta të veçanta për secilin dhe në hartë të përbashkët me diferencim linjash në ngjyra dhe me vendosje të fotografive të pikave identifikuese në sit (psh, kollona, elemente arkitektonike, skulptura). Në lidhje me këtë do të kërkohet që në sit të rikthehen të gjithë elementët që janë gjetur në të, (kollona, kapitete, skulptura etj) të cilat duhet të vendosen si kopje identike, duke ruajtur në muze kopjen origjinale.

Parku arkeologjik i Bylisit mund të ofrojë për vizitorët shumë objekte ku pjesa më e madhe e tyre janë të rëndësishme nga ana monumentale. Monumentet që deri më sot vizitohen nga turistët janë të arritshëm lehtësisht me itineraret ekzistuese mbi tarracat dhe shtigjet e krijuara në mënyrë natyrore, dhe që mirëmbahen nga administrata e Parkut Arkeologjik Bylis. Më të vështirë për tu vizituar janë monumentet e krahut lindor, porta 3 dhe 4, fontana e Dionisit, bazilika E dhe euhorioni, të cilat nuk kanë itinerar të përcaktuar, si dhe janë larg pikave të shpłodhjes dhe pa streha nga kushtet klimatike.

Propozohen tre itinerare turistikë mbi bazën e monumenteve që do vizitohen përgjatë tyre, të cilat do të jenë sipas rrugës së aksesit për në park dhe në funksion të vendndodhjes së muzeut:

Itinerari I. Brenda murit të Viktorinit deri tek Muzeu, i cili përfshin monumentet brenda qendrës, i përshtatshëm për turistët e moshës së tretë, për personat me kufizim në lëvizje dhe për fëmijët deri në 12 vjeç (shkalla e vështirësisë e ulët).

Monumentet e vizitueshëm: Kulla A, Porta 1 dhe 2, Bazilika D, Muri i Viktorinit, Kompleksi Peshkopal (Bazilika B, Katedralja), Banesa helenistike B, Stoa, Stadiumi, Terma e Antikitetit të Vonë, Bazilika A dhe C, Teatri, Stoa B, Muzeu



FIGURA 74 - PAMJE AJRORE E PARKUT ARKEOLOGJIK TË BYLISIT ME MONUMENTE KYRESORE QË DO TË VIZITOHEN DHE TRE VENDOSJE TË NDRYSHME TË MUZEUT ARKEOLOGJIK. FOTO A. ISLAMI, PËRPUNUAR NGA O. CEKA




FIGURA 75 - SKEMË E INTINERARIT TË PARË DHE LËVIZJA BRËNDA TIJ. PËRPUNOI S. XHYHERI (SKICA) DHE O. CEKA (FOTO)

Itinerari II. Jashtë dhe përreth murit të Viktorinit deri tek Muzeu, i cili përfshin monumentet brenda qendrës, bazilikën D dhe E, mbishkrimet, i përshtatshëm për turistët nga moshë +12 vjeç të rinj dhe të moshës së tretë me lëvizshmëri të mirë (shkalla e vështirësisë e mesme).

Monumentet: Kulla A, Porta 1 dhe 2, Bazilika D, Muri i Viktorinit, Kompleksi Peshkopal (Bazilika B, Katedralja), Banesa helenistike B, Stoa, Stadiumi, Terma e Antikitetit të Vonë, Bazilika A dhe C, Teatri, Stoa B, Mbishkrimi i Loljanit, Muzeu, Bazilika E, Kulla Y, X, V, U, T, Monumenti i Terencianit.




FIGURA 76 - SKICË E ITINERARIT TË DYTË. PËRPUNO I S. XHYHERI

Itinerari III. Jashtë dhe përreth murit të Viktorinit tek Muzeu, përgjatë rrugës për në Klos dhe deri në rrënojat e Klosit antik, i cili përfshin monumentet brenda qendrës së Bylisit, bazilikën D dhe E, Klosin antik, Murin rrethues të Klosit, i përshtatshëm për turistët me lëvizshmëri të mirë dhe shumë të mirë, që bëjnë *trekking* (shkalla e vështirësisë e lartë).

Monumentet: Kulla A, Porta 1 dhe 2, Bazilika D, Muri i Viktorinit, Kompleksi Peshkopal (Bazilika B, Katedralja), Banesa helenistike B, Stoa, Stadiumi, Terma e Antikitetit të

Vonë, Bazilika A dhe C, Teatri, Stoa B, Mbishkrimi i Loljanit, Muzeu, Bazilika E, Kulla Y, X, V, U, T, Monumenti i Terencianit. Qytetin antik të Klosit, Murin antk rrethues të Klosit, teatrin, qendrën e fshatit Klos.




FIGURA 77 - SKICË E ITINERARIT TË TRETË. PËRPUNOI S. XHYHERI

Ky itinerar është për një grupim turistësh, të cilët duan të kombinojnë njohuritë e tyre për monumentet e qendrave antike të Bylisit dhe të Klosit, me pamjet e ofruara nga Lugina e lumit Vjosë (ka marrë statusin e një Parku Natyror të Mbrojtur), por edhe me gastronominë, traditat dhe kulturën e zonës së Mallakstrës të ofruar nga zhvillimi i programit të “100 fshatrat” ku bën pjesë fshati i Hekalit.

Një itinerar të vecantë përfaqëson nga shtegu natyror për te mbishkrimi i Marcus Lollianus, në shkëmbenjtë perëndimorë të kodrës së Bylisit. Shtegu aktual përshkruan deri aty trasenë e rrugës anike, e cila në vazhdim ka shkarë dhe është mbuluar nga dheu. Deri te mbishkrimi, shtegu është relativisht i lehtë në kushte klimatike të mira, por duhet pastruar, mirëmbajtur dhe shtruar mundësisht me zhavorr të imët shkëmbi për të siguruar ecjen.



FIGURA 78 - SHTEGU I KALIMIT PËR TE MBISHKRIMI I MARCUS LOLLIANUS. FOTO O. CEKA

Shtegu turistik për hiking Bylis- Klos

Lidhja këmbësore nga Bylisi në Klos përfaqëson një kujtesë historike të lidhjes së lashtë midis dy siteve arkeologjike, që ka qenë edhe rruga e zhvillimit të tyre historik, nga vendbanimi protourban e qyteti i hershëm i shek. V p. Kr. Në Klos (Nikaia?) në formimin e qytetit të zhvilluar të Bylisit në shek. IV-III p. Kr.

Shtegu do të përbëjë një ndërhyrje krejt të re dhe do të projektohet në kuadrin e ndërhyrjeve konservuese restauruese të Parkut Arkeologjik të Klosit, duke parashikuar edhe alternativa të shtigjeve hiking nga portat nr. 4 dhe 7, si dhe paisjen e tyre me sinjalistikë dhe tabela shpjeguese. Shtegu do të fillojë që nga Porta nr. 5 e Bylisit, duke kaluar tek Mbishkrimi i M. Lollianus, për të vazhduar në gjurmët e rrugës së vjetër që i lidhte dy qytetet në drejtim të Klosit.

Ndonëse në vijë ajrore Klosi është vetëm 1 km nga Bylisi, gjatësia e shtegut do të jetë 2.5 km, për shkak të ndjekjes së terrenit dhe zbutjes së pjerrësisë së shtegut në një diferencë prej 197 m që paraqet pikënisja e saj në Bylis deri në mbërritjen në sheshin e fshatit Klos. Kohëzgjatja në zbritje është llogaritur për 60 minuta.




FIGURA 79 - ITINERARI HIKING BYLIS-KLOS

Duke qenë se qyteti i Bylisit ka një shtrirje të madhe sipërfaqësore dhe ofron shumë objekte për të parë, turistët në fund të vizitës në të, të lodhur e pa kohë në dispozicion, nuk spostohen në Klos, duke bërë që ai të jetë pak i njohur dhe jo një pikë atraktive për ta. Për këtë arsye duhet privilegjuar një akses direkt edhe në Klos, duke i dhënë mundësi turistëve edhe ta vizitojnë atë fillimisht, dhe jo si një apediks të Bylisit. Për të realizuar këtë do të duhet të lehtësohet arritja e vizitorëve në Klos si një destinacion pimar dhe jo si në një vizitë sekondare, pas asaj që bëhet në Bylis. Duke qenë se edhe qyteti antik i Klosit ndodhet në një lartësi të konsiderueshme, duhet parë mundësia e arritjes komode e jo të lodhshme në të.

5.4.2.2 ITINERARI TURISTIK NË RRENOJAT ARKEOLOGJIKE TË KLOSIT

Klosi është një nga fshatrat më të njohur të Mallakastrës, i cili ngrihet mbi truallin e qytetit antik të Nikaias. Rrënojat e një teatri, stadiumi, të një shëtitoreje, të disa banesave dhe të një vargu të gjatë muresh rrethuese, janë dëshmi të qytetërimit që gjallon këtu që nga antikiteti. Për të vizituar sitin arkeologjik të Mallakastrës u nisëm përgjatë autostradës Levan-Tepelenë dhe u ngjitëm sipër kodrave për të mbërritur fillimisht në Bylis dhe më pas në Klos. Të dy qendrat arkeologjike nuk janë veçse 1.5 km nga njëra-tjetra. Për orientimin e turistëve një panel duhet të vëndoset afër qendrës së fshatit të sotëm Klos dhe një tjetër në hyrje zë zonës arkeologjike të Nikaiës, dhe në një pozicion që të mos pengojë fotografimin e tij nga ana e turistët. Në hyrjen e vetme të murit rrethues të Rrenojave Arkeologjike të Klosit do të vendoset një panel përshkrim historik i qytetit antik të Nikaiës, me kombinim të shkurtër tekst dhe pamje të disa prej monumenteve të vendosura diagonalisht në dy gjuhë shqip dhe anglisht.

Paneli në qendër të fshatit duhet të japi një informacion më të zgjeruar, jo vetëm për Nikaiën, por edhe për historinë e fshatit të Klosit, sidomos për atë të periudhës lidhur me shek. XIX dhe të Luftën e Dytë Botërore.



FIGURA 80 - QENDRA E FSHATIT TË SOTËM TË KLOSIT. FOTO S. XHYHERI

Në sheshin kryesor të fshatit është lapidar, banesa e Bilbil Klosit, monument kulture i kategorisë së parë, një shtëpi e madhe dykatëshe prej guri, e cila luajtën një rol të rëndësishëm në lëvizjen për pavarësi kombëtare, si dhe në lëvizjen e rezistencës partizane gjatë Luftës së Dytë Botërore në këtë krahinë. Ajo është vendosur në qendër të fshatit, rrethuar me vreshta, ullinj shekullorë dhe dru frutorë, me portë monumentale me qemer.

Për nga vetë pozicioni banesa e Klosajve mund të fitojë një funksion të zhvillimit turistik të Parkut Bylis në mënyrë direkte ose indirekte si bujtinë, Muze Etnografik, pjesë e Muzeut të Bylisit etj. Një funksion të tillë mund të fitojë edhe grupi prej dy banesash tipike mallakastrite të Gjysho Muharremit brenda territorit të qytetit antik.



FIGURA 81 - SHITËPIA E FAMILJES KLOSI, MONUMENT KULTURE I KATEGORISË SË PARË

Paneli në hyrje zë zonës arkeologjike të Nikaiës duhet të japi një informacion rreth historisë së Nikaiës antike dhe të historikut të gjurmëve të kësaj qendër. Paneli-ide do të vendosen përpara secilit monument, me qëllim prezantimin e turistit me një informacion të shkurtuar dhe bazë për secilin monument. Paneli, me kombinim tekst të shkurtër dhe pamje të monumentit të vendosura diagonalisht në dy gjuhë shqip dhe anglisht dhe në një pozicion që të mos pengojë fotografimin e tij nga ana e turistit. Monumentet e propozuara janë Teatri, Stoa, Banesa, Muri rrethues.

Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet në Klos, Mureve rrethuese të qytetit antik, si një karakteristikë e veçantë që e veçon këtë qendër nga Bylisi. Gjendja e mirë e ruajtjes së tyre si në lartësi, por edhe një shtrirje e bëjnë që ato të jenë një pjesë e rëndësishme e Itinerarit të Tretë turistik. Për këtë do të ndihmojë përgatitja e planit për turizmin, me ide për "target group" të ndryshme në bazë të grupmohave dhe interesave të ndryshme të turistëve të cilët e fillojnë vizitën e tyre nga Klosi, i cili sot është i vetmi me rrugë të shtruar të aksesueshme nga Rruga Nacionale Fier - Tepelenë -Gjirokastër.

Në ndihmë të rritjes dhe kthimit të Klosit në një aset të shtuar turistik të PAB ndër atraksionet kryesorë do të jetë:

1. Vendosja e një Paneli të qytetit antik të Nikaiës, me drejtimin për në të, nga Rruga Nacionale Fier -Gjirokastër.
2. Promovimi, për banorët, artizanët ose sipërmarrësit e vëgjël të zones për të shitur produktet e tyre të specifikuar dhe të ambalazuara, si në rastin e Butrintit, Syrit të Kaltër etj., nga qendra e fshatit të Klosit.
3. Për të përmirësuar pamjen e të gjithë monumenteve të Klosit si dhe propozohet për tu bërë pastrimi i të gjithë dherave dhe gurëve të grumbulluara nga gjurmët e mëparëshme.
4. Propozohet të bëhet heqja e gardheve të jashtëligjshme, të cilët pengojnë lëvizjen e lirë në zonën e mbrojtur arkeologjike dhe të vendoset sinjalistika për vizitorët në park, në mënyrë që të anashkalohet hyrja në pronën private të turistëve.

Investimet në infrastrukturën turistike të mësipërme përmendur, që përfshijnë Klosin, do të mbulohen nga projekti i BE- IPA 2018.



FIGURA 82 - GARDHET TË VENDOSURA NË PARCELIZIMIN E TERRITORIT BRENDA QYTETIT ANTIK KLOS (FOTO S. MUCAJ)

5.4.3 PANELET INFORMATIVE

Me vendosjen e Panele Informative kuptohet sqarimi i përmbajtjes arkitektonike, historike dhe artistike të monumenteve që vizitohen nga kategoritë e ndryshme të turistëve gjatë atij itinerari. Në të gjitha parqet arkeologjike të Shqipërisë ky lexim realizohet nga kontakti vizual që ka vizitori me tabelat shpjeguese të vendosura në fillim të itinerarit, apo përgjatë tij. Propozimi i PM të Parkut Arkeologjik Bylis është diversifikimi i këtij leximi.

- a. Panelet informative duhet të jenë pjesë e një vendimmarrjeje të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) lidhur me dimensionet, kompozimin dhe përmbajtjen e tyre, për t'u vendosur përpara secilit monument. Qëllimi është prezantimi i turistit me një informacion të shkurtuar dhe bazë për secilin monument, duke kombinuar tekst të shkurtër dhe imazhe të monumentit, të vendosura në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Paneli duhet të vendoset afër monumentit dhe në një pozicion që të mos pengojë fotografimin e tij nga ana e turistit.

Këto panele do të propozohen për monumentet si: Kompleksi Peshkopal dhe Bazilika B; Propiletë dhe ndërtesat publike pranë tyre; Stadiumi dhe cisterna e tij; Teatri; Portat nr. 1-5; Stoa B; Termet Romake dhe Gimnazi; Stoa A; Banesat A dhe B; Muri i Viktorinit; Bazilikat A, C, D, dhe E; Termet e Justinianit; Mbishkrimi i Marcus Lollianus; Vëndet e Pamjeve Panoramike në Kullat T dhe Y të Murit të Viktorinit, etj.

- b. Një panel i vecantë propozohet në fillim të itinerarëve do të do të paraqesë itinerarët e ndryshëm që i ofrohen vizitorit
- c. Paneli kryesor do të përmbajë të dhënat kryesore historike dhe arkitektonike mbi Parkun Arkeologjik Bylis, bashkë me treguesit hartografikë.
- d. Përfshirja e vizitorëve në park edhe të turistëve me aftësi të vaçanta. Në ndihmë të tyre dhe të shoqëruesëve të tyre duhet të jenë edhe panele të këtij tipi:



FIGURA 83 - TABELË SPJEGUESE PËR PERSONAT QË NUK SHOHIN NË PARKUN ARKEOLOGJIK TË EGNAZIAS, BARI

Për ambiente me interes të veçantë brenda një monumenti të caktuar (p.sh. ambientet e prodhimit tek katedralja, ambienti i kushtimit të altareve brenda Banesës së Terencianit) bëhet një panel i vaçantë tregues, si në rastin e dy paneleve të përdorura në Parkun e Egnazias:

- e. Për sitin Arkeologjik të Klosit do të ketë një tabelë kryesore në hyrjen kryesore të murit rrethues dhe tabelat e tipit a për teatrin, Stoa, Banesën dhe Murin rrethues të anës juglindore.

Zbatimi i metodave të reja të leximit të monumenteve do të vihet në dispozicion të vizitorit në format e thjeshta, që janë aplikimi i tabelave transparente me rikonstrukcione virtuale 3D në perspektivën e teatrit, stoas A, Stadiumit, Oborrit të Fortifikuar, apo Bazilikave paleokristiane.



FIGURA 84 - RIKONSTRUKSION IDEAL ME PERSPEKTIVËN E LEXIMIT TË STOAS B DHE AGORASË NË APOLLONI

Informacioni në Institutin e Arkeologjisë, IKTK dhe në KKTKM jep mundësi edhe për zbatimin e lexuesve digitalë në formën e syzeve Google, të aplikuara në shumë parqe arkeologjike, apo komplekse arkitektonike europiane.

- f. Restaurim i pjesshëm i strukturave me interes të veçantë arkeologjik si teatri i Bylist, anteja jugore e Stoas A, narteksi i Bazilikës B, apo kullat T dhe Y të Murit të Viktorinit etj. Përvoja pozitive mund të përfitohen nga zbatimi i tyre në bazilikën paleokristiane në Parkun Arkeologjik të Sipontum në Manfredonia me një instalacion inovativ në rrjetë teli nga artisti lombard E. Tresoldi, si model për bazilikat e Bylisit:



FIGURA 85 BASILIKA NË SIPONTUM, [HTTPS://WWW.EDOARDOTRESOLDI.COM/WORKS/BASILICA-DI-SIPONTO/](https://www.edoardotresoldi.com/works/basilica-di-siponto/)

- g. Në rastin e paradosit të teatrit të Bylisit mund të shërbejë modeli i rikonstruksionit të pjesshëm të strukturave me interes të veçantë arkeologjik në Crypta Balbi



FIGURA 86 – CRYPTA BALBI, ROME ([HTTPS://WWW.COSAVEDEREAROMA.COM/CRYPTA-BALBI/](https://www.cosavederearoma.com/crypta-balbi/))

- h. Për pjesë të monumenteve me struktura të mbivendosura (rasti i ambienteve të prodhimit të katedrales) për të lehtësar aksesueshmërinë e turistëve dhe studiuesëve, të bëhen kalime me struktura të lehta dhe çmontueshme (si në rastin e mëposhtëm Parku Arkeologjik i Egnazias):



FIGURA 87 PARKU ARKEOLOGJIK I EGNAZIAS WWW.BARI.REPUBBLICA.IT

- i. Për vetë vlerat e veçanta që ka qyteti i Bylisit në periudhën antike të vonë duhet të bëhet restaurimi i një banese të periudhës antike të vonë, apo i brendisë së kullave të Murit të Viktorinit, të cilat të tregojnë hapësirat e jetesës në qytet gjatë kësaj periudhe.
- j. Nëpërmjet syzeve digitale mund të transmetohet nga serveri i Muzeut Arkeologjik të Bylisit rindërtim virtual i gjendjes së monumenteve në kohën e ndërtimit të tyre për efekt panelesh shpjeguese dhe ekspozimi si në rastin e mëposhtëm:



FIGURA 88 BAZILIKA NË SIPONTUM [HTTPS://WWW.EDOARDOTRESOLDI.COM/WORKS/BASILICA-DI-SIPONTO/](https://www.edoardotresoldi.com/works/basilica-di-siponto/)



FIGURA 89 - BANESË E ANTIKITETIT TË VONË NË EFES ([WWW.DOYOUKNOWTURKEY.COM/3D-ANIMATION-OF-EPHESUS-THE-ANCIENT-CITY-IN-TURKEY/](http://www.doyouknowturkey.com/3d-animation-of-ephesus-the-ancient-city-in-turkey/))

5.4.4 ANEKSET E MUZEUT TË HAPUR

Si anekse të Muzeut të hapur do të trajtohen veprimtaritë që ndihmojnë në leximin e përgjithshëm të itinerareve turistike, por do të japin edhe mundësi për impaktin e Parkut Arkeologjik në zhvillimin e turizmit vendor, të ekonomisë tradicionale dhe në edukimin e nxënësve të arsimit parauniversitar.

- **Kantieri Shkollë** për nxënësit

Nxënësit e sistemit parauniversitar do të njihen me historinë, artin dhe teknologjinë e mozaikut. Nëpërmjet demonstrimit në terren dhe përvojave praktike, pjesëmarrësit

do të njihen me teknikën e zbulimit të mozaikut gjatë gërmimit arkeologjik dhe, në vazhdim me masat konservuese dhe restauruese të tij. Mbi bazën e asaj përvoje do të eksperimentohet edhe imitimi i procedurave në shtrimin e një mozaiku të tipologjisë antike, si dhe eksperimentimi i kopjeve të dekoracioneve, apo figurave të mozaikëve të Bylisit.

- **Kampi i restaurimit dhe i gërmimit arkeologjik**

Aktiviteti i propozuar synon të përfshijë në menyrë aktive studentet në procesin e konservimit dhe restaurimit, si një përvojë trajnimi dhe orientimit të tyre të ardhshëm profesional në kontakt të drejtpërdrejtë me teknikët që punojnë në terren.

Përvojat e trajnimit me restauruesit do të organizohen gjatë fazave periodike të ndërhyrjes në mozaikët e bazilikave A-E dhe pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të familjarizohen me profesionin e restauruesit dhe të kuptojnë kompleksitetin e kujdesit për trashëgiminë kulturore. Njëkohësisht do të nxiten edhe përvojat me arkeologët gjatë zhvillimit të ekspeditave arkeologjike të zhvilluara nga ekipet që punojnë në Bylis.

- **Takimet me restauruesit dhe arkeologët**

Veprimtaritë do të zhvillohen në formën e vizitave të drejtuara në grupe të vogla në vendet e restaurimit, apo të gërmimit arkeologjik, në të cilat vizitorët do të ftohen të dialogojnë dhe të ndërveprojnë me specialistët për të mësuar rreth aktivitetit në vazhdim.

- **Zhvillimi i ditëve të hapura**

Muzeu i hapur organizohet edhe në mënyra periodike me shfaqje me teknologji multimediale apo me hologramë, duke shfrytëzuar për të parat, sfonde muralë ku mund të ndërtohet në mënyrë fotografike imazhi dhe evoluoni nga shekulli në shekull i një objekti, dhe në rastin e hologramës, të përdoren projektorët për të rindërtuar në dimension 1:1 objektin në formën që ka patur. Kjo do të kërkojë hologram projectors të instaluar në vend, por edhe të lëvizshëm njëkohësisht, që të mund të hiqen në rastin e rreshjeve në sit.

Në vendet ku janë veprat kryesore (teatër, stoa A, stoa B, cisterna) mund të bëhen shfaqje me Holografic Building. Këto spektakle do të organizohen nën brandin OPEN BYLIS. Në to do të rekomandohet të bëhen:

- Shfaqje teatrale, muzikore, apo baleti e operistke në në Agora dhe në Teatër.
- Inskenime teatrale e sportive në Agora apo në shtëpitë e zbuluara, mbi zakonet e tregëtisë e të prodhimeve artizanale (përpunimi i rrushit apo ullinjve)

Këto spektakle do të jenë me pagesë e do të shfaqen mbrëmjeve të stinëve të ngrohta, duke gjallëruar sitin dhe duke shtuar edhe orët e punës dhe të qëndrimit të hapur të tij. Shtimi i aktivitetit turistik natën, do të stimulojë turistët të akomodohen në struktura hoteliere të zonës, duke rritur të ardhurat turistike në ekonominë e fshatrave përreth.

- **Tregtimi permanent i prodhimeve artizanale**

Pjesë e itinerarit turistik duhet të jetë një hapësirë për një treg, mundësisht pranë hyrjes për në park, e ndërtuar me material të lëvizshëm si kashtë, kallam, dru etj., për banorët, artizanët ose sipërmarrësit e vëgjël të zones për të shitur produktet e tyre (produkte të specifikuar dhe të mbalazuara) si në rastin e Butrintit, Syrit të Kaltër etj.



FIGURA 90 - TREGTIMI I PRODHIMEVE ARTIZANALE NË PARKUN ARKEOLOGJIK BUTRINT (FOTO RRJETI)

Për tërheqjen e grupeve sezonale të interesit do të realizohen ditët e tregëtimit të prodhimeve tipike të zonës: vajit të ullirit, verës-rakisë, gjelave të detit, etj.

Përgatitja e planit për turizmin, me ide për “target group” të ndryshme në bazë të grupmoshave dhe interesave të ndryshme të turistëve do të jetë pjesë e programit të itinerareve turistikë. Përfshirja dhe prezantimi i herëpashërshëm me Parkun Bylis gjatë implementimit të PM-së me sipërmarrës të interesuar për hapjen e bujtinave, agriturizmave etj., përreth zones Bylis – Klos duhet të realizohet përmes organizimit të panairove dhe veprimtarive të tjera.

Në ndihmë të rritjes dhe kthimit të Bylisit në një ndër atraksionet kryesorë në Shqipëri do të jetë bërja e një logo të Bylisit për prodhimin dhe shitjen e suvenireve në Muze (bluzave, vizatimeve për ngjyrosje për fëmijët deri në 12 vjeç), por edhe për biletat dhe në sitin arkeologjik

5.4.5 ZHVILLIMI DHE KËRKESA E TURIZMIT

Objektivat e kërkesës së turizmit përfshijnë tipologjinë e mëposhtme:

- I. **Turizmi i përgjegjshëm**, i bazuar në parimet e drejtësisë ekonomike dhe sociale dhe në respekt të plotë të kulturave dhe mjedisit me fokus në komunitetin mikpritës lokal dhe të drejtën e tij për të qenë një protagonist në zhvillimin e turizmit të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm në territorin e tij. Turizmi funksionon duke promovuar ndërveprimet pozitive ndërmjet industrisë së turizmit, komuniteteve lokale dhe udhëtarëve dhe përfshinë:
 1. **Turizmin kulturor**: i) Turistët që kanë një vizitë një-ditore në Bylis/Klos si pjesë e një itinerari më të gjerë kulturor në Shqipëri;
 2. **Turizmi enogastronomik**: i) Turistët që kanë një vizitë një - ditore në Bylis/Klos si pjesë e një itinerari më të gjerë enogastronomik në Shqipëri; ii) Turistët që kanë një vizitë dy - ditore në Bylis/Klos si pjesë e një itinerari më të gjerë enogastronomik në Shqipëri;
 3. **Eko-turizmi**: i) Turistët që kanë një vizitë një - ditore në Bylis/Klos si pjesë e një itinerari më të gjerë eko-turistik në Shqipëri; ii) Turistët që kanë një vizitë dy - ditore në Bylis/Klos si pjesë e një itinerari më të gjerë eko-turistik në Shqipëri;
 4. Turistët që do të vinin për një **motivim primar** për të vizituar parkun arkeologjik të Bylisit dhe Renojat arkeologjike të Klosit dhe/ose Mallakastrën (për shembull turizmi i pelegrinazhit).
- II. **Turizmi i festivalit dhe eventeve, duke përfshirë**:
 1. Turistët që kanë vizitë një-ditore në Bylis/Klos si pjesë e një event artistik në terren/ose festival;
 2. Turistët që kanë një vizitë dy-ditore në Bylis/Klos si pjesë e një eko-turizmi më të gjerë në Shqipëri.
- III. **Turizmi i shkollave dhe arsimit të lartë, duke përfshirë**:
 1. Nxënësit, studentët/kërkuesit shkencorë që kanë një vizitë një-ditore në Bylis si pjesë e arsimi/program i arsimit të mesëm, apo të lartë;
 2. Studentët/kërkuesit shkencorë që kanë një vizitë dy-ose më shumë ditore në Bylis si pjesë e arsimi/program i arsimit të lartë;

Shërbimet e propozuara në lidhje me kërkesën e turizmit ndahen në tre kategori.

- **Biletat** (standarte, të ulura, ekstra);
- **Shërbimet e brendshme**, të siguruar nga stafi i PAB
- **Shërbimet e jashtme** (të siguruar nga kontraktore të jashtëm të zgjedhur me procedurat e prokurimit publik)

Bileta standarte e propozuar është 5 EUR për person, në krahsim me rreth 3.8 EUR që është sot. Bileta e ulur e propozuar është 3 EUR për person. Biletat ekstra (në varësi të shërbimeve shtesë si për shembull, ekspozitat, etj), 2 EUR për person.

Shërbimet e brendshme përfshijnë, jo plotësisht:

- Shërbime interaktive dhe proaktive për turistët, si:
 - i) Vula e "Mozaikut tënd" me imazhe të turistëve që vizitojnë mozaikun;
- Shërbimet "ZJARR", si:
 - i) organizimi i ceremonive të dasmës dhe të pagëzimit;
 - ii) guida turistike;
 - iii) audio-guida.

Shërbimet e jashtme, përfshijnë:

- **Shërbimet "TOKË"** : bar-kafe, shtëpi pritëse në vend;
- **Shërbimet "AJËR"** : organizimin e eventeve kombëtare, ndërkombëtare dhe lokale në vend. Një listë e eventeve lokale dhe kombëtare, përfshin: Dita e Verës; Festa e Sulltan Novruzit; Festivali Kombëtar i Polifonisë; Festa e shoqatës "Mallakastra"; festival teatrore, koncerte e balet klasike, apo popullore, konferenca, etj
- **Shërbimet SAL** (Suvenire, Art, Libra);
- **Shërbimet e territorit**, si për shembull: dyqane me prodhime tipike, guida lokale etj.

Analiza e kostove përfshinë:

- Kostot e stafit, sipas Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave;
- Shërbimet e internetit;
- Mirëmbajtjen IT;
- Shërbimet e sigurisë;
- Kërkimi shkencor;
- Kostot e promovimit;
- Kostot operacionale;
- Fondi rezervë.

Analiza e të ardhurave përfshin:

- Të ardhurat nga bileta;
- Të ardhurat nga shërbimet e brendshme;
- Të ardhurat nga shërbimet e jashtme.

6. VIZIONI

VIZIONI ,RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I PASURISË NË NJË PERIUDHË MË TË GJATË SE PM, QËLLIMI, OBJEKTIVAT E PROJEKTIT IPA 2018.

6.1 VIZIONI DHE ARDHMJJA

“Ruajtja dhe kultivimi i vlerave të pasura të qyteteve antike të Bylisit dhe Klosit do të kontribuojnë në formimin e një modeli frymëzues për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, edukimin përmes kulturës, dhe rritjen e ofertës turistike, duke garantuar njëkohësisht që kjo trashëgimi kulturore të mbetet një burim i identitetit kombëtar për brezat e ardhshëm”

Vizioni i Planit të Menaxhimit është i përqendruar në mbrojtjen, konservimin dhe vlerësimin e vlerave historike dhe arkeologjike, të cilat janë integruar në kuadrin e zhvillimit të infrastrukturës së një parku modern dhe të aksesueshëm. Qëllimi është promovimi i rëndësisë kulturore të vendit përmes rrëfimeve tërheqëse dhe emocionale, duke nxitur kështu zhvillimin e turizmit kulturor dhe inkurajuar rritjen e qëndrueshme të zonës. Ky plan synon të theksojë dhe të rrisë vlerën e pasurisë kulturore nëpërmjet një qasjeje që lidh trashëgiminë me zhvillimin e tanishëm dhe të ardhshëm të komunitetit.

Në nivelin kombëtar, Vizioni ofron një kontribut në zbatimin e “Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI)” të Qeverisë Shqiptare, si dokumenti strategjik më i rëndësishëm në vend në pikëpamjen e afrimit me Bashkimin Evropian dhe, më specifiku, i përgjigjet Vizionit të seksionit 11.10 “Më shumë vëmendje ndaj artit dhe kulturës” i cili njihet “trashëgiminë kulturore si një forcë lëvizëse për zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm të vendit”. Vizioni gjithashtu është në përputhje me objektivat specifike të theksuara nga SKZHI⁸, të tilla si “mbrojtja dhe konservimi i trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme, si një e mirë publike kombëtare” dhe me linjat e veprimit të lidhura: i) rehabilitimi i integruar i trashëgimisë materiale kulturore (qendrat historike urbane dhe rurale, monumentet kulturore, parket, vendet arkeologjike) dhe transformimi i tyre në qendra të hapura për vizitorë

⁸ <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim>

dhe turistë; ii) përmirësimi i standardeve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në Parqet Arkeologjike Kombëtare dhe në muze, me qëllim të rritjes së ndërhyrjeve të rehabilitimit dhe të ofertës së përgjithshme turistike.

Po në nivel kombëtar është marrë në konsideratë vizioni i Ministrisë së Kulturës si perfituesi direkt i këtij këtij PM, “Artet dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë, si një forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit”. Ky është një komponent kryesor i vizionit të këtij plani, veçanërisht i Konservimit, Restaurimit të Monumenteve. Qëllimi strategjik dhe objektivat specifike të Ministrisë së Kulturës janë marrë gjithashtu në konsideratë.

Në nivelin ndërkombëtar, ky Vizion është i rëndësishëm për konceptin e konservimit të trashëgimisë kulturore, të prezantuar nga legjislacioni italian dhe evropian i zhvilluar me Kartën e Venecias për restaurimin dhe konservimin e monumenteve dhe vendeve të vitit 1964⁹. Ky koncept, i cili është supozimi themelor në qasjen ndaj trashëgimisë kulturore, ka evoluar progresivisht, me kalimin e kohës, për të marrë një kuptim më të gjerë: atë të konservimit të integruar, duke pasur parasysh kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e vlerave që karakterizojnë pasurinë që duhet të mbrohet. Veçanërisht, Deklarata e Amsterdambit e vitit 1975 përcakton konceptin e konservimit të integruar me qëllim sigurimin jo vetëm të mbrojtjes së ndërtesave dhe mjediseve me vlerë arkitekturore, por edhe përfshirjen e kësaj mbrojtjeje në temën më të gjerë të rindërtimit të qytetit bashkëkohor, me objektivin e qartë të përmirësimit të cilësisë së jetës¹⁰.

Vizioni është gjithashtu i rëndësishëm për konceptin e menaxhimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore, i elaboruar për herë të parë në Kartën e Restaurimit të Krakovit të vitit 2000. Ky koncept merret me çështjet e konservimit dhe vlerësimit me vëmendje të veçantë ndaj ndryshimit, transformimit dhe dinamikave të zhvillimit, si dhe optimizimin e kostove operative, me qëllim të marrjes së kontrollit të vazhdueshëm të dinamikave të vetë ndryshimit, të zgjedhjeve të duhura dhe rezultateve. Në një kuptim të gjerë, konservimi i trashëgimisë kulturore duhet të jetë

⁹ Wong, L. Adaptive Reuse: Extending the Lives of Buildings; Birkhäuser Verlag GmbH: Basel, Switzerland, 2017; ISBN 978-3-03821-537-0

¹⁰ Della Torre, S. Una strategia di valorizzazione dei beni e della attività culturali. In Distretti Culturali Dalla Teoria Alla Pratica; Barbetta, G.P., Cammelli, M., Della Torre, S., Eds.; Il Mulino: Bologna, Italy, 2013; pp. 72–80. ISBN 978-8815239617

pjesë integrale e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor, duke kontribuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve¹¹.

Më e rëndësishmja, Vizioni është i rëndësishëm për konceptin e trashëgimisë kulturore si çelës për zhvillim të qëndrueshëm. Ky koncept është subjekt i Deklaratës së Hangzhou, të adoptuar më 17 Maj 2013, por edhe i përfundimeve të Këshillit të Europës të 21 Majit 2014 rreth trashëgimisë kulturore si një burim strategjik për një Europë të qëndrueshme, e cila fton shtetet anëtare të “forcojnë rolin e trashëgimisë kulturore në zhvillimin e qëndrueshëm, duke u fokusuar në planifikimin urban dhe rural dhe në projektet e rindërtimit dhe rimëkëmbjes”. Deklarata e Hangzhou gjithashtu thekson nevojën për një kombinim të ri të traditës (e kuptuar si trashëgimi kulturore e prekshme dhe e paprekshme) dhe inovacionit për qëndrueshmërinë e komuniteteve ndaj fatkeqësive mjedisore dhe ndryshimeve klimatike. Shtetet gjithashtu ftohen të “adoptojnë një qasje të integruar për politikat që lidhen me diversitetin kulturor, biologjik, gjeologjik dhe peizazhin”. Për më tepër, Deklarata e Hangzhou njih nevojën për të “nxitur ndërgjegjësimin për potencialin ekonomik të trashëgimisë kulturore dhe për ta përdorur atë, dhe për të marrë parasysh karakterin dhe interesat specifike të trashëgimisë kulturore në planifikimin e politikave ekonomike, me qëllim të shfrytëzimit të plotë të potencialit të trashëgimisë kulturore si një faktor në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm”.¹²

6.2 RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I PASURISË NË AFAT TË GJATË

Ruajtja dhe zhvillimi i pasurisë kulturore të Bylisit dhe Klosit shkon përtej këtij plani menaxhimit. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet objektivat afatshkurtër (2024-2026) për ruajtjen dhe konservimi, Objektivat afatmesëm (2027-2029) për një model më të qëndrueshëm administrimi dhe objektivat afatgjatë (2030+) për të shndëruar Parkun Arkeologjik Bylis dhe Klos një model zhvillimi me bazë komunitetin. Për të përmburshur këto objektiva përfshirja e Parkut Arkeologjik Bylis në aksionin IPA 2018 përbën një shans unik për zhvillimin tij dhe të klosit por edhe për një impakt të tij shumë pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të trevës së Mallakastrës. Nevoja e një permiresimi të funksionit dhe rrolit që ka Parku Arkeologjik Bylis në sistemin shqiptar të trashëgimisë kulturore nisët nga parimi se kjo trashëgimi është

¹¹ Cristinelli, G. La Carta di Cracovia 2000. Principi per la Conservazione e il Restauro del Patrimonio Costruito; Marsilio Editore: Venezia, Italy, 2002; ISBN 8831781235

¹² UNESCO. The Hangzhou Declaration. Placing Culture at the Heart of Sustainable Development Policies. Adopted in Hangzhou, People's Republic of China, on 17 May 2013. Available online: <http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CLT/images/FinalHangzhouDeclaration20130517.pdf>

nje aset zhvillimi të qëndrueshëm përmes nxitjes së turizmit, rigjenerimit të ekonomisë vendore, promovimit të integritit krahas diversitetit kulturor.

Strategjia e ndërhyrjes së PM e konsideron trashëgiminë kulturore si drejtuese prioritare ndaj rritjes gjithëpërfshirëse. Një qasje tjetër metodologjike, e quajtur “Shkolla kantier”, ka për qëllim të menaxhojë studimin, gjurmimin, ruajtjen dhe aktivitetet restauruese, jo thjesht si faza teknike, por si ndërtuese- kapacitetesh dhe veprimtari gjenerimi të ardhurash për një aftat të gjatë për përfituesin e investimit, që është Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, por edhe në sektorin e turizmit për komunitetet vendore, duke krijuar kështu një zinxhir të plotë vlerash. Ndërtimi i muzeut arkeologjik, restaurimi i teatrit për performanca artistike e kulturore, krijimi i shkollës kantier, ndërtimi i shtëpisë së arkeologut e restauratorit, aktivitetet e hapura për nxënësit, studentët dhe turistët gjatë aktiviteteve të restaurimit dhe ruajtjes, apo eventet promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare, janë vetëm disa shembuj të ndryshimit themelor në mënyrën e përdorimit të pasurisë kulturore sipas orientimeve të dhëna në “Strategjinë e zhvillimit të kulturës 2019-2025”.

Në përputhje me Dokumentin e Veprimit IPA 2018, objektivi specifik i projektit është *“të rrisë dhe ruajë përdorshmërinë dhe atraktivitetin e aseteve të trashëgimisë kulturore në zonën arkeologjike të Bylisit”*. Mbi këtë bazë do të prodhohen rezultatet e mëposhtme:

1. **Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë arkitektonike dhe artistike të Bylisit** i bashkërenduar me rritjen e kapaciteteve profesionale dhe menaxhuese të personelit të parkut dhe zbatimin e mënyrave adekuata të administrimit të tij në përputhje me prerogativat e Ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe të “Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025”
2. **Përmirësimi rrënjësor i infrastrukturës së pritjes dhe vizitave** për turistët, evidentimi në shërbim të tyre i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe ambientale të Bylisit, rritja e mundësive të interaktivitetit me institucionet edukuese të Mallakastës dhe me sistemin arsimor shqiptar në përgjithësi.
3. **Ndikimi mbi rritjen dhe zhvillimin ekonomik vendor** nëpërmjet miratimit të qasjes së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti i BE-së (CLLD), aftësive dhe kapaciteteve të përmirësuara dhe një bashkëpunimi të zgjeruar midis komuniteteve lokale dhe administratës së parkut.

7. ADMINISTRIMI

ANALIZË E MODELEVE PËR MENAXHIM EFIKAS TË PASURISË KULTURORE TË PALUAJTËSHME, ALTERNATIVA, NDRYSHIME DHE PËRMIRËSIME TË NEVOJSHME NË MODELIN AKTUAL TË ADMINISTRIMIT, MBROJTJA E PASURISË KULTURORE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSI TË TJERA.

7.1 ZHVILLIMI I STRUKTURËS SË MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË

Sitet arkeologjike janë dëshmitarë të historisë së përbashkët njerëzore të cilat bartin vlera kulturore, historike dhe shkencore. Ruajtja, mbrojtja dhe zhvillimi i tyre kërkon një strukturë të qartë të menaxhimit që integron parime të rëndësishme të konservimit, kërkimin shkencor, zhvillimit të qëndrueshëm, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përfshirjes së komunitetit lokal. Për të siguruar qëndrueshmërinë e siteve arkeologjike, menaxhimi i tyre duhet të integrohet pa ndërprerje në qëllimet më të gjëra të zhvillimit të qëndrueshëm. Politikat e Bankës Botërore “Lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore” ofrojnë udhëzime për arritjen e këtij integrimi¹³. Duke përputhur konservimin arkeologjik me qëllimet më të mëdha ekonomike, shoqërore dhe mjedisore, struktura e menaxhimit siguron një qasje të balancuar dhe harmonike që përfiton si siti ashtu edhe komunitetet përreth. Në menaxhimin e siteve arkeologjike të Bylisit dhe Klosit është shumë e rëndësishme që këto parime të kontribuojnë bashkërisht në një strukturë të përgjithshme dhe adaptive duke iu përgjigjur vizionit të këtij plani menaxhimi¹⁴.

7.1.1 ADMINISTRIMI I AKTUAL I P.A.B DHE RRËNOJAVE TË KLOSIT

Qyteti ilir i Bylisit dhe rrënojat e Klosit u shpallën monumente kulture kategoria e parë, respektivisht me vendim të Institutit të Shkencave (botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 95, datë 16.10.1948); Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ datë 15.01.1963 dhe Ministria e Arsimit dhe Kulturës/nr.1886/ datë 10.06.1973. Ndërsa sot rrënojat e

¹³ Banka Botërore. Politikat e Mbrojtjes lidhur me Trashëgiminë Kulturore.

¹⁴ UNESCO. (1972). Konventa Mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore.

ICOMOS. (1990). Karta për Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Trashëgimisë Arkeologjike.

ICOMOS. (1993). Karta e Enave për Interpretimin e Siteve të Trashëgimisë Kulturore.

Karta Ndërkombëtare e Venedikut, Karta e Burra-së, Konventa e Valletës dhe të tjera.

Klosit janë nën administrimin e DRTK Vlorë¹⁵, qyteti ilir i Bylisit u krijua si park me **VKM nr.396, dt. 31.03.2005**, së bashku me hartën e zonifikimit të tij, si dhe strukturën administrative. Në këtë vendim u krijua gjithashtu Bordi Kombëtar i Parqeve Arkeologjike (BKPA) në Shqipëri që në atë kohë paraqiste një nismë strategjike për mbikëqyrjen e veprimtarive të parqeve arkeologjike në vend. Drejtori i ZAKPA Bylis emërohej, lëshohej, dhe shkarkohej nga Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, bazuar në kriteret të përcaktuara nga BKPA. Sipas këtij vendimi zyra e ZAKPA Bylis luante një rol kyç në implementimin dhe administrimin e programeve të miratuara. Ajo bashkëpunonte me institucione të ndryshme qendrore dhe lokale, ndihmonte autoritetet lokale, organizonte konsulencë me ekspertë, dhe ndërtonte partneritete me individë, organizata, fondacione dhe organizma ndërkombëtare për njohjen, publikimin dhe mbështetjen financiare të projekteve për ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin dhe përmirësimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në parkun arkeologjik. Përveç kësaj, ZAKPA Bylis krijonte kushte sa më të mira për vizitorët përmes infrastrukturës bashkëkohore. Financiarisht, shpenzimet e ZAKPA Bylis mbulohehin nga Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ndërsa të ardhurat vinin nga veprimtaritë në parkun arkeologjik. ZAKPA Bylis kishte të drejtë të merrte donacione dhe sponsorizime nga burime të ndryshme, duke i përdorur ato në përputhje me qëllimet e parkut.

Më pas, **VKM Nr. 249, datë 30.4.2014** la si strukturë përgjegjëse për administrimin e Parkut Arkeologjik, Bylis, Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Bylis. Ndërkohë, në këtë vendim u bënë disa ndryshime të tjera në lidhje me strukturën e BKPA dhe administrimit të disa parqeve arkeologjike.

Më vonë, sipas **Urdhërit të Kryeministrit nr.132, dt. 21.10.2019** Parku i Bylisit u përfshi në një administrim të vetëm nën emërtimin Parku Arkeologjik i Apollonisë dhe Bylisit. Ky vendim ndryshoi VKM-të e mëparshme nr. 184 dt. 23.6.2014 për Strukturën dhe organikën e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni dhe nr. 185 dt. 23.6.2014 për Strukturën dhe organikën e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Bylis. Në organigramën e strukturës administrative Bylis u shndërua në sektor brenda zyrës Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni dhe Bylis.

¹⁵ https://iktk.gov.al/site/ep-content/uploads/2020/10/Monumentet_-Qarku-Fier.pdf

7.1.2 ANALIZA SWOT

Në analizën e mëposhtme merren parasysh Pikat e forta, Pikat e Dobëta, Mundësitë dhe Kërcënimet parësore për modelin aktual të menaxhimit dhe zbatimin e suksesshëm të PM për 5 vitet e ardhshme.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> • Bylis një vend mjaft i njohur dhe me vlera të jashtëzakonshme kombëtare, i mbrojtur nga shteti, i pasur në burime natyrore dhe kulturore. Ai është një vend unik: pika e fortë kyçe është peizazhi i tij • Rëndësia e njohur e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, që menaxhohet nga shteti. • Prodhime bujqësore vendase (fruta, perime, bulmet, verë, raki, mjaltë, etj.) në dispozicion të vizitorëve • Nisma private dhe biznese vendore ekzistuese dhe të njohura, që përfshijnë akomodimin, restorante, bare, ture dhe guida • Njerëz mikpritës dhe miqësorë që jetojnë në një klimë, që i përshtatet më së miri mendësisë perëndimore për pushimet verore • Ndërgjegjësim në shkallë kombëtare rreth nevojës për bashkëpunim dhe zhvillim të përbashkët, për të pasur një të ardhme të qëndrueshme • Punimet arkeologjike në revista akademike 	<ul style="list-style-type: none"> • Transport jo i mirë rrugor drejt dhe brenda Parkut dhe rajonit përreth • Angazhim i ulët komunitetit lokal me parkun • Mungesë e menaxhimit profesional të turizmit, nxitur nga sektori publik në shkallë vendore • Një strukturë relativisht e dobët e palëve private të interesit, për sa i përket përvojës së biznesit dhe financave të duhura • Numër jo i madh turistësh gjatë sezonit turistik. • Mungesë në baza të dhënash dhe statistika të besueshme dhe konsistente mbi turizmin dhe biznese të tjera • Aktivitete jo të efektshme marketingu që synojnë turistë me kosto të ulët, por me vlerë të lartë: mungon një faqe interneti apo faqe në mediat sociale, e menaxhuar në mënyrë profesionale, materiale të shtypura, me pak informacione dhe të vjetra, numër i kufizuar materialesh promovionale përgjatë Parkut • Mungesë e një brandi marke koherente dhe të njëtrajtshme e Parkut
Mundësitë	Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesë e vazhdueshme dhe në rritje për destinacione të reja e të pazbuluara, në Mesdhe dhe në vende të tjera, ku ndër destinacionet kryesore është Shqipëria • Qeveria ka njohur rëndësinë dhe fuqinë e turizmit ndërkombëtar, si pjesë e axhendës më të gjerë socio-demografike • Ndikimi në të ardhmen e Parkut në tërësi, si tregues i pranisë së institucioneve donatore që operojnë në 	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i industrisë së naftës afër Parkut Arkeologjik Bylis, ndërtime brenda parkut, pa leje dhe në zona arkeologjike • Vendosija e paligjshme e gardheve në rrënojat arkeologjike të Klosit • Shfrytëzimi i paqëndrueshëm i burimeve (shfrytëzimi i gurorëve, menaxhimi i keq i ujit, rreziku zjarreve dhe shpyllëzimi i pakontrolluar)

<p>shkallë kombëtare dhe rajonale dhe investojnë në turizëm, kulturë dhe konservim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statusi i vendit kandidat për aderim në Bashkimin Evropian krijon mundësi për financime por, pa dyshim, të shoqëruara me kushte të BE-së • Zbatimi i nismave në shkallë kombëtare për zhvillimin e zonave rurale dhe oferta e përgjithshme turistike • Potenciali për bashkëpunim rajonal me vendet e tjera të Ballkanit dhe të Mesdheut, si Bosnja Hercegovina, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi, Serbia dhe Slovenia • Mundësia për ta zhvilluar Bylis si destinacion të qëndrueshëm turistësh në nivelin kombëtar, nëpërmjet ndërhyrjeve të lehta të planifikuara mbi struktura dhe interpretime të ndryshme • Rritja dhe Aftësia për t'i përdorur karakteristikat e Parkut për përfitime tregtare, zhvillimeve të ardhshme, si dhe në veprimtari edukuese dhe kulturore 	<ul style="list-style-type: none"> • Shtimi i veprimtarisë së trafikantëve të pasurive arkeologjike dhe gërmimet ilegale të gjuetarëve të thesareve. • Ndryshimet klimatike (ndryshimi në modelin e rreshjeve dhe temperaturave të larta mund të shkaktojë erozion e tokës ku gjenden monumentet. Temperaturat e larta mund të shkaktojnë dëmtim në materiale të ndryshme, duke përfshirë muret e vjetra dhe mozaikët). • Turizmi i masës masë është edhe një mundësi për të rritur financat, por edhe një kërcënim pasi prurja e mijëra njerëzve mund të çojë në shkatërrimin e atyre vendeve që vizitojnë;
--	---

7.1.3 ASPEKTE TË TJERA QË LIDHEN ME SFIDAT E ADMINISTRIMIT

Ashtu si del edhe nga analiza SWOT, modeli aktual i menaxhimit të Bylisit dhe Klosit përballet me sfida të rëndësishme që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Këto sfida përfshijnë **rrezikun nga zjarret**, i përkohshëm dhe i vazhdueshëm për shkak të vegjetacionit të dendur dhe temperaturave të larta. Kjo situatë vë në rrezik integritetin e strukturave arkeologjike dhe sigurinë e vizitorëve gjatë periudhave të nxehta, duke kërkuar për këtë një strategji të kujdesshme për menaxhimin dhe parandalimin e zjarrit. **Mungesa e një muzeu dhe hapësirave të sigurta për depozitim** ka shkaktuar humbje dhe dëmtime të artifakteve arkitektonike dhe dekorative, duke theksuar nevojën për mjedise të sigurta për ruajtjen dhe ekspozitën e artifakteve kulturore. Hapësirat e hapura të parkut, pa rrethim të plotë, kërcënojnë objektet kulturore dhe rrezikojnë integritetin e tyre. Përgjigja e mundshme përfshin rrethimin e zonave të hapura për të mbrojtur artifikatet nga dëmtimet dhe grabitjet. **Ndikimet e ndryshimeve klimatike**, si erozioni dhe shirat e rrëmbyer në një kohë të shkurtër, kanë ndikim në strukturat arkeologjike, duke kërkuar hartimin e planeve për t'u përgjigjur ndaj tyre. **Rritja e trafikantëve të pasurisë arkeologjike** sjell rrezikun e grabitjes dhe dëmtimit të objekteve me vlerë, ndërsa aktivitetet industriale dhe bujqësore duhet të ndërmerren me kujdes për të mbrojtur integritetin e qytetit antik. Prania e një gurore që shfrytëzon territorin për nxjerrje rëre dhe djegje guri gëlqerorë rrezikon integritetin e kodrës, duke bërë të nevojshme ndalimin e kësaj veprimtarie për **ruajtjen e integritetit natyror dhe kulturor të kodrës së Bylisit**. Ndërkohë, **vendosja e gardheve dhe rrethimeve private** në rrënojat arkeologjike si në Klos pengon vizitueshmërinë e sitit. Gardhet duhet të largohen menjëherë që monumenti të vizitohet. **Ruajtja fizike** është një tjetër çështje për tu adresuar. Strukturat e sipërpërmendura nuk janë të mjaftueshme për të kryer funksionin e ruajtjes fizike të siteve. Përveç Parkut Arkeologjik të Butrintit dhe Apollonisë, të cilët ruhen me roje private, parqet Bylis, Amantia dhe Orikum nuk kanë asnjë punonjës për ruajtjen e tyre. Për shkak të shtrirjes së parqeve arkeologjike dhe morfologjisë së tyre të vështirë, është e nevojshme të analizohet mundësia për sistemet elektronike të kontrollit me kamera të shpërndara në pikat më të përshtatshme dhe strategjike të siteve, të cilat mund të lidhen me një sallë të vetme monitorimi ku një roje i vetëm ka mundësi të kontrollojë gjithë veprimtarinë dhe situatën si gjatë ditës ashtu edhe gjatë natës për dëmtime, zjarre apo ndërhyrje të paligjshme të çdo lloji. Në brendësi të Parkut të Bylis, duhen vendosur **tabela të reja interpretuese**, të cilat mungojnë krejtësisht që nga viti 2019. Në këto site arkeologjike, vizitat e turistëve zhvillohen pa mbështetjen e teknologjive të audioguidës dhe të videoguidës.

7.2 PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E ADMINISTRIMIT

Ligji 27/2018, krahas ndryshimeve të shumta që solli në sistemin e trashëgimisë kulturore, prezantoi koncepte të reja për format e administrimit të pasurive kulturore në Shqipëri. Të zbatuara me korrektësi, këto koncepte kanë brenda tyre potencialin e madh për të zhvilluar pasuritë kulturore dhe për ti kthyer ato në destinacione turistike dhe kulturore, me përfitues kryesor komunitetin lokal.

Në përgatitjen e analizës për modelin e administrimit në sitet e Bylisit dhe Klosit u morën shembuj tipologjikisht të ngjashëm me to nga Anglia, Italia dhe Greqia. Ndërsa Anglia ka një traditë të gjatë të menaxhimit të siteve arkeologjike përmes trusteve dhe përfshirjes së English Heritage në çështjet e konservimit, Italia ka filluar së fundmi të aplikojë modele administrimi përmes fondacioneve të varura ose jo nga shteti. Përkundrazi, Greqia vazhdon të ketë një menaxhim dhe kontroll të plotë nga shteti pa ndonjë alternativë të menaxhimeve indirekte. Pavarësisht kësaj, modeli i propozuar për sitet e Bylisit dhe Klosit ka marrë për bazë ecuritë e këtyre modeleve përmes avantazhet dhe disavantazhet, është bazuar në format e parashikuara sipas kuadrit ligjor të trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe ka ndërmarrë një analizë ekonomiko-financiare për të parë qendrueshmërinë e tij.

7.2.1 ANALIZA E MODELIT

Modelet e administrimit të aseteve kulturore në Shqipëri përcaktohen nga Ligji 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, në veçanti nga neni 171, 'Mënyra e Administrimit' dhe neni 172 “Fondacionet e Posaçme të Trashëgimisë Kulturore”. Sipas nenit 171, pasuritë kulturore në pronësi publike administrohen në formë direkte ose indirekte.

1. **Administrimi direkt** nëpërmjet strukturave të specializuara organizative në varësi të institucioneve shtetërore ose institucioneve të tjera publike me autonomi shkencore, organizative e financiare dhe ekspertizë të specializuar teknike e shkencore. Institucionet publike mund të kryejnë menaxhim të drejtpërdrejtë në bashkëpunim me organe të tjera të administratës publike.
2. **Administrimi indirekt** nëpërmjet:
 - a. **Fondacioneve të posaçme**, të krijuara sipas nenit 172;
 - b. **Fondacioneve të themeluara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore**, sipas këtij ligji;
 - c. **Personave fizikë dhe juridikë, publikë apo privatë**, të cilëve u jepet administrimi i pasurisë kulturore përmes procedurave publike bazuar në një vlerësim krahasues të projekteve të paraqitura.

Zgjedhja ndërmjet dy formave të mësipërme të administrimit bazohet në një vlerësim krahasues në terma ekonomiko-financiarë dhe efektiviteti, bazuar në objektivat e paracaktuara.

MODELET E ADMINISTRIMIT	AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
1.ADMINISTRIMI DIREKT		
1.1 Parku Arkeologjik Bylis	Tashmë i krijuar	Menaxhimi ekzistues nuk duket se funksionon në mënyrë efektive. Bylisi gjendet si sektor brenda Parkut të Apollonisë
	Status Quo (ruhet gjendja ekzistuese, varësia nga shteti)	Më pak fleksibël për t'u përshtatur me situatat aktuale dhe në zhvillim
	Mund të përmirësohet	Pak ose aspak fonde private të mundshme
	Risk të vogël financiar pasi mbështet nga shteti	
2.ADMINISTRIMI INDIREKT		
2.1Fondacion i Posaçëm	Përvojë në menaxhim privat	Duhet kohë e mjaftueshme për të krijuar
	E hapur për donacione private	Perceptim negativ
	Mbështetje nga donatorë që sigurojnë modelin	Do të duhet kohë për të gjetur partnerin ose donatorin e duhur privat
		Mund të përforcojë dëshirën për të prodhuar fitime, në vend që t'i jepet përparësi ruajtjes dhe vizitës
		Mungesa e përvojës me fondacione ad hoc të bashkëthemeluara me një partner privat ose jofitimprurës
2.2 Fondacion i krijuar nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore	Krijon një model të qeverisjes vendore duke ruajtur ende lidhjet institucionale	Mund të shihet vetëm si një ndryshim formal, ende si një institucion i qeverisë
	Fondet e siguruar ka të ngjarë të shkojnë për	Përfshirje e kufizuar private dhe mundësi të pakta dhurimi

	ruajtjen/konservimin dhe aktivitete me komunitetin	
	Lidhja me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të ishte e fortë	Mungesa e mundshme e përvojës në menaxhimin e ndërmarrjeve private apo partneriteteve
	Konservimi me prioritet	Nuk është ende i provuar në site të tjera.
2.3 Personat fizikë dhe juridikë	Do të ishte shumë e shpejtë për t'u krijuar	Nuk është e mundur me site me vlera kulturore të rëndësishme
		Është projektuar për site më të vogla dhe më pak të rëndësishme
		Nuk do të përkrahej nga publiku apo institucionet
		Eksperiencë e pamjaftueshme për të menaxhuar

Administrimi Direkt

Ruajtja e formës së administrimit direkt nënkupton se do të ndiqet vazhdimësia e modelit aktual në të cilin restaurimet, mirëmbajta dhe menaxhimi i monumenteve do të mbeten nën përgjegjësinë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të cilat do ti realizojë këto kompetenca përmes IKTK-së, DRTK Vlorë dhe Parkut Arkeologjik të Bylisit. Plani i menaxhimit për sitet e Bylisit dhe Klosit kërkon që modeli i administrimit të pasqyrojë përmirësime të cilat adresojnë sfidat thelbësore dhe mundësitë për të ardhmen duke përfshirë gjetjen e mënyrave dhe mundësive fleksibël për zbatimin e projekteve, përmirësimin e strukturës së menaxhimit, përmirësimin e shërbimeve ndaj vizitorëve, rritjen e kapaciteteve lokale dhe afrimin e komunitetit lokal me trashëgiminë kulturore. Investimet kapitale në konservim, muze, biletari dhe ndërhyrjet e tjera në përmirësimin e turizmit, si dhe rritja e kapaciteteve lokale dhe afrimi i komunitetit me Parkun etj., që pritet të financohen nga projekti IPA 2018 i Bashkimit European mund të krijojnë kushte të përshtatshme për mirëadministrimin e këtyre dy siteve pa rrezik të lartë financiar.

Administrimi indirekt

Kjo formë sugjeron tre alternativa të dallueshme:

Alternativa e parë: Themelimi i një Fondacioni të posacëm. Kjo alternativë kërkon formimin e një enti të ri juridik jofitimprurës si fondacion, bashkëthemeluar nga institucione shtetërore, të përfaqësuara nga Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, dhe një partner strategjik. Ky partner mund të jetë një individ ose entitet privat që luan një rol kyç në mbështetjen dhe zbatimin e politikave në fushën e trashëgimisë kulturore dhe arritjen e synimeve të përbashkëta, bazuar në përvojën e tyre, vlerën dhe cilësinë e sponsorizimit, bashkëpunimin e zgjatur, shkëmbimin e vlerave intelektuale dhe burimet njerëzore dhe financiare, si dhe kohëzgjatjen e bashkëpunimit me qeverinë shqiptare ose ministrinë përkatëse të trashëgimisë kulturore. Ky model ofron autonomi të madhe, nxit menaxherët të kërkojnë burime të reja të të ardhurave dhe bashkëpunon me partnerë strategjikë për të përdorur përvojën e sektorit privat, duke bërë të mundur ofrimin dhe pranimin e donacioneve private. Megjithatë, ky model është kompleks dhe mund të marrë kohë për t'u zbatuar, dhe ka rrezikun e moskuptimit nga publiku dhe perceptimit të ndërhyrjes private në trashëgiminë kulturore. Rezultatet e këtij modeli priten të testohen në një nga sitet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe Mesdhe sic është Parku i Butrintit.

Alternativa e dytë: Fondacion i krijuar nga Institucione të Specializuara. Në përputhje me nenin 28, Titulli III, Institucionet e Specializuara në Fushën e Trashëgimisë Kulturore, siç përcaktohet në Aneksin 2 të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", përfshihen institucionet e mëposhtme:

- a. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
- b. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
- c. Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore
- d. Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale
- e. Institucionet e Rrjetit Kombëtar të Arkivave
- f. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë
- g. Instituti i Studimeve të Artit dhe Antropologjisë Kulturore
- h. Instituti i Arkeologjisë.

Kjo alternativë e fondacionit të themeluar nga një institucion i specializuar, ofron një menaxhim më të shpejtë dhe është një ndryshim i nevojshëm i qeverisjes për të përballuar sfidat. Në këtë alternativë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të vazhdojë të mbajë kontrollin dhe të jetë përgjegjëse për ruajtjen dhe konservimin në Bylis dhe Klos, duke lejuar ndërkohë fondacionin të menaxhojë funksionimin e përditshëm, organizimin e aktiviteteve, ekspozitat dhe promovimet. Ky model është më pak i rrezikshëm dhe mund të zbatohet në terma afat të shkurtër dhe të mesëm. Mobilizimi i fondeve nga donatorë të huaj mund të jetë një aspekt kyç i

aktivitetit të fondacionit, megjithëse ka njëfarë hezitimi nga donatorët në lidhje me financimin e enteve shtetërore. Ky model paraqet zgjidhjen më të mirë për të përparuar dhe trajton të gjitha çështjet e diskutuara më lart.

Për momentin, nuk është e mundur të bëhet një vlerësim i detajuar i të gjithë këtyre institucioneve se kush do ishte i duhuri për të themeluar fondacionin e ri. Megjithatë, disa nga to institucione, si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe Instituti i Arkeologjisë, janë kandidatë potencialë për të ndërtuar një bazë dhe për të filluar një model të ri të qeverisjes. Këto institucione kanë një mandat të qartë për mbrojtjen, ruajtjen, kërkimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Përzgjedhja e institucionit më të përshtatshëm nga këto alternativa duhet të bëhet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, e cila do të marrë në konsideratë faktorë të ndryshëm si kapaciteti, ekspertiza dhe burimet njerëzore dhe financiare që çdo institucion posedon. Ky vendim do të jetë kyç në përcaktimin e rrugës më efikase për të përballuar sfidat dhe për të implementuar një model qeverisjeje që është i qëndrueshëm, efikas dhe i përgjegjshëm ndaj nevojave të Bylisit dhe Klosit.

Personat fizikë

Ky model është në përputhje me legjislacionin dhe, në thelb, paraqet një delegim të menaxhimit. Ai ofron një nivel të lartë të autonomisë me një ndërhyrje minimale nga autoritetet rregullatore. Është shumë e mundshme që ky model të jetë inkorporuar në ligjet për objekte më të vogla, më pak kritike, si dhe për muze lokal. Zbatimi i këtij opsioni do të hasë në rezistencë të madhe nga komuniteti dhe grupet e interesit, duke u konsideruar si një tërheqje e përgjegjësive shtetërore ndaj një siti të rëndësishëm. Ky model nuk është i përshtatshëm për Parkun Arkeologjik të Bylisit.

Përfundim dhe rekomandim

Në kontekstin e nevojës për një menaxhim efikas të pasurisë kulturore të Bylisit dhe rrënojave në Klos, propozohet një qasje përmirësuese e administrimit aktual. Një administrim direkt nga MEKI sugjerohet si një zgjidhje e përshtatshme për këtë fazë. Ky model synon të përmirësimin e instrumenteve ligjore dhe financiare si dhe të adresojë çështjet të cilat janë evidentuar përgjatë modelit aktual që ka patur Bylisi dhe rrënojat e Klosit. Në këtë model Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të vijojë të mbajë përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ndërsa administrata e përmirësuar lokale e parkut do të jetë përgjegjëse në menaxhimin e përditshëm, organizimin e aktiviteteve të ndryshme me karakter edukues, evente, dhe promovime.

Misioni i Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos:

Misioni dhe realizimi i tij përmes objektivave specifike të këtij Parku janë ato të evidentuara në këtë plan menaxhimi dhe përfshijnë:

-Mbrojtja dhe mirëmbajtja e monumenteve në Bylis dhe Klos, përmirësimi i qasjes dhe qëndrueshmërisë së këtyre sitet, dhe nxitja e zhvillimit ekonomik lokal.

-Menaxhimi efektiv i burimeve financiare, dhe përcaktimi i një strukture administrative funksionale.

-Menaxhimi i Parkut Arkeologjik të Bylisit dhe Klosit si një atraksion turistik kyç në Shqipëri dhe si një model i menaxhimit të parqeve arkeologjike, përfshirë ndalimin e degradimit të ekosistemeve, garantimin e konservimit dhe vazhdimin e studimeve arkeologjike, përmirësimin e interpretimit të aseteve natyrore dhe kulturore, promovimin e turizmit miqësor ndaj mjedisit, dhe ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e mbrojtjes së këtyre aseteve.

-Organizimi i aktiviteteve arsimore, kulturore dhe shkencore, duke përfshirë kërkime arkeologjike, dhe trajnime.

-Bashkëpunimi me entitete brenda dhe jashtë vendit për të rritur efikasitetin e administrimit, mbështetur nga publikimi dhe shpërndarja e materialeve informative dhe organizimi i nismave për të mbështetur zhvillimin lokal dhe rajonal.

Këto objektiva janë themelore për realizimin e Planit të Veprimit dhe synojnë një menaxhim të qëndrueshëm dhe të efektshëm të trashëgimisë kulturore në sitet e Bylisit dhe Klosit.

Në terma ekonomik dhe financiar, Parku Arkeologjik i Bylisit dhe Klosit do të mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Fondet e MEKI-t do të mbulonin shpenzimet administrative, sigurinë fizike dhe kosto të tjera të operimit, ndërkohë që fondet e projektit IPA 2018 të financuar nga BE do të ndihmonin restaurimin e monumenteve arkeologjike në tre vitet e para si dhe aktivitete të tjera për komunitetin. Si rrjedhojë e këtyre investimeve, Parku Arkeologjik Bylis dhe Klos do të ishte i aftë që gradualisht të rriste kapacitetet lokale të punonjësve jo vetëm në operimin e të dy siteve por edhe në trajnimet me kara kter konservues dhe edukues.

7.2.2 ANALIZA E MODELIT TË ADMINISTRIMIT

Bazuar në analizën e mësipërme modeli i propozuar për Parkun Arkeologjik Bylis dhe Klos, në planin dhe objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm është Administrimi direkt nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Rekomandohet që Parku i ri të

shkëpus Bylisin nga administrimi aktual me Apolloninë dhe t'i bashkëngjitë administrimit të ri rrënojat e Klosit. Nëpërmjet kësaj forme admnistrimi ndërtohet një marrëdhënie të besueshme dhe të qëndrueshme ndërmjet lidhjeve historike të këtyre dy siteve, komuniteteve lokale dhe administratës së parkut e cila do të ndikojë më fuqishëm mbi zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor në trevën e Mallakastrës. Për të arritur këtë, krahas Planit të Menaxhimit të Bylisit dhe Klosit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të paraqesë për miratim aktet nënligjore përkatëse për mënyrën e administrimit dhe se si do të arrihen këto ndryshime.

Organizimi i strukturës dhe detyrave të personelit

Organigrama e propozuar për menaxhimin e indirekt i Parkut Arkeologjik Bylis-Klos dhe synon të ketë një numër jo shumë të madh personash (13), duke kombinuar sektorët e veprimtarisë së tyre. Punësimi do të kryhet gradualisht deri në 4 vitet e para të operimit. Në numërin e përgjithshëm prej 13, punonjësish, drejtori do të jetë arkeolog, arkitekt apo restaurator, në mënyrë që përveç angazhimit në administrimin e Parkut, të veprojë edhe në veprimtaritë kërkimore, restauruese, apo edukuese të Parkut. Edhe punonjësi i laboratorit do të jetë njëkohësisht përgjegjës dhe përpunues i fondeve arkeologjike, apo prokurimi do të bëjë njëkohësisht punën e financierit, ndërsa menaxheri i turizmit mund të mbulojë koordinimn e eventeve dhe pjesë të angazhimit me publikun (public engagement/relations). Organigrama shoqërohet me një përshkrim të shkurtër të detyrave dhe mënyrës së rekrutimit të personelit.

Administrimi i ri do të ketë autoritet në të gjitha sferat e funksionimit që lidhen me mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, përfshirë menaxhimin e vizitorëve, organizimin e ngjarjeve, menaxhimin e shërbimeve turistike, zhvillimin e kapaciteteve të brendshme, dhe angazhimin me komunitetin lokal etj..




FIGURA 91 - SKEMA ORGANIZATIVE E PARKUT ARKOLOGJIK BYLIS-KLOS

Përshkrimi i detyrave të stafit në Parkun Arkeologjik Bylis-Klos:

Drejtori: Punësohet përmes një konkursi të hapur dhe vjen nga rradhët e arkeologëve ose arkitektëve me Doktoraturë në arkeologji apo restaurim. Detyrat përfshijnë drejtimin e punëve administrative, konservuese-restauruese, edukuese dhe të lidhura me komunitetin në park. Veprimtaria e tij zhvillohet në përputhje me Rregulloren e Parkut Bylis dhe Klos e cila do të hartohet dhe më pas miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, dhe legjislacionit përkatës.

Punonjësit e tjerë të Parkut: Bazuar në aftësitë e tyre dhe detyrat specifike që do të kryejnë.

Arkeologu: Punësohet nga rradhët e arkeologëve me master në arkeologji përmes një konkursi të hapur. Detyrat përfshijnë drejtimin e ndërhyrjeve arkeologjike në kuadër të konservimit të monumenteve të parkut dhe zgjerimin e sipërfaqeve të vizitueshme, në koordinim me institucione të specializuara brenda dhe jashtë vendit.

Restauratori: Punësohet nga rradhët e restauratorëve me master në restaurim, histori arkitekture ose arti, përmes një konkursi të hapur. Detyrat përfshijnë drejtimin e ndërhyrjeve konservuese-restauruese në kuadër të konservimit të monumenteve të parkut.

Përgjegjësi i Muzeut: Punësohet nga rradhët e specialistëve të trashëgimisë kulturore me nivel master, përmes një konkursi të hapur.

Laboranti Përgjegjës i Fondeve Arkeologjike: Punësohet nga rradhët e të diplomuarve në kimik apo trashëgimi kulturore.

Manaxheri i Prokurimit/Financë: Përgjegjës për veprimtaritë financiare dhe prokurimin e shërbimeve. Emërohet nga drejtori i Parkut

PR/evente/turizëm: Përgjegjës për veprimtaritë turistike dhe kulturore në park.

Shitësit e Biletarisë (2 Punonjës): Përgjegjës për shitjen e biletave dhe shërbimin ndaj klientëve.

Sanitare (1 Punonjës): Mban pastërtinë në hapësirat sanitare të parkut.

Punëtorët e Mirëmbajtjes (3 Punonjës): Përgjegjës për mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve dhe infrastrukturës në park.

7.3 STRATEGJIA E ADMINISTRIMIT TË PARKUT

Plani i ngritjes së kapaciteteve

Nisur nga objektivi i përgjithshëm i PM - të ruajë, mbrojë dhe promovojë zonën arkeologjike të Bylisit dhe Klosit dhe ta shndërrojë atë në një atraksion turistik dhe një nxitës për rritjen e qëndrueshme ekonomike të zonës - përzgjedhja dhe trajnimi i stafit është një veprim vendimtar, i cili duhet të hartohet duke marrë parasysh situatën lokale, por në të njëjtën kohë duhet t'u referohet standarteve ndërkombëtare profesionale. Ndërtimi i kapaciteteve do të përqëndrohet si në aftësitë që kanë natyrë njohëse, teknike e shkencore, ashtu edhe në aftësitë që synojnë përmbushjen e kërkesave të audiencës dhe nxitjen e përgjigjeve ndaj komunitetit lokal.

Aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve – të vazhdueshme gjatë kohezgjatjes të PM – do të artikulojnë në tre faza kryesore:

- a) Aktivitetet përgatitore për trainimin
 - Kontaktet me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe autoritetet lokale për të identifikuar profilet e duhura profesionale
 - Analiza për nevojat e trajnimit
 - Ndërtimi i profilit dhe përshkrimi i punës
 - Përgatitja e thirrjes për punësim
 - Para-seleksionimi , Seleksionimi dhe Intervistat
- b) Zhvillimi dhe adresimi i kurseve të trajnimit
 - Prodhimi i materialeve të trajnimit (platforma e trajnimit online, materialet e printuara dhe digjitale)
 - Adresimi i trajnimit (module të zakonshme dhe të specializuara)
 - Vizita studimore dhe internshipe/me parqe arkeologjike të ngjajshme.
- c) Vijueshmëria
 - Trainimi dhe Këshillimi i stafit të trajnuar nga ekspertë arkeologë / kuratorë / administratorë trashëgimishë kulturore, edukatorë stafi në terren gjatë një periudhe kohore pas përfundimit të trajnimit.

7.4 MBROJTJA E PASURISË KULTURORE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

7.4.1 PLANI I MENAXHIMIT TË RISKUT

Si një dokument i rëndësishëm, Plani i Menaxhimit të Riskut (PMR) ka për qëllim të forcojë sigurinë dhe mbrojtjen e qytetit përmes ndërhyrjeve për parandalimin dhe zbutjen e rrezikut. Krijimi i një Plani të detajuar të Menaxhimit të Riskut është një nga çështjet kyçe që duhet të rrjedhë dhe të elaborohet në detaj përtej këtij plani menaxhimi, bazuar në sugjerimet e tabelës në fund të këtij kapitulli si dhe dokumentit kombëtar “Për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror” që mbështet Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në zbatimin e strategjisë së re kombëtare për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. Megjithatë, në PM-në e Parkut Arkeologjik të Bylisit (PAB) dhe Klosit, kjo çështje e rëndësishme është trajtuar në linja udhëzuese. Ky seksion ofron rekomandime për të forcuar kapacitetet dhe zbatimin aktual të masave të menaxhimit të katastrofave dhe hartimin përfundimtar të PMR-së. Rekomandimet duhet të synojnë trajtimin e shkaqeve (dmth., parandalimin e rrezikut nga katastrofat) dhe pasojave (dmth., zbutjen e efekteve të katastrofave) të rreziqeve të identifikuar. Rekomandimet duhet të përkthehen pas miratimit të këtij plani në një listë projektesh të ndara që mund të zbatohen në PMR, dhe që mund të kontribuojnë në rritjen e nivelit të sigurisë dhe mbrojtjes së Parkut Arkeologjik të Bylisit dhe Klosit. Rekomandimet janë të grupuara në kategori të ndryshme si: qeverisje, financimi i rrezikut, çështje ligjore dhe operacionale.

Qeverisja

Organizimi i konsultimeve dhe simpoziumeve vjetore me aktorët dhe institucionet përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me qëllim diskutimin dhe identifikimin e strategjive dhe zgjidhjeve optimale për rreziqet. Plani i Menaxhimit të Riskut duhet të hartohet duke marrë parasysh kërkesat e Ligjit nr. 45/2019 'Për Mbrojtjen Civile. Ngritja e tre ekipeve ekspertësh për të përcaktuar faktorët kryesorë të rrezikut:

- a) tërmeti,
- b) siguria,
- c) rreziku nga katastrofat e shkaktuara nga klima.

Drejtimi dhe lehtësimi i diskutimeve brenda këtyre ekipeve për të krijuar mirëkuptimin dhe përparësinë e rrjedhës së veprimeve, trajtimin e nevojave ekzistuese dhe atyre që shfaqen në çdo zonë me prioritet.

Ligjore

Rishikimi i strategjive kombëtare të zhvillimit, planet e veprimit dhe programet është kritik për të rekomanduar mënyrat më të mira për integrimin dhe trajtimin e nevojave për zbutjen e rreziqeve. Zhvillimi i miratimit të ndryshimeve ligjore është esencial për të siguruar që të gjitha pronat publike, duke përfshirë vendet arkeologjike si muzetë dhe pronat e ministrive, të kenë plane emergjence, të cilat përfshijnë një plan evakuimi të aprovuar zyrtarisht. Është e rëndësishme që përpjekjet për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat të reflektohen adekuatësisht në Legjislacionin e Shqipërisë, i cili aktualisht është në proces rishikimi. Nëse është e nevojshme, duhet të propozohen amendamente për të siguruar që ligji të përfshijë konsideratat për sigurinë dhe mbrojtjen.

Financimi për Riskun

Për sa kohë që nuk ka fonde të caktuara për aktivitetet e lidhura me rrezikun nga katastrofat dhe ekzistojnë kufizime të forta financiare në agjencitë qeveritare, është e nevojshme të kryhet një studim për të shqyrtuar opsionet e financimit për rrezikun nga fatkeqësitë dhe të propozohen rekomandime të mundshme. Është e rëndësishme të sigurohet që të ketë fonde të alokuara për aktivitetet e menaxhimit të rrezikut nga katastrofat në kuadër të Planit të Menaxhimit të Riskut (PMR).

Operative

Është e domosdoshme që të gjitha pronat me vlera të jashtëzakonshme trashëgimie kulturore të vlerësohen për rrezikun nga tërmeti. Duhet të hartohen dhe zbatohen aktivitete specifike, të përshtatura për nevojat specifike të çdo prone, për zbutjen e rrezikut nga tërmeti në çdo pronë me vlerë të trashëgimisë në Parkun Arkeologjik të Bylisit. Organizimi i seminareve për vendimmarrësit, duke përfshirë ekspertë, politikëbërës, përfaqësues të ministrive të ndryshme dhe organizatave joqeveritare, është jetik për të rritur ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në përgjithësi dhe për të vlerësuar menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Gjithashtu, duhet të organizohen stërvitje gjashtëmujore në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha agjencitë përkatëse për skenarë të ndryshëm reagues, si ngjarje sizmike gjatë mbledhjeve masive, zjarr në një nga pronat e trashëgimisë kulturore, apo përmbytje në një nga gërmimet arkeologjike.

Zhvillimi i një plani të detajuar të evakuimit për tubime masive është gjithashtu esencial. Ky plan kërkon veprime të koordinuara midis organeve të ndryshme, si policia, zjarrfikësit, ambulanca, si dhe autoritetet kombëtare dhe lokale, përfshirë ministritë relevante. Planin e evakuimit duhet të përfshijë mjetet e transportit,

kapacitetet ekzistuese dhe ato që mungojnë të organeve përkatëse, linjat e përbashkëta të komunikimit, mekanizmin e koordinimit dhe rendin e komandës.

Implementimi i një fushate të gjerë të ndërgjegjësimit të publikut është thelbësor për të siguruar vlerësimin dhe mbështetjen e kulturës së sigurisë dhe mbrojtjes në mesin e popullatës lokale. Organizimi i ngjarjeve dhe programeve sensibilizuese për shkollat, si dhe zhvillimi i iniciativave për sigurinë dhe mbrojtjen, do të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgatitjes.

Hartimi i një Plani të Menaxhimit të Riskut duhet të zhvillohet për Bylis dhe zonat përreth arkeologjike. Ky plan do të ndihmojë Parkun Arkeologjik të Bylisit, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Bashkinë për të përgatitur dhe zbutur rreziqet natyrore dhe artificiale.

7.4.2 MBROJTJA DHE MASAT NGA FATKEQESITË NATYRORE

Propozime dhe Rekomandime për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore. Në përputhje me politikat udhëzuese, propozohen rekomandimet e mëposhtme për menaxhimin e fatkeqësive natyrore:

- Ndalojini degradimit dhe përkeqësimit të mëtejshëm të ekosistemeve dhe habitateve nga veprimtaritë e parregulluara dhe të pakontrolluara të njeriut brenda dhe rreth Parkut Kombëtar.
- Garantoni konservimin e habitateve dhe specieve, nëse ka, brenda Parkut Kombëtar me interes të veçantë, nga pikëpamja e konservimit.
- Zbatoni një projekt për rehabilitimin, mbjelljen e pyjeve dhe shkurreve mesdhetare në park.
- Përmirësoni prezantimin e aseteve natyrore dhe kulturore të parkut për kënaqësinë e vizitorëve.
- Promovoni menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, nëse ka.
- Promovoni turizmin miqësor ndaj mjedisit, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës së ndjeshme për të nxitur angazhimin në veprimtari brenda parkut kombëtar që respektojnë asetet natyrore.
- Ndërgjegjësoni publikun dhe rrisni pjesëmarrjen e komunitetit.
- Arritja e këtyre qëllimeve dhe objektivave afatgjata është qëllimi kryesor i Planit të Veprimit. Megjithatë, ato ndikohen nga një sërë faktorësh të rrezikut artificial dhe natyror, të jashtëm ose të brendshëm.

Faktorët e Rrezikut Natyror:

- Bimësia natyrore
- Era, stuhitë dhe zjarri
- Sedimentet
- Erozioni
- Ndryshime klimatike

Faktorët e Rrezikut Artificial:

- Ndotja
- Erozioni lokal i shkaktuar nga veprimtaritë e njeriut
- Ndërhyrjet e njeriut
- Zhvillimi i infrastrukturës
- Menaxhimi i këtyre faktorëve të rrezikut do të jetë fokusi i Planit të Menaxhimit të Riskut.

7.4.3 MBROJTJA E PASURISË KULTURORE NGA FATKEQËSI TË TJERA

Impianti për shuarjen e zjarrit dhe kontrolli periodik në periudhën e Verës/Vjeshtës, kur temperaturat janë të larta, është një propozim i domosdoshëm për mbrojtjen e pasurisë në Parkun Arkeologjik të Bylisit (PAB). Propozohet që pastrimi i plehrave dhe mirëmbajtja e shtigjeve të bëhet në mënyrë periodike, sepse këto mund të krijojnë akses për fatkeqësi ambientale.

Rregullimi i aksesit për publikun në veprimtaritë turistike me bazë natyrën ose edukimin është thelbësor për mbrojtjen e pasurisë. Mbrojtja e pasurisë nga veprimtaritë që bien në kundërshtim me qëllimet e zonës dhe krijojnë fatkeqësi të tjera në PAB përfshin:

- Ndalimin e aksesit të paautorizuar nga çdo lloj mjete, si makina, karroca, betoniere, etj., brenda në PAB.
- Ndërtimin dhe përdorimin e godinave industriale dhe banesave.
- Përdorimin e kimikateve (plehra kimike, biocide, etj.), ose shfrytëzimin e gurorëve dhe minierave.
- Përdorimin e agregateve dhe futjen e specieve të huaja nga njeriu.
- Për veprimtari që as nuk lejohen, as nuk ndalohen shprehimisht, duhet të kërkohet leje nga autoriteti përkatës.

Këto përfshijnë:

- Kullotjen e bagëtive sezonale dhe të kontrolluar, me leje nga një ose më shumë organe.
- Ndërhyrje të lehta në lidhje me menaxhimin e fluksit të vizitorëve dhe infrastrukturës.
- Aktivitete me ndikim të ulët për qëllime edukative, ekologjike ose kulturore.
- Vendosjen e zonave të posaçme për piknik, vendparkim, kamping dhe fusha të vogla joformale për sport, si dhe godina për shërbime turistike.
- Kamping gjatë natës në zona të caktuara sipas rregullave të parashikuara.
- Aksesin e pakufizuar për ecje, vrotim zogjsh dhe veprimtari të tjera argëtuese.
- Aksesin për qëllime kërkimi, edukimi dhe trajnimi.

- Gjuetinë, shkatërrimin ose shqetësimin e florës dhe faunës indigjene të egër ilegale.
- Veprimtaritë pyjore pa miratimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).
- Zhvillimin e agroturizmit dhe turizmit në natyrë.
- Aksesin e rregulluar për shëtitje, ecje, çiklizëm, kalërim dhe vrojtim zogjsh.
- Mbledhjen e produkteve pyjore jodrusore (kërpudha, mjalti).

Për veprimtari që as nuk lejohen, as nuk ndalohen shprehimisht, duhet të kërkohet leje nga autoriteti përkatës. Këto përfshijnë ndërtimin dhe rikonstruksionin e banesave për banorët vendas, ndërtesat e fermave, kufizimet e fushave, përfshirë gardhet, muret dhe rrethimet.

Struktura e një Plani të detajuar të Menaxhimit të Riskut për Parkun Arkeologjik Bylis dhe rrënojat arkeologjike të Klosit.

1. Hyrje dhe Përmbledhje

- Qëllimi i Planit: Përshkrimi i qëllimit të Planit të Menaxhimit të Rrezikut (PMR) për Parkun Arkeologjik të Bylisit dhe Klosit.
- Fusha e Veprimit: Përcaktimi i kufijve të planit, duke përfshirë të gjitha zonat e parkut dhe llojet e rreziqeve të konsideruara.
- Objektivat: Detajimi i qëllimeve kryesore, si mbrojtja e trashëgimisë kulturore, sigurimi i sigurisë së vizitorëve, dhe ruajtja e mjedisit natyror.

2. Identifikimi i Rreziqeve

- Fatkeqësitë Natyrore: Identifikimi i rreziqeve si tërmetet, përmytjet, zjarret në pyje, etj.
- Rreziqet e Shkaktuara nga Njeriu: Vandalizmi, vjedhja, gërmimet pa autorizim dhe ndotja.
- Rreziqet Mjedisore: Erozioni, ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe humbja e biodiversitetit.
- Rreziqet Operacionale: Dështimet në mirëmbajtje, masat e pamjaftueshme të sigurisë, etj.

3. Analiza dhe Vlerësimi i Rreziqeve

- Vlerësimi i Gjasave: Vlerësimi i probabilitetit të çdo rreziku të identifikuar.
- Vlerësimi i Ndikimit: Vlerësimi i ndikimit potencial në aspektet kulturore, historike dhe mjedisore të parkut.
- Analiza e Cenueshmërisë: Përcaktimi i cenueshmërisë së zonave të ndryshme të parkut dhe artefakteve ndaj këtyre rreziqeve.

4. Strategjitë e Zbutjes së Rreziqeve

- Masat Parandaluese: Detajimi i strategjive për parandalimin e rreziqeve, si protokollet e rrepta të sigurisë, sistemet kundër zjarrit dhe qasja e kontrolluar në zonat e ndjeshme.
- Planet e Përgatitjes: Zhvillimi i planeve të reagimit emergjent për fatkeqësitë natyrore, duke përfshirë rrugët e evakuimit dhe stërvitjet e sigurisë.
- Përpjekjet e Konservimit: Përmbledhja e masave të konservimit për artefakte dhe zonat natyrore.
- Qëndrueshmëria e Infrastrukturës: Forcimi i infrastrukturës për të rezistuar ndaj rreziqeve.

5. Plani i Zbatimit

- Veprimet: Lista e veprimeve të caktuara që do të ndërmerren për zbatimin e strategjive të zbutjes së rreziqeve.
- Përgjegjësitë: Caktimi i përgjegjësive për stafin e parkut, shërbimet emergjente dhe palët e tjera të interesuara.
- Afati Kohor: Ofrimi i një afati kohor për zbatimin e çdo veprimi.

6. Programet e Trajnimit dhe Ndarjes së Ndërgjegjësimit

- Trajnimi i Stafit: Programe të rregullta trajnimi për stafin e parkut mbi menaxhimin e rrezikut dhe reagimin emergjent.
- Ndarja e Ndërgjegjësimit të Vizitorëve: Fushata informuese për të edukuar vizitorët rreth rreziqeve dhe protokolleve të sigurisë.

7. Monitorimi dhe Rishikimi

- Vlerësimet e Rregullta: Planifikimi i rishikimeve periodike të rreziqeve dhe efektivitetit të strategjive të zbutjes.
- Adaptimi dhe Përmirësimi: Azhurnimi i vazhdueshëm i planit bazuar në informacione të reja, ndryshimet e kushteve dhe analizat pas ngjarjeve.

8. Buxheti dhe Burimet

- Planifikimi Financiar: Alokimi i buxhetit për aktivitetet e menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë trajnimin, përmirësimet e infrastrukturës dhe furnizimet emergjente.
- Alokimi i Burimeve: Identifikimi i burimeve të nevojshme, si personeli, pajisjet dhe teknologjia.

9. Bashkëpunimi dhe Partneriteti

- Angazhimi me Autoritetet Lokale: Punë në bashkëpunim me organet e qeverisjes lokale, shërbimet emergjente dhe autoritetet e trashëgimisë kulturore.
- Përfshirja e Komunitetit: Angazhimi i komuniteteve lokale në përpjekjet e konservimit dhe programet e ndërgjegjësimit.

10. Shtojcat

- Dokumentet Mbështetëse: Përfshirja e hartave të parkut, listave të aseteve kritike, informacionit të kontaktit për shërbimet emergjente, etj.
- Referencat: Dokumentimi i burimeve të informacionit dhe udhëzimeve të përdorura në plan.

8. PLANI I VEPRIMIT

MASAT DHE VEPRIMET AFATSHKURTËR, AFATMESME DHE AFATGJATË QË DUHEN PËR TË REALIZUAR OBJEKTIVAT

Plani i Veprimit si një element jetik i planit të menaxhimit të pasurive kulturore të Bylisit dhe Klosit karakterizohet nga një qasje e detajuar dhe e strukturuar që synon përdorimin efikas të këtyre pasurive, duke garantuar ruajtjen dhe promovimin e tyre për të ardhmen. Ky plan fillon me veprime afatshkurtra 2024-2026, që zbatohen menjëherë për të adresuar çështjet më urgjente, si mbrojtja dhe menaxhimi i pasurisë kulturore (me miratimin e këtij plani menaxhimi), mirëmbajtja e menjëhershme, dhe restaurimi dhe konservimi i strukturave arkeologjike. Ndërkohë, veprimet afatmesme 2027-2029, që shtrihen nga një deri në pesë vjet, përqendrohen në përmbylljen e gjithë aktiviteteve dhe zhvillimin e strategjive të qëndrueshme për miradministrim e sitëve (këto të financuara nga projekti i *BE për Zhvillimin Ekonomik drejtuar nga turizmi, zhvillimi ekonomik dhe vendor me fokus mbi Trashëgiminë Kulturore*). Po në këto dy terma afatshkurtër dhe afatmesëm është e rëndësishme zhvillimi i komunitetit lokal dhe stafeve që punojnë ose janë të angazhuara në Bylis dhe Klos.

Pjesa më e rëndësishme e planit përfshin veprimet afatgjata që shkojnë përtej 2030, të cilat janë vazhdimi i aktiviteteve me bazë komunitare nga vetë strukturat administrative të parkut duke rritur më tej ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e pasurisë kulturore dhe iniciativa të reja turistike që vazhdojnë edhe pas përfundimit të afatit të zbatimit të këtij plani menaxhimi.

Gjithmonë në fokus të këtij plani është procesi i monitorimit dhe vlerësimit, që siguron që veprimet të jenë efektive dhe në përputhje me objektivat e planit. Ky proces ndihmon në identifikimin e nevojave për ndërhyrje shtesë ose korrigjime.

Një pjesë e rëndësishme është alokimi i burimeve të nevojshme, si ato financiare ashtu edhe njerëzore, për të mbështetur zbatimin e planit, të cilat janë parashikuar për çdo aktivitet. Planin e Veprimit e bën të vlefshëm angazhimi i palëve të interesuara, si komuniteti lokal, ekspertët në fushën e kulturës, autoritetet qeveritare dhe organizatat joqeveritare. Bashkëpunimi i tyre është thelbësor për suksesin dhe zbatimin e tij.

PLANI I VEPRIMIT, AFATET KOHORE							
Viti	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030+
OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	Temat - Afatshkurtër			Afatmesëm			Afatgjatë
RESTAURIMI / KONSERVIMI / MBROJTJA							
Miratimi i Planit të Menaxhimit Bylis-Klos							
Masterplani							
Ruajtja/restaurimi i strukturave arkeologjike							
Konservimi i mozaikëve dhe masat ruajtëse							
Ndërtimi i nje qendre multifunkionale							
Hulumtime dhe gërmime arkeologjike							
MODELI I ADMINISTRIMIT							
Modeli efektiv për menaxhimin e PAB dhe Klos							
Strategjitë dhe udhëzimet për menaxhimin e PAB-Klos (kuadri ligjor)							
Siguria e shtit me roje fizike							
ZHVILLIMI I QENDRUESHËM EKONOMIK							
Ngritja e kapaciteteve							
Aktivitetet e zhvillimit lokal							
Ngritja dhe operimi i Grupeve të Veprimit Lokal							
Komunikimi dhe vizibiliteti							
Grantet për komunitetin							

Shënim:

-Investimet e parashikuara, për vitet 2024-2029, në parkun arkeologjik të Bylisit janë të lidhura kryesisht me fondet e siguruar nga Programi IPA 2018 "BE për Zhvillimin Ekonomik - Drejtuar nga Turizmi, Zhvillimi Ekonomik Vendor, me Fokus mbi Trashëgiminë Kulturorë", financuar nga Bashkimi Evropian, dhe zbatuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim për Zhvillim, si dhe fonde nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. -Kursi i këmbimit valutor është 1 Euro m = 100 ALL

PLANI VEPRIMIT AFATSHKURTËR 2024-2026					
VEPRIMI	Institucioni Përgjegjës	Autoriteti miratues/ Mbikqyrës	Afati kohor	Kohëzgjatja	Buxheti/Partnerët
RESTAURIMI / KONSERVIMI / MBROJTJA					
Përgatitja dhe aprovimi Plan të Menaxhimit Bylis-Klos	MEKI/IKTK/AICS	KKTKM/Këshillimi i Ministrave/IKTK	2024	6-mujori i parë 2024	60,000 Euro (6,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet
Përgatitja dhe miratimi i Masterplanit	MEKI/IKTK/AICS	KKTKM/AZHT-KKT	2024-2025	2 vjet	50,000 Euro (5,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet
Ruajtja dhe restaurimi i strukturave arkeologjike Mozaikët/murri rrethues/agora stoa/stadium etj. Përgatitja e projektit, miratimi dhe zbatimi i projektit të ndërhyrjeve konservuese dhe restaurues, përfshij edhe sondazhet arkeologjike në kuadër të konservimit	MEKI/IKTK/AICS/IA	KKTKM/MEKI/IKTK	2024-2025	3 vjet (vazhdon deri në-2026)	1,300,000 Euro (130,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet
Punimet civile (Qendra multifunkionale)	MEKI/IKTK/AICS/IA/OSHE E	KKTKM/MEKI/IKTK	2025-2026	3 vjet (vazhdon deri në-2026)	1,400,000 Euro (140,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet 100,000 Euro (10,000,000 ALL) (kosto utilitete + shpronësim nëse ka, MEKI)
Mobilimi, instrumentet e laboratorit, pajisjet e trashëgimisë digjitale	MEKI/IKTK/AICS/IA	KKTKM/MEKI/IKTK	2025-2026	3 vjet (vazhdon deri në-2026)	200,000 Euro (20,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet
Heqja e rrethimeve pa leje në Klos	MEKI/IKTK	MEKI/IKTK	2024-2025	2 vjet	Pjesë e planit të punës së personelit të IKTK-së dhe DRKK Vlorë

MODELI I ADMINISTRIMIT					
Modeli efektiv për menaxhimin e PAB dhe Klos Propozimi dhe përmirësimi i modelit të administrimit direkt	MEKI/IKTK/AICS/IA	MEKI	2025-2026	3 vjet (vazhdon deri në-2026)	50,000 Euro (5,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet
Strategjitë dhe udhëzimeve për menaxhimin e PAB-Klos Përgatitja e planeve përkatese të mirëadministrimit	MEKI/IKTK/AICS	MEKI/IA/Bashkia Mallkastër	2025-2026	3 vjet (vazhdon deri në-2026)	100,000 Euro (10,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet
Siguria e sitit me roje fizike	MEKI	MEKI	2025-2026	Në vazhdimësi	30,000 Euro çdo vit (3,000,000 ALL)
ZHVILLIMI I QENDRUESHËM EKONOMIK					
Ngritja e kapaciteteve -Themelimi dhe fillimi i operimit të Grupit të Veprimit Lokal. -Trajnimet përkatese për personelin dhe komunitetin -Shkollja kantier (trajnime në konservime dhe praktikat arkeologjike, menaxhim të pasurive kulturore)	MEKI/IKTK/AICS	MEKI/IKTK/IA/Bashkia Mallkastër	2025-2026	3 vjet (vazhdon deri në-2026)	700,000 Euro (70,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet
Aktivitetet e zhvillimit lokal, marketim i territorit, angazhimi i Komunitetit Plani Paraparak i Angazhimit të Komunitetit	MEKI/IKTK/AICS/Bashkia Mallkastër	MEKI/IA/Bashkia Mallkastër	2025-2026	3 vjet (vazhdon deri në-2026)	249,000 Euro (24,900,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet
Komunikimi dhe vizibilitetit	MEKI/IKTK/AICS Bashkia Mallkastër	MEKI/IA Bashkia Mallkastër	2025-2026	3 vjet (vazhdon deri në-2026)	340,000 Euro (34,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet
Grante për komunitetin	AICS/MEKI Bashkia Mallkastër	AICS/MEKI Bashkia Mallkastër	2025-2026	3 vjet (vazhdon deri në-2026)	210,000 Euro (21,000,000 ALL) AICS zyrat e Tiranës. I parashikuar në buxhet

PLANI VEPRIMIT AFATMESËM 2027-2029					
VEPRIMI	Institucioni Përgjegjës	Autoriteti miratues/ Mblidhës	Afati kohor	Kohëzgjatja	Buxheti/Partnerët
RESTAURIMI / KONSERVIMI / MBROJTJA					
Monitorimi i restaurimit të strukturave arkeologjike Mozaiket abcd/agora stoa/stadium etj.	Stafi lokal i PAB	IKTK	2027-2029	3 vjet	Pjesë e planit të punës së personelit të PAB
Punimet civile	MEKI/IKTK/AICS/IA	KKTKM/MEKI/IKTK	2027	1 vit	Vazhdimi i punimeve të mbetura. Mbuluar nga buxheti fillestar i projektit përmes AICS zyrat e Tiranës.
Mobilimi, instrumentet e laboratorit, pajisjet e trashëgimisë digjitale	MEKI/IKTK/AICS/IA	KKTKM/MEKI/IKTK	2027	1 vit	Vazhdimi i punimeve të mbetura. Mbuluar nga buxheti fillestar i projektit përmes AICS zyrat e Tiranës.
Infrastruktura për aksesin multimediale	MEKI/IKTK/AICS/IA	KKTKM/MEKI/IKTK	2027	1 vit	Vazhdimi i punimeve të mbetura. Mbuluar nga buxheti fillestar i projektit përmes AICS zyrat e Tiranës.
Muzeu multimedial	MEKI/IKTK/AICS/IA	KKTKM/MEKI/IKTK	2027	1 vit	Vazhdimi i punimeve të mbetura. Mbuluar nga buxheti fillestar i projektit përmes AICS zyrat e Tiranës.
Gërmimet arkeologjike Zona jashtë murit të Viktorinit si dhe gërmime të tjera në vazhdim	IA	KKTKM/MEKI/IKTK	2027-2029	Në vazhdim	15,000 Euro për tre vjet (1,500,000 ALL)

MODELI I ADMINISTRIMIT					
Monitorimi i ndryshimeve në përmirësimin e administrimit	MEKI/IKTK	MEKI	2027-2029	3 vjet	Pjesë e monitorimit vjetor nga institucionet e varësish.
Siguria e sitit me roje fizike	MEKI	MEKI	2027-2029	Në vazhdimësi 2029+	30,000 Euro çdo vit (3,000,000 ALL)
ZHVILLIMI I QENDRUESHËM EKONOMIK					
Ngritja e kapaciteteve	MEKI/IKTK/AICS/Stafi lokal i Parkut	MEKI/IA/Bashkia Mallkastër	2027-2029	3 vjet	Vazhdimi i aktiviteteve të parashikuar nga buxheti fillestar i projektit përmes AICS zyrat e Tiranës.
Aktivitetet e zhvillimit lokal, marketim i territorit, angazhimi i Komunitetit Vazhdimi deri në 2026 i aktiviteteve të financuara nga AICS	MEKI/IKTK/AICS/Bashkia Mallkastër/Stafi lokal i Parkut	MEKI/IA/Bashkia Mallkastër	2027-2029	3 vjet	Vazhdimi i aktiviteteve të parashikuar nga buxheti fillestar i projektit përmes AICS zyrat e Tiranës. 50,000 Euro (5,000,000 ALL) për dy vjet - PAB
Komunikimi dhe vizibilitetit Vazhdimi deri në 2026 i aktiviteteve të financuara nga AICS	MEKI/IKTK/AICS Bashkia Mallkastër/Stafi lokal i Parkut	MEKI/IA Bashkia Mallkastër	2027-2029	3 vjet	Vazhdimi i aktiviteteve të parashikuar nga buxheti fillestar i projektit përmes AICS zyrat e Tiranës. 20,000 Euro (2,000,000 ALL) për dy vjet - PAB

PLANI VEPRIMIT AFATGJATË 2030+					
VEPRIMI	Institucioni Përgjegjës	Autoriteti miratues/ Mbiqkyrës	Afati kohor	Kohëzgjatja	Buxheti/Partnerët
RESTAURIMI / KONSERVIMI / MBROJTJA					
Monitorimi i restaurimit të strukturave arkeologjike Mozaikët abcd/agora stoa/stadium etj.	Stafi lokal i Parkut	N/A	2030+	2 vjet	Pjesë e planit të punës së personelit të PAB
Gërmimet arkeologjike Zona jashtë murit të Viktorinik si dhe gërmime të tjera në vazhdim	IA	KKTKM/MEKI/IKTK	2030+	Në vazhdim	5,000 Euro (500,000 ALL) çdo vit
MODELI I ADMINISTRIMIT					
Monitorimi i ndryshimeve në përmirësimin e administrimit	MEKI/IKTK/Stafi lokal i Parkut	MEKI	2030+	2 vjet	Pjesë e monitorimit vjetor nga institucionet e varësisë.
Siguria e sitit me roje fizike	MEKI	MEKI	2030+	Në vazhdim	30,000 Euro çdo vit (3,000,000 ALL)
Përgatitja e dosjes për nominimin e parkut në UNESCO	MEKI/UNESCO	MEKI/UNESCO	2030+	2 vjet	Pjesë e planit të punës së personelit të MEKI
ZHVILLIMI I QENDRUESHËM EKONOMIK					
Aktivitetet e zhvillimit lokal, marketim i territorit, angazhimi i Komunitetit Kryerja e aktiviteteve për komunitetin	MEKI/IKTK Bashkia Mallkastër/Stafi lokal i Parkut	MEKI/IA/Bashkia Mallkastër	2030+	2 vjet	Vazhdimi i aktiviteteve të parashiluara nga buxheti fillestar i projektit përmes AICS zyrat e Tiranës. 50,000 Euro për dy vjet. (5,000,000 ALL)
Komunikimi dhe vizibiliteti Vazhdimi i promovimit	MEKI/IKTK Bashkia Mallkastër/Stafi lokal i Parkut	MEKI/IA Bashkia Mallkastër	2030+	2 vjet	Vazhdimi i aktiviteteve të parashiluara nga buxheti fillestar i projektit përmes AICS zyrat e Tiranës. 20,000 Euro për dy vjet. (2,000,000 ALL)

9. ZBATIMI DHE MONITORIMI

MASAT DHE INDIKATORËT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT TË MENAXHIMIT

9.1 KOORDINIMI DHE MENAXHIMI NDËRINSTITUCIONAL

Një plan menaxhimi nuk duhet të jetë një dokument statik, por një mjet dinamik për trajtimin e çështjeve të identifikuara më parë, vendosjen e vizionit, objektivave dhe caktimin e përgjegjësive. Megjithatë, është jashtëzakonisht e vështirë të planifikohet për një periudhë pesë-gjashtë vjeçare dhe të ndiqet një vizion frymëzues. Sfidat në këtë kontekst janë të mëdha dhe variojnë nga vendimarrja në politikbërje deri te faktorët e jashtëm dhe të brendshëm, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Prandaj, plani menaxhues duhet të jetë në zhvillim të vazhdueshëm dhe të përshtatet me ndryshimet. Ky fakt e bën thelbësore zbatimin dhe monitorimin, jo vetëm për të siguruar që plani është në rrugën e duhur drejt objektivave të shpallura, por edhe duke u përshtatur me ndryshimet e rrethanave. Në këto seksione përfshihen matje dhe tregues për zbatimin e planit të menaxhimit, në mënyrë që të arrihen objektivat e caktuara. Miratimi, koordinimi dhe menaxhimi i planit do të përfshijnë formimin e një komiteti koordinues për të garantuar arritjen e strategjisë së planit përmes zbatimit të të gjitha aktiviteteve kryesore dhe të vogla. **Përgjegjësia për koordinimin e këtij komiteti do të jetë nën drejtimin e Ministrisë së Kulturës.** Në strukturën e menaxhimit, të gjithë aktorët kryesorë të përfshirë në zhvillimin e projekteve të ndryshme do të jenë të përfaqësuar, **duke përfshirë menaxhimin lokal të Parkut Bylis dhe Klos, Bashkia Mallakastër dhe AICS** (për periudhën e zbatimit të projektit). Përveç subjekteve që duhet të jenë të përfshira vazhdimisht për të garantuar bashkërendimin e aktiviteteve, optimizimin e burimeve dhe respektimin e afatit të zbatimit, është e rëndësishme të përfshihen edhe institucione shtesë kulturore nga Fieri, Vlora, si dhe agjenci të tjera shtetërore në nivel qendror si AKZM etj..

9.2 STRATEGJIA E ZBATIMIT

Manuali i UNESCO-s për Menaxhimin e Trashëgimisë Botërore (2013) përcakton tri elementet kyçe të një sistemi efektiv dhe të qëndrueshëm të menaxhimit: kuadri ligjor, korniza institucionale dhe burimet, përfshirë burimet njerëzore, financiare dhe intelektuale për të ndërtuar kapacitet operacional dhe për të lehtësuar proceset. Plani i Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos për periudhën 2024-2029 synon të kontribuojë në realizimin e vizionit për të bërë këtë park një destinacion të

rëndësishëm për Shqipërinë dhe rajonin e Mesdheut, duke u përqendruar në zhvillimin e sektorëve të trashëgimisë kulturore dhe turizmit. Ky plan operon nëpërmjet tre kanaleve kryesore strategjike: përmirësimi i restaurimit dhe konservimit, prezantimi dhe valorizimi, si dhe rritja e mbrojtjes dhe kapacitetit. Plani i Menaxhimit Bylis-Klos, duke ndjekur këto tri qëllime strategjike, synon të arrijë objektivat e mëposhtme nëpërmjet veprimeve të shumta.

- Përmirësimi i Restaurimit ,Konservimit dhe paraqitjes– projekte zbatimi
- Rritja e mbrojtjes –kornizat legislative dhe veprimet ligjore për të përmirësuar mbrojtjen
- Përmirësimi dhe valorizimi i përdorimit– për të integruar vendet arkeologjike në jetën e banorëve, studentëve, fëmijëve ndërsa përgjegjësia e gjeneruar shndërrohet në konservim, prezantim dhe akses të qëndrueshëm.

Veprimet e PM-së, edhe pse të hartuara nëpërmjet tri kanaleve të ndryshme, për nga natyra e tyre dhe qasja e integruar që është përdorur në përgatitjen e planit, prekin të tre objektivat. Prandaj, ato duhet të zbatohen dhe të monitorohen me një metodologji të integruar, duke kërkuar strategji partneriteti dhe përfshirje aktive të të gjithë aktorëve institucionalë ose individualë të zonës dhe burimeve të synuara.

Ndërkohë, kompetenca kryesore për të implementuar dhe monitoruar Sitet e Trashëgimisë Kulturore i mbetet Ministrisë së Kulturës dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si pronarë kryesorë të burimeve. Partnerët strategjikë, nëse do të ketë rrisin efikasitetin operacional dhe mundësitë e mbledhjes së fondeve për qëndrueshmërinë financiare të burimeve të trashëgimisë.

Stafi i ekipit të menaxhimit të sitit do të përcaktohet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në përputhje me qëllimin dhe objektivat e PM-së, dhe do të rregullohet në kohë, në përputhje me kërkesat dhe sfidat e paraqitura gjatë periudhës së zbatimit.

Menaxhimi përfshin veprimet që lidhen me ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e Siteve Kulturore, si dhe valorizimin dhe përdorimin e tyre për zhvillimin e qytetit si një destinacion turistik.

Dy parime kryesore që ndikuan në përmbajtjen dhe metodologjinë e planit të menaxhimit të Bylisit dhe Klosit janë fleksibiliteti dhe përshtatshmëria për të ndryshuar gjatë procesit në përputhje me problemet e reja dhe kushtet e ndryshimit, dhe qasja gjithëpërfshirëse, e bazuar në komunikimin dhe ndërveprimin e vazhdueshëm me palët e interesit. Këto dy parime do të sigurojnë gjithashtu bazën e proceseve të Zbatimit dhe Monitorimit gjatë gjithë jetëgjatësisë së planit, në mënyrë

që të garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm për të mirën e komunitetit lokal dhe trashëgimisë unike kulturore të qytetit.

9.3 MONITORIMI DHE VLERËSIMI, MASAT DHE INDIKATORËT

Plani i Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos përbëhet nga një gamë e gjerë veprimesh në mënyrë që të arrihen objektivat kryesore specifike. Shtrirja, kohëzgjatja dhe kompleksiteti i këtyre veprimeve, si dhe burimet e kërkuara, paraqesin një larmi të gjerë. Për këtë arsye është veçanërisht i rëndësishëm, monitorimi i tyre i sinkronizuar nëpërmjet një përcaktimi të qartë të përgjegjësive, mjeteve dhe metodologjive.

VEPRIMTARI	QËLLIMI	FREKUENCA	REZULTATI
Gjurmimi i progresit të zbatimit	Të dhënat e progresit në krahasim me treguesit e rezultateve do të mblidhen dhe analizohen për të vlerësuar progresin e zbatimit të MP-së në arritjen e rezultateve të dakorduara.	Sipas frekuencës së kërkuar për çdo tregues	Progresi më i ngadaltë se sa pritej do të trajtohet nga menaxhimi i parkut
Monitorimi dhe Menaxhimi i Rrezikut	Identifiko rreziqet specifike që mund të kërcënojnë arritjen e rezultateve të synuara. Identifiko dhe monitoro veprimet e menaxhimit të rrezikut duke përdorur një regjistër rreziku. Kjo përfshin monitorimin e masave dhe planeve që mund të jenë kërkuar.	Vjetore	Rreziqet identifikohen nga menaxhimi i parkut, dhe merren masa për menaxhimin e rrezikut. Regjistri i rrezikut mirëmbahet aktivisht për të mbajtur gjurmë të rreziqeve të identifikuara dhe veprimeve të marra.
Nxënia/Edukimi	Njohuritë, praktikat e mira dhe mësimet do të kapen rregullisht, si dhe do të merren në mënyrë aktive nga projekte të	Ad-hoc, kur aktivitetet specifike të fokusuara në shkëmbimin e	Mësimet përkatëse evidentohen nga struktura e menaxhimit dhe përdoren për të

VEPRIMTARI	QËLLIMI	FREKUENCA	REZULTATI
	tjera/partnerë dhe do të integrohen përsëri në MP	njohurive përfundojnë	informuar vendimet e menaxhimit.
Sigurimi i Cilësisë Vjetore	Cilësia e zbatimit të planit do të vlerësohet në krahasim me standardet e cilësisë për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta dhe për të informuar vendimmarrjen e menaxhimit për të përmirësuar zbatimin e planit të menaxhimit	Vjetore	Pikat e forta dhe të dobëta do të rishikohen nga dhe do të përdoren për të informuar vendimet për të përmirësuar MP
Rishiko dhe Bëj Korrigjime të Kursit	Rishikimi i brendshëm i të dhënave dhe provave nga të gjitha veprimet e monitorimit për të informuar vendimmarrjen	Vjetore	Të dhënat e performancës, rreziqet, mësimet dhe cilësia do të diskutohen nga partnerët dhe do të përdoren për të bërë korrigjime të kursit
Vlerësimi Përfundimtar	Palët përkatëse dhe konsulentët e pavarur të jashtëm do të kryejnë një vlerësim përfundimtar për të vlerësuar rezultatet, progresin, sfidat, rreziqet, praktikat më të mira dhe mësimet e mësuara si dhe për të dhënë rekomandime për përmirësime të ardhshme në fushat brenda fushës së veprimit të MP	Në fund të periudhës së zbatimit të MP (5 vjet).	Pikat e forta dhe të dobëta do të rishikohen nga palët përkatëse, dhe do të përgatiten rekomandime për programimin e ardhshëm
Rishikimi i MP	Struktura e qeverisjes së MP dhe palët përkatëse do të mbajnë rishikime të rregullta të MP për të vlerësuar performancën e	Vjetor	Çdo shqetësim për cilësinë ose progres më të ngadaltë se sa pritej duhet të

VEPRIMTARI	QËLLIMI	FREKUENCA	REZULTATI
	dokumentit dhe për të rishikuar Planin e Punës që të sigurojnë buxhetim realist gjatë jetëgjatësisë së vetë MP		diskutohet nga palët përkatëse, dhe duhet të merren veprime menaxhimi të dakorduara për të trajtuar problemet e identifikuar

MASAT DHE INDIKATORËT



1) Indikatorët - për produkte-shërbime

Përbushja e Objektivave të PM me aktivitetet e mëposhtme:

- Harta e Komunitetit, që përfaqëson ndërthurjen e marrëdhënieve ndërmjet elementeve materiale dhe jomateriale të një vendi, duke nxjerrë në pah tiparet dalluese të identitetit me aktorët lokalë; Plani Paraprak do të përfshijë një planifikim të fazave të ndryshme të zbatimit të këtij aktiviteti, përkatësisht:
- hartëzimi i pasurive territoriale (private dhe publike) që lidhen me turizmin ose që do të përdoren për rritjen e atraktivitetit të turizmit dhe analiza e statusit të tyre;

- lehtësimi i procesit pjesëmarrës (ku përfshihet komuniteti i Mallakastrës) për identifikimin me pjesëmarrje të elementeve materiale dhe jomateriale të territorit të Mallakastrës dhe tipareve dalluese të identitetit të tij territorial.

Asistencë teknike për planifikimin dhe monitorimin me pjesëmarrje të produkteve të integruara të turizmit.

II) Indikatorët -Menaxhimi i produkteve-shërbimeve

- mbështetje ligjore dhe teknike për fazën e regjistrimit dhe fillimit (start-up) të shoqatës;
- takime të rregullta për përditësimin dhe përhapjen e ofertave të produkteve dhe shërbimeve turistike;
- mbështetje për organizimin e studimeve vjetore për matjen e prurjeve turistike dhe përpunimin e të dhënave;
- sigurimi i një modeli dhe mbështetje për shpërndarjen e një përmbledhjeje mësimore;
- lehtësimin e praktikave më të mira, dhe shkëmbimin e njohurive me palët e interesuara kombëtare dhe ndërkombetare.

III) Indikatorët -Zhvillimi i produkteve-shërbimeve

Konceptimi dhe zbatimi i edicioneve të para të një eventi kryesor të qëndrueshëm, që do të promovojë markën territoriale, dhe potencialisht do të krijojë një traditë tërheqëse me të cilën emri i Mallakastrës mund të vazhdojë të lidhet në të ardhmen. Ngjarja mund të jetë, për shembull, një festival muzikor ose teatri në zonën arkeologjike, ose një festival i ndërtuar mbi një traditë lokale, që do të organizohet çdo vit dhe do të promovohet si i lidhur me markën Bylis/Mallakastra. Koncepti i eventit do t'u ofrohet autoriteteve vendore në formën e një plani të plotësisht të zhvilluar dhe të detajuar për organizimin dhe menaxhimin e eventit. Një vemendje e madhe do t'i kushtohet qëndrueshmërisë, përfshirjes dhe aksesueshmërisë së eventit.

- Integrimi i Bylisit dhe Mallakastrës në të paktën 1 produkt turistik kulturor (si p.sh. një tur në zonat arkeologjike shqiptare) dhe 1 produkt turistik bregdetar (si p.sh. një ofertë turistike detare), të menaxhuar nga operatorë turistikë rajonalë/kombëtarë. Kështu, ky aktivitet do të hedhë themelet e lidhjeve të Bylisit si me rrugën arkeologjike shqiptare që do të ndërtohet rreth vetë Bylisit, Apolonisë dhe Antigones, ashtu edhe me ofertën turistike bregdetare që ofron zona e Vlorës.
- Zhvillimi një strategjie qëndrueshmërie për të ardhmen e strategjisë territoriale të marketingut, për të siguruar që ndikimi social i PM të zgjasë dhe të rritet me kalimin e kohës. Për shembull, organizata të ndryshme, organizatat

që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mund të përfshihen në planifikimin e masave për aksesin e zonës së Bylisit, dhe më pas mund të vazhdojnë të menaxhojnë aktivitetet e destinuara posaçërisht për përdoruesit me aftësi të kufizuara (të tilla si një shërbim transporti i dedikuar nga Fieri ose Vlora ose turne të aksesueshme); ose organizata mjedisore mund të angazhohen në menaxhimin dhe rikuperimin e mbetjeve në parkun e Bylisit ose në burimet natyrore përreth zonës.

IV) Indikatorët - Strategjia e Marketingut Territorial

- Një strategji e markës territoriale, e bazuar në aspektet unike të rajonit (prania e parkut të Bylisit, burimet lokale, kulturore dhe natyrore) dhe mbi konceptin e një "territori të pazbuluar". Strategjia e markës do të identifikojë një mënyrë gjithëpërfshirëse për promovimin e të gjithë territorit si produkt turistik, duke përfshirë të gjitha burimet kulturore dhe natyrore të rajonit, duke përfshirë produktet ushqimore, artizanale dhe traditat kulturore jomateriale; do të përcaktojë me saktësi elementet që duhen theksuar në perpjekjet promovuese/komunikimi dhe do të zhvillojë një tregim koherent për rrefimin e territorit. Strategjia e markës jo vetëm do të përbejë themelin për krijimin e markës (logo/slogan) dhe do të sigurojë përmbajtjen thelbësore për të gjithë materialin e komunikimit që do të hartohet dhe prodhohet më vonë, por gjithashtu do të krijojë një mënyrë koherente, tërheqëse dhe të dallueshme të prezantimit të territorit, që do të përdoret në vitet në vijim.
- Një analizë e tregut, e bazuar në vlerësimin e llojeve të pranisë turistike në rajonet kufitare (veçanërisht në zonën e Vlorës) dhe në rajone me karakteristika të ngjashme (zonat e sitëve të Apolonisë dhe Antigonës). Analiza e tregut do të sugjerojë skenarë të mundshëm për turizmin vendas, duke identifikuar tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare për të fokusuar, por dhe mundësitë për t'iu afruar atyre në objektiva afatmesëm dhe afatgjatë (pjesëmarrje në panairë turistike, përpjekje të përshtatura komunikimi për grupe të veçanta përdoruesish...); do të identifikojë gjithashtu nevojat dhe mundësitë për krijimin e agjencive të reja turistike dhe organeve publike në nivel vendor dhe për zhvillimin e sipërmarrjeve të reja të mikpritjes apo turizmit.
- Një trajnim për administratorët lokale mbi strategjinë e marketingut territorial, menaxhimin e shërbimeve publike të lidhura me turizmin dhe menaxhimin e ngjarjeve të lidhura me turizmin. Strategjia do të bazohet në potencialin turistik të rajonit të Mallakastres për nxitjen e rritjes së zinxhreve të ndryshëm të vlerave të lidhura me turizmin, duke nxitur kështu një zhvillim vendor

gjithëpërfshirës, me ndikime pozitive në punësimin dhe kohezionin social. Strategjia e marketingut territorial do të ndërtohet mbi rezultatet e Planit Paraprak për zhvillimin ekonomik vendor dhe do të fokusohet në promovimin strategjik të territorit dhe krijimin dhe forcimin e sinergjive publiko-private.

Plani vjetor për aktivitetet rekreative

Mbi bazën e identifikimit të grupeve të mundshme të përdoruesve të zonës së Bylisit, do të zhvillohet një plan aktivitetesh rekreative për rritjen e përdorimit të parkut arkeologjik të Bylisit përmes identifikimit dhe zbatimit të veprimeve të mundshme specifike (si hapët e natës, ngjarjet kulturore ose vizitat e synuara për shkollat) dhe hartimi i propozimeve për turne në parkun arkeologjik, të synuara për grupe të ndryshme përdoruesish (p.sh. fëmijë, shkolla, turistë të interesuar për arkeologjinë, turistë të interesuar për historinë/kulturën tradicionale). Një analizë e qëndrueshmërisë ekonomike të veprimeve të propozuara për përmirësimin e rezultateve do të përfshihet në plan, si dhe identifikimi i mjeteve të nevojshme për të propozuar/promovuar turnetë e synuara nga përdoruesit (p.sh., harta e targetuar e vendit, sinjalistika, turnetë me udhëzues).

Lista e aktiviteteve rekreative në terren është si vijon:

- Dita e Verës (Dita e Verës) më 14 Mars;
- Sulltan Novruzi (festë fetare bektashiane);
- Manifestimi i shoqatës "Mallakastra";
- Ditët e Ullirit;
- Ditët e Vjosës;
- Javë e Trashëgimisë Kulturore;
- Veprimtaria e kostumeve arbëreshe;
- Festat arbëreshe;
- Koncerte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Ditët e mbledhjes së fondeve

10. SHTOJCAT

KËRKIMET ARKEOLOGJIKË DHE HISTORIA SITIT, PLANI I KONSERVIMIT, AKTE LIGJORE DHE NËNLIGJORE, PLANI I BIZNESIT, SKEDA, HARTA, MATERIALE GRAFIKE

SHTOJCA 1 - KËRKIMET ARKEOLOGJIKE DHE HISTORIA E BYLINËVE

Me pozicionin e tij zotërues mbi luginën e Vjosës, si dhe me madhështinë e rrënojave që ruheshin ende mbi sipërfaqen e tokës, Bylisi ra në sy të udhëtarëve të huaj që vizituan Pashallëkun e Ali Pashë Tepelenës në fillim të shek. XIX. Në librin e tij "Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia" (Udhëtime në ishujt Jonianë, Shqipëri, Thesali, Maqedoni), botuar në Londër më 1815, mjeku anglez H. Holland përshkroi muret rrethuese të qytetit, duke dalluar dy periudha të ndryshme ndërtimi. Ai pa edhe gjurmë të ndërtimeve publike të zbukuruara dikur me kolona, por zbulimi më i rëndësishëm ishte një mbishkrim latin i skalitur në shkëmbinjtë e anës jugore, nga leximi i të cilit ai shprehu mendimin se rrënojat i takonin qytetit antik Bylis. Në të njëjtën kohë rrënojat e Bylisit u vizituan nga konsullit francez pranë Ali Pashës në Janinë, F.Pukëvil, i cili në librin "Voyage dans la Grèce" (Udhëtim në Greqi), Paris, 1820 përveç murit rrethues dhe mbishkrimit shkmbor lati vuri re edhe teatrin e qytetit.

Arkeologu i parë që botoi të dhënat shkencore mbi Bylisin ishte austriaku K.Patsch në librin "Sandschak Berat in Albanien" (Sanxhaku i Beratit në Shqipëri), Vjenë, 1904, përveç monumenteve të vëzhguara nga parardhësit e tij, botoi një sërë mbishkrimesh e skulpturash, si dhe një katalog të monedhave byline. Gjatë Luftës I Botërore, në dimrin e viteve 1917-1918, zhvilloi gërmimet e para arkeologjike në Bylis austriaku C. Praschniker, që zbuloi pjesë të murit rrethues, një pjesë nga stoa e madhe si dhe një kënd të teatrit. Në librin tij "Muzakhia und Malakastra" ai botoi edhe disa mbishkrime e skulptura të panjohura më parë.

Në verën e vitit 1978, nga Qendra e Kërkimeve Arkeologjike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u organizua në Bylis një ekspeditë arkeologjike e drejtuar nga N.Ceka dhe S.Muçaj, me asistimin e një grupi restaurimi të Institutit të Monumenteve nën drejtimin e L.Papajanit.



FIGURA 92 - EKIPI I GËRMIMEVE TË TEATRIT TË BYLISIT NË VITIN 1978. NË QENDËR, ULUR MAJTAS: L. PAPAJANI, N. CEKA. MË KËMBË, I PARI DJATHTAS: S. MUCAJ.

Kërkimet për periudhën e antikitetit ilir u përqëndruar kryesisht në agoranë e qytetit, ku u zbuluan teatri (1978-1981), stadiumi (1981), stoa e madhe (1984-1986), stoa e teatrit (1985), hyrja e agorasë me ambientet publike pranë saj (1987), stera nën stadium (1987), gimnazi (1989), si dhe një pjesë e rrjetit urbanistik nëpërmjet zbulimit të banesës A (1979) në anën lindore, të asaj B (1990-1991) në anën perëndimore, si dhe të rrugëve kryesore të anës lindore. Ndërkohë u zbulua pjesa më e madhe e hyrjeve të murit antik ilir e atij bizantin, si dhe u gërmuan pjesë të nekropolit antik pranë këtyre hyrjeve. Një fushë tjetër të rëndësishme të kërkimeve në Bylis paraqiste qyteti bizantin, kryesisht nëpërmjet gërmimit të bazilikave paleokristiane. Në vitin 1980 u zbulua bazilika A, e ngritur mbi rrënojat e stoas së madhe. Zbulimi i bazilikës B, që kishte qenë edhe katedralja e qytetit nisi më 1984 dhe zgjati, me ndërprerje, deri më 2003. Më 1989 u zbulua bazilika C në pjesën veriperëndimore të agorasë, si dhe një banjë bizantine e ndërtuar pranë sterës së stadiumit në periudhën e sundimit të Justinianit.



FIGURA 93 - GËRMIMET ARKEOLOGJIKE NË BAZILIKËN A NË VITIN 1981

Një bazilikë e katërt, e emërtuar D, u zbulua jashtë rrethimit bizantin, në anën veriore të qytetit antik (1990). Në vitin 1991 filloi gërmimi edhe në bazilikën E, në jug të banesës A. Më 1999 nisi punën një ekspeditë shqiptare-franceze e drejtuar nga S. Muçaj, J.P. Sodini dhe P. Chevalier. Gërmimet u përqëndruan në zbulimin e plotë të bazilikës B, kompleksin peshkopal, si dhe në vlerësimin e monumenteve të periudhës bizantine. Në vitet 2014-2017 në Bylis punoi një ekspeditë shqiptare italiane e drejtuar nga L. Përzhita dhe R. Belli, që u përqëndrua kryesisht në dokumentimin e monumenteve të periudhës antike ilire të zbuluara nga gërmimet e mëparshme arkeologjike. Gërmimet arkeologjike rifilluan në vitet 2018-2021 nën drejtimin e L. Përzhitës dhe O. Cekës, me konsulencën e N. Cekës, duke u përqëndruar në zbulimin e cisternës. Krahas tyre u bë restaurimi i baseneve 1-2 të cisternës nga E. Harizi, si dhe u kryen kërkime gjeofizike nga Njësia ArkeoBylis e Akademisë së Shkencave nën drejtimin e N. Cekës dhe S. Muçajt.

Vazhdimi i gërmimeve arkeologjike dhe shoqërimi i tyre me ndërhyrjet restauruese, të financuara nga Akademia e Studimeve Albanologjike ka ndikuar në kujdesin e përgjithshëm ndaj Parkut Arkeologjik të Bylisit, gjë që nuk mund të thuhet për sitin arkeologjik të Klosit, që është në gjendje të plotë braktisje. Gjithashtu duhet shënuar shkalla shumë e kufizuar e këtyre gërmimeve e restaurimeve në krahasim me periudhat e mëparshme, që ka pasur si rrjedhim mungesën e zbulimit të monumenteve të rinj. Megjithatë, është e rëndësishme dhe rekomandohet botimi i studimeve të dëritanishme të cilat do të ofronin një perspektivë më të gjerë mbi zhvillimin ekonomik, kulturor dhe social të këtyre dy qendrave theksuar rëndësinë e tyre si pika kyçe të civilizimit dhe kulturës antike në këtë rajon.

Historia e Bylisit dhe e Bylinëve

Territori i popullsisë ilire të Bylinëve përmblidhte përgjithësisht krahinën e sotme të Mallakastrës me një shtrirje rreth 20 km². I banuar që në periudhën e Neolitit të Mesëm, rreth 6000 vjet më parë, sic dëshmojnë gërmimet arkeologjike të zhvilluara në vitet 1969-1970 nga Zh. Andrea dhe M. Korkuti në fushëne Cakranit, ai territor njohu një zhvillim të mëtejshëm në epokën e Bronzit. Gërmimet arkeologjike në Margëlliç pranë Patosit (1982) nën drejtimin e N. Cekës, evidentuan një vendbanim të fortifikuar, si dhe një nekropol të tij, ku u gjet edhe një enë keramike e importuar nga Mikena rreth viteve 1300 p. Kr. Fortifikime të tjera të asaj periudhe u dokumentuan edhe në Greshicë, fare pranë Bylisit, si dhe në Kalivaç, në njerën nga grykat e luginës së mesme të Vjosës. Gërmimet arkeologjike në tumën e Patosit (1976) dhe në atë të Lofkendit (2003-2007) të ndërmarra përkatësisht nga M. Korkuti, J. Papadopulos dhe L. Bejko, evidentuan një kulturë shumë të pasur të periudhës së hershme të Hekurit, rreth viteve 1200-800 p. Kr., që bënte pjesë në grupin kulturor iliro jugor, të njohur si Grupi Devollit. Kjo kulturë shënon një vazhdimësi të lulëzuar në shek. VII-VI p. Kr. të

dëshmuar nga formimi i qendrave të fortifikuara protourbane në Margëllic dhe Mashkjezë (1982-1983), që kanë qenë objekt i gërmimeve arkeologjike të drejtuara nga N. Ceka. Ajo ka qenë edhe periudha e instalimit të kolonisë korintase-korkyrase të Apollonisë rreth vitit 620 p. Kr., duke krijuar një sinergji të zhvillimit ekonomik e shoqëror me vendësit ilirë, që favorizoi krijimin e qyteteve të mirëfillta autoktone në gjysmën e dytë të shek. V. Si i tillë është vërtetuar nga gërmimet arkeologjike qyteti ilir i Klosit, i identifikuar me qytetin e bylinëve Nikaia, të njohur nga një mbishkrim i shek. II p. Kr. Fqinjësia e mirë me Apolloninë bëri që në ngjarjet historike të shek. V p. Kr. që zotërohen nga konflikti ndërmjet Athinës dhe Spartës, të njohur si Lufta e Peloponezit, kjo trevë e njohur si Atintania, do të mbante anën e korintasve, aleatë të Spartës, duke dërguar një kontigjent ushtarak në vitin 429 në një fushatë të spartanëve kundër Akarnanisë. Një mbishkrim mbi një fletë plumb i gjetur në Dodonë na vërteton se rreth gjysmë shekulli më vonë, rreth viteve 470-450 p. Kr. në këtë trevë të Atntanisë ishte themeluar edhe qyteti i Bylisit. Aty ishte shkruar pyetja që komuniteti i Bylinëve i bënte orakullit të Dodonës, në se mund të përdorej pasuria e përbashkët për një investim të rëndësishëm. Ne nuk e dimë se cili ishte ky investim, por nga kërkimet arkeologjike dijmë se ai mbante emrin Koinoni i Bylinëve, i cili përveç Klosit dhe Bylisit përfshinte edhe qytetet e Margëllicit Bargulum) e të Gurëzezës (Eugenium), si dhe kështjellat në Rabie dhe në Kalivaç. Në fund të shek. III p. Kr. qyteti në Gurëzezë rezultoi të ketë qenë kryeqendra e Mbretërisë Ilire në periudhën e sundimit të mbretit Monun, i cili preu edhe monedha prej argjendi, duke përdorur simbolet e monedhave të Apollonisë.

Koinoni i Bylinëve ishte pjesë e Mbretërisë Ilire pothuaj gjatë gjithë shek. III p. Kr., duke ruajtur autonominë administrative. Rreth mesit të shek. III p. Kr. kryeqendra e koinonit, Bylisi, mori pamjen e një qyteti bashkëkohor me agoranë, ku ishte ndërtuar teatri, dy stoa, stadiumi, gimnazit dhe ndërtesa të tjera, ndërsa lagjet u zhvilluan sipas një rrjeti rrugor të njohur si sistemi hipodamik. Nga mbishkrimet të gjetura në Bylis dhe Klos mund të rindërtohet virtualisht sistemi politik i atij koinoni. Prytani, i cili zgjidhej çdo vit sipas një praktike të huazuar nga Apollonia, qëndronte në krye të pushtetit ekzekutiv, krahas një strategu që komandonte këmbësorinë dhe një hiparku, komandant i kalorisë. Ndërkohë, pushteti legjislativ u përkiste damiorgëve-përfaqësues të qyteteve, një institucion politik i huazuar nga Epiri. Si funksione të tjera njohim tamiasin si drejtues i financave, gymnasiarkun, si frjtues i edukimit të të rinjve, peripolarkun, drejtues i repartit të rojeve kufitare, si dhe gramatejtë, apo sekretarët e institucioneve të koinonit. Koinoni i Bylinëve preu dhe monedhat autonome prej bronzi në periudhën 270-167 p. Kr. Simbolet e monedhave, të ndryshme nga ato të Apollonisë, pasqyrojnë një përpjekje për të konkuruar Apolloninë fqinje në tregun financiar. Ato transmetojnë edhe mitologjinë locale me paraqitjen e Zeusit Dodonas dhe vecanërisht flakën e Nymfeut të famshëm, një zjarr natyral hidrokarburesh, i cili

sipas Plinit dilte nga toka në kufirin midis Apollonisë dhe “bylinëve e amantëve barbarë”. Ndër zyrtarët e koinonit zotërojnë emrat tipikë ilirë mes zyrtarëve të koinonit, si Aspimas, Paton, Praugis, Triteutas, etj.

Në marrëdhëniet e tij me Mbretërinë Ilire, apo më pas me senatin romak dhe Mbretërinë Maqedonase, koinoni kufizohej vetëm me detyrimin e pagimit të taksave dhe kishte të drejtën e marrëdhënieve me shtetet e tjera. Kështu, midis viteve 232 – 219 koinoni i Bylinëve ngriti një statujë për nder të një zyrtari të Lidhjes Epirote Krison Sabyrtiu në Dodonë dhe po në atë kohë i dërgonte një letër spartanëve. Në vitin 229 p.Kr., kur romakët zbarkuan në Apolloni, e gjithë treva ilire në lindje të saj, e njohur si Atintania, u bashkua me ta kundër Mbretërisë Ilire të Teutës. Për gati nëntëdhjetë vjet treva e bylinëve u bë shesh lufte ndërmjet ushtrive romake dhe atyre maqedonase, të cilat vlerësonin rëndësinë strategjike të kësaj treve për zotërimin e Apollonisë. Në vitin 213 Atintania, pra edhe Bylisi, u pushtuan nga Filipi V i Maqedonisë, i cili e përdori territorin bylin si një bazë për të sulmuar romakët në Apolloni. Në vitin 205 romakët shkëputën nga ky territor qytetet Bargul dhe Eugen, që mund të identifikohen me Gurzezën dhe Margëlliçin. Kjo ishte edhe koha e shpërbërjes së Atintanisë si federatë politike dhe e daljes më vehte të Koinonit të Bylinëve. Pas thyerjes së Filipit V nga ushtria romake e konsullit Flamini në stenat e Aosit (Dragot i Tepelenës) në vitin 198, bylinët fituan përsëri autonominë dhe u bënë aleatë të Romes. Më 168 një kontigjent trupash byline mori pjesë krahas romakëve në luftën kundër mbretit Gent, por një vit më vonë ata ishin lidhur me molosët dhe maqedonët në një koalicion antiromak. Si ndëshkim, konsulli romak Paul Emili krahas shkatërrimit të shtatëdhjetë qyteteve në Molosi, dogji edhe qytetet e bylinëve, Klosin, Gurëzezën dhe Margëlliçin. Bylisi duket se i shpëtoi asaj katastrofe, sepse Senati romak i njohu statusin e koinonit vetëm qytetit, i cili vazhdoi të priste monedhat e veta prej bronzi, por me ndryshimin që në vend të mbishkrimit bylionon (monedhë e bylinëve), mbi këto monedha shënohej vetëm Byllis.

Bylinët dalin përsëri në dritën e historisë në një letër të Ciceronit, nga e cila del se në vitin 54 p. Kr. koinoni i tyre ishte në konflikt me prokonsullin e Ilirisë, L. Kuleoli. Është përsëri Ciceroni, i cili përmend për emër Byllisin në vitin 44 në një fjalim para senatit romak, ku ai akuzon Brutin se kishte pushtuar qytetin krahas Apollonisë dhe Amantias. Pak vite më vonë, në 39 p. Kr. ishte biri i tij, Marcus Tullius Junior, që ndërton në Byllis një tropaion me rastin e fitores që arriti me trupat ushtarake të Brutit kundër një ushtrie të drejtuar nga vëllai i Mark Antonit. Edhe në shënimet e Cezarit për luftën civile me Pompeun kuptohet se bylinët vepronin si një njësi autonome, duke marrë anën e tij, posa ai pushtoi Apolloninë. Më pas ata pranuan rojet që Cezari dërgoi në kështjellat e tyre. I fundit që përmend Koinonin e Bylinëve nën emrin Bylliake, është gjeografi i periudhës së Augustit, Straboni (VII, 316, 326). Pikërisht në atë periudhë në

Bylisi u kthye në një koloni romake, të cilën mbishkrimete latine të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike e cilësojnë si Colonia Iulia Augusta. Përzgjedhja e Bylisit për vendosjen e një kolonie veteranësh romakë lidhet kryesisht me pozitën strategjike të qytetit në rrugën që lidhte Apolloninë me Epirin dhe Maqedoninë përmes luginës së Aosit (Vjosës). Gërmimet arkeologjike dëshmojnë një lulëzim të jetës në qytet me rimëkëmbjen e mureve rrethuese, restaurimin e teatrit dhe stoave, si dhe me ndërtimin e tempullit madhështor kushtuar Augustit dhe termeve publike, të domosdoshme për një koloni romake. Periudhës koloniale i takon edhe ndërtimi i rrugës që lidhte Bylisin me krahinën e Astacias të dëshmuar nga mbishkrimi latin në emrin e Mark Lolianit në shkëmbintë posjtë mureve rrethuese të qytetit. Një numër mbishkrimesh që lidhen me ndërtime apo ngritje shtatoresh i përkasin sundimit të perandorëve August, Vespasian, Hadrian dhe Antonin Piu. Nga mbishkrimet njihemi edhe me institucionet kryesore të kolonisë, që ishin këshilli legjislativ i dekurionëve dhe duumvirët, dy nëpunës të zgjedhur çdo pesë vjet si drejtues të pushtetit ekzekutiv të kolonisë. Një mbishkrim përmend edhe dy augustalë, nëpunës të ngarkuar me kultin e perandorit, që financonin me të ardhurat e tyre garat dhe festat e lidhura me këtë kult.

Roli që luante Bylisi si qendër e rëndësishme ekonomike dhe ushtarake bëri që të zinte vend në hartën e gjeografit aleksandrin të shek. II m. Kr, Ptolemeut, krahas qyteteve të vjetra, si Dyrrahu, Apollonia, Amantia, por edhe qendrave të reja, si Albanopolisi, Skampini e Aulona. Ai mbeti si i vetmi qytet në trevën e bylinëve, ku u zhvilluan qendra të rëndësishme rurale në Qesarat, Kutë dhe Kraps. Një investim intresant të asaj periudhe paraqesi dy diga mbi lumin Gjanicë pranë fshatrave Patos dhe Kraps, që kanë shërbyer për vaditjen e tokave bujqësore.

Mungesën e të dhënave historike për Bylisin gjatë Antikitetit të Vonë plotësohet nga gërmimet arkeologjike, nga të cilat del se Bylisi ka pësuar të njëjtin fat pushtimesh e dhune si dhe qytetet e tjera në dy anët e Jonit gjatë inkursioneve të fundit të vizigotëve. Monedhat e Valentinianit II, të prera gjatë periudhës 383 – 392, të zbuluara në shtresën e depozituar nga shkatërrimi japin kohën e kësaj ngjarje. Përveç ndërtesave ndodhi edhe prishja e strukturës së vjetër të popullsisë brenda qytetit, ku u strehua popullsia e zonave fshatare, si dhe një pjesë të popullsisë që braktisi Apolloninë pas shkatërrimit nga vizigotët. Duke filluar me sundimin e Teodosit II (408-450) Bylisi filloi të rindërtohej, duke nisur me muret rrethuese të braktisura gjatë Pax Romana, por duke mos respektuar më sistemin e vjetër urbanistik. Ndërtimet kryesore të kësaj periudhe ishin një numër i madh kishash brenda dhe jashtë murit rrethues, duke i dhënë një rol të veçantë në procesin e kristianizimit të popullsisë ilire të asaj periudhe. Pozita strategjike dhe fortifikimi i qytetit tërhoqi aty edhe një seli peshkopale, sepse në Koncilin e Efesit më 431 peshkopi Feliks përfaqësonte njëkohësisht Apolloninë dhe

Bylisin, ndërsa në vitin 458 peshkopi Filokar përfaqësonte vetëm peshkopatën e Bylisit (Philocarus, episcopus Ballidi), krahas qendrave të mëdha peshkopale të Epirit të Ri : Dyrrahut, Apollonisë, Aulonës, Skampinit e Lyhnidit. Gjatë sundimit të perandorit Justinian (527 - 565) Bylisi përmendet ndër qytetet kryesore të provincës së Epirit të Ri në listen e përpiluar nga Hierokli. Kisha u bë një pronare e madhe në qytet dhe në territoret ku dikur banonin bylinët, ku janë identifikuar deri tani më shumë se njëzet kisha. Katedralja e qytetit me kompleksin e saj peshkopal zotëronte një sipërfaqe afërsisht sa agoraja e dikurshme. Dhurues të shumtë (Pakatiani, amator i ndërtimeve; Agllaia, drejtuese e ndërtimeve; Agapetos dhe Isauros, psalltë; Demetri, poçar dhe Kasandri, kalorës, besimtarë të devotshëm etj) shënuan kontributet e tyre në mbishkrimet e mozaikëve, skulpturat dekorative, apo në pajisje metalike të kishave. Në to dokumentohet emri i peshkopit Prais(ios), por edhe një person me funksionet eparhikos (prefekt) dhe ekdikos (mbrojtës i qytetit). Gratë duket se kishin fituar një rrol në ierarjinë e qytetit, sepse përveç drejtueses së ndërtimeve në katedrale, ka shënuar emrin e saj në mozaikë edhe Pakata, bashkë me lutjen që i drejtonte Shën Andreas, apostulli i cili duhet të ketë predikuar edhe në Ilirinë e Jugut, sepse është paraqitur në mozaikun e ekzonarteksit të katedrales.

Ndërtimi kryesor në Bylis në periudhën e Antikitetit të Vonë është muri rrethues, i cili përfshinte brenda tij vetëm një të tretën e qytetit të dikurshëm. Nga gërmimet dhe vëzhgimet arkeologjike del se edhe sipërfaqja prej rreth 10 ha nuk ishte banuar dendur. Banesat gjendeshin të përqëndruara kryesisht rreth tre kishave të ndërtuara brenda murit rrethues. Ato ishin ndërtime të thjeshta, kryesisht njëkatëshe, me pak ambiente, me mure të ndërtuar dobët me gurë të vegjël të lidhur me baltë, ndërsa dyshemetë ishin kryesisht me truall dheu. Pamja e brendshme e Bylist ishte ajo e një grupi fshattrash të strehuara brenda murit rrethues, me kontrastin midis madhësisë dhe luksit të brendshëm të kishave me pamjen e thjeshtë të ndërtimeve. Veprimtaria ekonomike duket se ishte e përqëndruar tek kishat e qytetit, që sipas të dhënave të gërmimeve arkeologjike kishin punishte për prodhimin e verës dhe të vajit të ullirit. Amfora të lyera me bitum, të gjetura me shumicë gjatë gërmimeve të bëra në Bylis, por edhe në qendra të largëta të asaj periudhe dëshmojnë për rrolin e Bylisit në eksportimin e prodhimeve të veta.

Zbulimi i katër mbishkrimeve me përmbajtje ndërtimore në rrënojat e bazilikës së Ballshit dhe i një të pesti në Bylis, pasurojnë historinë e Bylisit në periudhën e fundit të egzistencës së tij. Në njerin prej tyre shënohet koha dhe drejtuesi i ndërrimit të mureve rrethuese të qytetit: “Me uratën e perëndisë dhe hyjnilindëses virgjëreshë, duke i shërbyer drejt qëllimit dhe mënyrave të veprimit të Justinianit, sundimtari (ynë) shumë i fuqishëm, pasi ka ngritur kështjellat e Myzisë e të Skythisë, ato të territorit të Ilirisë si dhe të gjithë Trakisë, Viktorini, ky njeri me aftësi strategjike, ndërton me

përvuajtje këtë mur rrethues për Bylisin”. Nga kjo kuptohet se fortifikimi i Bylist bënte pjesë në planin e madh të fortifikimit të Perandorisë së Bizantit, të urdhëruar nga perandori Justinian dhe të dokumentuar hollësisht në veprën e shkrimtarit bizantin Prokop ii Cezaresë. Si drejtues i punimeve shënohet Viktorini, sigurisht një udhëheqës ushtarak i Bizantit, që rezultoi të ketë drejtuar edhe punimet për fortifikimin e Korinthit. Një mbishkrim tjetër pasqyron situatën që bëri të domosdoshëm atë ndërtim: “Nuk ankoem më për barbarët, nuk u frikësohem më, sepse gjeta tek Viktorini i Madh, një njeri që më ndërtoi me duart e tij”. Barbarët e përmendur në mbishkrim ishin sllavët, të cilët në vitet 547-551 sipas Prokopi të Cezaresë (Proc, De aed. VII, 29, 1 – 3) kishin shkatërruar qytetet dhe kishin shfarosur popullsinë e Epirit të Ri, ku gjendej Bylisi. Me muret solide dhe bazilikat madhështore duket se Bylisi rifitoi një pjesë të madhështisë së dikurshme, të paktën në sfondin e trishtuar të dekadave të fundit të jetës së tij. Këtë duket se do të transmetojë mbishkrimi tjetër me tekstin e shkurtër promocional: “O i huaj, mos e shmang vështrimin nga bukuria e Bylisit, muret rrethuese të të cilit, dikur të rrënuara, i rindërtoi Viktorini guximtar”.

Edhe pse qyteti u fortifikua, gjysma e dytë e shek.VI m.Kr. ishte një periudhë rënieje, ndërsa një shkatërrim i dytë nga sllavët në vitin 586 bëri që Bylisi të braktisej përfundimisht. Pas kësaj selia e peshkopatës u shpërngul në Ballsh, ku që para mesit të shek.VI ishte ndërtuar një bazilikë kristiane. Qendra e re trashëgoi emrin e qytetit të vjetër, i cili gjatë shekujve u transformua nga Byllis në Ballis dhe së fundi në Ballsh. Përkthimi i tij në dokumentet mesjetare, si Kefalenia (nga greqishtja kefalos-kokë), apo Glavinica (nga sllavishtja glava-kokë), dëshmon se kuptimi i emrit Byllis shpjegohet me shqipen ballë, pra- kryevend.

SHTOJCA 2 - PLANI I KONSERVIMIT TË QYTETEVE ANTIKE TË BYLISIT DHE KLOSIT

PËRMBAJTJA

- I. ANALIZË PËR PLANIN E NDËRHYRJEVE KONSERVUESE
- II. ANALIZË E GJENDJES SË DEGRADIMIT
- III. PLANI I REALIZIMIT TË NDËRHYRJEVE KONSERVUESE
- IV. METODOLOGJIA E NDËRHYRJEVE
- V. PËRSHKRIMI I NDËRHYRJEVE KONSERVUESE NË BYLIS
- VI. PËRSHKRIMI I NDËRHYRJEVE KONSERVUESE NË KLOS

I. ANALIZË PËR PLANIN E NDËRHYRJEVE KONSERVUESE

Hartimi dhe menaxhimi i planit apo strategjisë përfshin formulimin e qëllimit themelor dhe objektivave që lidhen me realizimin e tij, si edhe hartimin e programit për përmbushjen e tyre, mbështetur në analizën e burimeve aktuale si: të gjendjes ekzistuese të vendbanimeve, burimeve njerëzore, burimeve financiare, duke konsideruar dhe vlerësuar ambientin të jashtëm e të brendshëm në të cilin po operojmë.

Plani i Konservimit është një dokument i cili evidenton veçoritë e vendbanimeve të Bylisit dhe Klosit, me qëllim përdorimin e tyre në të ardhmen sipas një strategjie të hartuar me objektiv të qarta.

Objekti kryesor është t'i jepet më shumë vëmendje monumenteve, duke i evidentuar, konservuar, ruajtur vlerat e trashëgimisë kulturore, e duke krijuar një mjedis tërheqës për vizitorë të ndryshëm, vendas dhe të huaj. Qëllimi kryesor është kthimi në faktor të rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm si turistik, ekonomik, kulturor, rekreativ etj., si në rrafsh vendor ashtu edhe në atë kombëtar.

Për realizimin e objektivit për ruajtjen dhe konservim si dhe evidentimi i vlerave të trashëgimisë kulturore është parashikuar një plan pune/grafik, ku kryesore është **ruajtja dhe konservimi i monumenteve në vendbanime**. Rëndësi të veçantë ka ndërthurja e këtij plani pune me një strategji gjithëpërfshirëse, sidomos me atë të promovimit dhe zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm.

Bazuar në qasjen konservuese dhe atë të rjetëzimit të monumenteve, paralelisht projektojmë promovimin, duke u orientuar drejt turizmit kulturor, me mundësitë për interpretim dhe lexim të vendbanimeve me tjetër këndvështrim.

Në vendbanimet, përkatësisht të Bylisit dhe të Klosit, plani i konservimit do të hartohet sipas një analize të gjendjes ekzistuese të monumenteve, ku fillimisht do të evidentohen monumentet, muret, mozaikët etj., sipas gjendjes së tyre të degradimit, të cilat do të listohen sipas përparësive. Ndërhyrjet restauruese dhe konservuese në struktura dhe monumente do të shoqërohen gjithnjë me hartimin e dokumentacionit të detajuar të tyre.

Do të evidentohen fillimisht ato që kanë nevojë emergjente për ndërhyrje konservuese e deri tek ato objekte që kanë pak ose aspak nevoja ndërhyrjeje.

Plani (afatmesëm) i konservimit do të formulojë dhe zbatojë iniciativa dhe veprime (aktivitete) në pasuritë kulturore të Bylisit dhe Klosit, të cilat parashikojnë zhvillimin e këtyre vendbanimeve nga gjendja e tanishme siç janë sot, në një nivel tjetër, të përmirësuar pas 5 vitesh.

Qasja që parashikon plani i ndërhyrjes konservuese në monumentet e Bylisit dhe Klosit është ajo e ruajtjes së sa më shumë informacioni të pasurive kulturore. Punimet me karakter konservimi, të cilat parashikohen të zbatohen përmes pastrimit, ndërhyrje me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë, rimodelimit/rikompozimit, (plotësimi i pjesëve të munguara/ anastiloza në raste të veçanta), kanë si qëllim ruajtjen e vlerave të

monumentit, të autenticitetit, të identitetit, pra ndërhyrje të lehta në strukturë/objekt vetëm me qëllim mirëmbajtjeje. Kjo qasje konservuese i bën të mundur brezave të ardhshëm të marrin informacione sipas çdo faze ndërhyrjeje.

Parku Arkeologjik i Bylisit përfshin një nga qytetet më të mëdha dhe emblematike Ilire. Formimi i tij në rrjedhën e shek. V-IV p. Kr ka qenë rezultat i një zhvillimi të hershëm të jetës qytetare të nisur në qendrat protourbane të Margëllicit, Mashkvezës dhe Klosit, që nisi në mesin e shek. VII p. Kr., para themelimit të Apollonisë dhe u zhvillua nën ndikimin e saj gjatë shek. VI-V p. Kr. Të dy qytetet janë pjesë e një konstelacioni qytetar të përbërë nga katër qytete (Bylisi, Klosi, Gurëzeza dhe Margëlliçi) dhe tri kështjella (Rabie, Kalivaçi dhe Cfiri). Ky është kompleksi më i plotë dhe më i qartë i zhvillimit urban të Ilirisë së Jugut në atë periudhë, e cila karakterizohet edhe nga formimi i Mbretërisë Ilire si një nga faktorët e rëndësishëm të Ballkanit ilir. Është një vendbanim i rëndësishëm i përfaqësuar nga rrënojat e një qytetërimi të vjetër ilir, i vendosur në pllajën e një kodre me peizazhe të jashtëzakonshme, sot pranë fshatit Hekal. Dikur shtrihej në një sipërfaqe prej 30 ha e cila mbrohej nga një mur rrethues me gjatësi 2.2 km. Muri rrethues ishte pajisur me hyrje dhe kulla të shumta mbrojtëse. Në qytetin antik të Bylisit rruhen rrënojat e teatrit me kapacitet rreth 7000 spektatorë i cili shërbente jo vetëm për shfaqje të ndryshme teatrale dhe muzikore për banorët e qytetit dhe zonave për qark tij por edhe si vend mbledhjesh ku merreshin vendime të rëndësishme për fatet e bashkësisë byline.

Krahas teatrit qyteti kishte stadiumin e vet, dy shëtitore, njëra prej të cilave dykatëshe, depozitën e ujit, prytaneonin, gjimnazin, altarë, banesa, bazilikat, mozaikë, rrugë, si dhe punishtet e veta të poçarisë, ndërtimit, skulpturës, metalpunuesit si dhe punishten e prerjes së monedhave të veta.

Pasazhi piktoresk, pamjet panoramike në Lindje dhe Perëndim të diellit mbi Luginën e Vjosës janë shumë mbresëlënëse gjatë vizitës në vendbanim.

Rrënojat Arkeologjike në Klos, Nikaja ishte qyteti i dytë për nga rëndësia brenda Koinonit bylin, i cili ishte themeluar si i tillë rreth shekujve VIII-VII p. K., gjatë periudhës arkaike. Nikaja ishte vendosur në pjesën më të lartë të kodrës së sotme të fshatit Klos, e cila përbëhej nga dy maja dhe një pjesë e gjerë dhe e rrafshët midis tyre. Muret rrethues që arrinin një gjatësi prej 1850 m, përfaqësojnë një nga fortifikimet e hershme të gjysmës së dytë të shek. të V p. K. nga ku përfitohej një sipërfaqe prej 18 ha, me një hyrje të vetme dhe tre kulla mbrojtëse. Por meqenëse kodra ku shtrihej qyteti i Nikajës ishte e vogël dhe nuk u përgjigjej kërkesave për zgjerim të banorëve, autoritetet vendosën që rreth 1,5 km më në perëndim të saj të ngrinin një qytet të ri, në një tjetër kodër buzë të Vjosës. Kështu lindi qyteti i Bylisit, fillimisht në formën e një dy-qytetëshi, diku gjatë shekullit IV p. K. dhe që i ngjante shumë qytetit “nënë”. Nikaja kishte banesa, shëtitore, akropol, teatër, stadium dhe gjimnaz, të vendosura në

mënyrë të rregullt sipas planit arkitektonik të Hipodamnit. Teatri është monumenti i ruajtur më mirë i këtij qyteti, i vendosur 60 m larg mureve me pamje nga veriu në kurriz të kodrës mbi muret rrethuese. Me një kapacitet prej 700 spektatorësh, ai përbëhej prej 17 shkallaresh me diametër prej 11,30 m, të gdhendura të gjitha në shkëmb ku ruhen 14 mbishkrime për dhënie qytetarie, dhe daton në shekullin e III p. K.

Disa nga monumentet kryesore janë teatri i vogël, shëtitorja (Stoa) dhe gjurmët e stadiumit, shëtitorja me gjatësi rreth 40 m dhe e gjerë rreth 10 m.

Baza ligjore lidhur me ndërhyrjet restauruese dhe konservuese:

- Ligji 27/2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*;
- VKM nr.396, datë 31.3.2005 *“Për Miratimin e Kufijve dhe të Rregullores së Administrimit të Parqeve Arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Oriksmit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”*, i ndryshuar
- VKM nr. 249, datë 30.4.2014, Për disa ndryshime në vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e Kufijve dhe Rregullores së Administrimit të Parqeve Arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Oriksmit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”*, të ndryshuar;
- VKM nr. 1099, datë 24.12.2020 *“Për Miratimin e Mënyrave të Trajtimit, Normave Teknike, Kriteve dhe Modeleve të ndërhyrjeve në fushën e Ruajtjes së Pasurive Kulturore”*;
- VKM Nr.1125, datë 30.12.2020 *“Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”*;

Konservimi si përkufizim:

- Sipas Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.
 - *“Konservimi paraprak”* janë të gjitha masat e ndërmarra, që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në pasuritë kulturore materiale, siç janë krijimi i kushteve të përshtatshme (lagështi relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.
 - *“Konservim i integruar”* është metodologjia, që nënkupton pajtimin e kërkesave të konservimit me objektivat e planifikimit dhe menaxhimit urban, të cilat duhet të kenë për qëllim krijimin e harmonisë, shmangien e funksioneve të padëshiruara dhe mirëmbajtjen e nivelit ekzistues të vlerave funksionale dhe kulturore.

- Sipas “Kartës Ndërkombëtare së Konservimit dhe Restaurimit të Monumenteve dhe Siteve”, Venecia 1964.
 - *“Konservimi i monumenteve detyron së pari vazhdimësinë e mirëmbajtjes së tyre.”*
 - *“Konservimi i monumenteve është gjithmonë i favorizuar nga destinimi i tyre për një funksion të dobishëm për shoqërinë, një destinim i tillë është pra i dëshirueshëm por ai nuk duhet të ndryshojë kompozimin ose dekorin e ndërtesës. Vetëm në këta kufij mund të konceptohen dhe mund të autorizohen përshtatjet e kërkuara nga ndryshimi i funksionit.”*
 - *“Konservimi i një monumenti duhet të marrë parasysh dhe ambientin përreth. Kur ky ambient është tradicionalisht i lidhur me monumentin, ai duhet ruajtur dhe nuk duhet lejuar ndërtimet e reja, prishjet dhe përshtatjet që mund të ndryshojnë raportet e volumeve dhe të ngjyrave.”*

- Sipas VKM nr. 1099, datë 24.12.2020 “Për Miratimin e Mënyrave të Trajtimit, Normave Teknike, Kritereve dhe Modeleve të ndërhyrjeve në fushën e Ruajtjes së Pasurive Kulturore”
 - *“Mënyrat e trajtimit të lejuara gjatë procesit të ruajtjes, konservimit dhe restaurimit të pasurive kulturore janë:*
 - a) plotësimi i pjesëve të munguara, në funksion të qëndrimit statik dhe të riintegritetit të pjesëve të vogla, të vërtetuara historikisht, në atë pozicion, duke evidentuar në mënyrë të qartë kufirin mes pjesës së plotësuar, por edhe duke adaptuar material të ndryshëm nga origjinali, të aprovuar, të dallueshëm me sy të lirë, në veçanti në pikat e takimit me pjesët si dhe në rastet e një motivi dekorativ, motiv floreal dhe gjeometrik, që është riprodhim i së njëjtës formë dhe linja është e qartë. Plotësimet duhet të jenë në çdo rast të dallueshme nga pjesa origjinale, si dhe të sigluara dhe datuara aty ku është e mundur; gjykimi për plotësim duhet të vendoset nga ana e ekspertit restaurator, në konsultë me ekspertë të tjerë të së njëjtës fushë;*
 - b) procesi i pastrimit të materialit ndërtimor apo veprës, i cili duhet të marrë në konsideratë respektimin e patinës së kohës. Në rastin e pikturave dhe skulpturave polikrome, pastrimi nuk duhet të arrijë kurrë deri te ngjyra, duke respektuar patinën dhe bojën origjinale;*
 - c) rikompozimi i veprave të copëtuara, sistemimi i veprave me pjesë të mangëta, duke bërë rigrupime të fragmenteve dhe të masave a pjesëve të dobëta, me një teknikë të dukshme për syrin e lirë, me zona neutrale të vendosura në nivel të ndryshëm nga ai i pjesëve origjinale ose duke vënë në pah suportin origjinal,*

por duke mos integruar asnjëherë një ex novo në zona me figurina dhe ndërthurur elemente që përcaktojnë figuracionin e veprës;

ç) modifikimi dhe ndërhyrjet e reja me qëllim qëndrueshmërinë statike dhe ruajtjen e strukturës së brendshme, vetëm kur këto nuk ndikojnë në pamjen përfundimtare dhe kur pas përfundimit të ndërhyrjes nuk rezultojnë ndryshime kromatike apo sipërfaqësore ose vëllimore;

d) vendosja në një hapësirë tjetër, të sigurt ekspozimi, në rastin kur konteksti in situ nuk ekziston më apo, në rast se kushtet e konservimit nuk mund të përmbushen.”

II. ANALIZË E GJENDJES SË DEGRADIMIT

Vendbanimet e Bylisti dhe Klosit i janë nënshtruar disa fushatave arkeologjike gjatë shekullit të kaluar, të cilat vijojnë ende. Gjatë këtyre fazave të zbulimit, dokumentimit dhe interpretimit, vendbanimet janë transformuar nga ndërhyrjet konsoliduese e restauruese vit pas viti, duke na u paraqitur në fazën aktuale që janë sot. Sigurisht që vendbanimi i Bylistit ka shumë më shumë informacion shkencor nga fushatat arkeologjike në vijim, dhe gjendja e tij shfaqet më e mirë se sa e Klosit. Duke iu referuar ndërhyrjeve konservuese të parashikuara, është bërë një interpretim i gjendjes së degradimit të strukturave/monumenteve duke i vlerësuar sipas shkallëve nga 1-5. E njëjta analizë është bërë edhe për shkallën e emergjencës së ndërhyrjeve duke i vlerësuar si më poshtë:

*Shkallët e matjes së degradimit dhe vlerësimi i emergjencave

*Degradimi		*Emergjencia	
1	është në gjendje shumë të mirë	1	nuk ka emergjenca
2	është në gjendje të mirë	2	ka nevojë për pastrim dhe sistemime
3	është në gjendje jo të mirë	3	ka nevoja restauruese / konservuese
4	është në gjendje të dëmtuar	4	ka nevoja për ndërhyrje konsoliduese
5	është në gjendje shumë të dëmtuar	5	ka nevoja për ndërhyrje emergjente
		a	gërmime arkeologjike
		b	zbulimi i mozaikëve

Tabela me strukturat/monumentet e P.A.Bylis–gjendja e degradimit dhe shkalla e emergjencës

	Emertimi	Tipilogjia/Lloji	Degradimi	Emergjencia
1	Muri antik bylian	Mur/strukture	4-5	2-3
	Portat hyrese	Mur/strukture	4-5	2-3
2	Muri i Viktorinit	Mur/strukture	2-3	3-4
	Kullat e murit S,T,U,VX,Y	Kullë	2-3	3-4
3	Bazilika D	Bazilikë/ Mozaikë	2	2-3
4	Bazilika B	Bazilikë	2	2-3
	Mozaiket e Bazilikes B	Mozaik	2	2-b
5	Stoa A	Ndërtim/Strukturë	3-4	2-3
6	Bazilika A	Bazilikë	2	2-3
7	Teatri	Ndërtim/Strukturë	2-3	2-3-a
8	Mbishkrimi i Mark Lolianit	Mbishkrim	2	2
9	Stoa B	Ndërtim/Strukturë	4-5	4-5
10	Stadiumi dhe cisterna	Ndërtim/Strukturë	2	3-a
11	Bazilika C	Bazilikë	2	2-3

12	Gjimnazi dhe Terma e Justinianit	Ndërtim/Strukturë	2-3	3-a
13	Prytaneioni dhe Arsenalit	Ndërtim/Strukturë	2-3	3
14	Banesa A	Ndërtim/Strukturë	3-4	3
15	Bazilika E	Bazilikë	2	2-3
16	Banesa B	Ndërtim/Strukturë	3-4	3
	fregmente afreskesh	Afresk	x	3
17	Banesa C	Ndërtim/Strukturë	3-4	3

Tabela me strukturat/monumentet e Klosit–gjendja e degradimit dhe shkalla e emergjencës

	Emertimi	Tipilogjia/Lloji	Degradimi	Emergjencia
1	Muri antik bylian	Mur/strukture	4	3-4
2	Portat hyrese	Mur/strukture	3-4	4-a
3	Stoa	Ndërtim/Strukturë	x	a
4	Teatri	Ndërtim/Strukturë	3-4	a
5	Stadiumi	Ndërtim/Strukturë	x	a

Analiza e më sipërme do të shërbejë për hartimin e një plani ndërhyrjesh konservuese/restauruese në të dy vendbanimet, duke marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë që lidhen direkt dhe indirekt me to.

III. PLANI I REALIZIMIT TË NDËRHYRJEVE KONSERVUESE

Planifikimi për realizimin e ndërhyrjeve në të dy vendbanimet e Bylisit dhe atë të Klosit lidhen me disa faktorë, analizimi i të cilëve parapërcakton skematikisht ku dhe kur do të bëhet ky proces.

Periudha e ndërhyrjeve konservuese parashikon të marrë në konsideratë parimisht vizitueshmërinë dhe kushtet atmosferike të shprehura në katër fasha 3-mujore:

- bazuar në flukset e vizitorëve gjatë vitit:
Stina e dimrit (Dhjetor-Janar-Shkurt- low season) Stina e pranverës (Mars - Prill- Maj- high season) Stina e verës (Qershor-Korrik-Gusht- medium season) Stina e vjeshtës (Shtator-Tetor-Nëntor- high season)

- **Bazuar në kushtet atmosferike:**

Gjatë stinës së dimrit parashikohet të realizohen ndërhyrje me karakter konsolidues, të cilat nuk ndikohen nga temperaturave të ulëta (nën zero gradë) dhe shirave. Punime të cilat kërkojnë praninë e mjeteve të rënda dhe masa sigurie të shtuara, periudhë në të cilën favorizohen nga prania e paktë e vizitorëve gjatë kësaj stine.

Gjatë stinës së pranverës parashikohet të realizohen ndërhyrje të lehta si pastrime bimësie, sistemime, rimodelimi i monumenteve apo plotësimi i pjesëve të munguara/anastiloza si dhe sondazhe arkeologjike.

Gjatë stinës së verës parashikohet të realizohen ndërhyrje rimodelimi i monumenteve apo plotësimi i pjesëve të munguara/anastiloza, sondazhe arkeologjike, zbulimi i mozaikëve të bazilikave si dhe të vijojë restaurimi i tyre. I cili përkon edhe kushte optimale atmosferike, si temperaturat e larta që ndihmojnë në tharjen e shpejtë të llaçrave të ndryshëm dhe mungesën e shirave.

Gjatë stinës së vjeshtës parashikohet të realizohen ndërhyrje të lehta si pastrime bimësie, sistemime, rimodelimi i monumenteve apo plotësimi i pjesëve të munguara/anastiloza si dhe sondazhe arkeologjike.

Punime të cilat janë shumë tërheqëse dhe për vizitorët, një rast shumë i mirë për të krijuar ndërveprim mes tyre dhe specialistëve restauratorë, arkeologëve dhe punonjëseve të parkut. Një qasje e tillë, do t'u japi vizitorëve mbresa dhe eksperiencë të paharruara.

- Bazuar edhe në gjendjen e degradimit dhe emergjencës së ndërhyrjes në monument:

Gjendja e strukturave/monumenteve në varësi të shkallës së dëmtimit, që kanë nevojë emergjente konsoliduese/restauruese do të jenë të parat që do t'i nënshtrohen ndërhyrjeve konservuese.

Në vitin e parë, mund t'u paraprihet këtyre ndërhyrjeve, duke u zbatuar në çdo muaj të vitit edhe skanimit i territorit me anë të teknikave të gjeoprospeksionit, me qëllim identifikimi i zonave potenciale që do t'i nënshtrohen hulumtimit.

Po ashtu, punimet e mirëmbajtjes do të jenë pjesë e pa ndalur e punës, duke ndërhyrë sipas një planifikimi por edhe sipas nevojave që do të shfaqin strukturat/monumentet.

Grafiku i ndërhyrjeve në Parkun Arkeologjik të Bylisit – 5 vite

	EMËRTIMI	TIPOLOGJIA	LLOJI I NDËRHYRJES	VITET			
				VITI I PARE (4 - tre mujorë)			
				DH-J-SH	M-P-M	Q-K-G	SH-T-N
low season	high season	medium season	high season				
VENBANIMI I BYLISIT							
1	Vëzhgime arkeologjike brenda mureve antike kryesisht aty ku ka mungese informacion nga fushatat arkeologjike të mëparshme		Vëzhgim arkeologjik	x	x	x	x
2	Skanimi i territorit me anë të teknikave të gjeoprospeksionit, me qëllim identifikimi i zonave potenciale që do t'i nënshtrohen hulumtimit		Dokumentim		x	x	x
3	Dokumentim i gjendjes ekzistuese të strukturave dhe vlerësimi gjeomorfologjik		Dokumentim	x	x		
4	Dokumentim grafik dhe fotografik		Dokumentim	x	x	x	x
Konsolidimi i murit të Viktorinit -							
5	Evidentimi i problematikave mbi qëndrueshmërinë e murit si dhe përcaktimi i ndërhyrjeve në varësi të shkallës së degradimit	Mure/Strukture	Vlerësim/Dokumentim/Sondazhe arkeologjike	x			
	Ndërhyrje të lehta konservuese me qëllim shmangjen e dëmtimeve të mëtejshme	Mure/Strukture	Konservim/Konsolidim	x	x		
Bazilika B							
6	Zbulimi i mozaikut të Bazilikës	Mozaik	Zbulim/Pastrim/Mirëmbajtje		x		
	Mbulimi i mozaikut të Bazilikës	Mozaik	Mirëmbajtje				x
	Ndërtimi i një strukture të lehte për ta mbuluar mozaikun me qëllim mbrojtjeje (opsionale)	E re	Mirëmbajtje		x		
Teatri							
7	Pastrime në zonën e teatrit dhe përreth saj	Teatri	Pastrim	x			
	Vlerësim i gjendjes aktuale të strukturës (gjendja e konservimit) duke vlerësuar edhe shkaqet e degradimit	Teatri	Vlerësim/Dokumentim/Sondazhe arkeologjike		x		x
	Identifikimi dhe dokumentimi i elementeve arkitektonike të strukturës me qëllim ripërdorimi në të ardhmen	Teatri	Dokumentim		x		x
Stoa B							
8	Vlerësim i gjendjes aktuale të strukturës (gjendja e konservimit) duke vlerësuar edhe shkaqet e degradimit- muri jugor shfaqet shumë i dëmtuar	Stoa/struktururë	Vlerësim/Dokumentim/	x			
	Ndërhyrje konservuese me qëllim përforcimin e strukturës, shmangjen e rënies së mëtejshme të murit nga erozioni	Stoa/struktururë	Përforcim/Konsolidim / Restaurim	x	x		

EMERTIMI	TIPOLOGJIA	LLOJI I NDERHYRJES	VITI I DYTE (4 - tre mujorë)				
			DH-J-SH	M-P-M	Q-K-G	SH-T-N	
			low season	high season	medium season	high season	
Bazilika A, C,D dhe E							
1	Zbulimi i mozaikut të Bazilikës	Mozaik	Zbulim/Pastrim / Mirëmbajtje		x		
	Mbulimi i mozaikut të Bazilikës	Mozaik	Mirëmbajtje				x
	Strukturat e bazilikës		konsolidim/restaurim		x	x	
STOA A							
	Vlerësim i gjendjes aktuale të strukturës (gjendja e konservimit) duke vlerësuar edhe shkaqet e degradimit si dhe strukturat e mbivendosura	Stoa/ strukturë	Vlerësim/ Dokumentim/ Sondazhe arkeologjike	x	x		x
2	Konsolidimi i strukturave do të arrihet nëpërmjet plotësimit të pjesëve të munguara të stlobatit dhe të murit mbështetës në krahun perëndimor	Strukturë	Konsolidim/Restaurim /Anastilozë		x	x	
	Çlirimi i monumentit nga ndërhyrjet më të vona të banesave të Antikitetit të Vonë.	Strukturë	Mirëmbajtje/Dokumenti/ Sondazhe arkeologjike		x	x	
	Ndërhyrje konservuese dhe restauruese	Strukturë	Konsolidim/Restaurim / Anastilozë		x	x	
Teatri							
	Cavea dhe proedria- konsolidohet një pjesë e cavea-s deri në nivelin e 20 radhëve të poshtme	Teatri	Konsolidim/Konservim		x		
3	Ndërhyrje tek portiku i ndërtesës së teatrit.	Teatri	Restaurim / Anastilozë			x	
	Ndërhyrje ne proedria, duke përdorur ndenjëset origjinale, duke plotësuar ato të dëmtuara dhe duke riprodhuar elementet që mungojnë do të jetë pjesë e këtij	Teatri	Restaurim / Anastilozë		x		x
	Ndërhyrje tek ndërtesa e skenës	Teatri	Konsolidim		x		
Kompleksi i ndërtesave publike - Termet; Gjimnazi; Mbishkrimi i Mark Lolianit							
4	Evidentimi i problematikave mbi qëndrueshmërinë e murit si dhe përcaktimi i ndërhyrjeve ne varësi të shkallës se degradimit	Ndërtime/ Struktura	Vlerësim/ Dokumentim/Sondazhe arkeologjike/ Konsolidim/ Restaurim	x	x		
Muri antik							
	Evidentimi i problematikave mbi qëndrueshmërinë e murit si dhe përcaktimi i ndërhyrjeve ne varësi të shkallës se degradimit	Mure/ Struktura	Vlerësim/ Dokumentim/Sondazhe arkeologjike/ Konsolidim/ Restaurim	x	x	x	x
5	Ndërhyrje te lehta konservuese me qëllim shmangjen e dëmtimeve të mëtejshme	Mure/ Struktura	Konservim/Konsolidim		x		x
	Ndërhyrje konservuese ne portat hyrëse	Mure/ Struktura	Konservim/Konsolidim / Restaurim		x	x	x

EMERTIMI	TIPOLOGJI A	LLOJI I NDERHYRJES	VITI I TRETE (4 - tre mujorë)				
			DH-J-SH	M-P-M	Q-K-G	SH-T-N	
			low season	high season	medium season	high season	
Kompleksi i ndërtesave publike - Termet; Gjimnazi; Mbishkrimi i Lollianus; Ndërtesa e arsenalit;							
1	Evidentimi i problematikave mbi qëndrueshmërinë e murit si dhe përcaktimi i ndërhyrjeve ne varësi te shkalles se degradimit	Ndërtime/ Struktura	Vlerësim/ Dokumentim/Sondazhe arkeologjike/ Konsolidim/ Restaurim	x	x		
Stadiumi, cisterna dhe Prytaneion							
2	Evidentimi i problematikave mbi qëndrueshmërinë e murit si dhe përcaktimi i ndërhyrjeve ne varësi te shkalles se degradimit	Ndërtime/ Struktura	Vlerësim/ Dokumentim/ Sondazhe arkeologjike/ Konsolidim/ Restaurim	x	x		
	Ndërhyrje ne propilete dhe kolonadën e prytaneionit	Ndërtime/ Struktura	Restaurim		x	x	
Teatri							
3	Vijimi i hulumtimeve arkeologjike ne kuadër te kërkimeve shkencore	Ndërtime/ Struktura	Sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime			x	x
	Nivelimi dhe mbushje e cavea-s me çakull.	Teatri	Mirëmbajtje	x	x		
	Vijim i punës konsoliduese/ restauruese të vitit paraardhës	Teatri	Mirëmbajtje	x	x		
Konsolidimi i murit të Viktorinit -							
4	Kulla S	Kullë	Konsolidim/Restaurim			x	
	Kulla T	Kullë	Konsolidim/Restaurim			x	
	Kulla U	Kullë	Konsolidim/Restaurim		x		
	Kulla V	Kullë	Konsolidim/Restaurim			x	
	Kulla X	Kullë	Konsolidim/Restaurim		x		
	Kulla Y	Kullë	Konsolidim/Restaurim			x	
Banesat A, B dhe C							
5	Ndërhyrje konservuese ne banesa	Ndërtime/ Banese	Pastrim /Konsolidim/ Plotësime		x		x
	Punime mirëmbajtjeje	Ndërtime/ Banese	Mirëmbajtje		x		x

	Ndërhyje ne banesën B, për konservimin e mbetjeve te afreskeve dekorative ne mure		Konservim/ restaurim			x	
EMERTIMI	TIPOLO GJIA	LLOJI NDERHYRJES	VITI I KATERT (4 - tre mujorë)				
			DH-J-SH	M-P-M	Q-K-G	SH-T-N	
			low season	high season	medium season	high season	
Stadiumi, cisterna dhe Prytaneion							
1	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Ndërtim/ Struktura	Mirëmbajtje	x	x	x	
	Vijimi i hulumtimeve arkeologjike ne kuadër te kërkimeve shkencore	Ndërtim/ Struktura	Sondazhe gërmime arkeologjike/ dokumentime			x	x
Teatri							
2	Vijim i punës konsoliduese/restauruese të vitit paraardhës	Teatri	Mirëmbajtje	x	x		x
Kompleksi i ndërtesave publike - Termet; Gjymnazi; Mbishkrimi i Lollianus; Ndërtesa e arsenalit;							
3	Vijim i punës konsoliduesit/restauruese te vitit paraardhës	Ndërtim/ Struktura	Mirëmbajtje	x	x	x	
	Vijimi i hulumtimeve arkeologjike ne kuadër te kërkimeve shkencore	Ndërtim/ Struktura	Sondazhe gërmime arkeologjike/ dokumentime			x	x
Banesat A, B dhe C							
4	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Ndërtim/ Struktura	Mirëmbajtje	x	x		x

EMERTIMI	TIPOLO GJIA	LLOJI NDERHYRJES	VITI I PESTE (4 - tre mujorë)				
			DH-J-SH	M-P-M	Q-K-G	SH-T-N	
			low season	high season	medium season	high season	
Muri antik							
1	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Mure/ Struktura	Mirëmbajtje	x			x
Stadiumi, cisterna dhe Prytaneion							
2	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Ndërtim/ Struktura	Mirëmbajtje	x	x	x	
Teatri							
3	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Teatri	Mirëmbajtje	x	x		x
Kompeksi i ndërtesave publike - Termet; Gjymnazi; Mbishkrimi i Lollianus; Ndërtesa e arsenalit;							
4	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Ndërtim/ Struktura	Mirëmbajtje	x	x	x	
	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Ndërtim/ Struktura	Sondazhe gërmime arkeologjike/ dokumentime			x	x
Banesat A, B dhe C							
5	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Ndërtim/ Struktura	Mirëmbajtje	x	x		x

Grafiku i ndërhyrjeve në Klos – 5 vite

	EMERTIMI	TIPOLOGJIA	LLOJI I NDERHYRJES	VITET			
				VITI I PARE (4 - tre mujorë)			
				DH-J-SH	M-P-M	Q-K-G	SH-T-N
				low season	high season	medium season	high season
VENDBANIMI I KLOSIT							
1	Marrja e masave për mundësimin e aksesueshmerisë në vendbanim duke biseduar me banoret vendas për të hapur rrethimet me gardhe			x	x	x	x
2	Vëzhgime arkeologjike brenda mureve antike kryesisht aty ku ka mungese informacion nga fushatat arkeologjike të mëparshme		Vëzhgim arkeologjik	x	x	x	x
3	Skanimi i territorit me anë të teknikave të gjeoprospeksionit, me qëllim identifikimi i zonave potenciale që do t'i nënshtrohen hulumtimit		Dokumentim		x	x	x
4	Dokumentim i gjendjes ekzistuese të strukturave dhe vlerësimi gjeomorfologjik		Dokumentim			x	x
5	Dokumentim grafik dhe fotografik		Dokumentim	x	x	x	x
6	Muri antik						
	Evidentimi i problematikave mbi qëndrueshmërinë e murit si dhe përcaktimi i ndërhyrjeve në varësi të shkallës së degradimit	Mure/ Strukture	Vlerësim/ Dokumentim/Sondazhe arkeologjike	x			
	Ndërhyrje të lehta konservuese me qëllim shmangien e dëmtimeve të mëtejshme	Mure/ Strukture	Konservim/Konsolidim	x	x		
	Ndërhyrje konservuese tek porta hyrëse	Mure	Konservim/Konsolidim		c		
7	Teatri						
	Pastrime në zonën e teatrit dhe përreth saj	Teatri	Pastrim	x			

	Vlerësim i gjendjes aktuale te strukturës (gjendja e konservimit) duke vlerësuar edhe shkaqet e degradimit	Teatri	Vlerësim/ Dokumentim/Sondazhe arkeologjike		x		x
	Identifikimi dhe dokumentimi i elementeve arkitektonike te strukturës me qellim ripërdorimi ne te ardhmen	Teatri	Dokumentim		x		x
	Evidentimi i elementeve kryesorë të tij, kryesisht të cavea-s dhe skenës	Teatri	sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime			x	
8	Stoa dhe monumentet e tjera perreth						
	Vlerësim i gjendjes aktuale te strukturës (gjendja e konservimit) duke vlerësuar edhe shkaqet e degradimit- muri jugor shfaqet shume I dëmtuar	Stoa/strukturë	Vlerësim/ Dokumentim/	x			
	Vijimi i hulumtimeve arkeologjike ne kuadër te kërkimeve shkencore	Ndërtime/ Struktura	sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime			x	x

	EMERTIMI	TIPOLOGJIA	LLOJI I NDERHYRJES	VITI I DYTE-TRETE-KATERT			
				DH-J-SH	M-P-M	Q-K-G	SH-T-N
				low season	high season	medium season	high season
1	Muri antik						
	Ndërhyrje të lehta konservuese me qëllim shmangien e dëmtimeve te mëtejshme	Mure/ Strukture	Konservim/Konsolidim	x	x		
2	Teatri						
	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Ndërtime/ Struktura	Mirëmbajtje	x	x	x	
	Vijimi i hulumtimeve arkeologjike ne kuadër te kërkimeve shkencore	Ndërtime/ Struktura	sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime			x	x
3	Stoa dhe monumentet e tjera përreth						
	Vijimi i hulumtimeve arkeologjike ne kuadër te kërkimeve shkencore	Ndërtime/ Struktura	sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime			x	x
	Dokumentim grafik dhe fotografik		Dokumentim	x	x	x	x
4	Stadiumi						
	Hulumtimeve arkeologjike në kuadër te kërkimeve shkencore	Ndërtime/ Struktura	sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime		x	x	

	EMERTIMI	TIPOLOGJIA	LLOJI I NDERHYRJES	VITI I PESTE (4 - tre mujorë)			
				DH-J-SH	M-P-M	Q-K-G	SH-T-N
				low season	high season	medium season	high season
1	Muri antik						
	Ndërhyrje mirëmbajtjeje	Mure/ Struktura	Mirëmbajtje	x	x		
2	Teatri						
	Vijim i punës konsoliduese/restauruese te vitit paraardhës	Ndërtim/ Struktura	Mirëmbajtje	x	x	x	
	Vijimi i hulumtimeve arkeologjike ne kuadër te kërkimeve shkencore	Ndërtim/ Struktura	sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime		x	x	
3	Stoa dhe monumentet e tjera përreth						
	Ndërhyrje mirëmbajtjeje	Mure/ Struktura	Mirëmbajtje		x		
	Vijimi i hulumtimeve arkeologjike ne kuadër të kërkimeve shkencore	Ndërtim/ Struktura	Sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime			x	x

IV. METODOLOGJIA E NDËRHYRJEVE

Të gjitha ndërhyrjet në pasuritë kulturore dhe arkeologjike në vendbanimet e Bylisit dhe Klosit, të cilësuar si vlera të rralla kombëtare, do të synojnë ruajtjen, konservimin, konsolidimin dhe restaurimin e strukturave/monumenteve duke ruajtur në çdo fazë auticintetin e tyre. Ndërhyrjet e parashikuara do të jenë të gjitha në përputhje me legjislacionin shqiptar, Ligjin 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Qasja e ndërhyrjeve konservuese në struktura/monumente do të konsistojë në disa hapa kyç:

- Realizmin e vëzhgimeve arkeologjike për të marrë informacion më të zgjeruar;
- Skanimi i territorit me anë të teknikave të gjeoprospeksionit, me qëllim identifikimi i zonave potenciale që do t'i nënshtrohen hulumtimit;
- Dokumentim grafik dhe fotografik (vizatime, foto dhe foto e video me dron).
- Vlerësimi gjeomorfologjik për të kuptuar si kanë ndryshuar monumentet në kohë;
- Përcaktimin e shkallës së degradimit;
- Realizmin e sondazheve/gërmimeve arkeologjike për të marrë informacion më të zgjeruar;
- Ndërhyrje të lehta konservuese me qëllim shmangien e dëmtimeve të mëtejshme;
- Konsolidimi i strukturave me qëllim rritjen e kapacitetit statik (për qëndrueshmëri të lartë) si dhe plotësimin e pjesëve të munguara me elementë arkitektonikë origjinalë aty ku ekziston kjo mundësi. Parashikohen edhe aplikimi i sondazheve të kontrollit në themele;
- Ndërhyrje me karakter konservues dhe restaurues (anastiloza) bazuar në projekte restaurimi, për të bërë të mundur rikthimin apo leximin e formës origjinale të monumentit në kohën kur është ndërtuar. Plotësimin e pjesëve të munguara me elementë arkitektonikë origjinalë, gjithnjë duke ruajtur vlerat dhe veçantitë. Përdorimi i materialeve plotësuese gjatë ndërhyrjeve konservuese-restauruese do të bëhet mbi bazën e afërsisë së tyre me materialet e vetë monumenteve. Dallimi i pjesëve plotësuese në çdo rast duhet të jetë i dallueshëm qartësisht;
- Restaurimi në çdo rastet duhet të jetë i *reversibël*, për të dhënë mundësi të kthimit të monumentit në gjendjen e mëparshme në rastet e ndërhyrjeve të gabuara.
- Punime mirëmbajtjeje;

Periudha e çdo ndërhyrje është parashikuar sipas një grafiku (kapitulli III) i cili ndërthur dhe merr në konsideratë disa faktorë:

- gjendjen e degradimit dhe emergjencës së ndërhyrjes në monument;
- flukset e turistëve gjatë vitit;
- kushtet atmosferike;

V. PËRSHKRIMI I NDËRHYRJEVE KONSERVUESE NË BYLIS

Ndërhyrjet konservuese do të përqendrohen në struktura/monumente që shfaqin nevoja urgjente për konsolidimin dhe restaurimin e tyre. Strukturat do të konservohen, konsolidohen e restaurohen, si dhe do t'i nënshtrohen anastilozës sipas rastit, me qëllimin fundor, që të ruhen vlerat e pasurisë kulturore. Ndërhyrjet do t'i shtojë vlerat monumentale, historike e kulturore strukturave/objekteve të cilat do integrohen në itineraret turistike të Planit të Menaxhimit. Çdo propozim duhet të përgatitet/hartohet nga individë/subjekte të licencuar për ndërhyrjet në pasuri kulturore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryesisht do të konservohen **Muret** (ai antik dhe bizantin), **Portat hyrëse** të murit antik, **Kullat** e murit të Viktorinit, (kryesisht ato që ndodhen afër me Bazilika B) **Bazilika B dhe mozaiku** i saj, si dhe **Teatri** dhe zona përreth.

Vëmendje do të kenë edhe mozaikët që ndodhen në dyshemetë e **Bazilikave B, A, D dhe E**, të cilat do të kenë ndërhyrje konservuese por edhe zbulimin e tyre me qëllim ekspozimi, gjatë sezoneve të larta turistike.

Po ashtu, monumente të tjera që do të preken nga ndërhyrjet konservuese do të jenë veprat monumentale me karakter publik si **Cisterna dhe Stadiumi, Prytaneonin, Termet dhe Gjimnazi, Stoa A dhe B**, si dhe kompleksi i rrugëve dhe i banesave **A, B dhe C**.

Ato do të ruajnë integritetin historik dhe arkitektonik në një raport të ekuilibruar me anastilozën e pjesëve origjinale dhe plotësimin e pjesëve të munguara.

- **Konservimi dhe konsolidimi i mureve**

- **Muri Antik i periudhës byline**

Muri rrethues i Bylisit i periudhës së parë dhe shtesa e bërë për krijimin e oborrit ka qenë nga monumentet e para ku ka filluar gërmimi duke u shoqëruar dhe me restaurimin e tij. Ky proces ka vazhduar për një kohë të gjatë duke filluar që nga viti 1978 dhe ka vazhduar me ndërprerje deri në vitin 2008. Që gjatë gërmimeve u vërejt se muri rrethues i fazës së parë Bylis I kishte pësuar shtesa apo rindërtime të tjera në perioda të ndryshme në shek. III p. Kr., fillimin e shek. V dhe mesin e shek. VI m. Kr. Për një kohë të gjatë, duke filluar nga Lufta civile romake dhe deri në fillim të shek. V, sistemi fortifikues jo vetëm i fazës së parë por edhe ai fazës së dytë ishte jashtë funksionit, prandaj pjesë të rëndësishme të tij sidomos në lartësi janë dëmtuar. Gjatë rindërtimeve një pjesë e blloqeve janë ripërdorur, por jo në pozicionin që ata ishin vendosur në fazën e parë dhe të dytë të ndërtimit. Kjo gjë ka sjellë që gjatë

restaurimeve të bërë në vitet e fundit nuk ruhet e njëjta fasadë. Nga muri i fazës së parë është trashëguar plotësisht gjithë traseja e murit së bashku me elementet përkatës në rindërtimi e bërë në fillim të shek. V, kurse në atë mesit të shek. VI vetëm ajo pjesë e anës perëndimore. Po ashtu gjatë pastrimeve të bëra është vërejtur se muri i fazës së parë dhe të dytë ruhen në lartësi të ndryshme duke filluar nga tri e më shumë radhë blloqesh *insitu* por dhe një pjesë e lëvizur gjatë periudhave më të vona kur qyteti ishte i braktisur. Deri tani janë restauruar pjesë të ndryshme të fazës së parë dhe të dytë: porta nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, kulla rrethore e oborrit, pjesërisht bastioni në oborr i fazës së parë dhe pjesë të shkëputura të kurtinave. Po ashtu janë kryer pastrime edhe në faqen e jashtme të murit duke filluar nga teatri e deri tek porta nr. 4, duke vazhduar në drejtim orar.

Propozohet restaurimi i **Portës nr. 1**. Të restaurohet hyrja në krahun e djathtë e cila është e mbuluar nga asfalti i rrugës.

Propozohet restaurimi i **Portës nr. 2**. Të restaurohet hyrja.

Propozohet restaurimi i **Portës nr. 5**. e cila është pjesë e kompleksit Teater, Stoa, Terma romake ka dhe ka vlera të veçanta sepse aty ruhen edhe fazat e ndryshme të ndërhyrjeve. Duhet të bëhen të dukshme dhe të përfaqësohen në restaurime edhe dy fazat e fundit të antikitetit të vonë (Bylis III-IV).

Propozohet restaurimi i muri i oborrit. Muri që fillon nga Porta nr. 2 deri tek bastioni i ka blloqet të lëvizur dhe kjo pjesë duhet të restaurohet.

Muri nga kulla rrethore deri tek Porta nr. 6. Duhet të restaurohet me blloqet që kanë rrëshqitur poshtë trasesë së murit.

Nëse hyrja për në vendbanim do të bëhet përmes **Portës nr. 6.**, atëherë do të hartohet një projekt të veçantë restaurimi/rijetëzimi.

Propozohet restaurimi i **Portës nr. 7**. Të pastrohet nga depozitimet që e kanë mbuluar. Të shikohet si një objekt i veçantë dhe të realizohen ndërhyrje konservuese dhe punime anastilozë.

Propozohet restaurimi i **Portës nr. 8**. duke ndërhyrë te trarët e dëmtuar dhe të bëhet e mundur hyrja duke i larguar dherat që kanë rrëshqitur dhe e kanë mbyllur.

Propozohet restaurimi i **Portës nr. 9**. e cila në anën e jashtme të saj është mbyllur me një mur të hollë të ndërtuar me llaç, që ka shërbyer për ta maskuar atë gjatë sulmeve më të vona të ndërmarra kundër qytetit. Do të këtë ndërhyrje lidhur me lartësimin e paturave dhe mureve.

- Muri i Viktorinit- periudha bizantine


Si ndërtim masiv dhe i ruajtur mirë i kësaj periudhe, duhet trajtuar si një monument i veçantë, i cili do të kalojë në fazat e dokumentimit, hulumtimit e më pas të konservimit. Krahas konsolidimit të muraturës dhe zgavrave të murit të krijuar nga mungesa e mirëmbajtjes ndër vite, është parashikuar të realizohen edhe punime të tjera restauruese për t'i shtuar vlerat monumentale.

Restaurimi i pjesëve që mungojnë të kullave S, T, V dhe Y të murit bizantin, parashikohet të bëhet sipas një projekti restaurimi duke e modeluar sipas volumetrisë së periudhës kur është ndërtuar. Rimodelimi i kullave do të mundësojë edhe përdorimin e tyre nga vizitorët për të soditur peizazhin natyror e arkeologjik. Për konsolidimet e murit të Viktorinit do të përdoren gurët që janë depozituar pranë murit nga pastrimet e bëra jashtë dhe brenda tij, si dhe gurë të tjera që do të mblidhen gjatë pastrimit të pjesës së qyteti të anës perëndimore që përfshihet brenda murit të Viktorinit.

Kulla T

Ndodhet në lindje të katedrales, ka formë katërkëndëshe dhe është ruajtur më mirë së kullat e tjera.

Nga elementet funksionale të kullës ruhet një frëngji në faqen jugore të katit të dytë, qe shërbente për shigjetarët. Ajo ka përmasa, me prerje në formë trapezi me bazën e vogël nga jashtë. Gjatë gërmimit të kryer në këtë kullë u gjetën një shtresë me tjegulla, gjë që tregon se kulla ka qenë mbuluar me çati katërujësë. Përveç tjegullave, në këtë shtresë u gjet edhe një pitos i njëjtë me ata të zbuluar në banesat e shek.VI e. sonë të qytetit gjë që tregon se ambienti ka shërbyer si depo.



Muri i Viktorinit. Kulla T. Rikonstruksion virtual nga S. Mucaj

Kulla S.

Ka një planimetri katërkëndëshe, me mure të dala plotësisht jashtë murit rrethues. Hyrja për në katin e parë të kullës ndodhet në anën perëndimore të saj, i mungon arkitrau, por ruhen këmbët e harkut që ngrihesh mbi të, kurse basamakët e shkallëve

ruhen pjesërisht. Propozohet restaurimi dhe konsolidimi i hyrjes, i shkallës si dhe muret e kullës.

Kulla V.

Ngrihet në anën jugore të hyrjes nr. 9, aty ku terreni ngrihet për të vazhduar përsëri në rrafsh pas saj. Ashtu si kullat e tjera, ka formë katërkëndëshe me mure të dala plotësisht jashtë dhe në pjesën e pasme të saj, që vazhdon në një vijë të drejtë me murin rrethues. Nga bazamakët e shkallëve ruhen plotësisht dy të parët. Propozohet restaurimi dhe konsolidimi i trarëve, fillimi i këmbeve të harqeve me tulla mbi arkitra, si dhe konsolidimi i bazamakëve të shkallëve.

Kulla X.

Është ndërtuar në një largësi 63 m nga kulla V, duke shënuar kështu distancën më të shkurtër midis kullave. Ashtu si dhe kullat e tjera, ajo ka formë katërkëndëshe. Në katin e parë të kullës hyhet nëpërmjet një porte me gjerësi në anën e jashtme 1.30 m, kurse në të brendshmen 1.41m.

Porta mbulohet nga arkitrarë në fundet e të cilëve fillon qemeri cilindrik. Ngjitja për në shtegun e kalimit bëhet nëpërmjet shkallares që, në ndryshim nga të tjerat, është vendosur në krahun e majtë të kullës. Propozohet dhe konservimi i shkallëve që ruhen dhe të zëvendësimi i traut të thyer i cili të ngrihet në lartësi muret e jashtme të kullës, që do shërbejnë edhe për rrethimin.

Kulla Y.

Ndodhet në anën jugore të fortifikimit, aty ku linja e murit kthehet në një kënd të gjerë për t'u bashkuar me murin antik. Ajo ka formë katërkëndëshe me mure të dala plotësisht jashtë kurtinës. Në mjedisin e brendshëm hyhet me anën e një porte Ngjitja për në shtegun e kalimit si dhe në katin e tretë të kullës, në ndryshim nga kullat e tjera, bëhet nëpërmjet dy shkallareve, që lartësohen në të dyja anët drejt kullës. Shkallarja e anës verilindore është vendosur në gjatësi prej 5.30 m, deri aty ku muri bën kthesën për në jug-perëndim dhe vazhdon edhe për 3.50m pas kthesës. Shkallarja tjetër, me gjatësi 8.50m, është vendosur në krahun e djathtë të kullës, përgjatë linjës së kurtinës, duke u ndërtuar njëkohësisht me të. Në shkallaren e parë ruhen shtatë shkallët që shkojnë në një gjatësi 2.20m dhe lartësi 2.05 m, kurse në shkallaren tjetër ruhen vetëm 3 shkallë. Nisur nga pozicioni dominues jo vetëm mbi qytetin por edhe mbi luginën e Vjosës dhe gjithë krahinën e Mallakastrës mendojmë që kulla të restaurohet të shërbejë si ballkon panoramik. Po ashtu duhet të restaurohen bazamakët e shkallëve deri tek shtegu i kalimit.

- **Bazilika B**

Është bazilika më e madhe dhe më komplekse e zbuluar deri më sot në territorin e Shqipërisë. Në kontekstin e pesë bazilikave të Bylisit ajo shquhet për përmasat dhe pasurinë e dekoracioneve, që i japin padyshim vendin e katedrales së qytetit. Në kompleksin e saj, ku janë integruar ndërtesa e pagëzimores dhe një kompleks i tërë ambientesh me karakter ekonomik, Bazilika B është qendra e një Manastiri të madh, i vetmi i kësaj natyre i zbuluar pothuajse plotësisht.

Mozaiku i ekzonarteksit të bazilikës B është më i bukuri dhe më i ruajturi i zbuluar në vendin tonë dhe ka një vend nderi në artin muziv të periudhës së konsideruar si Rilindja e Justinianit. Të dy tabllotë e mozaikut, të punuar nga mjeshtër të ndryshëm, i referohen paradigmeve të Dhjatës së Re me temën e përhapjes së krishterimit, që ishte aktuale në kohën e veprimtarisë së gjerë religjioze të Justinianit dhe Teodorës. Motivi i peshkatarëve të Galilesë, që sipas porosisë së Krishtit “do të gjuanin njerëz dhe jo peshq”, ka të bëjë me këtë mission të kishës, po aq sa edhe tema e “Bariut të Mirë”, si alegori e punës që bënte klasa e priftërinjve dhe e murgjve.



Mozaik nga ekzonarteksi i bazilikës “Bariu i mirë” Bazilika B, Foto N. Ceka

Në kuadrin e PM bazilika B do të ketë rrolin e tërheqjes së vëmendjes së vizitorëve dhe do të konsumojë një pjesë kryesore të kohës së qëndrimit të tyre, duke transmetuar njëkohësisht mesazhet e vlerave të veçanta të periudhës që përfaqëson. Për këtë arsye do t’i kushtohet një vëmendje e veçantë ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese që do të evidentojnë ato vlera. Rëndësi të veçantë do të ketë edhe kujdesi i përditshëm që do të kombinohet me vazhdimin e konsolidimit të strukturave.

Bazilika B përfaqëson një nga monumentet, në të cilin puna konservuese-restauruese e deritanishme ka dhënë rezultate të kënaqshme. Këto janë realizuar në tre drejtime kryesore:

- Restaurimet në arkitekturë, që kanë realizuar anastilozën e kolonadës së kuadriportikut, të tribelonit të bapatisterit, si dhe njerin prej harqeve të portave që lidhnin bazilikën me ambientet e manastirit.
- Restaurimet në mozaikë, që kanë synuar konsolidimin e paneleve të mozaikëve në naosin qendror dhe në ekzonarteks në një punë sistematike që përsëritet në mënyrë periodike me ndërrimin e mbulojës prej rëre dhe heqjen e vegjetacionit.
- Konsolidimi i strukturave të bazilikës dhe të ambienteve të manastirit. Këto të fundit, të përbëra prej muresh me gurë të vegjël dhe baltë janë mbuluar me një kapotë prej gurësh të vegjël e llaci, që nuk e ndryshon pamjen origjinale të strukturave.



Bazilika B e Bylisit - Anastoza e kuadriportikut

Katedralja me pasurinë e saj të shumëllojshme dhe me vlera të spikatura, jo vetëm për qytetin e Bylisit por dhe më tej ka nevojë për një projekt të veçantë dhe kompleks restaurimi jo vetëm që mozaikët të jenë të hapur për pothuajse gjithë vitin, por të bëhet ngritja e gjithë pjesëve arkitektonike në pozicionet e tyre të mëparshme.

Meqenëse në kompleksin peshkopal janë identifikuar një numër i madh sternash dhe pesë prej tyre janë gërmuar plotësisht, propozojmë që ato të pajisen me grykën e pusit, në tri ku ato mungojnë dhe restaurimin me ulluqet e furnizimit në njërin prej tyre, ashtu siç ka dalë nga gërmimi.

Punishtja e verës, meqenëse është nga rastet e rralla ku ajo është gjetur me të gjitha pjesët e saj përbërëse (magazina e rrushit, vaska e shtypjes me këmbë, enët për shtrydhjen me dorë, vaska e mbledhjes së mushtit, ulluku për transportin e mushtit,

vaskat e dekantimit dhe fermentimit, depoja e enëve të rezervës (pitos dhe amfora) duhet të restaurohet plotësisht. Në kompleksin Peshkopal ruhet pjesërisht edhe magazina e drithërave (21 pitosa), kurse një magazinë tjetër shërbente për lëngje, ku gjatë gërmimit u evidentuan 14 pitosa të vegjël njëri prej të cilëve i punuar në gurë. Propozojmë se disa prej tyre mund të restaurohen ose atë të vegjlit edhe të prodhohen. Ndërhyrja kryesore propozojmë të jetë në zonën e narteksit dhe ekzonarteksit, për të krijuar mundësinë e krijimit të një mbulesë permanente për mozaikët, ku do të lëvizin vizitorët, si dhe një mbulesë të lëvizshme mbi mozaikun e naosit qendror.

Propozohet zgjerimin e gërmimeve arkeologjike në anën veriore, ku vazhdojnë ambientet e manastirit dhe në anën jugore.




Foto nga Kompleksi Peshkopal i Bazilikës B

Agoraja e Bylisit është përfaqësuese e vetme e plotë e njohur deri më sot në qytetet ilire e kësaj hapësire publike në modelin e gjeometrizuar nëpërmjet kufizimit me një mur të veçantë dhe vendosjes skenografike të monumenteve kryesore, teatrit, stoave, stadiumit dhe ndërtesave të tjera shoqërore.

Model i saj me vendosje në harmoni planimetrike të monumenteve ka ndjekur parimin e zbatuara nga agoratë e tipit jonik, të zbatuara që në shek. IV p. Kr. në Magna Graecia, nga u sollën në Dodonë nga mbreti Pirro në çerekun e parë të shek. III p. Kr. Risia që

ka sjellur arkitekti bylin është zbatimi i saj i kombinuar me parimin e agorasë perspektive të Apollonisë, duke i ndërtuar monumentet në dy plane, me vendosjen skenografike të teatrit, që unifikon planin e sipërm të stoas me atë të poshtëm të stadiumit dhe prytaneionit.

Hyrja monumentale me ndërtimin e propileve ka qenë çelësi i leximit të kësaj vendosje dhe duhet të shërbejë si pikënisje për evidentimin e vlerave të agorasë.



Agoraja e bylisit në shek. III p. Kr. Planimetri nga n. Ceka, O. Ceka, P. Naipi.

Me themelimin e kolonisë romake të Bylisit nga Augusti rreth vitit 31 p. Kr., agoraja e Bylisit vazhdoi të përdorej si sheshi kryesor publik i qytetit, por duke pësuar ndryshime në formën dhe funksionin e saj. E gjithë fasha perëndimore e agorasë, që kishte mbetur e pan dërtuar për të lejuar shikimin e horizontit nga monumentet e periudhës byline, u përdor për shtrirjen e Forumit. Dy monumentet kryesore të identifikuar në këtë hapësirë janë termet e mëdha romake në anën jugore dhe tempulli i periudhës së Augustit në pjesën veriore. Të dy monumentet ende nuk janë gërmuar plotësisht dhe do të përbëjnë objektivat e ardhshme të kërkimeve arkeologjike në kuadrin e PM. Ndryshime të rëndësishme strukturore dhe funksionale pësoi edhe teatri, që u adoptua për ndeshjet me gladiatorë. Për këtë qëllim proskena dhe skena e periudhës byline u kthye në një frons scenae, duke zgjeruar hapësirën para saj, për tu përdorur për luftimet e gladiatorëve. Qoftë nga strukturat e ruajtura, ku u ripërdorën si spolie elementët më të hershëm arkitektonikë, qoftë nga dekoracionet, skena e periudhës romake nuk paraqet vlera të veçanta në krahasim me atë paraardhëse.

- Teatri

Është padyshim monumenti më i rëndësishëm i Bylisit jo vetëm për përmasat e tij impresionuese, por edhe për zgjidhjen arkitektonike. Megjithëse gjatë Antikitetit të Vonë është shkatëruar pjesa kryesore e ndërtesës së tij, teatri ruan plotësisht formën e *cavea-s*, si dhe të gjithë muret që përbënin strukturën e asaj ndërtese. Kjo ka dhënë mundësi për një rindërtim të saktë 3D të teatrit, si dhe klasifikimin e tij në tipologjinë e teatrove bashkëkohore. Si i tillë ai i takon tipit të teatrove të Magna Graecia të shek. III p. Kr., të karakterizuar nga forma gjysmë rrethore e *cavea-s*, me analema monolineare dhe proskenë të zhvilluar, për zhvillimin e performimit theatral. Prototipi i këtij teatri përfaqësohet në Dodonë rreth vitit 280 p. Kr., për t'u zbatuar përveç Bylisit në Finiq, Klos, apo Dimal rreth mesit të shek. III p. Kr. Teatri i Bylisit përfaqëson modelin më të zhvilluar arkitektonik të këtij tipi me krijimin e hyrjeve monumentale, të cilat unifikojnë për herë të parë *cavea-n* me ndërtesën e plotë të skenës, gjë që përbënte një mangësi të teatrit kanonik helen.

Gjendja e ruajtjes - Teatri i Bylisit ka qenë monumenti i parë i zbuluar përmes gërmimeve arkeologjike të viteve 1978-1981. Që në atë kohë u konstatua një ruajtje e ndryshme e pjesëve të tij në varësi të ndryshimeve që pati pësuar gjatë përdorimit të tij të gjatë që nga shek. III p. Kr. deri në fund të shek. III m. Kr., por kryesisht nga grabitja e pjesëve arkitektonike që u ripërdorën si spolie në ndërtimin e murit rrethues të Antikitetit të Vonë, apo djegies së tyre për t'u kthyer në gëlqere për të njëjtin mur. Si rrjedhim *cavea* e teatrit është krejtësisht e zhveshur nga ndenjëset dhe ruhet vetëm një pjesë e kokolit, ku kanë qenë vendosur orthostatet që veçonin proedrinë nga *cavea*. Një pjesë e stolave të proedrisë dhe të orthostateve ndarës të gjetura të lëvizur nga vendet e tyre, janë rivendosur përkohësisht në vendet e tyre të mundshme, por pa bërë plotësimet e pjesëve të munguara dhe pa integruar të gjitha ndenjëset e sjella. Të gjithë orthostate kanë gjurmët e goditjeve me plumba gjatë periudhës së turbullirave politike të vitit 1997, që kanë nevojë të restaurohen. Ka qenë restauruar përkohësisht edhe një sektor i vogël me ndenjëset e *cavea-s*, së bashku me një pjesë të murit të analemës veriore. Vendosje të përkohshme të pjesëve arkitektonike janë bërë edhe në proskenë me zhvendosjen e një frizi jonik, që ishte përdorur si spolie në zokolin e proedrisë, si dhe në parodos me vendosjen e një pilastrit. Në portikun e teatrit janë vendosur përkohësisht dy pilastra të hyrjes, një kolonë dorike të vetë portikut dhe janë ekspozuar mbi stilobat pjesët arkitektonike të antablementit.

Muret e analemave janë ruajtur në gjithë gjatësinë e tyre, por për shkak të mbulimit nga shtresa e shkatërrimeve të *cavea-s* janë ruajtur më mirë pjesët e poshtme deri në lartësi 3.60 m. Të dy këto mure janë restauruar menjëherë pas gërmimit me rivënien e blloqeve të rëna, ashtu si dhe muret anësore të dy parodoseve.

Në një gjendje më pak të ruajtur është zbuluar ndërtesa e skenës, ku diferencohet bazamenti i periudhës së parë me pllaka të mëdha gëlqerore nga rindërtimi masiv me

blloqe të lidhur me ganxha hekuri e plumb të periudhës koloniale romake. Është ruajtur në tërë gjatësinë e tij kanali i kullimit të ujërave, që kalon poshtë ndërtesës së skenës në formë tuneli, por nuk është ndjekur dot vazhdimi i tij drejt një cisterne të mundshme në sheshin para teatrit.

Ruajtja e mureve të **parodosve dhe analemave** nën nivelin e dikurshëm ka zbuluar mbushjet e tarracimeve prapa tyre, duke i ekspozuar ndaj erozionit. Kjo gjendje përsëritet në të gjithë sipërfaqen e *cavea-s*, që ka qenë mbushur për vendosjen e ndenjësve të shkallares. Grabitja e tyre në Antikitetin e Vonë e ka zbuluar atë mbushje, që në pjesën më të madhe është gërryer nga erozionet. Veçanërisht i theksuar është ky fenomen në pjesën veriperëndimore të *cavea-s*, që ka qene ngritur tërësisht me mbushje artificiale në nivelin e analemës.

Sipërfaqja e orkestrës ka pësuar dëmtime në gjithë harkun e euripus, pllakat e të cilit kanë qenë grabitur tërësisht. Pa gërmimit të tij i gjithë euripus është mbushur përsëri nga dherat e erroduara të *cavea-s*.

Në gjendjen e tanishme nuk është organizuar rruga e lëvizjes së vizitorëve, që shkelin mbi strukturat e teatrit, apo kalojnë pranë tij pa u njohur me elementet e monumentit. Leximi i formës së teatrit dhe funksioneve të pjesëve të veçanta të tij është shumë i vështirë për vizitorët, për shkak të shpjegimeve të pamjaftueshme të ofruara vetëm nga një tabelë e vogël shpjeguese dhe mungesa e plotë e mjeteve të tjera të informimit.

Gjendja e konservimit është mjaft e mirë pasi struktura ndodhet brenda Parkut Arkeologjik dhe konsiderohet e mbrojtur. Megjithatë, disa ndërhyrje diagnostikuese, konservuese dhe mirëmbajtjeje të zonës konsiderohen të mundshme, veçanërisht me synimin për një komunikim të ri dhe më modern të kontekstit arkeologjik. Më poshtë propozohen ndërhyrje të ndryshme për t'u zbatuar brenda një pjese të monumentit, e cila mund të përdoret si test për një ndërhyrje në të gjithë kompleksin.

Propozime për ndërhyrjet konservuese dhe restauruese


Nevojitet një projekt i veçantë për restaurimin e teatrit, për të arritur një restaurim të qëndrueshëm të strukturave origjinale të teatrit, si dhe për plotësimin e tyre sipas një modeli të studiuar, të adaptueshëm për zhvillimin e shfaqeve artistike. Kërkohen të kryhen gërmime arkeologjike në anën perëndimore për të parë edhe lidhjen e tij me stadiumin si dhe ndërhyrje restauruese dhe plotësimin e *cavea-s*.

Cavea dhe proedria. Në rradhë të parë është e nevojshme të restaurohet një pjesë e *cavea-s*

Restaurimi i **proedrisë**, duke përdorur ndenjëset origjinale, duke plotësuar ato të dëmtuara dhe duke riprodhuar elementet që mungojnë do të jetë pjesë e këtij, së bashku me plotësimin me të njëjtën mënyrë të ndarjes me orthostate.

Plotësimi i pjesës tjetër të *cavea-s* me mbushje dhe veshje të qëndrueshme bari është i nevojshëm për të mënjanuar erodimin e mëtejshëm të saj, si dhe për të krijuar një pamje të perceptueshme.

Parodoset dhe portiku i ndërtesës së teatrit. Duhet të paraqitet një projekt i veçantë për restaurimin e parodosit, i cili do të përmbajë anastilozën e elementeve të gjetur gjatë gërmimit me elementë që do të ribëhen me materiale të ngjashëm. Duhet të plotësohet edhe këndi i portikut që kufizon parodosin, duke kombinuar anastilozën e elementeve të kolonadës dhe entablementit me plotësimin e elementëve që mungojnë, të cilët do të përgatiten me material të ngjashëm. Duhet të plotësohen rreshta e sipërm të murit verior të analemës për të ndaluar erodimin e tarracës mbi parodos. Parodosi jugor do të ketë vetëm plotësime të murit të analemës dhe të atij jugor të parodosit në nivelin e dy rreshtave të domosdoshëm për leximin e monumentit, si dhe për mbrojtjen e dherave të tarracës nga erodimi.



Rikonstrukcioni virtual i pylon të parodosit verior. Skicë nga o. Ceka- I. Alia

Ndërtesa e skenës do të ketë vetëm ndërhyrje konservuese për konsolidimin e strukturave. Restaurimi i stilobatit të portikut do të jetë një nga ndërhyrjet për të konsoliduar pjesët e ruajtura dhe mundësuar leximin e planimetrisë. Dallimi i dy periudhave të ndërtimit do të jetë një nga synimet e kësaj ndërhyrje.

Analemat. Restaurimi i *cavea-s* do të bëjë të nevojshëm plotësimin e mureve të analemave, ku do të restaurohet vetë *cavea*. Duhet të restaurohen edhe pjesët fundorë të dy analemave, për të siguruar stabilizimin e mbushjeve të *cavea-s* prapa tyre nga gërryerja prej ujërave të shirave.

Cavea dhe Euripus. Për sigurimin e kalimit të vizitorëve, por edhe zhvillimit të shfaqjeve artistike sipërfaqja e *cavea-s* do të nivelohet dhe do të mbushet me çakull. Euripusi do të rigërmohet deri në nivelin e dikurshëm dhe do të restaurohet, për përcjelljen e ujrave që derdhen nga *cavea*. Do të pastrohet edhe kanali përcjellës poshtë ndërtesës së skenës dhe do të sigurohet përcjellja e ujrave jashtë teritorit të teatrit.

Masat ruajtëse dhe mirëmbajtja.

Vendosja e ndriçimit do të jetë pjesë e këtij kujdesi së bashku me vendosjen e kamerave vëzhguese për 24 h. Një ndriçim i veçantë do të jetë i nevojshëm për evidentimin e formës arkitektonike të monumentit, si dhe për zhvillimin e shfaqjeve artistike gjatë netëve. Instalimi i kamerave për vëzhgimin e monumentit gjatë 24 orëve do të jetë i domosdoshëm. Mirëmbajtja e monumentit pas investimit do të bëhet në praktikën e sotme të pastrimit periodik nga bimësitë dhe depozitimet nga erodimi, por do ketë një nevojë shtesë punëtore për ruajtjen e instalimeve elektrike, kamerave dhe elementeve plastike që do të aplikohen gjatë restaurimit.

Teatri përbën një nga zonat kryesore të tërheqjes së vizitorëve, për shkak të vlerave të veçanta arkitektonike, por edhe njërin nga elementet bazë të *brand-it* të Parkut Arkeologjik Bylis, për efektin që do të kenë ndërhyrjet restauruese dhe funksionin e tij për zhvillimin e shfaqjeve artistike.

Monumente të tjera:

Stoa A me gjatësinë prej 143 m në dy krahë, ndërtimin dykatësh dhe zbatimin e dy ordërave, dorik dhe jonik, është një monument më imponant i këtij tipi të arkitekturës ilire-epirote të shek. III p. Kr. Duke u nisur nga tipologjia e stoave me ante, me origjinë korintase, stoa e Bylisit ka marrë së pari funksionin e kufizimit të hapësirës së agorasë, si pjesë integrale e murit ndarës të saj. Gjithashtu, mund të thuhet se arkitekti bylin ka marrë si model stoaan e Apollonisë përse i përket funksionit të saj dhe volumetrisë dykatëshe me dy navata, por ka krijuar një tip të ri me dy krahë në forme të shkronjës L, si dhe me vendosjen e lirë të monumentit, ndryshe nga Apollonia, Butrinti, apo Antigonea, ku i mbështetej faqes së kodrës.

BYLLIS STOA A



Stoa A e Byllisit. Rikonstrukcion virtual i krahut lindor të monumentit nga N. Ceka-S.Çela

Përdorimi i kolonave dorike tetëfaqëshe mbi bazë eliptike ka qenë një risi tjetër e zhvilluar në adaptimin e modelit apolloniat. Punimi i një pjese të krahut lindor të stoas në shkëmb dhe ruajtja e punimeve për instalimin e dikurshëm të dyshemesë dhe çatisë së monumentit, japin mundësi për një lexim të lehtë të formës së dikurshme të tij nga vizitori. Ruajtja e elementëve të shumtë arkitektonikë, si kolona dhe kapitete, ofrojnë mundësi që të arrihet një vertikalizim i këtij leximi përmes anastilozës dhe plotësimit virtual të tij në pjesën më juglindore të monumentit. Çlirimi nga banesat e Antikitetit të Vonë që e vështiresojnë këtë lexim dhe që përmbajnë spolie të shumta, që mund të përdoren në anastilozë është një mundësi për të krijuar imazhin e plotë të monumentit.

Gjatë procesit të ndërhyrjes në Stoa A do të përdoret metoda e çlirimit të strukturave kryesore nga ndërhyrjet e mëvonshme, që pengojnë perceptimin e saktë të monumentit do t'i japë prioritet fazave më përfaqësuese dhe me vlera më të larta arkitektonike dhe historike të monumenteve.

Gjatë ndërhyrjeve do të synohet ruajtja maksimale e integritetit të ambientit dhe peizazhit, si dhe adaptimi i shtigjeve të lëvizjes së vizitorëve në përshtatje me urbanistikën e dikurshme të qytetit.

Stoa B përfaqëson një monument interesant për vendosjen e saj në funksion të teatrit, që përbën një zgjidhje ende të padëshmuar në Apolloninë fqinje. Këndi lindor i saj ruhet mjaft mirë, duke dhënë mundësi të perceptohet lehtësisht si funksion i teatrit edhe nga vizitori i thjeshtë. Ruajtja e dobët për shkak të shkatërrimit gjatë Antikitetit të Vonë, bën të vështirë leximin e planimetrisë së saj nga vizitori i thjeshtë. Ndërhyrjet konservuese restauruese duhet të evidentojnë formën e saj tipike të stoas me ante, ilire-epirote, njëlloj si ajo e stoas A, si dhe mundësojnë konsolidimin e strukturave

kryesisht në anën jugore nga dëmtimet e faktorëve atmosferikë, të cilat sot shfaqen të dëmtuara.

Stadiumi dhe cisterna e tij përfaqësojnë gjithashtu një kombinim interesant arkitektonik jo vetëm për arkitekturën ilire-epirote, por edhe për atë të antikitetit klasik. Ndërsa vendosja e stadiumit pranë teatrit në planin e agorasë është një përsëritje e modelit të zbatuar më herët në agoranë e Dodonës, forma e stadiumit dhe vendosja e cisternës përfaqësojnë një arritje origjinale arkitektonike. Ndryshe nga stadium i Amantias, që ka formën kanonike gjysmëeliptike të zgjatur, stadium i Bylisit ka vetëm një krah të vendosur në pjerrësinë e kodrës, duke shërbyer njëkohësisht në ndarjen, por edhe komunikimin e të dy planeve të agorasë. Pjesa më veriore e tij është punuar me shkallëzim të rregullt, për të krijuar aksesin në sheshin e stoas A, ndërsa pjesa më jugore është lënë vetëm në nivelin e pistës, për të plotësuar gjatësinë prej një stade (180 m) përpara teatrit.

Një veçori tjetër origjinale e stadiumit të Bylisit është gjerësia e vogël e shkallëve, që lejonte qëndrimin vetëm në këmbë të spektatorëve. Por origjinaliet kryesor në zgjidhjen e formës së stadiumit është shfrytëzimi i shkallares së tij për mbledhjen e ujrave të shirave gjatë dimrit dhe depozitimi i tyre në cisternën që gjendej poshtë pistës së tij. Gërmimi i cisternës, i filluar që në vitet '80, ka vazhduar me ndërprerje për tri dekada, për shkak të vështirësive që paraqet rindërtimi i pareteve dhe harqeve të rrëzuara të mbulesës së tij. Ruajtja pothuaj e plotë e materialeve ndërtimore në rrënojat e cisternës jep mundësi për një rikonstrukcion të plotë të saj. E rëndësishme është që anastiloza e monumentit të evidentojë vlerat konstruktive të monumentit, ku përdorimi i harqeve dhe qemerit për mbulimin e hapësirave të konsiderueshme përbën një nga arritjet kryesore të arkitekturës byline dhe asaj ilire-epirote në përgjithësi.

Propiletë dhe ndërtesat publike pranë tyre përbëjnë një kompleks origjinal të ruajtur relativisht mirë me elementë të kolonave dhe pilastrave, që ka dhënë mundësinë e anastilozës fillestare të tyre, krahas një rikonstrukcioni 3D të monumentit. Porta monumentale e agorasë e zgjidhur me krijimin e katër hapësirave kalimi midis një kolonade të ordërit jonik është e vetmja e këtij lloji e zbuluar në një qytet antik të vendit tonë. Me këtë formë dekorative monumentale ajo shënon edhe rastin e vetëm edhe në arkitekturën ilire-epirote. Dallimi është i qartë edhe me zgjidhjen e thjeshtë, pa asnjë veshje dekorative të propileve të agorasë së Apollonisë të ndërtuar afërsisht në të njëjtën periudhë të shek. III p. Kr.

Përdorimi i ordrit jonik në nivelin bazë, ndryshe nga përdorimi i ordrit solid dorik të propileve të njohura të arkitekturës Helene, është një risi tjetër e arkitekturës së Bylisit, që synonte që të theksonte elegancën e kolonadës së hyrjes në sfondin e

thjeshtë të murit dekorativ të agorasë të përshkuar prej saj. Si e tillë ajo formonte një kompleks arkitektonik me ndërtesën e prytaneionit, që ngrihej menjëherë në të djathtë të hyrjes, duke u dalluar nga brenda me kolonadën e tij të ordërit dorik. Anastiloza e përkohëshme e saj ka krijuar vertikaltetin aq të nevojshëm për leximin e kompleksit arkitektonik, si dhe për kuptimin e tërësisë së tij me përfshirjen edhe të ndërtesës së arsenalit. Ky kombinim monumentesh ishte i rëndësishëm për konceptin e vlerësimit të investimeve publike në atë periudhë të zhvillimit të demokracisë, ku ndërtesat administrative shprehnin një pamje modeste në krahasim me madhësinë e ndërtimeve të mëdha shoqërore, si teatri, stoat, apo stadiumi. Ndërhyrja konservuese- restauruese në këtë kompleks duhet të synojë evidentimin e këtyre vlerave të monumentit.

Bazilikat A, C, D dhe E përfaqësojnë një seri monumentesh me interes të veçantë shkencor, për studimin e historisë së arkitekturës së Antikitit të Vonë në territorin e Shqipërisë. Njëkohësisht, secila prej tyre dallohet për veçoritë arkitektonike dhe temat e ndryshme të realizuar përmes artit të mozaikëve.

Bazilika A karakterizohet nga mozaiku i ruajtur pothuaj plotësisht, me një pasuri të jashtzakonshme motivesh gjeometrike dhe nga jeta e natyrës, si dhe nga përshtatja e arkitekturës së saj ambientit të antikitetit, nga i cili kishte adoptuar shkallaren e stadiumit, murin ndarës të agorasë, si dhe stilobatin e Stoas A.

Bazilika C paraqet vlera të veçanta për skenat e mozaikëve, ku tregohet “Grigja e Krishtit” e 12 apostujve të simbolizuar nga qëngjat, si dhe paraqitja e murgjëve në procession. Mbishkrimi i peshkopit Praisos, të panjohur nga burimet historike, i jep atyre edhe një vlerë dokumentare.

Bazilika D krijon një kompleks me vendosjen e saj në sfondin e murit të Viktorinit dhe shënon një object të vizitueshëm në itinerarin turistik të Bylisit. Vlera të vecanta paraqet mozaiku me paraqitjen e katër Lumenjëve të Parajsës, të shoqëruar edhe me emra e tyre biblikë: Fison, Gjeon, Tigër dhe Euftrat.



BAZILIKA D. PAMJE NGA AJRI. FOTO A. PËRZHITA

Bazilika E përfaqëson fazën e fundit të zhvillimit arkitektonik të bazilikave në Bylis, si një tregues i vlefshëm edhe për studimin e këtij lloji monumenti kryesor në provincën e Epirit të Ri në periudhën e shek. V_VI m. Kr. kur ndodhi ky zhvillim.

Edhe dy ndërtime të tjera të kësaj periudhe duhen marrë në konsideratë për vlerat e tyre arkitektonike.

Termet e Justinianit pranë cisternës janë të vetmet e këtij lloji të zbuluara në vendin tonë dhe përfaqësojnë fazën e fundit të zhvillimit të këtij monumenti të rëndësishëm të arkitekturës romake-bizantine. Është me interes fakti se monumenti i Bylisit ka ruajtur gjithë strukturën tradicionale të termeve romake me ambientet e *caldarium* dhe *tepidarium* me *hypocaust*, por ka shfrytëzuar edhe cisternën antike të Bylisit, duke e bërë atë monumentin më jetëgjatë të Bylisit. Termet janë monumenti i rëndësishëm në konceptimin e zhvillimit të jetës në periudhën koloniale romake të Bylisit dhe është e nevojshme një evidentim i gjithë strukturës së monumentit. Kjo mund të arrihet edhe pa një gërmim të plotë të tij, por vetëm me gërmimin e gjerësisë së mureve të ambienteve të tij. Në këtë mënyrë do të plotësohej e gjithë planimetria e termeve, duke sqaruar edhe funksionin e ambienteve të saj.

Për shkak të nivelit të ulët të ruajtjes së mureve dhe ruajtjes së sipërfaqes së pa gërmuar rreth tyre do të jetë e nevojshme që të mbahet e gjelbër ajo sipërfaqe. Gjithashtu, nuk do të jetë i nevojshëm rrethimi i monumentit dhe do të mjaftonte hapja e shtegut turistik dhe vendosja e tabelave për termat dhe ndërtesën e gjimnazit që ndërthuret me të.

Ndërhyrja konservuese restauruese në termat romake dhe në gjimnazin pranë saj do të jetë pjesë e të njëjtit projekt të stadiumit dhe cisternës.

Banesat A, B dhe C dhe rrjeti rrugor

Ndërhyrjet konservuese-restauruese në sistemin urbanistik të Bylisit do të realizohen në këto drejtime:

Në shkallën më të gjerë ndërhyrjet konservuese do të synojnë të sigurojnë leximin e të gjithë monumenteve të zbuluara, kryesisht në territorin që përfshihet brenda murit të Viktorinit.

Banesa A duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjeve konservuese/restauruese, duke plotësuar kuadratin e stilobatit në anët veriore dhe lindore, në mënyrë që të ndalohet erodimi i truallit dhe të qartësohet tipologjia peristil e banesës. Propozohet të pastrohet plotësisht cisterna dhe do të restaurohet gryka e saj, duke e siguruar nga rënia e njerëzve, apo mbushja me mbeturina.

E njëjta procedurë do të ndiqet edhe për **banesën B**, me plotësimin e stilobatit, nivelimin e pjesës perëndimore për të penguar erodimin, pastrimin e cisternës, sigurimin e grykës së saj dhe konsolidimin e mbetjeve të afreskeve dekorative në murin lindor. Pastrimi i gjithë territorit që nga banesa deri në murin e agorasë nga grumbujt e gurëve është shumë i nevojshëm, ashtu si dhe plotësimi i gërmimit për të zbuluar lidhjen e shtëpisë me plateian në anën perëndimore të saj.

Banesa C, në Veri të asaj B, duhet të ketë kryesisht punime konsoliduese të mureve të ndërtuara me gurë e llac balte. Pastrimi i stenopoi që e ndan nga banesa B është i domosdoshëm për leximin e planimetrive dhe raportit të banesave me rrjetin rrugor.


Ndërhyrjet në sistemin rrugor, banesave dhe në terrenin e hapur midis monumenteve me largimin e dherave kërkojnë angazhimin për një kohë relativisht të gjatë të grupeve të vogla punëtoresh me mjete të lehta transporti, që mund të bëhet edhe nga vetë administrata e Parkut Arkeologjik.

VI. PËRSHKRIMI I NDËRHYRJEVE KONSERVUESE NË KLOS

Rrënojat Arkeologjike të Klosit përmban vetëm dy komplekse në të cilat mund të ndërhyhet për të siguruar ruajtjen e mëtejshme të monumenteve të tij, si dhe për të krijuar një atraksion turistik në kuadrin e Parkut Arkeologjik Bylis.

Krijimi i shtegut të vizitorëve dhe vendosja e sinjalistikës me tabelat shpjeguese do të jenë veprimet kryesore për lidhjen e Parkut Arkeologjik të Bylisit me Rrënojat Arkeologjike të Klosit. Aseti më i rëndësishëm arkitektonik i Klosit është **muri rrethues**, i cili përfaqëson modelin më të hershëm të arkitekturës ilire epirote me planimetrinë e thjeshtë, të përforcuar vetëm me bastione, por pa kulla, si dhe me prezencën vetëm të një hyrje kryesore, me strukturën e thjeshtë të mureve rrethuese dhe përdorimin e teknikës trapezoidale poligonale në fasadat e tyre. Ruajtja e tij në përmasa madhështore, veçanërisht në anët perëndimore dhe jugore të qytetit dhe aksesit relativisht të thjeshtë në vizitimin e tyre ofron një atraksion të rrallë turistik, si dhe një imazh të veçantë në perceptimin e përzgjedhjes së vendit dhe në fortifikimin e qytetit të hershëm antik ilir. Muri rrethues i Klosit ruhet mirë në gjithë gjatësinë e tij prej 1800 m, por ka tre pjesë të tij, të cilat mund të evidentohen në itinerarin turistik. Në anën veriperëndimore, në drejtim të Bylisit, gjendet **hyrja e vetme e qytetit antik**, e gërmuar dhe restauruar nga L. Papajani. Kjo është edhe hyrja për në lagjen e banuar që vazhdon të ekzistojë brenda mureve rrethuese. Gjendja e ruajtjes së tij është mjaft e mirë për shkak të pozicionit të izoluar dhe ndërprerjes së lëvizjeve brenda sipërfaqes së qytetit antik nga parcelizimi i saj nga gardhe të pakalueshme.

Një aset tjetër të rëndësishëm arkitektonik përfaqëson **teatri**, i vendosur në agoranë e qytetit, të eksploruar vetëm pjesërisht, por që identifikohet ashtu si ajo e Bylisit në llojin e agorave ilire-epirote të tipit të Magna Graecia. Edhe vetë teatri i takon të njejtit tip si Bylisi, me planimetrinë në formë gjysmë-rrethore dhe *analemat* monolineare. Ruajtja relativisht mirë e pjesës së *proedrisë* dhe parodosit lindor jep mundësi për përdorimin e tij në raste të veçanta për shfaqje artistike në koordinim me aktivitete kulturore në kuadrin e Parkut Arkeologjik Bylis.



Rikonstruksion ideal i teatrit të Klostit sipas L. Papajani

Monumentet e tjerë të Klostit, stoa dhe banesa, që ruhen në gjendjen e zbulimit mund të përfshihen në një itinerar vizite që pason atë të teatrit, duke krijuar edhe perspektivën e zgjerimit të zonës turistike përmes gërmimeve të ardhshme arkeologjike, të konsideruara të domosdoshme për këtë vendbanim.

SHTOJCA 3 - INICIATIVA TË TJERA

Këto iniciativa janë të rëndësishme për vizibilitetin e Bylisit dhe Klosit. Nuk është qëllimi i këtij plani menaxhimi të përgatisë dokumentet e nevojshme për secilën nga këto iniciativa, por, bazuar në vlerat dhe potencialin e evidentuar në këtë dokument, administrata e Bylisit dhe Klosit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit duhet të shikojë mundësinë për të përfshirë këto dy site në këto iniciativa, duke përgatitur materialet e nevojshme në përputhje me kriteret e kërkuara.

Programi Rrugët Kulturore të Këshillit të Evropës

Nisur nga Këshilli i Evropës në vitin 1987, Rrugët Kulturore demonstrojnë, përmes një udhëtimi nëpër hapësirë dhe kohë, se si trashëgimia e vendeve dhe kulturave të ndryshme të Evropës kontribuon në një trashëgimi kulturore të përbashkët dhe të gjallë. Certifikimi 'Rruga Kulturore e Këshillit të Evropës' është një garanci e përsosshmërisë. Një herë në vit, ky certifikim iu jepet rrjeteve të krijuara ligjërish, të cilat fokusohen në një temë europiane dhe zhvillojnë aktivitete në të paktën tre shtete anëtare të Këshillit të Evropës.

Certifikimi u jep shikueshmëri iniciativave europiane që sjellin në jetë vlerat e Këshillit të Evropës, si diversiteti kulturor, dialogu ndërkulturor dhe shkëmbimet reciproke përtej kufijve. Përmes programit 'Cultural Routes – Rrugët Kulturore', Këshilli i Evropës ofron një model për rrjetet transnacionale që punojnë në promovimin e trashëgimisë europiane. Rrugët Kulturore bashkojnë, për të përmendur vetëm disa, vende të trashëgimisë, universitete, autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale, si dhe palët e interesuara socio-ekonomike si SME-të dhe operatorët turistikë.

Zhvillimi i një Rruge Kulturore kërkon: Përcaktimin e një teme

Hapi 1

Identifikimin e elementeve të trashëgimisë

Hapi 2

Krijimin e një rrjeti European

Hapi 3

Koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta

Hapi 4

Krijimin e vizibilitetit të përbashkët

Hapi 5

Rregullat për dhënien e certifikatës si 'Rruga Kulturore e Këshillit të Evropës' janë përcaktuar në Komitetin e Ministrave CM/Res(2013)67. Këto rregulla përfshijnë kriteret të caktuara që duhen përmbushur për të garantuar se rrugët e propozuara respektojnë parimet dhe vlerat e Këshillit të Evropës. Aktualisht, në Shqipëri, katër Rruga Kulturore të Këshillit të Evropës, si anëtare të rrjetit, janë paraqitur dhe listuar si vijon:



FOTO 2 RRUGET E PEMES SE ULLIRIT, VITI 2005 [SOURCE [HTTPS://WWW.COE.INT/EN/WEB/CULTURAL-ROUTES/ALBANIA](https://www.coe.int/en/web/cultural-routes/albania)]



FOTO 3 RRUGA E FENIKASVE, VITI 2003 [SOURCE [HTTPS://WWW.COE.INT/EN/WEB/CULTURAL-ROUTES/ALBANIA](https://www.coe.int/en/web/cultural-routes/albania)]



FOTO 4 ATRIUMI - VITI 2014 [SOURCE [HTTPS://WWW.COE.INT/EN/WEB/CULTURAL-ROUTES/ALBANIA](https://www.coe.int/en/web/cultural-routes/albania)]



FOTO 5 RRUGE ENEAS - VITI 2021 [SOURCE [HTTPS://WWW.COE.INT/EN/WEB/CULTURAL-ROUTES/ALBANIA](https://www.coe.int/en/web/cultural-routes/albania)]

Është e rëndësishme që Parku Arkoelogjik i Bylisit dhe Klosit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe partnerë të shikojnë mundësinë për të përfshirë Bylisin dhe Klosin në një nga rrugët kulturore të KiE ose propozimin e një rruge të re të mundshme.

Çmimet e Trashëgimisë Evropiane / Çmimet Europa Nostra

[burimi: <https://www.europeanheritageawards.eu/>]

Çmimet e Trashëgimisë Evropiane/Çmimet Europa Nostra u prezantuan në vitin 2002 nga Komisioni Evropian dhe që atëherë janë organizuar nga Europa Nostra. Këto çmime promovojnë praktikën më të mirë në fushën e ruajtjes, menaxhimit, kërkimit, edukimit dhe komunikimit të trashëgimisë. Përmes kësaj skeme çmimesh, kontribuohet në një njohje më të fortë publike të trashëgimisë kulturore si një burim strategjik për shoqërinë dhe ekonominë e Evropës.

Çmimet nderojnë çdo vit deri në 30 arritje të jashtëzakonshme të trashëgimisë nga të gjitha pjesët e Evropës. Deri në katër prej tyre zgjidhen si laureatë të Çmimit të Madh dhe njëri merr Çmimin e Zgjedhjes Publike, i cili zgjidhet nëpërmjet një sondazhi online. Të gjithë fituesit marrin një certifikatë si dhe një pllakë. Laureatët e Grand Prix (Çmimit të Madh) marrin gjithashtu 10,000 euro secili. Juritë e specializuara, të përbëra nga ekspertë të pavarur, vlerësojnë aplikimet dhe përzgjedhin fituesit në të katër kategoritë.

1. Konservimi

Arritje të jashtëzakonshme në ruajtjen, përmirësimin dhe përshtatjen ndaj përdorimeve të reja të trashëgimisë kulturore.

2. Hulumtimi

Projekte të shkelqyera kërkimore dhe transferim të njohurive që çojnë në efekte të prekshme në ruajtjen dhe përmirësimin e trashëgimisë kulturore në Evropë.

3. Shërbimi i përkushtuar nga individë apo organizata

E hapur për individë ose organizata, kontributet e të cilëve, për një periudhë të gjatë kohore demonstrojnë përsosmëri në mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e trashëgimisë kulturore në Evropë.

4. Edukimi, trajnimi dhe ndërgjegjësimi

Nisma të jashtëzakonshme në lidhje me edukimin, trajnimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe/ose jomateriale, për të promovuar dhe/ose për të kontribuar në zhvillimin e qendrueshem të mjedisit.

European Heritage Awards – Çmimet e Trashëgimisë Europiane në Shqipëri janë fituar tre herë nga:

Fondacioni Gjirokastra

Kategoria: Shërbim i Dedikuar

Fondacioni Gjirokastra, i themeluar në vitin 2001, është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e saj për përfitim social dhe ekonomik të zonës së shquar të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, të Gjirokastrës dhe rrethinave të saj. Puna e Fondacionit ka ruajtur në vazhdimësi trashëgiminë e shquar të Gjirokastrës përmes mbështetjes së rivitalizimit të qendrës së saj historike dhe prezantimit të parimeve dhe praktikave më të mira europiane për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë.

“Kampet Rajonale të Restaurimit të Trashëgimisë Kulturore pa Kufij”

Kategoria: Trajnim Arsimor dhe Ndergjegjësim

Kampet rajonale të restaurimit të CHwB (Trashëgimia Kulturore pa Kufij) janë pjesë e një shtytjeje në mbarë Ballkanin për të inkurajuar njerëzit që të vlerësojnë dhe kujdesen për trashëgiminë e tyre lokale. Ato përfaqësojnë një model trajnimi të thjeshtë dhe të suksesshëm, i cili është rritur, gjatë shtatë viteve të fundit, nga pak studentë në Shqipëri në sesione të shumta, në katër vende (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi) me pjesëmarrës nga tetëmbëdhjetë vende të tjera. Synimet janë përdorimi i trashëgimisë kulturore për të ndërtuar marrëdhënie midis profesionistëve të rinj, duke krijuar kushte për pajtim si parakusht për paqen dhe demokracinë, si dhe për të ruajtur zanatet dhe teknikat tradicionale.

Kisha e Shën Gjergjit

Kategoria: Ruajtje

Qëllimi i projektit ishte restaurimi i kishës së Shën Gjergjit në fshatin Shipskë të qarkut të Korçës në Shqipëri. Kisha është një bazilikë trepjesëshe e mesit të shekullit të 17-të, me një sistem çati me harqe, qemere dhe kupola, stabiliteti i përgjithshëm i së cilës ishte në rrezik të madh. Restaurimi filloi në vitin 2004 me një ekip ekspertësh të koordinuar nga arkitekti i projektit dhe Fondacioni Egnatia Epirus.

“Jurisë i la mbresë suksesi i këtij projekti restaurues, i cili gëzoi mbështetje të fortë nga popullsia vendase dhe nga Fondacioni “Egnatia Epirus” dhe autoritetet lokale. Kjo arritje e jashtëzakonshme u bë katalizator për rigjallërimin e vendbanimit të Shipskës, duke rezultuar në rihapjen e kishës për ceremonitë fetare dhe zhvillimin e aktiviteteve të reja turistike.”

Çertifikimi ndërkombëtar HERITY

Çertifikimi Ndërkombëtar HERITY

Burimi: <http://www.herity.it/33434/index.html>

HERITY, nga bashkimi i dy fjalëve angleze 'Heritage' (trashëgimi) dhe 'Quality' (cilësi), është Organizata Botërore Jofitimprurëse dhe Joqeveritare për Çertifikimin e Cilësisë së Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore. Kardinali Francesco Marchisano ishte President i HERITY International deri në korrik 2014, ndërsa Presidenti i HERITY Itali është senatori Tullia Romagnoli Caretoni. HERITY është i pranishëm edhe në vende të tjera, si Spanja, Brazili, Portugalia, Suedia, Mbretëria e Bashkuar, Lituania, Republika Çeke, Franca, Turqia, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe po përhapet me shpejtësi.

Duke u nisur nga kriteret e pranuar shkencërisht, por në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme, HERITY:

- i ofron publikut informacion që i lejon ata të vendosin nëse do të vizitojnë apo jo një pasuri kulturore;
- inkurajon pronarët dhe menaxherët e aseteve që të vlerësojnë dhe ruajnë më mirë asetet e tyre përgjegjëse.

Në hyrje të çdo muzeu, monumenti, mjedisit të jashtëm, biblioteke, arkivi, publik ose privat të hapur për publikun, simboli HERITY, i ngjashëm me një objektiv, tregon qartë dhe paraprakisht vizitorit për vitin aktual, nivelin e arritur nga 1 në 5 në lidhje me 4 kriteret e mëposhtme:

a) perceptimi i vlerës kulturore (RELEVANCA);

b) gjendja e mirëmbajtjes dhe restaurimit (KONSERVIMI);

c) informacioni i transmetuar vizitorit (KOMUNIKIMI);

d) cilësia e pritjes (SHËRBIMET).

Etiketa e Trashëgimisë Evropiane

Burimi: <https://ec.europa.eu/culture/cultural-heritage/initiatives-and-success-stories/european-heritage-label-sites>

Etiketa e Trashëgimisë Evropiane ka disa dallime në krahasim me Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Vendet e Trashëgimisë Evropiane sjellin në jetë narrativën europiane dhe historinë pas saj dhe fokusohen në promovimin e vlerave simbolike europiane dhe rolin e rëndësishëm që këto vende kanë luajtur në historinë dhe kulturën e Evropës. Ato ofrojnë gjithashtu aktivitete të vlefshme arsimore, veçanërisht për të rinjtë. Vendet e Trashëgimisë Evropiane mund të shihen veçmas ose si pjesë e një rrjeti. Vizitorët mund të marrin një ndjenjë të vërtetë për gjerësinë dhe shkallën e asaj që Europa ka për të ofruar dhe çfarë ka arritur. Që nga viti 2013, janë caktuar 48 site të vlerësuara, por fatkeqësisht Shqipëria nuk është përfshirë në listën e vendeve.



[source: <https://geo.osnabrueck.de/eh/EN/map>]

SHTOJCA 4 - SONDAZHI PYETËSORË / ANKETIM

Vëzhgimin e komunitetit për banorët e fshatrave pranë Parkut Arkeologjik të Bylisit (Bashkia Mallakastër)

ANKETIM: RRETH 665 FAMILJE / NXËNËS / FSHATARË / PUSHTETI LOKAL / BIZNESI

METODA E PËRDORUR: INTERVISTAT NGA AFËR

PERIUDHA: Shtator 2021 – Dhjetor 2021

Një pyetësor është një metodë e strukturuar kërkimore që lejon portretizimin e një grupi të caktuar të përzgjedhur si përfaqësues të të gjithë grupit që është i hulumtuar. Pyetësorët zbulojnë të dhënat statistikore që mund të lexohen dhe interpretohen në bazë të interesit të caktuar. Prandaj, është thelbësore të përcaktohet paraprakisht dhe në mënyrë të saktë dukuria/bashkësia mbi të cilën kryhet hulumtimi, pra njohuritë e reja të kërkuara që do të merren përmes anketimit. Është gjithashtu e rëndësishme të shqyrtohen njohuritë ekzistuese mbi këtë temë për të përcaktuar më mirë objektivin e anketës dhe për të zhvilluar metodologjinë më të përshtatshme. Të dhënat dhe hulumtimet empirike kryhen për të kuptuar, vendosur, diskutuar dhe bindur. Përdorimi i një sondazhi të fokusuar në jetën shoqërore dhe në ndikimin që kanë iniciativat lokale në të, është i nevojshëm dhe me qëllim për të organizuar veprime me interes kolektiv. Pyetësi dhe administrimi i tij përmes intervistave janë mjeti dhe teknika e mbledhjes së të dhënave që plotësojnë këto nevoja. Besueshmëria e të dhënave të ofruara nga një ankete bazohet në besueshmërinë metodologjike të atyre që kryejnë anketën dhe në njohuritë e tyre paraprake për popullsinë në fjalë.

Në këtë rast, pyetësi u drejtua te rreth 650 njesi familjare dhe përfshin të gjithë banorët e zonës rurale pranë Parkut Arkeologjik Bylis dhe vendbanimeve urbane fqinje. Ky pyetësor është i ndarë në tre fusha kërkimore:

- Te dhëna statistikore (pyetjet nga 1 deri në 8).
- Perceptimi i vlerës së territorit (pyetjet nga 9 deri në 12).
- Mundësia për të përfshirë komunitetin lokal (pyetjet nga 13 deri në 16).

Më konkretisht, të dhënat statistikore janë të nevojshme për të marrë shembuj përfaqësues të komunitetit lokal në aspektin statistikor. Këto të dhëna paraqesin bazën mbi të cilën mund të zhvillohen kërkime të mëtejshme sociale të targetuara dhe për të përcaktuar politikat e zhvillimit lokal. E fundit ka të bëjë me mundësinë për të përfshirë komunitetin lokal në programe, veprime, aktivitete dhe për territorin. "Angazhimi i komunitetit" mund të bëhet me një strategji dhe një planifikim hap pas hapi.

AFATI KOHOR I SONDAZHIT

Faza	Periudha administrimit	Rezultati
Intervista telefonike	Shtator 2021	Mbledhja e të dhënave të para
Intervista direkte	Shtator 2021	Mbledhja e të gjitha të dhënave
Analiza sasiore	Tetor 2021	Raporti sasior me tabelat
Mbledhja e të dhënave në formatin Excel ose Access	Tetor – Nentor 2021	Raporti final

ANALIZA E SONDAZHIT

Hulumtimi ynë shqyrton se si banorët e fshatrave pranë Parkut Arkeologjik Bylis (Bashkia e Mallakastrës) e perceptojnë Parkun dhe nëse mund të arrihet ndonjë përfitim.

METODOLOGJIA

FUSHA: STUDIMI ËSHTË KRYER NË PERIUDHËN NGA 21.09.2021 DERI NË 26.09.2021

TARGET SHEMBULLI: 18+ VJEÇ

VENDNDODHJA: BALLSH, HEKAL, KLOS, POCEM, ARANITAS, FRATAR, GRESHICE, KUTE, NGRACAN, QENDER, SELITE

NUMRI I TARGET SHEMBULLIT: 665 INTERVISTA

NDARJA: NGA GJINIA, MOSHA, RAJONI

LLOJI I STUDIMIT: F2F (CAPI) SONDIM


KOHËZGJATJA E INTERVISTËS: RRETH 10 MINUTA

REZULTATET

STRUKTURA E MODELIT

- Modeli i anketimit është i mirëstrukturuar dhe i balancuar për sa i përket gjinisë dhe grupmoshave, duke arritur objektivat për të qenë përfaqësues i një pjese të madhe të grupeve të targetuara të përfaqësuesve që jetojnë pranë Parkut Arkeologjik Bylis.
- Të anketuarit në anketë janë kryesisht banorë në zonat rurale (75%). Kjo mund të ndikojë në perceptimin mbi përfitimet e zhvillimit të parkut arkeologjik, në gjenerimin e të ardhurave dhe mundësive të punësimit për komunitetin lokal, të ndikuar nga diversiteti i lartë i sektoreve ekonomike të përfshira (kultura dhe turizmi kundrejt ekonomisë rurale). Prandaj, përgjigjet e anketës duhet të vlerësohen duke marrë parasysh këtë aspekt.
- Popullsia totale e targetuar për të gjitha përgjigjet është 865 të anketuar (të gjithë të kontaktuarit)


GRUPET GJINORE DHE MOSHA




PËRCEPTIMI I PËRFITIMEVE TË PARKUT ARKEOLOGJIK

80% e të anketuarve deklarojnë se kanë vizituar zonën e Parkut Arkeologjik të Bylisit. Për më tepër, shumica e të anketuarve (95%), pavarësisht se kanë vizituar apo jo Parkun Arkeologjik, e konsiderojnë atë si përfitues për zonën ku jetojnë.


Duke pasur parasysh se 75% e të anketuarve jetojnë në zona rurale, është shumë interesante të vërehet se shumë prej tyre kanë vizituar tashmë parkun arkeologjik, i cili konsiderohet kryesisht një përfitim për vetë zonën. Ky reagim pozitiv është shumë i rëndësishëm për Planin e Menaxhimit të Parkut dhe strategjinë e tij.

 Po, mendoj se është i dobishëm

 Jo, nuk mendoj se është i dobishëm


Shumica e të anketuarve (95%) mendojnë se punimet dhe investimet në zonën e Parkut Arkeologjik do të sjellin përfitime për komunitetin.

Pavarësisht konsensusit të madh për zhvillimin e parkut, një pjesë e vogël e të anketuarve (12%) kanë një perceptim negativ për ndikimin e investimeve të parkut, dhe të njëjtët ose më shumë janë shqetësuar për efikasitetin e investimeve dhe hapjes së parkut, në termat e përgjithshëm të ndikimeve dhe përfitimeve ekonomike pozitive për komunitetin lokal.



Mendoni se punimet në park, siç janë ndërtimet e një hyrje, rrethimi, tualetet dhe ambjentet e restorantit, krijimi i rrugëve dhe vendeve të parkimit, etj., do të çojnë në shtimin e turistëve:


92% e të anketuarve mendojnë se hapja e parkut arkeologjik të Bylisit do të sjellë një zhvillim të përgjithshëm ekonomik. Megjithatë, vetëm 68% e tyre mendojnë se ky zhvillim do të shfrytëzohet për të mirën e të gjithë territorit.



MUNDËSIA E PËRFSHIRJES SË KOMUNITETIT LOKAL

GJASAT PËR TË PUNUAR PËR PARKUN ARKEOLOGJIK


Kur u pyetën për gjasat për të punuar për Parkun Arkeologjik ose për industrinë e turizmit të zhvilluar prej tij, vetëm 58% e të anketuarve shprehën interesin e tyre, veçanërisht në mesin e atyre me të ardhura personale më të ulëta.



SEKTORËT E PUNËSIMIT ME INTERES


Duke marrë parasysh 58% të të interesuarve, pastrimi i hapësirave të jashtme në Park, Biletaria dhe Dyqani i produkteve tipike dhe artizanatit vendas janë sektorët më të preferuar për të punuar nga të anketuarit. Gratë janë më të gatshme të punojnë në sektorin e hotelerisë, ndërsa burrat si oficerë biletash. Në përgjithësi, të gjitha këto

interesa në sektorin e turizmit janë të rëndësishme si për punëtorët ashtu edhe për pronarët e ndërmarrjeve, ekzistuese apo potenciale.



SEKTORËT QË PËRFITOJNË MË SHUMË NGA NDËRHYRJET NË PARK


Të anketuarit mendojnë se ndërhyrjet në Parkun Arkeologjik të Bylisit do të jenë të dobishme veçanërisht për përmirësimin e logjistikës dhe transportit në zonë (68%), si dhe për konsumin e produkteve ushqimore vendase dhe rritjen e mundësive të punësimit në zonë (përkatesisht 62%).




FESTAT VJETORE TË KOMUNITETIT

Shumica e të anketuarve (81%) janë të vetëdijshëm për festën vjetore të komunitetit. Më shumë se gjysma e të anketuarve (59%) janë të informuar se këto festime organizohen nga administrata komunale.


Does the community have an annual party



Organizing actors of the community annual party



Reasons for not participating in the annual community celebration




Shumica dërrmuese e të anketuarve (95%) mendojnë se duhet organizuar një datë vjetore për festën e komunitetit. Për më tepër, ata besojnë se ngjarjet e komunitetit tërheqin vizitorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë (94%).

Kjo përgjigje është shumë e rëndësishme për planin e menaxhimit të parkut arkeologjik, sepse mund të jetë një mundësi për të krijuar një festë të re vjetore të komunitetit lidhur me hapjen e parkut. Në këtë mënyrë, ndërgjegjësimi për parkun mund të forcohet çdo vit duke menduar një ngjarje lokale.

DEMOGRAFIA

Demografia e të anketuarve paraqet një pamje të një numri të madh grupesh dhe llojesh socio-ekonomike, bazuar në nivelin e arsimit (gjithsej 4), statusin e punesimit (gjithsej 11) dhe gjuhën e folur (gjithsej 7).

NIVELI ARSIMOR DHE STATUSI I PUNËSIMIT




FOKUSI MBI ZONËN RURALE

Pavarësisht se 75% e të anketuarve jetojnë në zonën rurale, nuk janë vërejtur dallime domethënëse në përgjigjet e përgjithshme në lidhje me njerëzit që jetojnë në qytet. Pozitivisht, banorët e fshatit janë të interesuar të punojnë në park (58%), kryesisht në shërbimin e pastrimit ose në zyrën e biletave, megjithëse 24% e tyre nuk e vizitojnë kurrë parkun ose nuk marrin pjesë në ngjarje të komunitetit lokal. Shumica e tyre i konsiderojnë ngjarjet lokale ekzistuese, ose të ardhshme, tërheqëse për vizitorët vendas dhe ndërkombëtarë.

Në lidhje me përdorimin e telefonit inteligjent dhe aftësitë digjitale, 1/3 e njerëzve rurale nuk e njohin telefonin inteligjent ose nuk e zotërojnë një të tillë, në të vërtetë vetëm 26% e tyre marrin lajme nga mediat sociale ose mesazhet e çastit (në zonën urbane është 35%).

Si përmbljedhje, personat mbi 50 vjeç jetojnë në zona rurale, ndërsa të rinjtë (mbi 30) preferojnë zonën urbane.



GJETJET KRYESORE TË SONDAZHIT DHE KONKLUZIONI

Në përgjithësi, ndikimi pozitiv ekonomik i zhvillimit të parkut arkeologjik u perceptua nga shumica e të anketuarve, të cilët pohuan se turizmi kombëtar dhe ndërkombëtar do të ndihmojnë në gjenerimin e të ardhurave dhe mundësive të punësimit për komunitetin lokal. Edhe pse u regjistrua një interes i ulët për të punuar drejtpërdrejt ose indirekt në park dhe për parkun, 68% e të anketuarve ranë dakord se zhvillimi i parkut mund të kontribuojë në përmirësimin e transportit lokal dhe në rritjen e mundësive të punësimit në zonë.

Përmirësimi i komunikimit të nismave dhe ngjarjeve lokale, qoftë edhe me modalitetet digjitale, mund të kontribuojë në rritjen e perceptimit të përfitimeve të parkut arkeologjik.

Zhvillimi i zonës me parkun arkeologjik dhe ambientet akomoduese për turistët konsiderohet si një ndikim pozitiv në ekonominë vendase, pothuajse nga të gjithë të intervistuarit, pavarësisht nëse e kanë vizituar parkun apo jo..

- 95% e të anketuarve konsiderojnë si të dobishme të kenë një Park Arkeologjik në zonën e tyre të banimit. Shumica e tyre (88%) besojnë se investimi në këto fusha do të sillte përfitime në përgjithësi. Shumica dërrmuese e të anketuarve (92%) besojnë se hapja e Parkut Arkeologjik do të ndikonte në një zhvillim të përgjithshëm ekonomik, megjithëse vetëm 68% e tyre mendojnë se zhvillimi do të shfrytëzohet për të mirën e të gjithë territorit.
- Më shumë se gjysma e të anketuarve (58%) shprehin interesimin e tyre për të punuar në Parkun Arkeologjik. Pastrimi i hapësirave të jashtme në Park, Biletat dhe Dyqani i produkteve tipike dhe artizanatit vendas, janë sektorët më të

preferuar për të punuar nga të anketuarit. Të anketuarit mendojnë se ndërhyrjet në Parkun Arkeologjik të Bylisit do të jenë të dobishme veçanërisht për përmirësimin e logjistikës dhe transportit në zonë (68%), konsumimin e produkteve ushqimore vendase dhe ofrimin e më shumë mundësive të punësimit (përkatesisht 62%).

GRUPET E FOKUSIT

METODOLOGJIA E GRUPEVE TË FOKUSIT

MODELI I PRITUR: NGA 6 NË 10 PERSONA PËR ÇDO TARGET GRUP

METODA E KËRKUAR: GRUP I PUNËS BALLË PËR BALLË OSE I BAZUAR NË FAQEN E INTERNETIT

PERIUDHA: NËNTOR 2021 – SHKURT 2022

Një grup fokusi është një teknikë kërkimore që përdoret për të mbledhur të dhëna përmes ndërveprimit në grup. Grupi përbëhet nga një numër i vogël njerëzish të përzgjedhur me kujdes që diskutojnë një temë të caktuar. Grupet e fokusit përdoren për të identifikuar dhe zbuluar se si njerëzit mendojnë dhe sillen, dhe ato hedhin dritë mbi pyetjet pse, çfarë dhe si.

Ato mund të përdoren në tre mënyra në hartimin e kërkimit:

- Të Veçuar – ku grupet e fokusit janë metoda e vetme e mbledhjes së të dhënave dhe ato shërbejnë si burimi kryesor i të dhënave.
- Suplementar – përdoret për të përmirësuar mjetet alternative të mbledhjes së të dhënave. Zakonisht kjo do të ishte si një pararendës i një faze sasiore - përcaktimi i çështjeve që do të mbulohen në intervistën e strukturuar dhe dhënia e njohurive për problemet ose mundësitë që po hulumtohen.
- Si Pjesë e një Modeli me Shumë Metoda – ku studimet përdorin disa burime të mbledhjes së të dhënave dhe asnjë metodë nuk përcakton përdorimin e të tjerave.

Grupet e fokusit ofrojnë një mjet për mbledhjen e informacionit që është subjektiv, duke kërkuar përgjigje për pyetjet e hapura, si në këtë rast 'Si përfitojnë zonat lokale nga restaurimi dhe menaxhimi i ri i PAB?'. Fokus grupet ofrojnë gjithashtu një platformë të shkëlqyeshme për nxjerrjen e kërkesave dhe kuptimin e lehtësuesit dhe çdo vëzhguesi në fazat e planifikimit, duke ndihmuar në krijimin e udhëzuesve të temave që formojnë diskutimin.

AFATI KOHOR I GRUPEVE

Faza	Periudha e Administrimi	Rezultati
Mbledhja e emrave dhe kontakteve per te krijuar 2 grupe fokusi(maks. 16 personane ne total)	Nentor 2021	Mbledhja e kontakteve
Takimi me Fokus Grupin e pare (maks. 8 persona)	Nentor 2021	Mbledhja e opinioneneve
Takimi me Fokus Grupin e dyte(maks. 8 persona)	Nentor/Dhjetor 2021	Mbledhja e opinioneneve
Analiza sasiore dhe cilesore	Shkurt 2022	Raporti final Infografik

TARGET GRUPET

Fokus grupet jane pjese e nje modeli me shume metoda. Pyetesoret i jane drejtuar popullates lokale, fokus grupet do te perfshijne 4 grupe te tjera te(targetuara) synuara:

1. Bashkesite Lokale
2. Opinioni Publik Kombetar
3. Udhetaret nderkombetare
4. Opinionberesit sektoriale kombetare dhe nderkombetare.


CESHTJET	NDRYSHIMET	BURIMI TË DHENAVE
Çështja: Perfitimi lokal ndaj turizmit		
Niveli i kënaqësisë së komunitetit	Ndryshimet në Perfitim mund të jenë një tregues paralajmërues një mjet për të vëzhguar informacionin në lidhje me problemet. Kjo është një masë e drejtpërdrejtë e opinionit aktual dhe është mënyra më e drejtpërdrejtë për të matur opinionin lokal të turizmit dhe efektet e tij.	Pyetësi i komunitetit
Numri i ankesave nga banorët lokal	Për sa i përket reagimit lokal, perceptimi mund të jetë më i rëndësishëm se çdo masë objektive. Monitorimi i ankesave është më pak përfaqësues i të gjitha mendimeve, por mund të jetë një sistem paralajmërues i hershëm për shfaqjen e pakënaqësisë. Mund të ndihmojë në hartimin e çdo pyetësi të përdorur për të matur çështjen në mënyrë më objektive	Autoritetet lokale, duhet te pajisen me regjistrin e ankesave
Çështja: Efektet e turizmit në komunitete		
Përfitimet shoqërore të lidhura me turizmin	Numri i shërbimeve sociale në dispozicion të komunitetit me turizmin (% që i atribuohen turizmit) Numri (%) i pjesëmarrësve në zanatet, aftësitë dhe zakonet tradicionale të komunitetit; % e arkitekturës vernakulare të ruajtur.	Autoritetet lokale Pyetësi i komunitetit
Ndikimet e përgjithshme në jetën e komunitetit	Numri i turistëve në ditë, në javë, etj Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit; % pjesëmarrje në evente të komunitetit; Raporti i turistëve me vendasit në evente; Perceptimi i ndikimeve negative në komunitet;	Pyetësi i komunitetit
	-% e bashkësisë lokale që pajtohet që kultura e tyre lokale, integriteti dhe autenticiteti janë në ruajtje)	
Ndryshimet kulturore	% e banorëve që ndryshojnë nga profesioni tradicional në turizëm gjatë vitit (eve) të mëparshëm; burra dhe gra; Numri ose % e banorëve që vazhdojnë me veshjet lokale, zakonet, gjuhën, muzikën, kuzhinën, fenë dhe praktikat kulturore.	Pyetësi i komunitetit


	(p.sh. ndryshimi i numrit të banorëve lokalë që marrin pjesë në eventet tradicionale) Rritja/zvogëlimi i aktiviteteve kulturore ose eventeve tradicionale; Vlera e kontributit turistik në kulturën lokale (shuma e marrë nga aksesi , shuma e dhurimeve) % e vendasve që gjejnë mundësi të reja rekreative të lidhura me turizmin	
Çështjet e strehimit	– % e strehimit të përballueshëm për banorët; – Numri i njësisve të reja të strehimit dhe % për banorët lokalë	Pyetësi i komunitetit
Demografia e komunitetit	– Numri i banorëve që janë larguar gjatë vitit të kaluar; – Numri i emigrantëve (banorë të përkohshëm ose të rinj) që punojnë në turizëm gjatë vitit të kaluar; – Migrimi neto brenda/jashtë komunitetit (rendit sipas moshës së emigranteve dhe migranteve)	Pyetësi i komunitetit
Çështja: Aksesi nga banorët lokalë në pasuritë kryesore		
Hyrja ne Park Arkeologjik nga banoret lokale	Hyrja nga vendasit në sitet kryesore (% e sitit me akses të lirë për publikun) Shpeshësia e vizitave nga vendasit në sit (et) kryesore - përfshirë	Menaxhimi


SHTOJCA 5 - SKEDAT E PARKUT BYLIS DHE KLOS


Bylis



1. Terma antikitetit te vone Justiniani
2. Bazilika A
3. Katedralja ,
4. Bazilika B
5. Bazilika C
6. Altari
7. Monumenti i Terencianit
8. Grupi Banesave periudha Antikitetit te Vone
9. Bazilika E
10. Muri Viktorinit
11. Bazilika D
12. Teatri
13. Cisterna
14. Kulla S
15. Kulla Y
16. Kulla V
17. Kulla U
18. Kulla T
19. Kulla X
20. Kulla Rrethore
21. Prytaenioni
22. Gjimnazi
23. Stera ujit
24. Porta 1,2,3,4,5,6,7, 8
25. Muri Agora
26. Nekropoli
27. Murri Rethues Verior
28. Arsenali
29. Stoa e madhe
30. Stoa e Teatrit
31. Batpisteri
32. Pallati Peshkopal
33. Furra e Gelqeres
34. Fabrika vajit
35. Fabrika veres





SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
1	Agoraja e periudhës helenistike, në krahun e djathtë të stadiumit.	Terma e Antikitetit të Vonë (Justiniani)	40° 32' 28" N 19° 44' 17" E
		<p>Të dhena te monumentit</p> <p>Burimet historike dhe identifikimi: Mbishkrimi i skalitur në një tabula ansata, i ruajtur pjesërisht, flet për ndërtimin e një banje në kohën e Justinianit I. "E Justinianit (sundimtar) shumë të fuqishëm, (...) unë jam banja, (ndërtim?) i dobishëm; (...), por (mbaj emrin) e vetë atij (...) që (...), sipër mbi gjithë (...)"</p> <p>Teknika e ndërtimit: Ndërtesa ka formë katërkëndëshe 24,50 m x 6,40 m, me disa kthina, ku dallohen apodyterium (dhoma e zhveshjes), frigidarium (vaskat e ujit të freskët), tepidarium (ambjenti i vakët), sudatio (banja e djersitjes), caldarium (salla e nxehtë), praefurnum (furra dhe dhoma e zjarrit).</p> <p>Materialet e përdorura: gurë gëlqeror, tulla, blloqe të ripërdorura</p> <p>Përshkrimi: Sterna ka vazhduar të përdoret deri në periudhën bizantine. Në perëndim të sternës, duke shfrytëzuar ujin e saj, ka qenë ngritur një terme publike.</p> <p>Datimi: Monedhat e shumta prej bronzit (numia) të gjetura në përfurnum, prerje të Justinianit I dhe Baduilës (Totila) e datojnë shkatërrimin e temës në vitet 547 – 551, kurse kohën e ndërtimit të saj e jep një mbishkrim i gjetur në murin rrethues të qytetit, që duket se vjen nga kjo banje.</p>	
<p>Sugjerimet për restaurimet, rikonstruksonet, anastilozat: konsolidim të mureve dhe të pjesës së hipokaustit.</p>		<p>Propozim për itinerarin</p> <p>i. Ky monument bën pjesë në itinerarin brenda murit të Viktorinit deri tek Muzeu, i cili përfshin monumentet brenda qendrës, i përshatshëm për turistët e moshës së tretë, për personat me kufizim në lëvizje dhe për fëmijët deri në 12 vjeç (shkalla e vështrësishë e ulët). Ky itinerar jep një pamje gjithëpërfshirëse të Bylisit nga periudha antike deri në braktisjen e këtij qyteti.</p>	


SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
2	Agoraja e periudhës helenistike	Bazilika A	40° 32' 29" N 19° 44' 18" E
		<p>Të dhena te monumentit</p> <p>Vendndodhja dhe Venbanimi: Bazilika është ndërtuar brenda agorasë së periudhës helenistike, duke shfrytëzuar pjesërisht mbeqet konstruktive të krahut verior të stao në formë L në një pozicion zotëruar ndaj pjesës veriperëndimore të qytetit. Gjithë sheshi në lindje dhe në jug të bazilikës, është lënë pastruar pa ndërtime të tjera në një distancë të konsiderueshme, gjë që nuk përsëritet te bazilikat e tjera të qytetit.</p> <p>Burimet historike dhe identifikimi: Nuk ka.</p> <p>Teknika e ndërtimit: Pjesët përbërëse të këtij monumenti janë ngritur në nivele të ndryshme, duke u ngjitur gradualisht nëpërmjet një shkallareje, portiku, narteksi për të arritur në naos. Nuk kanë qenë kushtet topografike ato që kanë përcaktuar shkallëzimin e ngritjes së niveleit të pjesëve të bazilikës, por kanë qenë vetë ndërtuesit që kanë zgjedhur një terren të tillë të pjerrët, për të rritur monumentalitetin e godinës.</p> <p>Materialet e përdorura: Skulptura e dekoruar arkitektonik dhe ajo e instalimeve iturgjike, që ka arritur deri në ditët tona e plotë apo e fragmentuar, është e punuar në gur gëlqeror të marrë nga gurorët e Bylisit. Numrin më të madh e përbëjnë pllakat ndarëse të kangjellës dhe parapetet ndarëse të nefëve, si dhe kornizat e vendosura në ballin e bazilikës. Në numër më të vogël janë kapitelet dhe kapitel-imporet, të dekoruara me motive të pasura dhe të larmishme gjeometrike, floreale dhe zoomorfe.</p> <p>Sanktuari, nefi qendror e verior, krahu verior i transeptit dhe narteksi e kanë dyshemenë të shtuar me mozaikë shumëngjyrësh. Motivet janë të larmishme dhe ndonjë prej tyre është krijim i kësaj atelejeje.</p> <p>Përshkrimi: Bazilika A është trenefshë, me një absidë gjysmërrethore e transepti trepjesësh. Hyrja orientohet nga Perëndimi duke u ngjitur në një shkallare dhe duke kaluar nëpër portik e narteks. Dy kthina në anën jugore, shërbenin për përgatitjen e ceremonive. Kisha kishte përmasa monumentale me gjatësi maksimale 38,22 m dhe gjerësi maksimale 23,42 m. Gjendja e ruajtjes së këtij monumenti lejon të përcaktohen qartë elementet planimetrike dhe vëllimore. Nefet ndahen njëri nga tjetri me harkada të ngritura mbi shtylla të murëzuara dhe këto të fundit mbi një stllobat të lartë. Hapësirat midis shtyllave kanë qenë të mbyllura me parapete. Nefet ndërpren nga transepti me tri pjesë, ku në mes është sanktuari i përcaktuar qartë nga bazamenti i ruajtur mirë. Kangjella e sanktuarit në fazën e parë ka qenë e ulët, kurse në fazën e dytë u lartësua. Sintroni (synthronon) me tri shkallë ka qenë i pajisur me një podium druri, i rrallë</p>	


<p>në formën e tij në kishat e kësaj periudhe. Para absidës, poshtë altarit ruhet vetëm depaja e relikeve në formë kryq. Në një fazë të dytë, mbi narteks është shtuar një galeri.</p> <p>Datimi: Bazilika A është ndërtuar në gjysmën e parë të shek. V dhe djegur gjatë dyndjeve sllove në mesin e shek.VI m. Kr. (547 - 548).</p>	
	


SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
3	Në pjesën veriore të qytetit të antikitetit të vonë	Katedralja dhe Bazilika B dhe ambientet e prodhimit të kompleksit peshkopal	40° 32' 36" N 19° 44' 19" E
		<p><i>Burimet historike dhe identifikimi: Pilakata kushtuar Shën Andreas. Pra, mendohet se pajtori i saj ka qenë pikërisht ky shenjt. Një numër i madh i mbishkrimeve në dyshemenë e nefti qëndror, në pjesën më të madhe, i përket riparimeve të bëra gjatë periudhës së Justinianit.</i></p> <p><i>Teknika e ndërtimit: Bazilika e katedrales (B) nga pikëpamja planimetrike e vëllimore ka një trajtim shumë më të pasur se bazilikat e tjera të Byllsit. Korridorët e përparme, atriumi, narteks, nefet, transepti tripjesësh me krahë të spikatur dhe absida gjysmërrethore, të vendosura në nivele të ndryshme, ndjekin njëri-tjetrin, duke arritur një gjatësi të përgjithshme 67 m.</i></p> <p><i>Plani i bazilikës në fazën përfundimtare të saj karakterizohet nga një strukturë e ngushtë dhe e gjatë, me nefet anësore, narteksin, ekzonarteksin dhe portiqet e atriumit të kurorëzuar me galeri, të cilat rrisin shumë lartësinë e saj.</i></p> <p><i>Atriumi ka formë katërkëndëshe, të zgjatur në drejtim L-P, me përmasa 11,15 m x 6,80 m. Ai është i rrethuar nga katër portikë, ku si portik i katërt shërben ekzonarteks. Një sterë në formë dardhe me thellësi 8,45 m ka qenë ndërtuar në portikun perëndimor, ndryshe nga rastet e tjera të shumta, kur në mesin e oborrit ndërrtohej një vaskë e madhe.</i></p> <p><i>Ekzonarteksit dhe tre portiqet e tjerë hapeshin ndaj oborrit të atriumit nëpërmjet arkadave të ngritura mbi kolonat e vendosura mbi një stilobat të lartë. Mbi kolona kanë qenë vendosur kapitete të trajtuara sipas ordrin të vjetër dorik. Në arkadën e katit të dytë, që ka ndjekur të njëjtin ritëm, kapitete janë të ardit jonik, sipas një kriteri të njohur nga antikiteti. Lartësia e madhe e stilobati dhe mungesa e shkallëve e ka veçuar plotësisht oborrin nga portiqet.</i></p> <p><i>Narteksit me gjatësi 3,96 m e gjerësi 14,40 m, i ndjekur në veri dhe jug nga aneksat, hapet në nefin qëndror përmes një tribeloni, ndërsa ndaj neëve anësore nga dyer të thjeshta.</i></p> <p><i>Naosi me gjerësi 14,40 m dhe gjatësi 24,70 m përbëhet nga tri nefe me gjerësi të ndryshme: qëndrori 7,75 m, veriorit 2,30 m dhe jugori 2,90 m. Një ombon, me një zjgjidhje të platformës tepër origjinale, është vendosur në jug të aksit gjatësor të nefti qëndror, ndërsa në nefin jugor ka një sofat. Nefet ndahen nga njëri-tjetri me harlada të ngritura mbi kolona, dhe këto të fundit, mbi piedestale të vendosura mbi një stilobat të lartë. Me të njëjtin ritëm vazhdon dhe harkada e galerive, e ngritur mbi kolona dhe piedestale të njëjta si dhe katit i parë.</i></p> <p><i>Skulpturat dekorative arkitektonike dhe ato të pajisjeve liturgjike, të gjetura në këtë bazilikë, janë më të shumta dhe më me shumë variacione se ato të gjetura në bazilikat e tjera të Byllsit. Skulptura ndahet në dy grupe: grupin e parë e përbëjnë dekoracionet e gdhendura në gur gëlqeror, kurse të dytin ato prej</i></p>	
			


 <p>Planimetria e katedrales</p>		<p><i>mermeri të importuar. Shumë elemente nga skulptura e Katedrales kanë qenë transportuar në bazilikën e Glavinicës në periudhën mesjetare.</i></p> <p><i>Dyshemeja e ekzonarteksit, neëve, sanktuarit dhe krahut verior të transeptit është shtuar me mozaikë, dhe përbën sipërfaqen më të madhe me mozaikë të zbuluar deri tani në territorin e Shqipërisë. Motivet dhe skenat janë tepër të larmishme. Aty gjejmë skena nga jeta e përditshme e barinive, por dhe paraqitje nga jeta e peshkatarëve të Nazaretit, si ajo e vëllezërve Simon dhe Andrea. Të gjitha muret kanë qenë veshur me afreske, por për fat të keq janë ruajtur vetëm ato me motive gjeometrike, të cilat i përkasin paneleve të brezit të parë.</i></p> <p><i>Nga narteksit kalohej nëpërmjet një tribeloni në kompleksin e pagëzimit, të vendosur në anën jugore. Nëpërmjet një pasasalle vazhdohej për në sallën e pagëzimit dhe në dy dhoma të tjera të pajtura me sofate dhe lavamane, të cilat kanë shërbyer për përgatitjen e të rinjve (katekumenus) me mësimet e dogmës së krishterë. Vaska e pagëzimit ka ndryshuar gjatë përdorimit dyshkullor jo vetëm formën por dhe thellësinë e saj në varësi të mënyrës së pagëzimit. Ajo furnizohej me ujë të ngrohtë nga një furrë e ndërtuar në oborrin në lindje të pagëzimit. Shkallët e ndërtuara në njërin nga dhomat kanë shërbyer për t'u ngritur në katin e sipërm të kompleksit të pagëzimit, prej ku kalohej edhe në kthinat e kompleksit peshkopal, që është i ndërthurur me baptisterin.</i></p> <p><i>Kompleksi peshkopal, me një numër të madh kthinash, kalimesh, oborresh, sterash, është akoma në proces gërmimi. Kati i parë i këtij kompleksi ka qenë përdorur për depo rezervash ushqimore, punishte dhe stalla dhe përfundimi i gërmimeve do të ndihmojë për të kuptuar më mirë rolin që luante hieri në një qytet të antikitetit të vonë. Numri i madh i elementeve arkitektonike të ditareve dëshmon se ndërtimet në Byllis kanë preferuar ndriçimin natyror, duke vazhduar traditën mesjetare.</i></p> <p><i>Materialet e përdorura: blloqe quri, gurë, pjesë arkitektonike nga antikiteti, tulla.</i></p> <p><i>Përshkrimi: Katedralja e Byllsit e përbërë nga bazilika, baptisteri dhe kompleksi peshkopal, është monumenti më i madh i qytetit për Antikitetin e Vonë, duke zënë një sipërfaqe më shumë se një hektar në pjesën më të rëndësishme të tij. Katedralja, një monument i përmasave të mëdha, me një shumëllojshmëri të vlerave të saj arkeologjike, me një arkitekturë e skulpturë dekorative shumë të pasur, me sipërfaqet e dyshemeve të shtuara me mozaikë, me mbishkrimet, enët e baltës dhe të bakrit, veglat e punës, objektet e zbulimitit e instrumentet muzikore dhe, së fundi, numri i madh i thesareve të monedhave të gjetura, përbën një nga shembujt më të spikatur për monumentet e kultit paleokristian.</i></p> <p><i>Datimi: Gjatë një periudhe, gati 200 vjeçare, katedralja ka njohur tri faza të rëndësishme ndërtimi: e para, në fundin e shek. IV m.Kr., ose fillimin e shek. V m.Kr.; e dyta në vitet 470 dhe e fundit lidhet me periudhën e sundimit të Justinianit, para vitit 547 m. Kr., kur bazilika u dogj gjatë dyndjes slave. Në fazën e parë kisha ka qenë një bazilikë trenefshë me një narteks dhe portik dhe një baptister të thjeshtë; në fazën e dytë ka qenë shtuar atriumi dhe galeritë në një kompleks; në fazën e fundit u ndërtua kompleksi peshkopal.</i></p>	
			

<p><i>Sugjerimet për restaurimet, rikonstruksionet, anastilozat: Katedralja, vizitueshmëria e mozaikut të narteksit gjatë gjithë vitit dhe ngritja e elementëve arkitektonik. Mozaiku i nefti qëndror të konsolidohet dhe të jetë i hapur për muajt e verës për të parë dhe dhuruesit e shumtë si kontribues me ndërtim. Kompleksi peshkopal. Konsolidimi i mureve të mjedisit të kompleksit. Restaurimi i sistemit të furnizimit me ujë të stermave. Rindërtimi i grykave të 5 stermave. Restaurimi i punishtes së verës, restaurimi i punishtes së vajit të ullirave dhe i ambientit të rezervave.</i></p>	
--	--


SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
4	Brenda agorasë antike, në krah të termës romake dhe në pjesën e forumit romak.	Bazilika C	40° 32' 26" N 19° 44' 14" E
		<p>Burimet historike dhe identifikimi: Një mbishkrim i shkruar në mozaik tregon se ai ka qenë realizuar në kohën e peshkopit Praisios. Për fat të keq ai nuk përmendet në listat e peshkopëve të Bylisit, gjë që do të mundësonte një datë për ndërtimin e mozaikut.</p> <p>Teknika e ndërtimit: Ndarja e nefëve është bërë me harkada të mbështetura mbi kolona monolite prej guri, të vendosura mbi një stilobat të lartë. Mbi kolona qëndrojnë kapitelet jonike me imposte të zbukuruara në të dy faqet. Hapësirat midis kolonave janë mbyllur me parapete të përbëra nga shtylla dhe pllaka guri të zbukuruara me motive të shumta dhe origjinale.</p> <p>Materialet e përdorura: tulla, biloqe, gurë qëlqerorë.</p> <p>Përshkrimi: Bazilika C është një kishë me përmasa mesatare, me gjatësi 33 m dhe gjerësi 22,80 m. Ajo ka tri nefë, narteksin me një galeri mbi të, të paraprirë nga një portik, dhe disa anekse. Nefi qëndror, i shtruar me pllaka guri, ka një gjerësi 5,80 m dhe përfundon me një absidë rrethore nga lindja. Nefet anësore kanë gjerësi 2,46 m e 2,26 m dhe janë të pajisura me sofate për t'u ulur besimtarët gjatë ceremonive. Sanktuari (bema) përfundon në lindje me një synthronon të thjeshtë me tri shkallë, për uljen e klerikëve. Para tij qëndron altari, nga i cili ruhet në vend bazamenti dhe poshtë tij depua e relikeve. Sanktuari dhe njëri nga anekset janë të shtruar me mozaikë me motive gjeometrike, bimore, zoomorfe dhe figura njerëzore. Në sanktuar ka dhe dy skena jo të zakonshme: në të parën, dy tuja me nga gjashtë qingja, që personifikojnë dymbëdhjetë apostujt, që shkojnë drejt altarit, kurse tek e dyta pjesëtarë të klerit me kandelabër në dorë drejtohen për në kishë.</p> <p>Datimi: Megjithatë, çereku i dytë i shek.VI m.Kr. duket se do të ishte më afër të vërtetës për periudhën e ndërtimit të bazilikës C.</p>	

		<p>Sugjerimet për restaurimet, rikonstrukcionet, anastilozat: Bazilika C. Vizitueshmëria e mozaikut të aneksit jugor. Anastilozat e tribelonit, pjesërisht e arkadave të nefëve dhe rindërtimi i plotë i parapeteve dhe kangjellës dhe tavolinës së altarit.</p>	
--	--	---	--

SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
5	Në pikën më të lartë të kodrës me lartësi 529 m mbi nivelin e detit, ka qenë vendosur kulla më jugore e fortifikimit të Viktorinit, e cila shërbeante edhe si pikë vrotimi mbi luginën e Vjësës.	Kulla Y	40° 32' 22" N 19° 44' 22" E
		<p>Burimet historike dhe identifikimi: Zbulimi i katër mbishkrimeve me përmbajtje ndërtimore në rrënojat e bazilikës së Baishit dhe i një të pesti në Bylis, jo vetëm pasurojnë historinë e Bylisit, por konfirmojnë më së miri veprën De aedificiis (Mbi ndërtimet) të Prokopit të Cezaresë, ku bëhet fjalë për ndërtimet e bëra nga perandori Justinian I ("Me uratën e perëndisë dhe hyjnilindësës virgjëreshë, duke i shërbyer drejt qëllimit dhe mënyrave të veprimit të Justinianit, sundimtari (yos) shumë i fuqishëm, pasi ka ngritur kështjellat e Myzisë e të Skythisë, ato të territorit të Ilirisë si dhe të gjithë Trakisë, Viktorini, ky njeri me aftësi strategjike, ndërton me përvojatje këtë mur rrethues për Bylisin"). Bylisit pas shkatërrimeve që pësoi në vitet 547-551 (Proc. B. VI, 29, 1 - 3) u rindërtua. ("Nuk ankohem më për barbarët, nuk u frikësohem më, sepse gjeta tek Viktorini i Madh, një njeri që më ndërtoi me duart e tij") duke lënë jashtë rreth një të tretën e sipërfaqes së dikurshme të qytetit. Me gjithë superlativat e përdorura në këto mbishkrime ("O i huaj, mos e shmanq vështrimin nga bukuria e Bylisit, muret rrethuese të të cilit, dikur të rrënuara, i rindërtoi Viktorini guximtar"), të paktën para shkatërrimeve ai duket se ka qenë një shembull vërtetë për t'u admiruar.</p> <p>Teknika e ndërtimit: Ndërtimi i kullës dhe i murit ka qenë bërë me spolie nga teatri, ku dallohen një numër i madh ndenjësesh. Gjithashtu, kanë qenë përdorur edhe mbishkrime, në të cilat lexohen COL(ONIA) dhe TONOC - një përkthim greqisht nga latinishtja locus-vend.</p> <p>Materialet e përdorura: shkallëz nga teatri, biloqe me mbishkrime latine, tulla dhe gurë qëlqerorë me madhësi mesatare.</p> <p>Përshkrimi: Kulla ka formën e zakonshme katërkëndëshe të kësaj periudhe ndërtimi dhe shërbehet me një portë, dikur të mbuluar me qemer në katin e poshtëm. Një shkallë në anën e majtë, të çonte në katin e dytë të kullës, si dhe në shtegun e rojeve.</p> <p>Datimi: Edhe pse qyteti u fortifikua, gjysma e dytë e shek.VI m.Kr. ishte një periudhë rënjeje, ndërsa një shkatërrim i dytë nga sllavet në vitin 586 bëri që Bylisi të braktisej përfundimisht. Nga ljo kohë duket se vjen edhe toponimia sllave gradishtë, siç quhet nga vendësit kodra e Bylisit.</p> <p>Sugjerimet për restaurimet, anastilozat: restaurimi i plotë i kullës dhe kthimi i tij në një monument të vizitueshëm dhe të shfrytëzueshëm.</p>	



SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
6	Rrënojat e kësaj banese gjenden pranë rrugës kryesore veri-jug, afër me marinën e Viktorinit.	Monumenti i Terencianit	40° 32' 33" N 19° 44' 20" E
		<p>Burimet historike dhe identifikimi: Në sondazhin e parë të kryer në vitin 2007, përgjatë murit të Viktorinit u zbuluan dy piedestale të periudhës romake me mbishkrime latine, pjesë e një faltoreje të ndërtuar brenda një banese romake, pronë e familjes Terentianus. Gërmimet e kryera gjatë viteve 2008-2011 nxorën në dritë se, mbi rrënojat e një banese helenistike, kanë qenë ndërtuar në 5 faza të ndryshme në disa banesa.</p> <p>Teknika e ndërtimit: periudha e parë me blloqe, periudha romake me opus reticulatum, periudha antike e vonë me gurë gëlqerorë, llaç dhe baltë.</p> <p>Materialet e përdorura: blloqe, gurë gëlqerorë, tjegulla fragmente tullash.</p> <p>Përshkrimi: Faza e parë, banesa helenistike C. Nga muret kuqzuese janë zbuluar pjesërisht muri jugor e verior dhe disa të mure ndarës të brendshëm. Një bazament i punuar me blloqe guri ruajtur në gjatësinë 8 m, mund të ketë qenë pjesë e stilobatit të oborrit me peristil. Gërmimet e deritanishme, nuk na kanë dhënë mundësi që të përcaktojmë planin e kësaj ndërtese, por nisur nga të dhënat e vjela mendojmë që edhe kjo banesë i përket tipit me peristil. Ndër pjesët e ruajtura është pragu i hyrjes që komunikon me rrugën në jug të saj. Ai është ndërtuar nga dy blloqe guri dhe në të ruhen dy vrimat për inkastrimin e binarëve të kasës së portës apo të kupave dhe një tjetër për shullin e fiksimit të kanatës së palëvizshme. Deri tani, përveç gjetjeve të shpërndara të periudhës helenistike, ne nuk kemi mundur të kapim një shtresë të rregullt arkeologjike që të lidhet me këtë fazë.</p> <p>Faza e dytë, monumenti i Terencianit. Banesa e Terencianit, ruhet më mirë dhe ka dhënë materialin arkeologjik më të shumtë, gjë që bën të mundur përcaktimin e kohës së braktitjes si dhe ndihman për të vendosur me afërsi periudhën e ndërtimit. Kjo banesë e gërmuar pjesërisht nuk ka respektuar sistemin e vjetër urbanistik, duke ndërtuar edhe mbi një pjesë të rrugës në krahu jugor të banesës helenistike. Ndër pjesët e ruajtura të kësaj banese, dallohen porta kryesore (osmium), faltorja (lararia), një portë anësore (posticum), disa mure të brendshëm, dysheme të shtruara me horasan (opus signinum), tulla, rrasa guri, kanale për shkarkimin e ujërave të shiut, një mjedis furre për përgatitjen e glazurës, etj. Krahas materialit tjetër arkeologjik gjetur në këtë shtresë, prania edhe e një monedhe të mbretit të Numidisë, Juba I, jep mundësi për vendosur vitin 48 p. Kr. si një datë post quem për shtresën e shkatërrimit. Të dhënat e vjela deri tani, kryesisht qeramika lindore B, sigilata italice, sigilata afrikane; të gjetura së bashku me shumë suva të pikturuara mundësojnë për të përcaktuar se banesa ka qenë e braktisur rreth viteve 150–</p>	







170 m. Kr., kurse për ndërtimin e saj, në gjendjen aktuale të gërmimit, do të propozonim perludhën pas kufijit të kolonisë. Porta kryesore, që paraprihet nga një strehë, është e ndërtuar me katër blloqe guri gëlqeror, dhe në të gjendeshin in situ edhe kupat prej bronzi ku mbështeteshin boshtet vertikale të flegrave të portës. Faltorja (lararia) ka qenë një konstruktion i hapur dhe pa çatë, duke shërbyer edhe si impluvium. Nga ndërtimi ruhet dyshemeja e shtruar me rrasa guri; stilobati që e qarkon në lindje, veni dhe jug; muret e ndërtuar mbi stilobatin lindor dhe perëndimor; dy piedestale prej guri ku kanë qenë vendosur statujat prej mermeri; dy bazamente të ulet prej guri dhe vetëm njëra nga kater kolonat e ngritura në qoshet e stilobatit që shërbenin për të fiksuar tarret e çatisë. Në mbishkrimet e gdhendura në faqen e përparmë të piedestaleve bëhet fjalë për babanë dhe dy djemtet e tij që i përkasin familjes Terentianus. Të dy piedestalet ruhen in situ, kurse nga statujat e vendosura mbi të, vetëm njëra u gjet e rrëzuar pranë piedestalit. Statuja prej mermeri, kushtuar Maksimit, paraqet një togat me përmasa natyrale. Nga impluviumi dalin dy kanale për marrjen e ujërave, i pari i gdhendur në blloqe guri, kurse i dyti i ndërtuar me tjegulla kalipere dhe tulla. Kanali i parë del në rrugën përgjatë ballit të banesës helenistike, kurse tjetri mund të ketë shërbyer për furnizuar sternën e shtëpisë. Aty u gjenden enë qeramike, gurë peshe prej balte, dorezë thike prej kocke, gozhdë hekuri, etj., që kanë qenë depozituar aty para djegies të ndodhur në vitin 48 p. Kr. Shtresa e shkatërrimit e gjetur në impluvium tregon se edhe kanali e ka humbur funksionin e parë për të grumbulluar ujërat e tij, por pjesë të veçuara të tij, flasin për përdorimin e pjesshëm të tij edhe në fazën e tretë. E tillë është edhe pjesa ku kanali perfundon në një uluk të gjerë, ku tjegulla e plotë ka edhe një vulë me emrin QINTUAN. Mjedisja për prodhimin e glazurës alkaline, i gërmuar pjesërisht, është më i thellë se pjesët e tjera të kompleksit të Terencianit. Nga analizat e kryera në mostrat e marra nga materiali i enëve, doli se materiali ishte galzurë alkaline me një përmbajtje SiO2 në masën 30-35%. Mendohet se, recetën e glazurës alkaline që përdorej në Lindjen e Afërme, sollën me vete ushtarët, të cilët riktheheshin nga fronti lindor. Në të u gjetën pjesë tullash të qelqëzuara, fragmente vorbash, fragmente enësh qelqi të ngjiftura me skarco qelqi, një pjesë mokre e tipit pompeian etj. Vorbat nga jashtë ishin të veshur me baltë, kurse nga brenda ato ishin të veshura nga një shtresë glazure të ngjeshme gjatë procesit të përgatitjes së saj. Nga analizat e bëra rezultoi qelqi i depozituar në vorba ishte i njëjtë me atë të disa prej enëve prej qelqi të gjetura në mjediset përreth. Faza e tretë, fundi i shek. II-junali i shek. IV m. Kr.. Nga kjo fazë, situata është më pak e qartë. Muret e kësaj periudhe ose janë ndërtuar rishitas ose janë mbivendosur mbi të mëparshmit. Nga ndërtesa romake e Terencianit, përveç faltores, pjesët e tjera të saj janë përfshirë brenda


statujes së gjetur "in situ". Riprodhimi i dy kupave prej bronzi, të vjedhura dhe vendosja e tyre në vend. Përfundimi i plote i gërmimit të insulës së banesës.


sipërfaqes së banimit. Shumë materiale nga shtresa e shkatërrimit, sidomos suva me pikturim të përziera me argjilë, janë përdorur për të krijuar truallin e mjediseve. Materiali arkeologjik që i përket kësaj faze janë qeramika (sigliata afrikane: Hayes 32, Hayes 50), gjilpëra kocke, gjilpëra bronzi, gjilpërë për thurje rrjete peshkimi, monedha të ndryshme, enë qelaj, fragmente makrash prej guri vulkanik, etj. Faza e katërt, Banesa të shek. V-gjysma e parë VI. Gërmimet e dëritanishme kanë treguar se nuk kemi të bëjmë me një ndërtesë të vetme por me disa të tilla. Muret janë ndërtuar me gurë mesator, copa tjegullosh e tullash, pjesë skulpture, makrash, mbishkrime, të lidhur me baite. Gjatë kësaj faze është riparuar një pjesë e grykës së sternes dhe është ndërtuar një kanal i ri për furnizimin e saj me ujë. Materiali kryesor është qeramika e prodhimit lokal me bitum, pitosa, amfora epirote, broka, vorba etj. Faza e pestë, ndërtime pas tkurrjes së aytetit (gjysma e dytë e shek. VI). Nga kjo fazë është gërmuar pjesërisht një banesë, kurse tre të tjera janë në fillimet e tyre. Të gjitha banesat janë vendosur sipas drejtimit lindje-perëndim, dhe për hyrjet nuk ka një rregull të caktuar orientimi. Materialin kryesor e përbëjnë fragmentet e pitosave dhe amforave epirote të lyera me bitum.

Datimi: Faza e parë: periudha helenistike; faza e dytë: shek. I-II m. Kr. (banesa e Terenclanit); faza e tretë: fundi i shek. II-fundi i shek. IV m. Kr.; faza e katërt: shek. V-VI; faza e pestë: gjysma e dytë e shek. VI.

SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
7	Në hapësirat e banesës helenistike D	Grupi i banesave të periudhës antike të vonë në krah të Restorantit "Beqa"	40° 32' 32" N 19° 44' 15" E
		<p>Burimet historike dhe identifikimi: nuk ka, por ripërdorur në mur ishte një mbishkrim latin.</p> <p>Teknika e ndërtimit: gurë dhe baite.</p> <p>Materialët e përdorura: gurë, blloqe të ripërdorura, pragje dyerësh të ripërdorura.</p> <p>Përshkrimi: Nga kjo fazë është gërmuar pjesërisht një banesë, kurse tre të tjera janë në fillimet e tyre. Të gjitha banesat janë vendosur sipas drejtimit lindje-perëndim, dhe për hyrjet nuk ka një rregull të caktuar orientimi. Materialin kryesor e përbëjnë fragmentet e pitosave dhe amforave epirote të lyera me bitum.</p> <p>Datimi: ndërtime pas tkurrjes së aytetit (gjysma e dytë e shek. VI) Pranë restorantit "Beqa" është një grup banesash të shekullit VI m. Kr. Ato i takojnë tipit më të përhapur të banesave të shek. V-VI në Bylis, të cilat janë zakonisht me dhoma drejtkëndëshe, paralele me njëra-tjetrën. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë me një kat dhe një gjysmëkat, që ka shërbyer për mbajtjen e rezervave ushqimore.</p>	
			


	<p>Sugjerimet për restaurimet, rikonstrukcionet, anastilozat: Pastrimi i mureve të banesave të antikitetit të vonë, midis bazilikës A dhe kompleksit peshkopaf.</p>
---	---


SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
8	Jashtë murit të Viktorinit, rrugës për në gurorë	Bazilika E	40° 32' 27" N 19° 44' 25" E
 <p>BAZILIKA E. Foto ajrore 2007</p>		<p><i>Burimet historike dhe identifikimi: nuk ka.</i> <i>Teknika e ndërtimit: biloqe, gurë dhe tulla lidhur me llaç.</i> <i>Materialet e përdorura: të marra nga monumentet antike.</i> <i>Përshkrimi: Ajo ende nuk është gërmuar plotësisht, por dallohen qartë tre nefe me një absidë gjysmërrethore, narteksin me portik dhe dy anekse të tjera. Bazilika ka gjatësi 24,60 m dhe gjerësi 19,22 m. DysHEMEJA e sanktuarit është e shtruar me mozaik. Skulptura e pakët dekorative e gjetur deri tani në bazilikën E ka tipare të veçanta që nuk ndeshen te bazilikat e tjera.</i> <i>Datimi: shek. VI m. Kr.</i></p> <p><i>Sugjerimet për restaurimet, rikonstruksionet, anastilozot: Bazilika E. Restaurimi i fasadës perëndimore, ngritja në lartësi deri në dyshemenë e katit të 2, kompletimi i ditareve të narteksit dhe ekzonarteksit</i></p>	




Klos

Është e rëndësishme të theksohet që rrënojat e Klosit si zonifikim mungojnën dhe duhen bërë urgjentisht. Zonifikimi, duhet të mbeshtet, nga ana tjetër, përmes kryerjes së një planimetrie të saktë dhe me kordinata të sakta të sistemit GIS për planimetrine e cila është marrë nga artikujt e studiuesve Ceka dhe Papajni.



SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
10	Fshat: Klos, Malia kastër	Kalaja e Klosit	40° 31' 40.10" N 19° 45' 21.82" E
		<p>Muret rrethojnë pjesën më të lartë të kodrës duke ndjekur formën e terrenit. Në anën verilindore gjendet hyrja e vetme për në qytet e formuar nga dy zqatimet paralele të dy drejtimeve të kundërt të mureve. Hyrja në krahun e majtë forcohet me një kullë me ballë të gjerë 5.10m., e cila ngushtohet nga brenda në 1.70 m. duke ruajtur gjerësinë e murit 3.40 m. Korridori i hyrjes me gjerësi prej 5.50 m. është i gjatë 6 m., aq sa është edhe gjerësia e murit që zqatjet nga brenda.</p> <p>Nga pika A.B.C etj deri në pikën G muri ruhet mirë e ndërprerje të vogla. Në pikën B. përveç një kthesë prej 3.50 dhe të gjatë 14.50 m. dhe tjetrën 3.80 m. Ndrëmjet pikave E-E 1 ndodhet muri me i ruajtur që në disa vende arrin një lartësi në 3.5m. Në pikën H muri ndjek zqatjet e kodrës duke bërë kthesën me një kullë me ballë të gjerë 7 m dhe me anët nga 9.50 dhe 6 m. Në të gjithë anën veriperëndimore nuk dallohen gjurmë muri. Në vitin 1972 gjatë punimeve të pastrimit doli në mes të kësaj distance një kullë sëbashku me murin në të dy krahët e tij. Kulla ka një gjerësi prej 7.40m dhe një dalje nga muri 2.50m. Muret kanë qenë të ndërtuar me gurë qëllororë të nxjerrë nga shkëmbinjtë e vet kodrës. Biloqet e themelet në pjesën më të madhe janë vendosur në shkëmb, duke krijuar dy paretë dhe duke i dhënë murit një gjerësi deri në 3.50m. Paretet e murit në distance të ndryshme, afërsisht 2.70 m këthen konstruktivisht me mure transversale prej biloqesh të punuara dhe gjysmë të punuara. Hapësirat e krijuara nga paretet anësore të murit dhe nga muret lidhëse mbushen me gurë të çfarëdashëm. Forma e biloqeve është trapezoidale, por ka edhe raste me forma poligonale, të cilat ndërpresin vijat e drejta të rreshtave. Faqja e jashtme e mureve është e gufmuar dhe e gadhendur trashë. Biloqet e gurëve janë puthitur mirë me njëri-tjetrin. Një nga veçoritë teknike është përdorimi i gurëve të veqjël në formë pykash, sidomos i atyre në formë trekëndëshi me bazën sipër. Në disa vende muratura është kuadratike izodomike me faqen e dukshme të sheshtë. Në një fazë të dytë janë ndërtuar të gjithë muret rrethuese të qytetit mbi kodrën e quajtur Gradishtë e Hekalit, ku muartaura është kuadratike izodomike.</p>	

		<p>Vija e murit mund të ndiqet, por janë të rradha vendet ku muri ruhet në lartësi të konsiderueshme.</p> <p>Ndërtuar me gurë qëlloror, dhe me biloqe guri në formë trapezoidale dhe poligonale.</p>
--	--	--

SKEDA NR.	ZONA	MONUMENTI	KOORDINATA
11	Fshat: Klos, Malia kastër	Banesa e Temo Çelajt	40° 31' 46.73" N 19° 45' 4.21" E
		<p>Banesa e Temo Çelajt në fshatin Klos është 2 kat me mur guri të zinj me b=80cm. Në katin përdehe janë 2 dhoma korridor dhe ëc ky katë është interesant se në pjesën që është brenda rrethimit është ambient shërbimi gatimi ngrënie dhe ëc, ndërsa në pjesën jashtë rrethimit kalon rruga e lagjes – poshtë qemerit që mban katin e parë. Shkalla që të ngjitet në katin e parë është prej guri dhe poshtë saj është një depo. Mbulesa është me cati lënde druri dhe tjegulla vendi. Tavani dhe dyshemeja janë me dërrasë. Të dy dhomat kanë oxhak. Qoshet e ndërtesës janë me gurë të punuar. Hyrja për në oborrin e shtëpisë është një portë e madhe me qemer guri e mbuluar edhe kjo me çati. Afër banesës është një ndërtesë e pa mbuluar me mur guri të bardhë e cila ka shërbyer për punë të ndryshme. Objekti është i pa suvatuar nga jashtë. Objekti është me themel dhe mure guri. Ndërkati është me dërrasë. Muret janë rindërtuar nga tërmeti.</p>	

SHTOJCA 6 - BIBLIOGRAFIA DHE IMAZHE NGA BYLIS DHE KLOSI

Kjo është një listë referencash/botimesh jo perfundimtare e cila është përdorur nga anëtarët e grupit të punës për hartimin e këtij plani

- Anamali Skënder. Dy punishte kandilash me firma në Bylis. / Deux ateliers de lampes estampillées à Byllis. In: Iliria, vol. 18 n°1, 1988. pp. 216-219.
- Beaudry, Nicolas (2010). 'Një punishte për prodhimin e verës në Bylisi', Monumentet 28, pp. 41–50.
- Beaudry, Nicolas, Chevalier, Pascale, & Muçaj, Skënder (2010). 'Le quartier épiscopal, campagne 2009, Byllis (Albanie)', Bulletin du Centre d'études médiévales d'Auxerre 14, pp. 57–60.
- Beaudry, Nicolas, et al. (2003). 'Byllis (Albanie)', Bulletin de correspondance hellénique 126.2, pp. 659–684.
- Ceka Neritan. Bylis - Shëtitorja . In: Iliria, vol. 14 n°2, 1984. pp. 262-263.
- Ceka Neritan. Bylis. In: Iliria, vol. 16 n°2, 1986. pp. 263-265.
- Ceka Neritan. Bylis. In: Iliria, vol. 20 n°2, 1990. pp. 261-262.
- Ceka Neritan. Bylis - Shëtitorja . In: Iliria, vol. 14 n°2, 1984. pp. 262-263.
- Ceka Neritan. Fortifikimet antike të bashkësisë byline /Les fortifications antiques du koinon des Bylliones. In: Iliria, vol. 20 n°1, 1990. pp. 99-146.
- Ceka Neritan. Koinoni i Bylinëve / Le koinon des Bylliones. In: Iliria, vol. 14 n°2, 1984. pp. 61-89.
- Ceka Neritan. Pesëdhjet vjet studime për qytetet ilire / Fifty Years of Studies on Illyrian Cities. In: Iliria, vol. 28, 1998. Simpozium ndërkombëtar 9-10 Nëntor '48 Tiranë '98. 50 Vjet Arkeologji Shqiptare. pp. 121-128.
- Chevalier, Pascale, et al. (2003). 'Trois basiliques et un groupe épiscopal des Ve-VIe siècles réétudiés à Byllis (Albanie)', Hortus Artium Medie-valium 9, pp. 155–165.
- Chevalier, Pascale, Beaudry, Nicolas, & Muçaj, Skënder (2009). 'Le quartier épiscopal, campagne 2008, Byllis (Albanie)', Bulletin du Centre d'études médiévales d'Auxerre 13, pp. 73–76.
- Chevalier, Pascale, et al. (2008). 'Byllis (Albanie), campagne 2007: le quartier épiscopal, la Basilique E et les carrières', Bulletin du Centre d'études médiévales d'Auxerre 13, pp. 73–76.
- Gjongecaj Shpresa. Qarkullimi i monedhave të Epirit në qendrat ilire / La circulation des monnaies de l'Épire dans les sites illyriens. In: Iliria, vol. 14 n°2, 1984. pp. 119-128.
- Korkuti Muzafer, Davis Jack, Bejko Lorenc, Galaty Michael L., Muçaj Skënder, Stocker Sharon R. The Mallakstra Regional Archaeological Project : First Season, 1998 / Rezultate të projektit arkeologjik rajonal të Mallakatrës : sezoni i parë 1998. In: Iliria, vol. 28, 1998. Simpozium ndërkombëtar 9-10 Nëntor '48 Tiranë '98. 50 Vjet Arkeologji Shqiptare. pp. 253-273.
- Muçaj Skënder. Bylis (Bazilika B) . In: Iliria, vol. 18 n°2, 1988. p. 271.
- Muçaj Skënder. Bylis — Bazilika . In: Iliria, vol. 14 n°2, 1984. pp. 270-271.

- Muçaj Skënder. Bylis (Bazilika D). In: Iliria, vol. 20 n°2, 1990. pp. 270-271.
- Muçaj Skënder. Bylis - 2013. In: Iliria, vol. 38, 2014. pp. 343-347.
- Muçaj Skënder, Chevalier Pascale, Xhyheri Suela, Bushi Skënder. Bylis 2012. In: Iliria, vol. 37, 2013. pp. 359-378.
- Muçaj Skënder, Chevalier Pascale, Xhyheri Suela, Bushi Skënder. Bylis - 2013. In: Iliria, vol. 38, 2014. pp. 343-347.
- Muçaj Skënder, Chevalier Pascale. Bylis. In: Iliria, vol. 36, 2012. pp. 457-462.
- Muçaj Skënder. Sistemi fortifikues i qytetit të Bylisit në antikitetin e vonë /Le système de fortification de la ville de Byllis dans la basse antiquité. In: Iliria, vol. 20 n°1, 1990. pp. 169-200.
- Muçaj Skënder. Dy monumente të Antikitetit të Vonë në Bylis / Deux monuments de la Basse Antiquité à Byllis. In: Iliria, vol. 16 n°1, 1986. Kuvendi II i Studimeve Ilire. IIe colloque des Etudes Illyriennes (Tiranë, 20-23. XI. 1985) pp. 321-327.
- Muçaj Skënder. Vendbanime të antikitetit të vonë në krahinën e Mallakastrës / Agglomérations de la Basse Antiquité dans le territoire de Mallakstra. In: Iliria, vol. 9-10, 1979. pp. 279-299.
- Muçaj Skënder. Bylis (Bazilika D). In: Iliria, vol. 20 n°2, 1990. pp. 261-262.
- Papajani Lazër. Gërmimet arkeologjike të vitit 1973 në qytetin ilir në fshatin Klos të Mallakastrës. In: Iliria, vol. 3, 1974. pp. 455-460.
- Papajani Lazër. Monedha të zbuluara në qytetin ilir në Klos (me një katalog të posaçëm mbi prerjet monetare të qytetit Bylis) / Monnaies découvertes dans la cité illyrienne de Klos (avec un catalogue sur les frappes monétaires de la cité de Byllis). In: Iliria, vol. 6, 1976. pp. 259-273.
- Përzhitia Luan, Belli Pasqua Roberta, Caliò Luigi Maria, Hobdari Elio, Jaia Alessandro M., Ceka Olgita, Pushimaj Paulin. Ekspedita kërkimore në Bylis 2014. In: Iliria, vol. 38, 2014. pp. 349-355.
- Vreka Bashkim. Tipare të qeramikës së zbuluar në Bylis, shek. IV p. e. s.- I e. s. / Les caractéristiques de la poterie de Byllis (du IVe siècle av. J.-C. au I siècle ap. J.-C.). In: Iliria, vol. 27, 1997. pp. 167-204.
- Vreka Bashkim. Tipare të qeramikës së zbuluar në Bylis, shek. IV p. e. s.- I e. s. / Les caractéristiques de la poterie de Byllis (du IVe siècle av. J.-C. au I siècle ap. J.-C.). In: Iliria, vol. 27, 1997. pp. 167-204

Referime

1. [^] Wilkes, J. J. The Illyrians, 1992, [ISBN 0-631-19807-5](#), Page 97, "... the Bylliones beyond the river Aous in the hinterland of Apollonia . Their hill-settlement developed later into the town of Byllis, at Gradisht on the right bank of the Aous. ..."
2. [^] An Inventory of Archaic and Classical Poleis: An Investigation Conducted by The Copenhagen Polis Centre for the Danish National Research Foundation, [ISBN 0-19-814099-1](#), 2005, page 1333, "refounded as a Hellenic Byllis not yet a polis in 400"
3. [^] Wilkes, J. J. The Illyrians, 1992, [ISBN 0-631-19807-5](#), Page 273, "... Scodra and Dyrrhachium were seats of the metropolitans, and there were bishops at Lissus,

Doclea, Lychnidus (Ohrid), Scampis, Apollonia, Amantia, Byllis and Aulona. The population of this area were Latin-speaking provincials..."

FOTO AJRORE DHE HARTA BYLLIS/KLOS (internet open sources)

